

ISMAIL KADARE

BLIC

17. 1994
24



ENDERR
MASHTRUESE

Tregime dhe novela

8SH-32
K 14

Ismail Kadare

Redaktor
KOSMIR MUSTAFAJ

Editor
AMRIM QEMAJ

ENDRRA MASHTRUESE

Tregime e novela



Recensurues
Kosmir Mustaj
Shtetësi

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KOHA E DASHURISË

I

Ne vendosëm «t'i futnim duart» Violës, në mbrëmjen e së premtes, fill pas kthimit nga kinemaja. Nga gjithë koha e mundshme e qëndrimit me të, ajo ishte më e përshatshme për një gjë të tillë. Në atë orë rrugica ishte bosh dhe gjysmë e errët, llambat nuk arrinin të ndriçonin dot gjithë gjatësinë e saj, e sidomos pjesën midis urës së vogël dhe portës së shtëpisë ku ajo banonte, pikërisht vendin që ne e kishim zgjedhur njëzëri për punën që mendonim.

Nuk kishte qenë e lehtë dhe e menjëhershme për ne të merrnim një vendim të tillë. Kishim kaluar pasdite të turbullta, me siguri net pa gjumë, megjithëse nuk ia pohanim njëri-tjetrit, por ai, të cilit përpiqeshim t'i shmangehim, vendimi për t'i futur duart Violës, sa më shumë donim të largonim, aq më këmbëngulshëm afrohej, gjersa më në fund mori formën e diçkaje fatale. E kuptonim se s'kishim si të shpëtonim prej tij dhe më në fund iu nënshtruam: të premtën në orën shtatë të mbrëmjes, te rrugica.

Atë që e kishim menduar së pari si një kënaqësi, pas-

taj si kureshtje dhe së fundi si ankth, tani që ishte afruar e ndiemë se s'ishte e përbërë veçse prej këtij të fundit dhe se padurimi i ardhjes të së premtes nuk ishte gjë tjetër veçse padurimi për t'u çliruar prej ankthit.

Duhet thënë megjithatë se trazimi, që secili e shikonte në sytë dhe zërin e tjetrit (ishim dobësuar, kishim marrë nota të këqija në mësim), nuk e nxiti asnjërin të shfaqte mendimin për të hequr dorë. Ne e ndienim se çdo gjë mund të ndodhte, me përjashtim të kësaj. Siç ia pohuam njëri-tjetrit më vonë, e ndienim turbull se asgjë të mirë s'do të kishim prej saj, megjithatë, ndonëse e dinim këtë, për asnjë çast nuk na ligështoi pendimi. Do të shkonim drejt asaj që kishim vendosur edhe sikur ta dinim se po shkonim drejt humbjes, sepse më e hidhur se çdo gjë ishte tani kthimi pas. E kishim provuar një ndjesi të tillë kur ishim hedhur për herë të parë nga ura e lumit në ujë. nën nxitjen e zakonshme të atyre që e kishin kaluar atë provë, por kjo që na priste ishte shumë më e vështirë.

2

Viola kishte ardhur në lagjen tonë tre muaj më parë. Shkollën e vazhdonte në lagjen ku kishte qenë, dhe ku ende ndodhej familja e saj, që për arsye që s'diheshin e kishte dërguar të banonte te xhaxhai.

Ishte pesëmbëdhjetë vjeçe, gati moshatare me ne dhe qysh në krye na u duk e ndryshme nga vajzat e tjera. Na u duk kështu ndoshta ngaqë vinte nga një lagje tjetër, apo ishte vërtet e tillë, këtë nuk e kuptuam dot. Më shumë kishte mundësi që më parë të kishte qenë njëlloj si vajzat e tjera, por, ngaqë kishte ndërruar befaz mjedis, ishte bërë vërtet e ndryshme. Ndoshta edhe në lagjen e saj,

ku shkonte në shkollë, kështu u dukej tani: • ndryshme dhe, me siguri, ata që e vinin re këtë gjë arsyetonin pak a shumë si ne... është ndryshuar ngaqë banon në tjetër lagje apo... etj. etj.

Viola u fut më shpejt se ç'e prisnin në shoqërinë tonë. Gjer atëherë s'kishim pasur ndonjë shoqe dhe, pavarësisht se fshehtazi e dëshironim një gjë të tillë, nuk ia kishim thënë kurrë njëri-tjetrit, siç nuk tnuhen gjërat që ngjajnë tejet të paarrtshme. Kurse me të parë Violën na u duk papritur se kjo mund të bëhej. Ndoshta ishte prapë fakti që ajo ishte e ardhur, e huaj, që luajti rolin kryesor në afrimin tonë, po kjo s'kishte rëndësi. Gjithçka ndodhi shpejt, duke na dhënë neve të treve atë gëzim të veçantë, të provuar rrallëherë, kur realizohet e pamundura.

E ndienim përnjëherësh se një gjë themelore kishte ndryshuar në jetën tonë. Ishte vështirë ta përcaktoje çfarë, madje ishte vështirë ta shpjegoje se ç'kishte ndodhur në ditët që në pamjen e jashtme s'kishin pasur asnjë ndryshim. Si mund t'ia shpjegoja për shembull një të jashtëm se prekja e faqes së saj të ftohtë, me një aromë uji dhe ere, ajo prekje e rastësishme gjatë lojës sonë tek obcrrri i Ilirit, ishte për ne (siç ia pohuam njëri-tjetrit, shumë vite më vonë, atëherë kur ishim në gjendje të kuptonim shumë gjëra), një zbulesë nga ata që janë të një familjeje me mëngjesin përmbi planet, agimet boreale etj. etj.?

S'jetonim veç për ato çaste, veç për këtë, ashtu si për shumë gjëra të tjera, do të duhej burrërimi që të guxonim ta pohonim. Shkurt në jetën tonë hyri një element i ri, nga ato që shkaktojnë në libra fraza të tilla si «rrugica na u duk befaz më e gjerë», ose «rrugica e errët papritur mori dritë» etj. etj.

... tani: e ndryshme...
... këtu u duket tani: e ndryshme...
... këtu u duket tani: e ndryshme...

Violën ishte simpatike. Do nëve na u duk edhe më shumë e vëllë kur shkuan së pari me të në kinema. Luhej Capajev. Ne ndiemë befasi atë që mund të quhej peshë e shfaqjes me një femër në një vend publik. Ishte e rëndë, gati e papërbalutshme. Ishim përzier në të hareja, krenari, hedra, shqetësimi, xhelozia, gatishmëria për sherr. Ato ishin të shpërndarë kudo, duke nisur nga flokët e saj të çelët, që dukëj se na jepnin gjysirën e krenarisë së hare-simeve gjë të gjoksit, që i spikaste nën bluzë dhe që kushedi opsionidhej me shqetësimin tonë të turbullt, rrjedhimisht me ngushtet që qysh më parë i mbanim gati për trahje.

... ndodhi asgjë e tillë, ngaqë e keqja ishte ruaj-tur për mësonë...
Pë nëserim, kur pordilnim me Ilirin nga shkolla. të këtu i rrugicës pamë dy çunat të klasës më lart që po pinin digarë bashkë me Vasonë. Dy javët e fundit, Vasoja ishte bërë idoli i gjithë djemve të shkollës. Ishte kthyer nga Ti-rana, ku vazhdon të shkollën teknike, e kishte kthyer emrin nga Vasò në Vaskò, kishte veshur një xhaketë me katrorë dhe, megjithëse ishte veçse dy vjet më i madh se ne, tregonte historiat e mahnitshme dashurie. Ne, ashtu si të tjerët, endëronim të gjithëshin me të. Në kinema, hihihitil në kinema, hihihitil në kinema. — Ju pamë mbrëmë Ne nuk dinim çfarë thoshim Vasojadna vështronte mos-përfillës.

— Ishit me atë, Violën, apo jo? Pse hiqeni sikur s'ishit ju?

— Ishim, — u përgjigj Iliri. — E çë pastaj? Tjetri ngriti supet.

— Asgjë, — tha. — Veç desha të dija a ia futët duart.

Ne vështruam njëri-tjetrin, pastaj Vason, që vazhdon-te të thithte cigaren me mendjen gjetkë, pastaj njeriun që në rrethana të tjera duhej t'ia kishim bërë hundën copë. Mirëpo ne, jo vetëm që nuk e bëmë këtë, jo vetëm që nuk u larguam prej tyre, po qëndruam në vend, dhe, vërtet e pabesueshme, pranua bisedën për futjen e duarve.

Nuk u përpoqëm asnjëherë më vonë të bisedonim për atë mesditë të turbullt, po me siguri secili në vetvete kishte gjetur si shkak kryesor Vason.

Rrinte pak mënjanë, me cigare në gojë, gati i paarritshëm. (A s'ishte kjo e vetmja bisedë që mund ta afronte?). dhe ne, pa e vrarë mendjen në gjatë, mendjelehtësisht, mizorisht ishim gati ta hidhnim në këmbët e të gjithëve Violën, mjaftonte që ai të na fliste.

— Vajzës i duhen futur duart, ndryshe të quan lolo, — tha çuni tjetër, ai që gjer atëherë s'kishte folur. — Apo jo, Vaso?

— Çfarë? — pyeti Vasoja, pa e hequr cigaren nga goja.

Ata ia përsëritën për se ishte fjala dhe Vasoja varri buzën e poshtme si të dëgjonte të flitej për një gjë tejet të mërziqshme. Po kjo bezdisje e tij ne nuk na fyu aspak. Si të mpirë prisnim fjalën e tij prej arbitri të pakundërshtueshëm.

— Ashtu është, — tha, duke pështyrë cigaren.

Çunat qeshën. E patë, o tyryfya, thoshin sytë e tij. Pastaj njëri prej tyre tha se me siguri ne trembestim se pas kësaj ajo do të largohej. Ah, sa të marrë që ishim.

— Pas kësaj vajza të vjen prapa vetë, si manarë, — tha Vasoja, dhe gogësiu, ngaqë ishte i detyruar të na shpjegonte gjëra që i dinte dhe bufi. Ai ndezi një cigare tjetër, na zgjati edhe neve. — Një herë në Tiranë...

Neve gati sa s'na u pre frymemarrja: Vasoja po fliste... Vasoja denjonte të na rrëfente një nga historitë e tij

të dashurisë. Do të besonim se do të hapte gojën statuja e Çerçiz Topullit, por jo enigmatiku Vaso.

Kur u ndamë prej tyre ishim si të trullësuar. Copëra të historirave të Vasos (kishte në to letra dashurie me fjalët sikur qielli të ishte letër dhe deti të ishte bojë, dashurinë që kam për ty, zemra kurrë s'do ta tregojë, të qara dashnoresh, përgatitje helmi për vetëvrasje, të bren-dshme të mëndafshta bojë qielli etj., etj.), pra historitë e tij përziheshin me gëzimin që ishin njohur me të, por edhe me një hidhësi të hajthme, që s'guxonte të shfaqej haptas, po që ishte përherë aty. Hidhësia që atë njohje e kishim fituar duke dhënë si këmbim Violën.

4

— Ç'keni kështu? — na tha ajo ditën tjetër, kur u takuam.

Me sa dukej nuk ishim në gjendje ta fshihnim dritën e parë të pabesë në sytë tanë.

Kështu filloi ajo periudhë e paharrueshme, gjatë së cilës u mësua dalëngadalë me të keqen. Ashtu si një organizëm nën veprimin e mikrobit të sëmundjes, ne ndienim çdo ditë ndryshimin që ndodhte brenda nesh. Ai ndryshim shfaqej në njëfarë mënyre në marrëdhëniet tona me Violën. Sjelljet tona me të ishin tani të befasishme, pa drejtpeshim, të ndryshueshme brenda disa sekondash. Dhe kjo ishte e kuptueshme, përderisa provonim ndjenjat më kundërthënëse për të: mëshirën, trishtimin që diçka do të shembej, përbuzjen, nënvleftësimin që të shkakton viktima e përdhosur, frikën prej saj, keqardhjen, së fundi tërbimin që ajo ishte bërë shkak për gjithë këtë trazim. Ajo na përfitohej herë e mjerë, herë krenare, herë e mposhtur e herë mposhtëse.

— Në qoftë se do të vazhdojë edhe pak, do ta kuptojë, — tha një ditë Mama Belgjika, (kështu e thërritnim për shkak të një historie të vjetër shokun tonë të tretë).

Në të vërtetë Viola disa herë na kishte thënë: «ju se ç'keni», dhe sytë e saj të çelët, që bëheshin edhe më të bukur kur hetonin diçka, na vështronin me radhë.

Edhe Iliri ishte i një mendjeje. Duhej t'i jepnim fund sa më parë kësaj... (megjithëse ai nuk shqiptoi ndonjë fjalë tjetër, ne e morëm me mend se mendoj fjalën «torturë»). Pra duhej t'i jepnim fund sa më parë kësaj torture, ndryshe do të çmendeshim.

Dhe kështu vendosëm përfundimisht: të premtën, pas seancës së dytë të kinemasë, te rrugica.

Ishim duke i thënë «natën e mirë» njëri-tjetrit, kur Mama Belgjika, duke u skuqur, tha:

— Pa dalë njëherë... të them të drejtën, unë...

— Çfarë? — i tha Iliri me ftohtësi.

Mama Belgjika u mbllaçit.

— Unë, të them të drejtën nuk e di si futen duart.

As unë, as Iliri s'dinim ku t'i çnim sytë. Të thoshim se as ne nuk dinim, ishte njëlloj si të ngrije flamurin e disfatës. Të pohonim të kundërtën, kjo do të ishte gënjeshtër me bisht.

— Ama dhe ti, Mama, bën ca pyetje që të çmend, — tha Iliri.

Një copë herë s'folëm të tre.

— Të kishim pyetur së paku Vasën, — tha Mama Belgjika me një zë prej fajtori.

— S'është e nevojshme, — thashë unë, — Do të qeshë me ne.

— S'është edhe ndonjë gjë për ta vrarë shumë mendjen, — tha Iliri. — Gjë e thjeshtë duhet të jetë. Vetë fjala e tregon: domethënë t'i futësh duart nën fustan... Ja kjo është e gjitha, ç'ka këtu për të vënë kujën?

— Unë s'yura kujën, — tha Mama Belgjika, — Unë
vetëm pyeta,

Para portës së shtëpisë së Ilirit i thamë njëri-tjetrit
«natën e mirë», duke qenë të sigurt se do të kalonim një
nga netët, më të këqija të jetës sonë.

5

Asnjëherë ajo që po ndodhte në ekranin e kinemasë
nuk më qe dukur aq e pakuptimtë. E njëjta gjë ndodhte
me siguri edhe me shokët e mi, sepse aty nga mesi i filmit
Mama Belgjika pyeti:

— C'është ky, nga doli?

Viola qeshi mbyturazi.

— Si nga doli? — tha me zë të ulët. — Po ky është

heroi kryesor. Gjithë filmi gjer tani është për të.

Aha.

I rashë në berrtyrë Mama Belgjikës në mënyrë qor-
tuese, megjithëse atë që na qenkësh heroi kryesor mua
gjithashtu më dukej të përshtatshëm për herë të parë.

Nga lëvizja e supeve të Violës kuptohej që ajo qeshi
me vete edhe disa sekonda.

Një ndriçim i herëpashershëm, që vinte nga ekrani,
kalonte butësisht, si një aureolë blu mbi flokët e saj. Me
ai ndriçim i përkohshëm blu kishte diçka të padurueshme,
një ftohtësi sublime të largët, dhe të pamëshirshme.

Nganjëherë ndriçimi kapte edhe mollëzat, në kërci-
min e butë të të cilave shkarkohej lehtëazi një si buzëqe-
shje që ikte edhe ajo larg.

Nuk e dija se ç'mendonin në ato caste shokët e mi,
po kjo s'qe e vështirë të merrej me mend. Ngazë i kishin

të dy flokët e errët (lliri si gjemba, kurse Mama Belgjika të krehur me kujdes), apo ndoshta ngaqë tani e dija si qubeshin mendimet që bluajnë njerëzit në raste të tilla, kokat e tyre më dukeshin fare të zeza.

Një ndërprerje katastrofike, rënie zjarri apo tërmeti do të na tromakste më pak se zbardhja e papritur e ekranit, që tregonite se filmi më në fund kishte mbaruar. Kaq e vërtetë ishte kjo, sa Iliri pyeti:

— Ç'është?

— Mbaroi filmi, — tha Viola dhe u mat të qeshte me hutimin e tij, por, kur vuri re në fytyrat tona të njëjtët mpirje, ngriti supet.

— Po ju? Mos nuk ju pëlqeu filmi?

Desha të pyesja: cili film?, por e përmbajta veten. Sigurisht e kishte fjalën te filmi që porsa pamë.

Shtytja drejt daljes na e lehtësoi disi çastin e vështirë. Sidomos zhurmëria, komentet dhe fërshëllimat me të cilat çunat kërkonin njëri-tjetrin. Mirëpo pas daljes nga salla, e sidomos në rrugë, turma shpëtimtare sa vinte shpërbëhej e rrallohej. Bashkë me të largoheshin zërat e saj, fjalët, të qeshurat dhe fërshëllimat e çunave, që s'na ishin dukur kurrë aq të nevojshme.

Mbetëm më në fund pothuajse vetëm, aq sa nisën të na dëgjoheshin hapat. Ca kalimtarë, që ndoshta s'ishin më të kinemasë, dy vitrina të ndriçuara, dyqanet me një njeri që vështronte ngeshëm përpara tyre, një grup i vogël njerëzish, po tepër larg, s'përbënin më asnjë shpresë për të mbushur boshin e krijuar mes nesh.

Viola e kishte vënë re më në fund heshtimin tonë dhe, nga mënyra si ecte, ndihej menjëherë që ishte e fyer. Ndoshta i qe dukur se ishim penduar që kishim shkuar së bashku në kinema, apo ndoshta ajo që neve na dukej si fyerje e saj, s'ishte veçse ndjesia e turbullt se diçka e keqe po përgatitej.

Rruga sa vinte shkurtëhej, shumica e vitrinave ishin

të errëta dhe e vetmja gjë që do të doja në atë çast ishte që të ndodhte një mrekulli dhe rrugica jonë pa njerëz e pa dritë të mbushej papritur me to Por e dija se kjo s'do të ndodhte kurrë, ashtu siç e dija se rruga jonë për në shtëpi kalonte përmes saj dhe këtë s'mund ta ndryshonte dot asgjë.

Ja më në fund, i errët, i heshtur, si gojë e ferrit, u duk kreu i rrugicës. Pas tij fillonte ajo vetë dhe diku midis saj, atje ku as vetë nuk e dinim, kishte ngrirë një pjesë e ditës së premtë, me vendimin tonë midis

6

Në mëngjes u zgjova me kokën plumb. S'e kisha menduar se mund të më zinte gjumi, por ai jo vetëm më kishte zënë, po më kishte zhytur më thellë se zakonisht, Kishte qenë një gjumë i rëndë, nga ato që në mënyrë të dukshme e ndajnë ditën e djeshme nga mëngjesi ku je zgjuar.

Një copë herë të gjatë ndenja në shtrat i palëvizur, krejt i trullosur. I mbylla sytë përsëri, si të doja që, duke fjetur edhe ca, ta trashja edhe më tepër atë mur ndarës opak, por, ndërsa po tërhiqja kuvertën për të mbuluar një pjesë të fytyrës, dallova gërvishtjen në dorën e djathtë. E kuptova në çast se ishte e kotë të bëja hilerë dhe se nga kujtimi i mbrëmjes të së premtës nuk do të shpëtoja aq lehtë. E skuqur vende-vende, e hollë, e lakuar, gërvishtja më dha papritur një djegie bezdisëse. Ishin me siguri thonjtë e Mama Belgjikës, që ma kishin shkaktuar, në çastin kur duart tona u ngatërruan me njëra-tjetrën nën fustanin e saj.

Ngjarja kishte vazhduar vetëm disa sekonda, po për

ta rikujtuar kishte nevojë për një kohë shumë më të madhe: Ishte si e sfungjertë, poroze, mezi futej në mendim. Pjesë të saj ishin të shurdhëta, boshe, ose dukej kështu ngaqë në ato çaste ne vetë ishim të errët dhe bosh.

Gjithçka ndodhi përpara portës së Pavli Urës. S'e kishim caktuar vendin, megjithatë s'di si u morëm vesh, verbtazi. Mbajtëm hapat, kthyem kokën nga njëri-tjetri dhe, para se ajo të pyeste se përse e ngadalësuam ecjen, zgjatëm duart drejt saj.

— Ej, ç'bëni kështu, budallenj, — tha ajo, po fjalët e saj në vend që të na pengonin bënë të kundërtën. Duart tona, të çliruara nga një ngecje e fundit, në një vrundull të shkurtër, kokëshkretë e pa mendim, iu sulën fustanit të saj, diku në lartësinë e gjunjëve, ia ngritën atë duke kërkuar ngutshëm këmbët e saj, që në prekjen e beftë m'u dukën të lëmuara si akulli.

— Ej, të çmendur, — thirri ajo, duke u përpjekur me njëren dorë të na shtynte e me tjetrën të ulte fustanin, nën të cilin duart tona, nën ngutjen e tyre të marrë, qenë ndeshur e gërvishtur më shumë me njëra-tjetrën se me trupin e saj.

U shkëput shumë shpejt dhe në krye u duk se do të rendte për të shpëtuar, por pas pak i mbajti këmbët dhe eci me hap normal, sikur ta kuptonte se ne mund të ndërmerrnim çdo gjë tjetër, por jo ndjekjen e saj.

Dhe vërtet, jo vetëm që s'na shkoi ndër mend një gjë e tillë, po nisëm të ecnim me hapa të lehtë, si të donim të mos ndiheshim më, ndërsa hapat e saj sa vinte bëheshin më të dëgjueshëm, me një ritëm të prerë, të huaj, të panjohur (ritmi i parë i gruas, më kishte thënë vite më vonë Mama Belgjika). Dhe pavarësisht se shpina ia jepte krejt dënësën e saj, trokitja e atyre hapave ishte qysh tani sunduese dhe shtypëse. Dhe e tillë, e pamëshirshme, e pafalshme ishte trokitja e dorezës së hekurt të portës së saj.

ndryshme. Violës i doli e drejta e studimit për arkitekturë, Iliri hyri në shkollën e aviacionit, kurse unë dhe Mama Belgjika shkuaam për studime jashtë shtetit.

Një mbrëmje, në qytetin e huaj ku studioja, po shoqëroja një vajzë për në shtëpi. Ishte takimi ynë i parë; kishim qenë në kinema, gjithë gëzimet i kishim përpara. Binte një dëborë e bukur dhe, ndërsa ecnim gëzueshëm nën të, më vinin ndër mend fjalët e një shoku të kursit se nga të gjitha elementet e planetit tokësor dëborë është ndoshta më e përshtatshme për të dhënë lumturinë.

Te hyrja e ndërtesës ku banonte qëndruam ca çaste për të vështruar edhe një herë rënien e kristaleve. Dhe vërtet s'kishim pse të nguteshim. Fërqafimi ynë i parë ishte ndërkaq midis tyre, dukej se zbriste që nga qielli, i sigurt, rrëzëllues. Ishte vërtet një mrekulli ajo pamje dhe ajo parandjenjë lumturie. Veç nuk e kuptoja, përse duart, në vend që t'i nxirrja nga xhepat, për të bërë lëvizjen e zakonshme drejt supëve të saj, atë lëvizje të njohur, pas së cilës supet e vajzës bënin një zhvendosje të lehtë dhe të njëjtën zhvendosje harmonike bënte koka, përpara së puthurës, pra, në vend që të nxirrja duart, e gjeta veten duke i rrasur ato thellë e më thellë, si të doja të shqyeja xhepat.


— E pra? — tha vajza pak e hutuar. — U bë vonë.

Disa sekonda u vështruam në sy dhe ajo buzëqeshi së brendshmi, me një flokëz bore që i ra në mollëz, por unë jo vetëm që nuk i nxora duart, po me një ton fare të ndryshëm nga ai që kisha folur gjer atëherë, të shurdhër, të keq, që ishte midis urdhrit dhe kërkimit të ndihmës, i thashë:

— Përqafo më!

Ajo lëvizi pak kokën si të më hetonte më mirë. Merrrej me mend që në sytë e saj bashkë me habinë kishte zemërim dhe frikë.

— Pa shiko... çfarë mendjemadhi, — tha pas pak, po



me një zë pa energji. Kuptohej që më shumë se e fyer ishte e befasuar.

Unë vetë nuk dija se ç'po ndodhte dhe përse. Ajo buzëqeshi në një përpjekje të fundit për të normalizuar gjërat (siç ma pohoi më vonë, frika nuk e linte të zemërohej plotësisht), por unë, në vend që të bëja të njëjtën gjë, përsërita mbyturazi.

— Përqafo më!

Atëherë ajo u kthye të ikte me vrulli por, pas disa hapash ngaqë unë nuk i thirra «Ana!» (siç ndodhte në të gjithë filmat dhe fantazimet njerëzore kur përfytyrohen grindje të mundshme), qëndroi në vend dhe bëri diçka që mendonte se s'do ta bënte kurrë: u kthye me hapa të ngadalshëm, (kureshtja fitoi mbi frikën, më tha më pas), dhe më vështroi gjatë, me të njëjtën mënyrë hetuese.

— E pra, meqë ngulke këmbë, po të përqafoj, — tha me zë të ulët dhe me një gjest të lehtë, pakëz teatral, më hodhi një rën dorë rreth qafës dhe më puthi lehtë te cepi i buzëve. Faqja e saj ishte e ftohtë, e lëmueshme si akulli dhe po ashtu m'u dukën buzët e saj.

Nuk e kuptoja ende ç'po ndodhte, vetëm se nga rrasja e duarve në xhepa e ndjeva se diçka më e fortë se vullneti im vazhdonte të më mbante të ngurtësuar.

Me një lëvizje të plogët, ajo e hoqi krahun nga qafa ime dhe, megjithëse hapat e ikjes së saj ishin energjikë, ndihej se ajo vetë ishte e molisur. (Nuk e mendoja kurrë se, pas asaj që bëra unë, ti do të vazhdoje të rrije ashtu. Isha e sigurt për të kundërtën, d.m.th. përqafoj i vrullshëm etj. etj. Po ti vazhdove të rrije me duar në xhepa dhe unë mendova: ky njeri ka diçka.)

Unë nuk e dija ç'kisha. Vetëm pas njëfarë kohe, ndërsa kthehesha në rrugën e shkretuar, m'u kujtua befas Viola. Atë natë dhe më vonë, kur e kisha vrarë mendjen për ngjarjen pakëz të çuditshme nën dëborë, nuk gjeja dot asnjë lidhje midis saj dhe historisë së Violës, përveç faktit

që Viola më ishte kujtuar befas (dhe për herë të parë pas shumë vitesh), fill pas përcjelljes së Anës.

Mungesa e pendimit, ndjesia lehtësuese se diçka ishte kryer më në fund, së fundi gjumi i rëndë plumb që bëra me t'u kthyer në dhomën time (mungonte vetëm shenja e gërvishtjes në dorë në mëngjesin e zgjimit), ishin ngjashmëri të tjera që vërtetonin se kishte një lidhje midis të dyja ngjarjeve, po kryesorja, shkak i vërtetë mbetëj i errët.

Dhe vërtet, në ç'rrugë të tërthorta mund të komunikonin vallë të dyja ngjarjet dhe në qoftë se komunikonin ç'që kështu ky rizgjim i papritur? Vallë ndërgjegjja ime kërkonte të çlirohej nga një peshë duke më diktuar një gjest që ishte midis ndëshkimit të vetvetes, revanshit dhe tregimeve moralizuese? (Demek: ti ke bërë dikur një faj ndaj dikujt, laje tani atë faj me një veprim të kundërt ose provoje vetë se ç'është dhuna, ose...) Ishte e qartë se këto arsyttime, përveç që ishin naive, s'kishin logjikë. Gjesti im s'ishte aspak i kundërt me atë që kishte ndodhur te rrugica e qytetit të vogël. Veç kësaj, ç'dhunë mund të quhej përqaqimi, qoftë edhe i shtyrë nga kureshtja ose frika e Anës? (Në të vërtetë kishte shije të mrekullueshme ajo përkëdhelje e kursyer, hezituese e vajzës, e cila ishte ende e panjohur për ty). Sa për ndjesinë e pendimit të vonuar, megjithëse dihej se pendimi kishte oraret e veta të paparashikueshme, kishte kaluar megjithatë shumë kohë që ai të shpërthente kështu befas, dhe aq më tepër në një vend të huaj, mijëra kilometra larg. Ishte vërtet e pabesueshme, aq më tepër që kjo s'ishte aspak e para vajzë në jetën time.

Kështu mendoja, megjithatë, fakti që në çastin e rëndë pas përcjelljes Viola më erdhi ndër mend dhe jo rrëshqitazi, por rendshëm, me këmbëngulje plagosëse, i vinte në dyshim arsyetimet e mësipërme. Kishte pa dyshim një lidhje midis tyre dhe, ndonëse ajo mund të ishte jashtë skemave të zakonshme të të menduarit, (pendim, larje e

fajit, një mësim morali), ndihej që ishte e fuqishme. Nga njëherë më dukej se fuqia e saj qëndronte pikërisht në trajektoren e tërthortë me anën e së cilës mbërrinte gjer tek unë. Ishte si një ndriçim i marrë pasqyrash të thyera, të pluhurosura, që, të vendosura në një mënyrë të çrregullt, të shqetësonin më shumë se të pastrat e të rregulltat.

I kishim shkaktuar vërtetë ndonjë traumë asaj vajze atje te rrugica, apo dëmin e kishim pësuar ne vetë, dhe ajo, pasi kishte vuajtur e qarë në fillim (atëherë kur ne e bënim gjumin plumb), ishte çliruar përgjithmonë prej kujtimit të hidhur? Apo, ishte e kundërta, kishte marrë një krismë të pariparueshme dhe turbullira nervore e saj rrezatonte kaq larg?

Kaq larg... Po të tjerët e ndienin vallë? Mama Belgjika ndodhej larg, si unë, kurse Iliri, që ndodhej në Shqipëri...

Ndjesia e fajit që nuk isha kujtuar t'i shkruaja në letër më pushtoi papritur. Doja t'ia mbushja mendjen vetes se letrën do t'ia shkruaja gjithsesi edhe pa qenë mëdis Viola, ndonëse e ndieja se kjo nuk ishte e vërtetë.

Një sy i stërvitur psikologu do ta dallonte lehtë në letrën time këtë lojë kukafshehthi me vetveten. I shkruaja diçka për qytetin ku studioja, për dinrin, vajzat, po ndihej menjëherë padurimi për të ardhur te rrugica e errët, në mbrëmjen e së premtes, fill pas daljes nga kinemaja.

Më dukej se letër më të vështirë s'kisha shkruar ndonjëherë. Lidhja me rrugicën më dilte e panatyrshme. Gusa disa fletë, gjersa arrita ta bëja njëfarësoj. Më merr malli për qytetin tonë, i shkruaja. Të kujtohen marrëzitë që kemi bërë, romanin që shkruam bashkë dhe që e ndamë përgjysmë kur u grindëm? Eh, ç'kujtime... Këtu rrugët janë të gjera, me drita dhe me shumë makina, po mua më vjen shpesh ndër mend rrugica jonë e shtrembër, e errët. Të kujtohet ç'marrëzira kemi bërë edhe atje? Të kujtohet Viola, kur një mbrëmje, fill pas kinemasë... Meqë ra fja-

! Ia, ç'bëhet vallë ajo? Tani duhet të jetë ashtu si edhe ne, në vitin e dytë të fakultetit. E ke takuar ndonjëherë?

Këtu ishte vendi për të shkruar përsiatjet e mia për atë që kishte ndodhur. Gjykimet uga larg të ngjarjes etj. etj., por e ndjeva që kjo ishte fare e pavend. Në një letër të dytë, në qoftë se Iliri do të ma përmendte Violën, mund t'u kthehesha zhbirimeve psikike, po tani ishte herët.

Po ti si ai çon? i shkruaja në fund. Gjithmonë qiellor, gjithmonë mbi re? (Prapë ishte vendi t'i shkruaja se si e gjykonte atë ngjarjen e atëhershme nga lartësia qiellore etj. etj., po me vete thashë: Ka kohë, në letrën tjetër). Në vend të saj, në mënyrë gazmore e pyesja për jetën e tij prej aviatori të ardhshëm. Si shkon me studime, në ç'avionë hipën?

E postova letrën dhe me mendje po llogaritja sa kohë do t'i duhej që të mbërrinte përgjigjja e tij.

Ajo erdhi më në fund në formën më të papritur për mua. E shkruar jo nga ai vetë, po nga nëna e tij. Sepse Iliri nuk mund të shkruante më. Se ai nuk kishte më dorë për të shkruar. Se ai s'kishte më as dorë, as trup e as shpirt. Këto fjalë pak a shumë më shkruante nëna e tij. Ishte vrarë para tri javësh gjatë stërvitjes dhe mbeturinat e trupit të tij ishin të varrosura në varrezën numër dy të kryeqytetit.

S'e mendoja se mund të ekzistonin në botë letra kaq të trishtuara. Me ç'postë vinin ato, ç'avionë i sillnin?

Në ç'avionë hipën? i kisha shkruar Ilirit. Në pyestë në ç'kalë hipi, në atë që hipën meiti

E kisha ulur ballin mbi syprinën e tryezës, ndërsa zëri i profesorit më vinte i largët nga katedra. Mendime, llogari të zymta më kërlësheshin në kokë. Kishte tri javë që kishte ndodhur. Pra afërsisht në kohën që unë isha njo-hur me Anën... Iliri s'kishte më as duar, as trup, asgjë... Ç'do të thotë «të futësh duart»... T'u thaftë dora, mallkonin plakat në qytetin tonë kur bëje me to diçka të keqe...

Dhe kjo kishte ndodhur tri javë më parë... Nuk doja ta bëja llogarinë e ditëve, por ajo bëhej vetvetiu... Pra kishte ndodhur tri javë më parë dhe jo afërsisht, por pikërisht në ditën që unë shkova në kinema me Anën.

E çë pastaj, i thashë vetes. Ç'del nga kjo? Asgjë, përgjigjesha. Asgjë dhe asgjë.

Dhe sa më shumë që përpiqesha ta shmangia këtë fjalë, aq më tepër e mendoja. Asgjë... asgjë... si Iliri.

8

Kjo histori u harrua më pas përfundimisht. Balta mbi varrin e Ilirit, ajo ndërprerje e rëndë opake, e kishte larguar edhe më tepër atë. Isha kthyer nga studimet nga jashtë shtetit. Mama Belgjika gjithashtu, po jo prej tij, po fare rastësisht, gjatë një pasdarkeje, kur u fol për fatin e mëtejshëm të ish-shokëve të shkollës, mora vesh se Viola, pas mbarimit të studimeve, qe emëruar në qytetin N, ku punonte si arkitekte pranë komitetit ekzekutiv.

Kaq. Dhe ndoshta asnjëherë s'do të më binte rasti të dëgjoja diçka për të, sikur një ditë, dikush, që nga zëri m'u duk i njohur, të mos më kërkonte në telefon.

Njeriu më tha emrin, por ai, në kundërshtim me zërin, më tingëlloi i panjohur.

— Kush? — përsërita.

Që nga ana tjetër e telefonit erdhi e qeshura e bashkëbiseduesit, edhe më e njohur se zëri.

— Mama Belgjika, — tha ai.

— Ah, po ç'dreqin ke që më flet me atë emrin tjetër?

— Ç't'i bësh. Tani të gjithë më thërresin me të: natyrisht veç teje.

— A, po.

— Dëgjo, — tha ai dhe zëri iu bë i shqetësuar, si i njeriut që ka një hall. — Desha të të takoja pak.

— Kur të duash.

U takuam po atë pasdite, në një kafe të vogël pranë qendrës. Ishte veshur me sqimë dhe pardësyja e këmisha i dukeshin edhe më elegante për shkak të bardhësisë së fytyrës. Ishte një bardhësi e veçantë, nga ato që krijohen prej mirëqenies ose prej qëndrimit jashtë shtetit. sidomos në vendet e Evropës Qendrore. Megjithatë, kundër dëshirës sime, m'u kujtuan pëshpërimat që kisha dëgjuar për të lidhur me sjelljen e tij morale. Nuk më pëlqente t'i besoja dhe mendoja se ishte natyra e tij e butë, pakëz femërore, si edhe fakti që nuk kishte lidhje me asnjë grua, që ishin bërë shkas për to.

— Po ç'kemi, Mama. si i ke punët?

Ai buzëqeshi.

— Mirë, shumë mirë.

Shumë shpejt ne ramë në rutinën e gjithë shokëve të fëmijnisë që takohen pas shumë kohësh: «të kujtohet kjo?» «të kujtohet ajo?», gjersa befas. me zë të ftohtë, ai pyeti:

— Të kujtohet Viola?

Më shumë se fjalëve të shokut të porsatakuar ajo i ngjante pyetjes së një hetuesi.

Unë nxora paketën e cigareve dhe ia zgjata, por ai, si edhe më parë, nuk pinte.

— Natyrisht, — iu përgjigja. Desha t'i thosha: po ti si u kujtove pas kaq kohësh? Ne edhe atëherë, pas asaj që ndodhi, në bazë të një marrëveshjeje të heshtur, nuk e përmendëm më. Kurse tani, aq më tepër që Iliri prej vitesh...

E ndieja që ai do të jepte vetë një shpjegim. ndaj nuk u nguta t'i thosha asgjë. Dhe ashtu ndodhi vërtot.

— Ty mbase të duket e habitshme që unë e përmenda Violën... por unë... dhe ajo...

Ah, ç'më polli, thashë me vete, duke e ndier në çast

gjithë gjendjen e vështirë në të cilën do të ndodhesha pas pak. Sepse, nga mënyra se si ai e nisi bisedën, isha i sigurt se do ta vazhdonte duke më thënë se, pavarësisht nga çikishte ndodhur, ai kishte vendosur ta lidhte fatin e tij me të, se ata të dy... etj. etj.

Idiot, desha të thërritja, shumë mirë që po e lidh fatin tënd me të, aq më tepër që t'u mbyllësh gojën edhe atyre thashethemeve të mallkuara, shumë mirë që je dashuruar, që do të fejojesh, do të martohesh me të, po pse vjen e ma thua mua, dhe me një mënyrë kaq dramatike, thua se unë kam qenë dashnori apo burri i saj? Idiot e shkuar idiotit. Si mund ta marrësh seriozisht një kalamallëk të dikurshëm, apo fanatizmi t'i ka verbuar sytë gjer në atë shkallë, sa që vetë ideja se e kemi lakmuar bashkërisht atë vajzë të lë pa gjumë? Ah, të rruaçin studimet në Pragë dhe pardësyja e këmisha elegante.

— Pse u vrenjte? — tha ai. — Unë s'të kam thënë ende asgjë.

— Më duket se u vrenjte ti, — iu përgjigja me toi të akullt. — Unë, sa për të tjerat, në do që të dish, unë as që kam dëshirë të të dëgjoj.

Ai shqeu sytë nga habia.

— Unë s'po të marr vesh...

— Jam unë që s'po të marr vesh ty, — i thashë. — Në qoftë se ke vendosur të lidhesh me të, përse duhet të më pyesësh mua? E kupton se sa pa vend dhe meskine është kjo?

— Zot i madh. Kush tha se dua të lidhem me të? As që më ka shkuar ndër mend një gjë e tillë.

— Ashtu? Atëherë ç'dreqin ke që e përmend? Kujtova se më thirre për të më folur për të.

Isha gati t'i kërkoja ndjesë e t'ia plasja gazit për keqkuptimin, kur ai më tha:

— Në të vërtetë të kam thirrur për shkak të saj. Ne jemi bashkë në një komision.

Disa çaste ende biseda jonë u ngjau të dy persona-zheve të teatrit absurd, gjersa më në fund arritëm të kup-toheshim. Dhe ja si qëndronte puna: Viola dhe Mama Belgjika bënë pjesë të dy në një komision kombëtar për ristosistimin e qytetit tonë të fëmijnisë. Si për çdo qytet të vjetër, kishte mjaft diskutime se ç'duhej ruajtur e ç'duhej flijuar për hir të kushteve të reja të jetesës. Po Mama Belgjika s'e kishte hallin të diskutimet në përgjithësi. Ajo për të cilën ai kishte mbetur kaq net pa gjumë dhe që ishte bërë shkak të më telefononte kishte lidhje vetëm me një hollësi të polemikës, atë që lidhej pikërisht me rrugicën ku... atëherë... të kujtohet... të premtën... fill pas daljes nga kinemaja...

Për prishjen ose jo të kësaj rrugice i ishin kundërvënë njëri-tjetrit, me një ngulm që e kapërcente pasionin profesional, Viola dhe Mama Belgjika. Mamaja ishte vendosmërisht për prishjen e rrugicës, po aq sa ishte për ruajtjen e saj Viola.

— Nuk është puna për hir të atij... kujtimi të hidhur... po nga urbanistika, nga pikëpamja arkitekturnale është krejtësisht e domosdoshme...

Ai i përsëriti disa herë fjalët urbanistike, arkitekturnale e të tjera terma teknikë, por sa më shumë që i përmendte ata, aq më tepër ndihej se shkaku i vërtetë për këmbënguljen e tij, ashtu si edhe për këmbënguljen e Violës, ishte e kundërta dhe pikërisht ai kujtim i hidhur.

Ai kishte gënjyer veten dhe kujtonte se do të më gënjente edhe mua duke folur me pasion, me aq pasion, thua se nga e vërteta e asaj që thoshte, nga prishja ose jo e asaj rrugice, varej edhe jeta e tij.

Kishte pritur me siguri që unë t'i thosha: të besoj, natyrisht, ke të drejtë, etj. etj., po ngaqë unë heshta ai papritur u lodh, mbylli sytë përgjysmë dhe foli me një ton krejt tjetër.

E pranoi se ajo rrugicë, domethënë ajo mbrëmje e

së premtës pas seancës së kinemasë, kishte luajtur një rol në jetën e tij, se ndoshta edhe ajo që pëshpëritej për moralin e tij kishte lidhje me të (më bëri përshtypje se as e pranoi, as e kundërshtoi pëshpërimën), se shumë gjëra që i ndodhën më vonë në jetë e kishin ndoshta burimin tek ajo rrugicë, ajo mbrëmje...

Ishte e mundimshme për mua të dëgjoja, dhe, kur më bëri pyetjen: po në jetën tënde, a s'ka ndikuar sadopak, ngaqë doja që kjo bisedë të mbyllej, iu përgjigja:

— S'e besoj.

I thashë këto fjalë pikërisht në kohën që me një qar-tësi të habitshme në mendjen time qe ringjallur mbrëmja me borë në qytetin e huaj, përcjellja e vajzës dhe ajo që kishte ndodhur te porta e saj, dhe që ishte përsëritur në njëfarë mënyre në dhjetëra forma e kushte të tjera, duke përcaktuar ndoshta një pjesë të asaj që quhet karakteri im.

Por unë nuk i thashë atij asgjë nga frika se mos edhe ai thellohej në rrëfimin e tij, që ndoshta do të më bren-goste.

Kështu qëndruam një kohë të gjatë pa folur, duke menduar ndoshta se ç'rol duhej të kishte luajtur ajo mbrëmje e së premtës pas kinemasë, në jetën e Violës, në jetën për të cilën ne s'ishim interesuar të dinim asgjë. Dhe ndoshta mendja e të dyve bënte ç'bënte e shkonte te rrugica, ose më saktë tek ideja se si ishte më mirë për ne: të she-mbej ajo apo jo, me fjalë të tjera e vdekur apo e gjallë jetonte, apo, më saktë, rëndonte ajo më shumë në ndër-gjegjen tonë.

— Unë do t'i shkruaj një letër Violës, — i thashë kur po ndaheshim dhe, pa i lënë kohë të më kërkonte shpjegime, u ndava me të.

9

Letrën ia shkrova vërtet Violës. po, pas tri javësh. Vonesa nuk u shkaktua aspak prej ndonjë mëdyshjeje nga ana ime, po thjesht se aq kohë m'u desh që të gjithë ngjarjen që kishte ndodhur te rrugica në mbrëmjen e së premtes, si edhe regëtimën e mëtejshme të saj në jetën tonë, ta shkruaj në formën e një tregimi.

Tregimi mbaronte me fjalët: «Unë do t'i shkruaj një letër Violës, i thashë kur po ndaheshim, dhe, pa i lënë kohë të më kërkonte shpjegime, u ndava me të.»

Dhe ja letra që i dërgova asaj:

«Viola, shoku ynë i përbashkët i dikurshëm Mama Belgjika (në kllapa ishte emri i tij), më tregoi për polemikën lidhur me rrugicën në qytetin e largët, ku nuk banon më asnjë prej nesh, po ku një karxhë e padukshme na ka lidhur e na tërheq herë pas here.

Unë nuk e di kush ka të drejtë nga ju të dy lidhur me shembjen ose jo të rrugicës. Në qoftë se ju mendoni se rrugica duhet të jetojë për të njëjtën arsye që mendoj edhe unë, po ju dërgoj këtë tregim, të cilin mendoj ta botoj, i bindur se kështu, edhe pas një shembjeje të mundshme, ajo do të jetë më e gjallë për ne si edhe për të tjerët.»

10

Pas disa ditësh më erdhi përgjigjija e Violës. Ajo ishte e shkurtër, e përbërë vetëm nga dy fjalë: «Faleminderit! Viola.»

Ishte një ditë me shi të ndërprerë. E mbaja letrën në

dorë dhe, si ai prizmi që në çdo lëkundje jep ndriçime të ndryshme, ajo «faleminderit» e saj më shfaqej në kuptimet më të larmishme. Ç'do të thoshte vallë me të, kishte vuanjtur vallë njëlloj si ne, ishte helmuar apo kthjelltësuar prej ngjarjes, ishte varfëruar apo përkryer moralisht? Ishte një «faleminderit» e mirëfilltë, apo me ironi? Ishte e kënaqur për autokritikën tonë të vonë, për revanshin e saj, apo thjesht e kishte gjetur atë fjalë kot sa për të dhënë një përgjigje, ndërsa me vete kishte thënë: Ohu, me ç'marrëzira e kanë rënduar kujtesën.

Sa më shumë që e mendoja, aq më e pamundur më dukej të gjeja kuptimin e vërtetë të përgjigjes së saj. Dhe hoqa dorë prej saj, duke menduar se fjalët e zakonshme, ato që shqiptohen miliona herë në ditë, në dhjetëra gjuhë, nga banorët e këtij planeti, janë disa herë edhe më të vështirat për t'u kuptuar.

qershor, 1986

PASDITJA SË CILËS I SHKONIN FJALË TË VJETRA PLEQSH

Po ktheheshim nga plazhi me tren. Ishim të gëzuar, sic mund të jesh pas një dite të kaluar këndshëm në plazhin e gjerë, ku kishim notuar, ishim nxirë në diell, kishim luajtur bagmington dhe kishim këmbyer me njëri-tjetrin kasetat e magnetofonit, dhe, në të gjitha këto, s'kishin patur asnjë incident.

Kur Artani me Stelën zbritën në stacionin e Vorës, për të kaluar të shtunën te një teze e Stelës dhe kjo e fundit në vend të përshëndetjes së zakonshme «mirupafshim», ose «natën», tha «të veni rre shëndet», ne padyshim që kjo na u duk disi e pazakonshme madje kështu do t'i qe dukur edhe asaj vetë, sepse një çast vështrimi i mbeti pezull, por as ne, as ata nuk patën kohë t'ia vinim në dukje njëri-tjetrit këtë, duke e komentuar në mënyrë gazmore, siç bënim zakonisht për këto gjëra, sepse zbritja ishte e ngutshme dhe nga altoparanti një zë femre përsëriste vazhdimisht: «Treni në Vorë ndalon vetëm një minutë! Ju lutem pasagjerëve që do të zbresin të shpejtojnë».

Pra fjalët e Stelës nuk i kujtuam pas nisjes së trenit

dhe nuk do t'i kujtonim ndoshta edhe më pas sikur dhjetë minuta më vonë Liliana të mos thoshte diçka të ngjajshme. Atëherë, vështruam njëri-tjetrin dhe për çudi nuk qeshëm me zë, siç mund të pritej, po qëndruam të heshtur, ndoshta ngaqë në të njëjtën kohë dhe bashkarisht e kuptuam se ajo ishte një pasdite që kërkonte fjalë të vjetra pleqsh.

Edhe pse nuk e tha njeri pyetja «përse?» është në sytë e të gjithëve. Ato u bënë disi të menduar, po pa asnjë shenjë zymtie. Ishte thjesht ai lloj mendimi që sytë i lë të kthjellët si ato pllakat e posalarë nga shiu.

Dhe vërtet përse ajo pasdite kishte nevojë për fjalë të dikurshme? Ç'kishte ndodhur, ku ishte defekti dhe ç'çfarë ishte hapur ndoshta diku që duhej mbyllur?

Ne e ndjenim se as në ato çaste e as më vonë nuk do të ishim në gjendje t'i jepnim përgjigje këtyre pyetjeve. E ndjenim gjithashtu se ishte e tepërt ndoshta t'i kërkonim aq shumë vetvetes. Në fund të fundit fakti që e kishim vënë re këtë ishte i mjaftueshëm për të na hequr çdo ndjenjë faji.

Kështu që nuk thamë asgjë më tepër, veç vështronin sprapsjen e fushave, ndërsa treni ecte tashmë drejt muzgut që po binte. Muzgu i pasdites së cilës i shkonin fjalë të vjetra pleqsh.

18 dhjetor 1985

*Tregim i mrekullshëm
Nga lexuesi!*

ËNDRRA MASHTRUESE

*Zeusi... Endrrën Mashtruese thirri
Homer (Iliada, Kënga II)*

Shefi më thirri për të më dërguar përsëri në tokë me një mision të ri. Kur dola prej tij, Hipnosi me hyjneshën e re, Shpresën, që pëshpëritnin kokë më kokë aty përjashta, e prenë të folurën dhe më ndoqën me të njëjtin vështrim ironik që më shoqëronin sa herë që dilja prej Zeusit. Për një sy të jashtëm, në atë vështrim spikaste ndjenja e epërsisë morale, që gjoja ata kishin në krahasim me mua (domethënë ata u jepnin njerëzve shpresa, ëndrra të ndershme, të mirëfillta, kurse unë, e pamoralshmja, gati-gati një lloj prostitute, i joshja ata me gënjimën mashtrues për t'i shtyrë në veprime të mbrapshta). Kështu përpiqeshin ta paraqitnin punën, kurse unë do të thosha se në atë shikim kishte në radhë të parë zili.

Zili që shefi e çmon përherë e më fort punën time, që misionet që kryej unë janë përherë të një natyre të zgjedhur e tejet delikate në krahasim me punën e tyre prej hamalli (mendo të projektosh e të prodhosh shpresa dhe ëndrra të rëndomta për miliarda njerëz), dhe së fundi, për një arsye tjetër që nuk më pëlqen ta përmend këtu.

Kalova, si përherë, mospërfillëse përsëri tyre, i merr-

ja me mend epitetet fyese që më shcqëronin një copë herë, dhe u nisa për në tokë. Kisha për të shpërndarë rreth dhjetë mijë e ca ëndrra mashtruese dhe kjo s'ishte një punë e lehtë. Duheshin gjetur një nga një personat e caktuar, vendi ku flinte secili, duhej bërë kujdes që të mos ngatërroheshin kokat e të fjeturve, sidomos kur qe fjala për të martuar, e aq më tepër dashnorë, që flinin aq shumë të pleksur me njëri-tjetrin, saqë ishte vërtet e vështirë të mos ngatërroje gjymtyrët e njerit me ato të tjetrit. Çasti më delikat ishte pa dyshim ai, kur më duhej të qëndroja një copë herë mbi kokën e njeriut që po flinte dhe, nëpër currilat e gjumit, që rridhnin pa pushim mbi të, të derdhja ëndrën çoroditëse. Duhej treguar kujdes, njëlloj si me lo-shnjën kur përpiquej që të mos i derdhej një pjesë e qumështit përjashta gojës, ose me të sëmurin kur është fjala për barnat.

Kisha shpërndarë gati një të tretën kur ndjeva lodhje dhe pushova pak. Si përherë në çaste të tilla, mendja më shkoi në gjithfarë gjërash, kryesisht në fatin e mëtejshëm të këtyre mjeranëve dhe sidomos në arsyet përse shefi ua dërgonte mashtrimin, arsye që përherë mbeteshin të errëta për ne vartësit.

Ishte ftohtë. Trupat qiellorë regëtinin përtueshëm, dhe unë i thashë vetes: lëri filozofitë, ngrehu më mirë ta mbarosh këtë punë.

Në fushimin përpara një qyteti të rrethuar m'u desh njëfarë kohe sa ta gjeja kryekomandantin e rrethuesve, njëfarë Agamemnon Atridi, të cilit, ç'është e vërteta, e nervozuar pakëz siç isha nga kërkimi, ia lëshova pa kujdes ëndrrën. E pashë si u derdh një pjesë e saj jashtë trurit, megjithatë qetësova veten me mendimin se, edhe aq sa i shkoi në tru, ishte e mjaftueshme për ta shtyrë në veprime të marra.

Kisha vërtet shumë punë dhe, po të tregohesha më e kujdesshme se ç'duhej, vështirë se do të më dilte koha e

caktuar për kryerjen e këtij shërbimi. Mora frymë lirisht dhe çava sërish mes shkumbajës së natës.

Ndërmend kisha morinë e emrave që nuk e di pse këtë herë po më dukej tepër e gjatë. Hoze T. Hoze Murana, Konfuci, Klod F., Alen Pons, Tom Xhekson, Jezu Krisht, Klod F.D., Hans Kramer, Kurt K., Makbeth, Ibrahim Ogllu, Mihail Gorbaçov, Luis Borges, Lin Min, Kululuma, Maria Morena, I. Kadare, Klod Durand, Niki Niki B., Tutmes III, Ana K., Ana V., Atë Shtjefën Gjeçov, Jukamura, Princ Vid, Adam.

Vazhdonin qindra të tjerë, përveç atyre që ua kisha hedhur ndërkaq gënjimin dhe i kisha fshirë nga kujtesa. Më ka mahnitur përherë aftësia e specialistëve që për secilën krijesë njerëzore e projektojnë nga një mashtrim origjinal. Kalimthi, nën dritën e zbehtë të yjeve, i hidhja nganjëherë nga një sy tubetit ku qe ndryrë ëndrra. Rrallë, shumë rrallë projektet ngjanin disi. Shumica ishin fare të veçanta. Ja, p.sh., sapo zbraza njërin tubet, ku ëndrra qe ndërtuar si dramë e vogël, me tri shtriga. Lëngu i tubetit tjetër e përndizte trurin e njeriut për t'u sulur midis një vrimë të zezë kozmike, në kërkim të vendit të vet, të thithur prej kohësh prej vrimës e të shtypur prej trysnisë së tmerrshme, siç shtypet një automobil prej presës për t'u bërë një grusht. Do të sulej, pra, ky i mjerë, për ta mbështjellë atë lëmsh e për të nxjerrë prej tij qytete, ujëra, breza njerëzore, kambanore kishash, alpe, flamurë, borë e histori e s'di çfarë tjetër.

Një herë më kujtohet, s'di si u hutova dhe ngatërrova tubetin e njëfarë Dante Aligeri me të njëfarë Dedalije ose Dedalusi. Po s'kisha dhe shumë faj. Isha e lodhur, dhe, veç kësaj, që të dyve u fillonin emrat me D., dhe ëndrrën e kishin që të dy me njëfarë ndërtimi misterioz, një labirint njëri, e tjetri një lloj metroje primitive ku udhëtonin veç të vdekurit. Kur, sapo ia zbraza njërit tubetin e tjetrit, e kuptova në çast gabimin. S'më mbetej gjë tjetër veçse

tubetin që teproi t'ia hidhja të parit. Dhe ashtu bëra. Mirëpo, ndryshe nga ç'kujtoja unë, shefi s'di se qysh e kishte marrë vesh. Kur mbërrita, fytyra e tij ishte e ngrysur tej mase, por pasi i kërkoja ndjesë, u zbut në çast, madje, si më mori në gjunjë, më tha: një hutim i vogël prej teje, atje në tokë merret shumë seriozisht.

Ja shiko! Dhe më tregoi librin që sapo kishte botuar një prej atyre të dyve. (Ndonëse e dija ndërkaq, më habiste përherë e më fort shkurtësia e jetës së njerëzve. Koha, që për mua s'ishte veç një natë, për ata të mjerë ishte e mjaftë që në të të lindnin e të vdisnin breza të tërë, kështu që ngjarjet që kishin ndodhur vetëm ca çaste më parë atyre u ngjanin të kohërave të lashta. Ja p.sh. unë ende s'isha kthyer nga shërbimi, kur njëri prej atyre shkretanëve jo vetëm që çoroditur nga lëngu im, po kishte arritur të botonte edhe një poemë për të çoroditur krejt fisin njerëzor.) Shikoje, pra, më tha Zeusi, duke më treguar titullin e librit: «Ferri». Ky libër do të ishte i Dedalusit, dhe ky këtu, (ai i ra me gisht librit në vendin ku që shtypur emri i autorit), ky Dante A. duhej të merrej me labirintin. Mirëpo hutimi yt bëri një gjë që askush në tokë nuk do ta besonte dot.

S'dija ç'të përgjigjesha, veç të qeshja si budallaqë. Atje në tokë gjërat merreshin vërtet tepër seriozisht. Sidomos kur ishte puna për rrjedhjen e kohës. Për ta kohë ecte në një drejtim, nga e shkuara drejt së ardhmes, dhe, po t'i thoshe se mund të ndodhte edhe e kundërta, që e shkuara të vinte pas së ardhmes, çka ndodh shpesh, ose e ardhmja, e tashmja dhe e shkuara të gjendeshin në një pikë, ata do të çoroditeshin krejt.

Një herë tjetër (më kujtohet ishte një natë e shqetësuar dhe, si të mos më mjaftonte lodhja, në kthim, disa kometa më kishin ngacmuar), ndërsa më ledhatonte, shefi më tha se u kishte bërë vërejtje mbushësve të tubetave

sepse nuk i lanin mirë ato. Kështu në tubetin e njëfarë Xhenxhis Khan kishte mbetur me sa duket një pikë lëngu nga përdorimi i mëparshëm, kur i qe derdhur ëndrra e një gjermani, Adolf H., më duket se quhej, ose kur një farë Xhojsi i kishte ndodhur e njëjta gjë me tubetin e një plaku të verbër, që s'më kujtohet emri.

Gjithmonë e më tepër më habit fakti që shefi ynë interesohet megjithatë për trurin e njerëzve me të njëjtin seriozitet që merret me çështjet më delikate, siç janë p.sh. ato të sigurimit, d.m.th. të ndonjë përбетimi të mundshëm kundër tij.

Në rrethet tona këtë e shpjegojnë me gjithfarë mënyrash. Shumica janë të mendimit se kjo s'është veçse një fobi e tij, po Prometeu ngul këmbë se arsyeja e vërtetë është tjetër gjë. Shefi ka frikë nga njerëzit, kjo është arsyeja e vetme, thotë ai. Po ne, ose nuk e besojmë, ose bëjmë sikur s'e marrim vesh ç'do të thotë, ashtu siç ndodh shpesh me gjërat që ti i di se s'janë për t'u folur.

Flitet madje se ka kohë që në fshehtësi të plotë shefi po përgatit një projekt për ndryshimin e njeriut. Madje këto ecejaket a mia me ëndrrat mashtruese s'janë veçse zhbirime paraprake për këtë plan të ri.

dhjetor 1985.

P R O M E T E U

Trilogji

I

Shkëmbinjtë i rëndonin mbi supe e mbi gjoks që prej qindra vjetësh. Gurët dhe guralecët që kishin ndjekur shkëmbinjtë gjatë çastit të rrokullisjes së tij në humnerë nuk ishin më të mëshirshëm. Ia vrisnin vendet e trupit ku i qenë rrasur, madje dy-tre prej tyre kishin arritur t'i futeshin në gojë dhe, ndonëse sa herë që pështynte kishte ndjesinë se i nxirrte, ata ishin përherë aty.

Humbella ishte e zezë sterrë. Po të mos e dinte se i kishte sytë të paprishshëm, do të besonte se qe verbuar ndërkaq.

Ç'bëhej vallë atje lart mbi tokë? E mbanin mend, e bekonin apo e mallkonin?

Nganjëherë përpiqej t'i mbushte mendjen vetes se mbase ishte më mirë kështu, i mbuluar nga gurët, sesa i mbërthyer faqe shkëmbit, ku e rrihte shqcta dhe e digjte dielli dhe kalimtarët e mërzitnin.

Herë-herë i vinin ndër mend ditët e fundit atje lart,

kur Zeusi për herë të fundit i kërkoi të përulej. E kishte ndier që kishin qenë çastet e prapsme mbi tokë, ndaj qe përpjekur që të thithte sa më shumë pamje, si t'i kishte rezervë për atje poshtë, në terr. Dita ishte me re dhe vetëtimat afroheshin si valltare kërcënuese e lejlekët u mënjantuan të trembur, por ai i tha «mirupafshim» gjithçkaje, vetëm kur toka nisi të trandej në prag të çarjes.

Pas rropamës së rënies, ulërimave, polemikave, akuzave, klithmave «pranoje fajin!», shurdhëria e nëntokës ngjante njëqind fish më e thellë.

Vetëm më pas, ai ndjeu zhurmat e para të dheut, ca kërcëllima të thella, thua se shkëmbinjtë, të lodhur nga trysnia, psherëtinin mbytur. Nganjëherë vinin ca gërvima, të shkaktuara ndoshta nga sondat e naftës, dhe ai mendonte: s'më kanë harruar jo, së paku njerëzit.

Nëntoka ishte ndoshta vendi më i përshtatshëm për të kujtuar ngjarjet e përlartme. Nga miliona ditët e tij, vetëm disa i vinin tani ndër mend. Njëra përpiquej të zinte sa më shumë vend në kujtesë. Ishte dita kur me ngut të pazakontë e lajmëruan se e priste Zeusi. Fytyra e shefit ishte më e ngrysur se kurrë. Ai ia dinte zemërimin e vërtetë, ashtu siç ia njihte zemërimin kallp, atëherë kur ai qe i përllogaritur, ashtu siç qenë të përllogaritura trashja e zërit dhe goditja e grushtit në tryezë. Po këtë herë çdo një qe e tmerrshme vërtet. Ti po përbeton kundër meje? tha ai. Në të vërtetë ajo s'ishte veç klithmë, që Zeusi mezi i dha formën e një pyetjeje.

Kështu kishte filluar gjithçka. Pastaj erdhën mbledhjet e tjera, kur ai jo vetëm nuk i kërkoi ndjesë, por e sulmoi haptas. Më pas erdhën veçimi. kthimi i krahëve prej të gjithëve, vetmia.

Të gjithë kujtonin se e keqja do të ndalej me kaq, po të nesërmen ngjante e zakonshme ajo që deri dje dukej e llahtarshme, e kështu çdo ditë zi e më zi, gjersa erdhi mëngjesi i paharruar, kur ndodhi ajo të cilën shumica s'e ki-

shin besuar se mund të ndodhte: atë e nisën për në internim.

Një titan në internim? Kjo s'është e mundur, thoshin të gjithë. Ç'do të thonë njerëzit? Ç'do të thotë bota?

Më pas, kur nga vendi i largët i internimit, për të cilin ca thoshin se qe në lindje të Evropës e ca në perëndim, kur më pas pra erdhi lajmi se ai jo vetëm qe i internuar, por e kishin lidhur me pranga këmbë e duar në faqen e një shkëmbi, njerëzit kishin hapur prapë gojën për të gjetur një fjalë të përshtatshme për këtë rast, domethënë një fjalë të egër, të papërdorur ndonjëherë, të frikshme, por, ngaqë të tilla është vështirë të gjenden, ata s'kishin thënë veç atë «s'është e mundur», banale, që përdorej për gjithçka.

Në faqe të shkëmbit ditët më të mërzitshme ishin ato kur kishte publik: kureshtarë, hetues, turistë e soditës të zakonshëm. Herë-herë vinin kasnecë të fshehtë të Zeusit për t'i parashtruar kushtet e pajtimit. Një ditë njëri prej tyre foli haptas: Zeusi i premtonte faljen në këmbim të diçkaje; një të dhënë të fshehtë, që e dinte veç ai, Prometeu.

Prometeu kishte qeshur së brendshmi. Ja pra ku e kishte pasur shkakun durimi i gjatë i tiranit, ai durim që kishte zgjuar admirimin e tërë servilëve të botës. Një interes meskin, që lidhej me sigurimin e tij.

Prometeu i kishte qeshur mu në fytyrë kasnecit dhe me tërë forcën e mushkërive kishte thirrur: jo!

Ishte pasditja e fundit e tij mbi tokë. Aty në prag të rënies së muzgut kishin nisur vetëtimat dhe ca çaste më pas ai qe rroposur.

II

Ditën e parë, kur e kishin nxjerrë nga zgafella, kishte thuruar se qe verbuar vërtet. Sulmi i dritës kishte qenë aq

i egër, sa i qe dukur se do t'ia shpërthente kafkën. Nuk kishte arritur as të pyeste se ç'ishte kjo zhburgosje: falje apo zhvendosje në tjetër burg. Po pastaj, ende pa i ardhur vështrimi, kishte ndier në trup fashat prej hekuri dhe ca zëra të njohur. Kur fill pas kësaj kishin gjëmuar çekiçët e kishte kuptuar në çast se historia po përsëritej dhe se po e mbërthenin prapë në ujë shkëmb.

Ishte vallë po ai shkëmb ku qe pranguar përpara se të rroposej? Apo ishte një tjetër mal, në një tjetër kënd të botës? Nuk dallonte ende asgjë, po krenaria nuk e linte të pyeste.

Kur dalëngadalë shikimi nisi t'i vinte, kishte shquar së pari ca si skica malesh, pastaj vijën e zbehtë të oqeanit dhe retë. Ishte i njëjti shkëmb.

Ai kishte qeshur me hidhërim. Kishte qenë aq meskin në hakmarrje tirani i tij, saqë as kaq s'i kishte bërë: t'i kishte ndërruar shkëmbi, domethënë pamjen.

Po pas dy ditësh, kur kishte parë që larg shkabën e Zeusit tek po afrohej, e kishte kuptuar në çast se ky mbërthim i dytë nuk do të ishte i njëjtë me tjetrin.

Shkaba e zezë kishte arritur më në fund, kishte vënë klithrat mbi barkun e tij dhe, para se ai ta mendonte se ç'mund të ndodhte, e kishte goditur me sqep në anën e majtë të barkut, atje ku ishte shpretka.

Prometeu kishte klithur nga dhimbja.

Kishte dhjetë mijë vjet që kjo gjë përsëritej çdo ditë.

Dhe ja, papritur, një mëngjes shkaba nuk u duk në horizont. Ishte dita e tretë që s'po vinte t'ia hante shpretkën si zakonisht. Për herë të parë pas dhjetë mijë vjetësh nuk e munduan dhimbjet e tmerrshme dhe trupi i gjetit prehje të faqja e shkëmbit. I flihej.

Dikush do të ketë ndërhyrë te Zeusi, mendoi me mos-përfillje.

Ditën e katërt e kaloi si në përgjumje. Në vendin ku më parë i ngulej sqepi i tmerrshëm tani ndiente si plagë

po i malcohej. Paqja shpërndahej qetësisht në tërë trupin. Muskujt që i tendoseshin çdo ditë nga vuajtja (në prag të goditjes trysnia ishte sidomos e padurueshme), tani po i zbuteshin.

Ç'po ndodh? pyeti papritur ditën e pestë. Këtë klithmë e lëshoi pa gëzim, pothuajse i trembur, si të ishte zgjuar nga një ëndërr e keqe. Ku ishte shkaba, pse s'vinte?

Shpretka i ngjante tani se i qe fryrë si një sfungjer i butë, i këndshëm.

Ç'të kishte ndodhur vallë? Qe rrëzuar Zeusi? Qe shpallur falja e tij?

Ai tundi kryet aq sa e lejonte fasha e hekurt rrotull qafës për të bërë shenjën e «Jo» -së.

Ishte më shumë e besueshme që shkabës t'i kishte ndodhur diçka. E kishte vrarë ndonjë gjahtar, me qëllim ose gabimisht, ndonëse vështirë mund të besohej se mund të vritej qeni fluturak i Zeusit.

Atëherë ç'kishte ndodhur, gati sa nuk thirri. E kishin harruar, s'përbënte më problem, kishin dalë çështje të tjera, më të ngutshme? Apo në ditët e përçartjeve, e kishte nxjerrë padashur të fshehtën që i interesonte aq shumë tiranit dhe tani ai as që kujtohej më për të?

Në qoftë se shkaba nuk vjen, do të thotë se unë kam mbaruar, mendoi me urrejtje.

Gjithë jetën nuk kishte pranuar kurrë asnjë kompromis. Të shumtë qenë ata që kishin dashur ta pajtonin me diktatorin, por ai e kishte pritur me përbuzje çdo ndërhyrje.

Kush ka guxuar të ndërhyjë prapë për mua? ulëriu.

Përreth s'gjendej askush që ta dëgjonte. Aty pranë kalonte ngadalshëm një copë mjegull. Më tutje binte shi.

Ditën e shtatë iu duk se pa nga larg krahët e shkabës që po avitej. Po s'ishte ajo. Ishte një aeroplan pasagjerësh, që fluturonte ngadalë sipër maleve.

E lëshoi kokën aq sa e lejonte fasha e hekurt rreth qa-

Ës dhe ndjeu dëshirën të qante. Kishte kohë që dyshonte, po tani po bindej që njerëzit po e harronin. Përherë e më të rrallë ishin kalimtarët, të dërguarit e Amnesty International dhe mitingjet për të.

S'ke ç'i bën, mendoj, kështu që e thënë prej fatit. Mendimi se kishte luftuar ndoshta kot, ishte aq dëshpërues, saqë ia erri vështrimin. Po, në çastin kur drita e syve po i shuhej, dalloj larg, shumë larg, në drejtimin ku shfaqej zakonisht, njollën e vogël që sa vinte rritej.

Ngriti kryet, tendosi muskujt dhe priti goditjen e sqepit. Kur sqepi u ngul, duke shkallmuar plagën e porsambyllur, bashkë me klithmën e dhimbjes, ai lëshoi fjalën «shpëtova», që u përzie me të çmendurisht.

Re të zeza të mbushura me bubullima dhe elektricitet ecnin mbi kokë të tij, ndërsa shkaba e godiste.

III

Tani që për mua ka nisur jeta normale, vuajtjet e kaluara i kujtoj rrallë e më rrallë. Nuk ia pohoj këtë gjë askujt nga droja se mos zgjoj mendime të pakëndshme. Në të vërtetë çdokush që do të dëgjonte një pohim të tillë prej meje, do të kishte të drejtë të thoshte se Prometeu qenka me kujtesë të shkurtër. Ose edhe më keq, se Prometeu ka pësuar një zvetënim në shpirt, përderisa nuk ka dëshirë të rikujtojë periudhën më heroike të jetës së tij. Është e kuptueshme që pas kësaj edhe pajtimi im me Zeusin të interpretohet në mënyrat më të ndryshme.

Unë e di që për këtë pajtim pëshpëritet shumë andej-këndeje. Përgjithësisht gjykohet për të në mënyrë kritike. Edhe kur s'e thonë haptas, madje edhe me dashamirësi, ata që e përligjin veprimin tim, duket sikur e shoqërojnë këtë

me një psherëtimë; sidoqoftë do të na pëlqente një Prometé më i pamposhtur... Ata thonë fjalën «i pamposhtur», por unë e di se nën lëvozhgën e saj rri në të vërtetë fjala «i papërlyer». Në kushte të tjera do të kisha dëshirën t'ua përplasja në fytyrë: Ah, kështu dashkit ju? Që unë të torturohesha nën tokë, në faqen e shkëmbit, nën erë, nën diell, nën sqepin e shkabës, kurse ju ta çonit jetën gëzueshëm, të shkonit me fëmijët nëpër plazhe, nëpër gosti. Kështu, ah?

Por unë prej kohësh nuk kam as energji e as dëshirë për shkrime të tilla. Le të mendojnë ç'të duan të tjerët, them me vete. Kjo gjë ka kohë që nuk më intereson.

Kujtoja se më e hidhura nga të gjitha do të ishte pëshpërima apo më mirë mosmirënjohja njerëzore. Por as kjo nuk më ka bërë atë përshtypje që prisja. Madje disa herë kam menduar ftohtësisht; unë vetë a nuk i ndihmova njerëzit të bëhen më të zgjuar e dyshimtarë? Është e natyreshme që ata të kërkojnë të arsyetojnë për gjithçka, duke përfshirë këtu edhe veprimet e mia. Në fund të fundit, kjo s'është veçse ajo që unë doja të arrija, pra pjesë e triumfit tim.

Qysh në kohën e mbërthimit të parë në shkëmb (sa herë në kujtesën e lodhur ai shkëmb i mallkuar më ngjan si faltore mbledhjesh ose sallë gjyqi), qysh në atë kohë, pra, e më pas, sidomos gjatë qëndrimit nën tokë, më pikonte në ndërgjegje pendimi që dikur i kisha shërbyer Zeusit. Por sa më shumë që vuaja aq më e zbehtë ishte kjo brerje. Sidomos gjatë mbërthimit të dytë, kur shkaba më torturonte, ajo brengë pothuajse u zhduk krejtësisht.

Tani që vuajtjet janë një kujtim i shkuar dhe unë, pas pajtimit, i kam fituar prapë të gjitha të drejtat si hyjni, brerja e ndërgjegjes ka filluar të më torturojë përsëri. E di që më marrin nëpër gojë prapë, sidomos për pajtimin që bëra me tiranin. Madje kam përshtypjen që për shkak të tij po më rikujtojnë edhe mëkatet e kaluara, që

me sa duket m'i kishin falur. Natyrisht që në netët e mia të pagjuma përpiqem të mbrohem me anë dialogësh apo fjalimesh të përfytyruara përpara turmës njerëzore. Ju këni të drejtë të gjykoni kështu, po pa përpiquni të jeni më gjakftohtë. Në qoftë se unë do të hiqja dorë nga çdo kujdes për të mbrojtur veten time, në qoftë se unë, pra, për një bujë apo skandal të çastit do të vetëshkatërrohesha, ç'shpresë do të mbetej për ju? Kush do ta mbante gjallë zjarrin e vetëm që regëlonte në terr? Sikur të kishte të tjerë prometej, kishit të drejtë të më akuzonit, por unë, për fat të keq, isha i vetëm dhe kurrfarë dritëze tjetër s'dukej në horizont të zi.

Kështu flisja me vete duke u lehtësuar nga pak. Po lehtësimi nuk vazhdonte gjatë. Ashtu si në qiellin e dikurshëm shfaqej që larg shkaba e zezë, ashtu avitej drejt meje, këtë herë nga sfera të panjohura, brierja e ndërgjegjes. Më e tmerrshme se shkaba sqephekurt. Më e pashpresë.

Kjo është tortura ime e tretë, ajo më e kobshmeja, që nuk ma di njeri. Ndaj është edhe më e llahtarshme se dy të parat, se e vuaj në heshtje, në kohën që të tjerët më dinë të lumtur. Ky është flijimi im i vërtetë. Ferri im në jetë të jetëve. Dhe pikërisht tani, kur fama ime ka nisur të zbehet, unë jam më Prometé se kurrë.

Tiranë, mars 1990

NATA E SFINKSIT

Të gjithë e dinë se gjithkush dridhet frikë prej meje. Po ndoshta askujt s'i shkon nëpër mend se si dridhem unë vetë. Ashtu si ata nga frika.

Kur tisi i parë i muzgut e terratis fushëtirën, nis edhe ankthi im. Çdo hije kalimtare që duket larg, çdo hije tjetër e shkaktuar prej territ, prej ndriçimit të hënës, apo prej ndonjë gjallese, nis e më kall datën Dyshimi i mallkuar se mos ajo hije është njeriu që po vjen drejt meje me atë pyetjen fatale, që unë s'do t'i përgjigjem dot, më mpin të gjithin.

Nuk e mendoja kurrë se tmerri që do t'u shkaktoja njerëzve do të më shpërblehej me të njëjtën monedhë. Veç, mund ta them pa e tepruar, se tmerri që provoj unë është shumë më i madh e sfilitës sesa i tyre. Sado e pabesueshme të tingëllojë kjo, për fat të keq është e vërtetë. Ndërsa tmerri i tyre është i përqendruar mbi qenien time, ankthin tim mund ta shkaktojë secili prej tyre. Dhe nuk ka gjë më të llahtarshme se ankthi me burim të panjohur, tmerri i anonimatit.

Njerëzit më quajnë «sfinks». Domethënë mbytës, asfiksues. Ata besojnë vërtet se, duke mos qenë në gjendje

t'u përgjigjen pyetjeve të mia, mbyten prej meje. Në të vërtetë unë u bëj pyetje fare të rëndomta, por ata kaq shumë janë të tmerruar qysh më parë nga ato ç'kanë dëgjuar për mua, saqë ngatërrohen me vetveten, u merret fryma, u bie të fikët.

Kuptohet se as që vjen puna që edhe ata të më bëjnë pyetje mua, ashtu siç ka qenë parashikuar në marrëveshjen tonë të parë, kur më pranuan si sfinks. Ky ishte në fakt edhe thelbi i marrëveshjes: unë do të kisha të drejtën t'i ndëshkoja ata në rast se nuk do t'u përgjigjeshin pyetjeve të mia por, nga ana tjetër, ata gjithashtu do të kishin të drejtën të më pyesnin dhe të më ndëshkonin në rast mos-përgjigjeje. Merret me mend që kjo e fundit dalëngadalë u la mënjanë (hakmarrja ime për ata që guxuan e bëri punën), dhe kështu mbeti vetëm e drejta ime për të pyetur e për të ndëshkuar.

Po lënia mënjanë s'do të thotë harresë. Unë e di fare mirë se diku, gojë më gojë kalon kujtimi i marrëveshjes sonë të parë dhe, pavarësisht se gjer më sot askush nuk e ka vënë atë në zbatim, ideja e saj jeton te njerëzit. Dhe kur jeton ideja, herët ose vonë prit frytet e saj.

Këto të gjitha më shkojnë ndër mend, sidomos kur afron mbrëmja. Sado që përpiqem ta heq mendjen, nuk rri dot pa përfytyruar njeriun e parë që do të kapërcente frikën e vet për të ma bërë i pari pyetjen. Cilado qoftë ajo, unë qysh tani e ndiej se do ta humb aq shumë toruan, saqë s'do të jem në gjendje të përgjigjem. Dhe ky do të jetë fillimi i katastrofës.

Rrënimi im ndoshta s'do të vijë përnjëherë, rrufe në të kthjellët, po ky është një ngushëllim i vogël. Rrënimi i ngadalshëm është më i pashpresë. Murmurima do të kalojë gojë më gojë, më tepër se një tërmet ajo do të gërryëjë themelet e mia. Më vonë, kur kjo histori do të kujtohet nga brezat e ardhshëm njerëzcrë, ka mundësi që periudha e gjatë e rrënimit tim të përmbliidhet brenda pak

gastesh, ashtu siç është e prirur t'i dendësojë shpesh ndodhitë mendja njerëzore. Të them të drejtën, unë do të parapëlqeja rroposjen e beftë, në krahasim me torturën e ngadaltë, shumëvjeçare, po kjo, ashtu si shumë gjëra të tjera, s'varet nga unë.

Hijet e muzgut sa venë dendësohen. Bashkë me të ftohtin e natës ndiej ankthin gjithaq të ftohtë të më kapullojë krejt. Është ankthi që unë e krijova vetë, duke kujtuar se, sa më shumë t'i shtyp njerëzit me të, aq më tepër do të çlirohem prej tij. Po fati e deshi që të ndodhte e kundërta.

3 shkurt 1986

MURI KINEZ

Debati përfundimtar, në prag të marrjes së vendimit, u bë një ditë të ftohtë dimri. Mospërfillës perandori dëgjonte zërin e ngjirur të gjeneralit Du Puç, i cili qysh në fjalët e para u duk se ishte kundër ndërtimit të murit. Megjithëse e ndjeu qysh në krye mospërfilljen, madje njëfarë pakënaqësie të perandorit, ai vazhdoi të fliste kundër projektit, duke i shoqëruar fjalët me lëvizjen e një shkopi që e tundte, sipër kartonit ku qe vizatuar, me sa dukej, kufiri verior i shtetit, pikërisht ai që do të mbyllej me mur.

Ai vazhdonte të shpjegonte se, në qoftë se ato forca njerëzore dhe ajo sasi gurësh, llaçi e hekuri do të përdorreshin për ndërtimin e një sistemi fortesash gjatë vijës së kufirit, ky sistem fortesash do të ishte shumë më i sigurt dhe i leverdishëm nga çdo pikëpamje. Kurse muri që propozohej, përveç harxhimeve kolosale, edhe nga pikëpamja ushtarake linte shumë për të dëshiruar. Shtrirja e tij e pafundme vetvetiu e dobësonte fuqinë qëndruese të tij, ai ishte lehtësisht i kapërcyeshëm në pika të panumërta, mjaftonte që armiku të përqendronte trupa në to.

Gjenerali i kishte lënë, me sa duket, shifrat për në

fund, me shpresë se ata do ta përmbysnin ngurrimin e fundit të sovranit, po nuk ndodhi ashtu. Megjithëse shifrat ishin tronditëse: sasia e njerëzve që do të duhej të punonin, sasia e materialit, shpenzimet e transportit, vdekjet, epidemitë që mund të përhapeshin në një kantier kaq të madh, fytyra e perandorit mbeti gjithaq mospërfillëse.

— Mbarove? — pyeti ai kur gjenerali bëri një pushim.

Në të vërtetë gjenerali kishte për të folur ende, po befaz ndjesia e një lodhjeje të paprovuar ndonjëherë, nga ato që lidhen me pamundësinë e kapërcimit të asaj që gjer në atë çast të qe dukur e kapërcyeshme, e çarmatosi. Ai bëri një shenjë me kokë për të thënë se mbaroi dhe perandori vështroi të tjerët.

— Ka dikush tjetër për të folur?

Ai e dinte se ç'ishte për t'u thënë ishte thënë dhe se të dyja palët kundërshtare nuk prisnin veçse vendimin e tij. Kushedi pse mendja i shkoi te konkubina e tij e re, të cilën tani po e bënin gati për të dhe u përpoq të merrte me mend dendësinë e floktores së vogël sipër pubisit. e vetmja kureshti që e tërhiqte kohët e fundit.

— Muri do të ndërtohet, — tha ai papritur, pa vështuar askënd, ngaqë e ndiente se ngazëllimi i fitimtarëve do të ishte për të po aq i padurueshëm sa pikëllimi i të mundurve.

Doli përmes heshtjes, i ndjekur nga këshilltari i tij më i afërt Shung.

— Madhëri, — i tha ai, kur po ecnin vetëm nëpër korridorin e gjatë, — përse nuk e shpjeguat arsyen e vërtetë të murit?

— E përse duhej ta shpjegoja, — tha sovrani.

— Për të mos mbetur asnjë keqkuptim lidhur me ato që tha gjenerali Du Puç.

— Gjenerali kishte të drejtë, — tha sovrani.

— Ju e dini se unë s'kam qenë kurrë kundër tij...

Megjithatë më duket e dënueshme përhapja e mendimeve të tilla që qysh më parë e cenojnë murin.

Perandori i ngadalësoi, pastaj i shpejtoi prapë hapat.

— Arsyeya e vërtetë e ndërtimit të murit është edhe më e dëmshme në qoftë se merret vesh, — tha ai pa e vështruar. — Në qoftë se ato që tha Du Puçi e dobësojnë murin, ajo e rrafshon si tërmet. Atë duhet ta harrosh edhe ti, Si Fun. Madje edhe unë vetë.

Këshilltari u drodh, po, sado e fortë të ishte dridhja e tij, manteli i mëndafshtë s'do ta jepte kurrsesi.

dhjetor, 1985

PËRPARA BANJËS

Ai iu afrua vaskës me ujë të ngrohtë, lëbyri sytë nga kënaqësia. (Sa herë e kishte ëndërruar këtë vaskë në çadrën e ftohtë të fushimit!), dhe në çastin kur po fuste njërën këmbë në ujë, ktheu kokën nga e shoqja që po i vinte pas. Ajo kishte ende në fytyrë atë buzëqeshje pakëz të zhvendosur, po, më tepër se buzëqeshja, atij i tërhoqi vëmendjen ndriçimi metalik i diçkaje që vetoi midis pëlhurës, që e shoqja mbante në dorë. Meqenëse gjithë trupi i tij e kishte marrë ndërkaq kahjen e lëvizjes, ai u fut në vaskë, po kureshtja, megjithatë, e bëri të kthente përsëri kokën për të parë se ç'ishte ajo gjë metalike. (Ndoshta gjatë mungesës së tij të gjatë këndeje ishin shpikur vegla të reja edhe për larjen në banjë.) Në atë çast ai pa të shoqen gati për sipër tij, me pëlhurën e hapur, që po ia hidhte sipër (Ç'bën kjo e marrë, arriti të mendonte, ku është parë që njeriu u fshika në fillim e jo në mbarim të banjës), dhe një gramë më pas, pa arritur ende të tmerrohej nga ideja se ajo pëlhurë i ngjante më tepër një rrjete, ai ndjeu krahët të ngatërroheshin në të, dhe po në atë çast pa sëpatën e shkurtër në duart e gruas. Dhembja në anën e djathtë të qafës dhe shkulmi i parë i gjakut iu dukën se ndodhën në të

njëjtën kohë, bashkë me klithmën «më vranë!», që atij iu duk se e dëgjoi nga tjetërkush.

U gjend përsëri jashtë vaskës, si për të ndrequr gabimin dhe ashtu, si më parë, futi njërën këmbë në ujë, pastaj pa gruan që i vinte pas, dalloi ndriçimin e sëpatës midis pëlhurës, po s'arriti ta mblidhte mendjen, madje pa u tmerruar ende nga pëlhura që iu kthye në rrjetë e i lidhi krahet, ndjeu goditjen e parë dhe pa gjakun që skuqi ujin.

U gjend përsëri jashtë vaskës, si për të ndrequr diçka, po këtë herë ngadalshëm, si ai që përpiqet ta shkoqitë gjakftohtësisht keqkuptimin. Iu afrua vaskës, avulli i ngrohtë i së cilës e bënte më të largët çdo gjë dhe lëbyri sytë nga kënaqësia. (Sa herë e kishte ëndërruar këtë vaskë në çadrën e ftohtë ushtarake, kur i palarë e gjithë nerva bënte dashuri me robinat) dhe, në çastin kur po fuste njërën këmbë në ujë, ktheu kokën nga e shoqja, si të sigurohej që lumturia ishte fare pranë. Ajo kishte ende në fytyrë të njëjtën buzëqeshje, pakëz të zhvendosur, si maska kur zhvendoset nga një lëvizje e tepërt, po, më tepër se buzëqeshja, atij i tërhoqi vëmendjen ndriçimi metalik i diçkaje që vetoi ftohtë midis pëlhurës, që e shoqja mbante në dorë. Megjithatë kaq shumë mendja i punonte te dasnuria që do të bënte së shpejti me të, sa që edhe ai metal iu duk, ose i pëlqeu t'i dukej, si diçka që kishte lidhje me një surprizë të saj, nga ato surprizat e këndshme që ajo i bënte zakonisht kur kthehej pas ndarjeve të gjata... Në atë çast ai pa të shoqen sipër tij, dhe pëlhura që u bë rrjetë, dhe bllokimi i krahëve, dhe sëpata, dhe goditja, dhe shkulmi i gjakut, dhe britma «më vranë!» ndoqën njëra-tjetrën kaq shpejt sa që u ngjitën e u bënë njësh, gjersa u gjend përsëri jashtë vaskës dhe po ecte drejt saj dhe e shoqja i vinte pas, me pëlhurë në dorë, dhe këtë herë ishte kujtimi i çadrës së fushimit, maska e buzëqeshjes të së shoqes, vezullimi i sëpatës në kohën kur futej në ujë, që u ngjitën rrufeshëm me njëra-tjetrën, për t'ia lënë, me sa dukej, ngadalsisë asaj që ndodhi më pas.

Para se të shihte të shoqen, ai pa hijen e saj sipër ujit, pastaj kur e pa me pëlhurë të hapur, qe bërë gati t'i thoshte e dashur, ç'është kjo shaka e re, por ishte pikërisht ai çast kur pëlhura iu duk tjetërlluj, me ca si nyje midis, ca si damarë, si krahët e lakuriqëve të natës, dhe ajo po binte ngadalë sipër kohës së tij, dhe sa më shumë që afrohej aq më tepër i ngjante një rrjete, madje atij iu duk se krahët iu mpinë para se t'ia prekte ajo, inadje përpara se sëpata t'i binte në qafë ai tha me vete «mbaroi», dhe nga ky mendim deri te skuqja e gjakut sipër ujit u duk se kaloi një kohë tepër e gjatë.

Ai u gjend përsëri jashtë vaskës dhe u nis drejt saj, ashtu si miliona herët e tjera për të përjetuar me ritme të ndryshme copëzën e fundit, gjithsej njëzet e dy sekonda, të jetës së tij. Ky ishte ferri i Agamemnon Atridit, vvarë nga e shoqja ditën e parë të kthimit të tij nga fushata e Trojës, në orën trembëdhjetë e njëzetë minuta të datës tridhjetenjë mars, vitit 1199 para erës sonë.

Tiranë, 23 shkurt 1990

NUDO

Po sidomos ata të dy lëshuan klithma të vogla admirimi kur ai në mes të punëve të tij u tregoi një pikturë të madhe të një vajze lakuriq.

— Bah, ç'femër!

Sytë e tyre përpinë me lakmi çdo centimetër katror dhe ai për një moment provoi një ndjenjë të keqe dhe deshi ta mbështillte përsëri pëlhurën, por ata iu lutën ta shikonin edhe pak. Pëlhura ishte shtrirë në dysheme dhe ata nuk e pyetën më për asnjë kureshtje nga jeta jashtë shtetit, po vazhduan të përpinin me sy vajzën e re, që kishte ulur kokën e menduar mbi supin e saj të djathtë dhe ishte e gjitha e freskët dhe e bardhë.

— Ishin të bukura të gjitha modelet? — pyeti njëri.

— Si të qëllonin, — u përgjigj ai i mërzhitur dhe ndezi një cigare. Pastaj u afrua te dritarja dhe vështroi përjashta se si binte shiu i imët, duke formuar gropa të vogla në oborrin e shkretë.

Ata qëndruan dhe pak dhe, duke vështruar flokët e tyre të lyster me brilantinë e të lëpirë, ai ndjeu edhe më tepër mërzi dhe shokët e fëmijnisë iu dukën më të largët se kurrë.

Njëri, ai që kishte lënë mustaqe, e pyeti për një artist kinemaje, po piktori nuk e kishte dëgjuar këtë emër dhe në sytë e tjetrit kaloi një nënqeshje çudie. Pastaj e pyetën për diçka tjetër dhe ai u mërziu edhe më shumë. Me sa duket ata e kuptuan dhe u ngritën.

— Do të dalësh, besoj, — tha ai me mustaqe, — në klub na gjen çdo natë, te bilardoja.

— Po, po, — tha piktori.

Dolën nga porta e vogël e oborrit me çadrat e hapura dhe piktori vazhdoi të vështronte se si pikat e shiut të imët binin në oborr, te hauri i vjetër mbuluar me letër serre dhe mbi mbulesën e llamarintë të pusit me çikrik.

Kur u kthye, pa valixhet e hapura dhe në dysheme pëlhurën gjysmë të mbështjellë të vajzës lakuriqe.

Duhet ta rregulloj disi dhomën, mendoi. Kjo do të ishte studioja e tij, megjithëse që e vogël, ishte e qetë dhe e këndshme, me dy dritaret ku e ëma kish vënë vazo me lule mbi parvazet e gdhendura.

Vendosi në mes të dhomës kavaletin dhe pastaj vari përballë dritareve dy piktura të tij. Pikturën e madhe të vajzës e vari në murin tjetër dhe një copë herë trazoi valixhet e rregulloi librat në një raft.

Pastaj u ul në një shezlong përballë dritares dhe po vështronte shiun. Nga kuzhina dëgjohej zhurma e tenxhereve dhe nallanet e nënës e të motrës Trokitja e nallaneve në dyshemenë e kuzhinës ishte një zhurmë kaq e njohur për veshin e tij. Kjo ishte për të si një mors i fëmijnisë që i rikujtonte një tok gjërash të narruara. Ishte po ajo trokitje e vjetër e nallaneve të nënës dhe trokitja e mëvonshme e së motrës, që ai e dallonte gjithmonë nga njëra-tjetra, dhe, megjithëqë nuk ishte i prirur ndaj tingujve si ndaj ngjyrave, vuri re menjëherë një ndryshim: trokitjet e nallaneve të nënës ishin bërë më të ngadalta dhe më të shkoqura, kurse në trokitjet e së motrës ndihej një bujë

dhe një ritëm i fshehtë e i panjohur, që ai nuk e kapte dot mirë, por e ndiente.

Ja, po vjen nëna, mendoi, duket që është lodhur nga vjetët, po vjen të më thërrasë për të ngrënë bukë.

E ndjeu se si dera e dhomës u hap pas tij dhe tani nëna do t'i thoshte frazën e vjetër, po aq të vjetër sa e gjithë kjo shtëpi: «Eja të hash, dreka u bë gati».

Po ishte tamam koha dhe një minutë më parë babai kishte hyrë në oborr, duke mënjanuar çadrën te porta dhe me siguri tani lante duart.

Nuk e kuptoi ç'e shtyri, ndoshta vonesa e frazës së zakonshme të nënës apo ndoshta ndonjë gjë tjetër dhe ktheu kokën. Ktheu kokën dhe buzëqeshi. Nëna ia kish ngulur sytë e mahnitur pikturës së madhe të vajzës lakuriq. Ai u ngrit dhe eci nëpër dhomë.

— Ç'është kjo leshprerë, mor bir? — pyeti nëna.

Ai qeshi dhe i ra supeve duke e shtrënguar në njërën krah.

— Gati është dreka, nënë?

— Po, — tha ajo me një zë të hutuar pak dhe e vështroi djalin me dhimbsuri. Ai e njihte mirë këtë vështrim të nënës së tij. Bile këtë e njihte më mirë se sa trokitjen e nallaneve të drunjtta të saj. Ajo e vështronte kështu kur ai ishte i sëmurë; apo i mërzhitur, apo kishte ndonjë hall. Dhe tani e vështroi tamam kështu sikur po e pyeste: «Ç'pësove, mor bir, mos je gjë sëmurë?».

Pastaj e vështroi prapë pikturën në mur dhe doli.

I bëri përshtypje nudoja, tha ai me vete, duke ndier të njëjtin vështrim të nënës në tryezë, po s'ka gjë, do të mësohet. Po hanin në heshtje dhe babai tek-tuk thoshte ndonjë fjalë si zakonisht nga jeta në zyrë, kurse e motra dukej që s'e kish mendjen atje, sytë e saj ishin bërë të papërcaktuar dhe nuk vështronte më drejt, po diku anash.

Ndoshta ka ndryshuar kështu që kur është fajuar, tha ai me vete. Po nuk kuptohet është e gëzuar apo jo që u

fejua. Sytë e saj janë si xhami i fotoapararit që duket turbull kur nuk është në fokus. Sidoqoftë kanë një shprehje interesante dhe janë të qartë në turbullimet e tyre.

E vështroi për një kohë të gjatë të motrën dhe pastaj tha ngadalë:

— Ke qejf të të bëj një portret?

— Kam, — u përgjigj vajza.

— Mirë, do të ta bëj ndonjë ditë, si e do, me bojëra, apo me tush?

— Si të duash ti.

— O perëndi, — murmuriti nëna dhe desh i ra luga nga dora.

— Ç'ke, nënë?

— O perëndi, — murmuriti ajo prapë. Pastaj filloi të mblihte pjatat; babai shkoi të shtrihet, ndërsa motra po pastronte tryezën.

Ai po e ndjente se babai e vështronte tani pak si ndryshe dhe në shikimin e tij bashkë me dhimbsurinë përzihej herë-herë një shprehje inati.

— Nga shkaku i kësaj pikturë që ke varur në mur, — i tha një ditë e motra. — Atyre nuk u pëlqen që ti je marrë me një gjë të tillë dhe aq më tepër që e ke varur në mur.

— Ashtu? Po ajo është punë e shkollës, të gjithë ashtu bëjnë.

— Po ku e dinë ata?

— Aha, prandaj babai nuk hyn kurrë në dhomën time.

— Ai më ndaloi dhe mua të njej këtu, — tha e motra.

— Ashtu?

— Ata janë shumë të shqetësuar, — përsëriti e motra.

— Budallallëqe, — tha ai. — E ç'u duhet atyre se ç'kam varur unë në mur?

-- Nuk është vetëm aty puna, po sidoqoftë bota mund të flasim, nuk është mirë.

— Cila botë? Ç'i hyn në punë botës se ç'kam varur unë në mur!

Ajo nuk foli dhe përsëri uli sytë e saj të turbullt, të bukur.

— E di? — tha ngadalë. — Ky muhabet është bërë edhe në shtëpinë e Seitit dhe atyre nuk u pëlqen kjo gjë.

— Ç'hyn këtu shtëpia e Seitit, ç'hyn këtu i fejuari yt?

— Po ata e morën vesh këtë gjë të dielën, kur Xhixhia kaloi pas buke në korridor dhe dera e dhomës tënde ishte e hapur, — tha vajza. — Për drej ajo e pa dhe siç duket ua tha atyre në mbrëmje.

— E pastaj?

— Seiti tha se kjo nuk ishte gjë e mirë dhe nuk e mbaj mend ç'tha tjetër, po foli gjatë.

Ai ndezi një cigare dhe e ndiente që po bëhej nervoz.

— Po ti ç'i the?

— Ç't'i thoshja? Asgjë!

— Shkrepe mizerje, — murmuriti ai duke ndezur cigaren.

Kaluan ca çaste në heshtje.

— Ti e do Seitin, — pyeti ai papritur.

Vajza uli kokën dhe vështroi një copë herë dyshtemenë, pastaj e ngriti dhe sytë e saj ishin më të papërcaktuar se kurrë.

— Jo!

Kurse zëri i saj është kaq i vendosur, mendoi ai dhe e ndjeu se kjo ishte e vërtetë dhe se motra e tij kurrë nuk e kishte dashur të fejuarin.

— Po pse u fejove atëherë?

Ajo nuk u përgjigj.

Ai rrinte në shezlong dhe sytë i shkuan te piktura e madhe. Qëndruan një copë herë kështu në heshtje, asaj i vinte turp të ngrinte kokën e të shihte vajzën lakuriq, megjithëse kur ishte vetëm në shtëpi e shikonte gjithmonë.

Kurse ai e vështronte pikturën dhe papritur iu kujtua

nata kur e kishte takuar modelin rastësisht në trainvaj dhe ishte hera e parë që e shihte të veshur e bile të veshur trashë. Kjo kish ndodhur disa muaj më vonë pasi kish bërë pikturën dhe që atëhere ajo nuk pozonte më. Ai që gëzuar shumë që ajo ishte e veshur dhe që nuk pozonte më; dhe binte një dëborë e tillë, e bukur, e ngrohtë. .

— Ç'të bëja? — tha papritur e motra, duke ngritur sytë nga dyshemeja. — Duhet të fejohesha me një njeri, apo jo? Si mund të kundërshtoja. Ti e di ç'bëhet po t'u kundërshtosh atyre.

...Kurse kur e puthi te hyrja, atij iu duk se po puthu diçka të njohur dhe mendoi se ishte më e lehtë t'i puthje se sa t'i vizatoje buzët e sai. . .

— Apo jo? — tha motra. — Ti nuk më dëgjon? — tha e motra.

— Më fal, s'e kisha mendjen. M'u kujtua diçka.

— Ty gjithmonë se ç'të kujtohet, dinak.

Ata qeshën me gjithë zemër fare kot dhe ai tha papritur:

— Shkojmë në kinema?

— Shkojmë! — gati sa s'bërtiti ajo nga gëzimi, — unë kam shumë qejf të shkoj me ty në kinema.

— Po dal të marr bileta.

Veshi pardesynë dhe doli.

Dëborë po binte në oborr flokë-flokë dhe çatia e haurit nuk dukej më e zezë. Ai vështronte flokët e dëborës i menduar. Dera e oborrit u hap dhe që pas xhamit ai pa se si hyri hoxha me të shoqen. Xhybja e vjehrrit të ardhshëm të së motrës dukej akoma më e zezë në sfondin e dëborës.

E diel e mërzitshme, mendoi. Duhet të gjej ndonjë shkak të dal për drekë. Kush rri me ta në një tryezë. Po çudi,

pse nuk erdhi dhe Seiti. Ai vjen gjithmonë të dielave për drekë me ta. Sa i zi dukej hoxha në dëborë.

Mendoj diçka dhe qeshi me vete.

Do të revoltohen, tha me vete, por unë do t'ia tregoj vetëm motrës.

Mori një letër të bardhë dhe filloi të bënte skica. Pastaj u ngrit, veshi pallton dhe doli.

— S'është mirë të ikësh, — i tha nëna.

— Kam punë, nënë.

Dëbora vazhdonte të binte e thatë dhe e pastër dhe në çdo qosh rrugice kalamanjtë kishin zënë pusi dhe gjuanin kalimtarët. Ai luftoi me topa bore me një grumbull kalamanjsh dhe e ndjeu veten të gëzuar. Në shtëpinë e kulturës gjeti shokët e tij të rinj, me të cilët shoqërohej kohët e fundit dhe të gjithë bashkë shkuan në kafe, në qendër të qytetit.

Kur u kthye ata kishin ikur. Dëbora kishte pushuar dhe në shtëpi ishte qetësi. E ndjeu se kish ndodhur ndonjë gjë e vogël, nga ato qindra gjërat e vogla të mërzitshme që mbushnin shtëpinë e tyre në ditët e gjata monotone.

— Dëgjo, — i tha babai, ndërsa ai po zhvishte pallton. — Dua të bisedoj me ty.

— Fol, baba.

Nëna bënte çorape dhe e motra hekuroste mbi tryezë. Ai vështronte se si vajza provonte hekurin e nxehtë duke lagur gishtin në gojë me atë gjestin e saj të pandryshueshëm.

— Bota flasin, — tha babai i ngrysur.

— Nuk të kuptoj, baba, ku e ke fjalën.

— Jo, ti më kupton ku e kam fjalën, — tha me inat

babai.

— Nuk të kuptoj.

— E pra po ta them, e kam fjalën tek ajo që ke varur në mur.

— Ah, po.

— Jo ah po, po kështu nuk bën, more djalë. Nuk bën të marrësh kështu nëpër këmbë prindërit e tu dhe ndërin e familjes. Hiqe atë djall nga muri!

Piktori nuk u përgjigj menjëherë, sepse e ndiente se po nxehej dhe nuk donte të grindej me babanë.

— Nuk e heq, — tha.

— Bota flasin, — vazhdoi babai — dhe njerëzit kanë të drejtë të flasin. Ata mendojnë shumë gjëra dhe kanë të drejtë. Të afërmit e Seitit nuk po na vijnë më për vizitë.

— Ashtu? — tha piktori. — Aq më mirë.

— Ty aq të bën, sigurisht, po duhet të mendosh për ndërin e familjes dhe mos harro se ke dhe motër

— Ç'punë ka motra me pikturën time?

— Në qoftë se ke vendosur të marrësh nëpër këmbë emrin tënd, së paku mendohu për të ardhmen e motrës sate, — tha babai.

— Tani po e marr vesh, — tha piktori. — Sigurisht ka lllapur ai hoxha.

— Së paku fol më me respekt për një burrë të ndërshtëm, të shkuar nga mosha, së paku përpara motrës sate.

— Nuk dua që në punët e mia të fusin hundët hoxhallarët, këta paçavure mizerabël, — thërriti djali.

— S'ke turp, — thërriti babai.

— Nuk kam turp.

— Me babanë tënd flet kështu ti, i pahairë, ti që të kam ushqyer me bukë, dhe për se ja, për një kurvë të huaj? Nëna zuri kokën me duar.

— Ju të gjithë i bini avazit të hoxhës.

— Harram e paç bukën time, — ulëriu babai dhe ai nuk e dëgjoi më se ç'tha tjetër, sepse doli duke përplasur derën dhe hyri në studio. U ul në shezlong dhe po vështronte dëborën e madhe dhe të qetë përjashta. Një sorrë e zezë kishte qëndruar mbi çikrikun e pusit dhe çatia e haurit dukej krejt e bardhë nga dëbora.

Nuk të duan, tha me vete duke iu drejtuar pikturës, ç'iu ke bërë që nuk të duan.

Ne po shkonim rrugicës së ngushtë dhe kishim ngritur jakat e pardesyve që mos të na futej shiu në qafë.

— Përveç këtyre mendoj të paraqes edhe një akva-rel, — më tha piktori.

— Kur mbaron afati i paraqitjes për ekspozitë? — e pyeta.

— Për dy javë, por unë pothuaj i kam përfunduar të katër punët. Dua të marr mendimin tënd, sidomos për një-rën.

Unë nuk i njihja rrugicat e këtij qyteti të vogël megjithëse ishte hera e dytë që po vija aty me shërbim.

— Ja këtu, — tha piktori. Shtyu kanatin e një porte dhe hymë në oborrin e vogël të shtëpisë përdhese. Një vajzë e re simpatike po rrotullonte çikrikun e pusit.

— Motra ime, — ma paraqiti ai

Kaluam korridorin dhe hymë në studio.

— Ulu, — tha dhe më tregoi një shezlong.

Në studio ishte ai çrregullimi i zakonshëm, i gjallë, që mua më pëlqen gjithmonë dhe ndihej era e bojës së freskët. Të mbështetura pas murit po thaheshin dy telajo që siç duket ai i kishte përgatitur një ditë më parë. Muret qenë mbushur plot me piktura dhe eskize të varura pa sistem.

— Njëra është kjo, — tha ai, duke më treguar një nga pikturat ku qe vizatuar një hoxhë që ecte me kujdes mbi dëborën e bardhë. Unë u ngrita dhe u mënjanova pak anash për ta parë më mirë.

— Më pëlqen shumë, — thashë, — megjithëse nuk marr shumë vesh nga piktura. Po më pëlqen se ke mundur

ta përfytyrosh hoxhën si një njollë të errët mbi sfondin e pastër.

— Tamam këtë ide desha të jepja.

Ai po bëhej gati të më tregonte pikturat e tjera kur mua më vajtën sytë në mur, te një pikturë e madhe e një vajze, që ishte e mbuluar me një perde basme që nga gjinjtë e poshtë. Koka e vajzës ish e anuar pak nga e djathta dhe sytë i kish drejtuar mbi supin e saj të bukur, e menduar.

— Po këtë, — i thashë, — pse e ke mbuluar?

Ai buzëqeshi me një buzëqeshje të përmbajtur dhe tundi kokën.

— E ka mbuluar nëna, është një histori e gjatë.

Dhe më tregoi si kish ndodhur.

Ndezëm nga një cigare dhe qëndruam një copë herë pa folur.

— Ishte një farë «kompromisi» — tha duke qeshur. — U lodha nga grindjet dhe më në fund i thashë nënës ta mbulonte me perde, sepse për ta hequr nga muri nuk desha në asnjë mënyrë. Mos kujto se e bëra për sentimentalizëm që nuk e hoqa nga muri, po nuk desha të dilte fjala e hoxhës.

Ne vështruam të dy vajzën me perde dhe papritur na hipi një gaz i papërmbajtur. Filluam të qeshnim me zë të lartë, duke thirrur: «O ç'vete!».

— E pastaj?

— Pastaj çdo gjë pak nga pak përsëri u normalizua. Tani disa kushërinj pleq, që nuk na vinin, na vijnë përsëri dhe njerëzit flasin më pak.

— Interesante kjo gjë, — thashë. — Megjithëse...

— Çfarë? — tha ai.

— Megjithëse mendoj se edhe ti je treguar pak mendjelehtë.

— Pse?

— E ke marrë pak si tepër seriozisht gjithë këtë punë.

— Nuk të kuptoj, — tha ai.

Unë nuk e kisha të lehtë t'ia shpjegoja.

— Megjithëse ti ma theksove shumë anën klasore të kësaj çështjeje, kam parasysh hoxhën, — thashë unë duke qeshur, — prapë mendoj se me prindët e tu mund të tregoheshe më pak parimor. A mundet njeriu të tregohet kaq parimor me nënën e tij, duke e ditur se si ka jetuar dhe ku ka jetuar ajo për gjysmë shekulli rresht?

— Ndoshta ke të drejtë, — tha ai i menduar. — Por ja, unë më në fund u binda, e mbulova atë përgjysmë.

— Kam përshtypjen se je bërë pak mizantrop, — i thashë, duke ndërruar bisedën. — A është e vërtetë?

— Si të them? — tha ai. — Jam pak i veçuar nga njerëzit, kjo është e vërtetë. Ti e di çështje karakteri.

Ne qëndruam një copë herë pa folur.

— Ajo i shqetësoi shumë ata, — tha duke vështruar pikturën sikur donte t'ia pohonte asaj sesa shumë i kish shqetësuar të gjithë.

— E megjithatë ishte vetëm një pikturë, — thashë. Nuk foli dhe thithi cigaren.

— Po tani çdo gjë po shkon normal, — përsëriti, — dhe për motrën u bë më mirë që u nda nga i fejuari. Ajo atë nuk e donte fare dhe për të u bë më mirë që ndodhi kështu.

Në kuzhinë u ndien dy palë nallane dhe vajza lakuriq vazhdonte të mbante kokën të mënjanuar pak mbi supin e djathtë dhe sytë e saj ishin të menduar. Ajo dukej qesharake mbuluar me atë futë prej basmeje.

UR — LIBRI

I

Kur miku im K.V. më foli për pasionin e tij të fundit, nga që kishte bindjen se edhe ky do të ishte diçka e përkohshme si gjithë të tjerët, e dëgjova duke u përpjekur të hiqem si i vëmendshëm, ndërsa, të them të drejtën, mendjen e kisha gjetkë.

— Ti më ndjek? — pyeti ai papritur nga që e ndjeu, siç duket, që unë s'isha aty.

— Natyrisht, — i thashë dhe u përpoqa të mos e vështroj. — S'është herë e parë që flasim për këtë.

Në të vërtetë s'ishte herë e parë që bisedonim lidhur me artifiksin në letërsi. Kohët e fundit çdo ditë e më tepër ai ngulte këmbë se kishte shumë artifice në librat, aq shumë sa që habitej se si njerëzit, të lodhur prej tyre, nuk i braktisnin libraritë, duke thënë «mjaft!» Ka shumë strukturë, ambalazh, sajime të qepura me pe të bardhë, vazhdonte ai. Ne tallemi sot me ato romane ku autorët i fillojnë kapitujt me fraza të tilla si: «Dhe tani, i dashur, lexues, le ta lemnë heroin tonë në bregën e tij, dhe le të ndjekim fatin e heroinës etj. etj.» Ne tallemi me truke të tillë dhe nuk

mendojmë aspak se ajo që shkruajmë vetë nuk është më pak artificiale se këto dhe se brezat e ardhshëm do të tailen me ne njëlloj si ne me të mëparshmit.

Kishim folur pra gjatë për këtë. Ai ngulte këmbë për domosdoshmërinë e një novatorizmi rrënjësor, sidomos në gjininë e romanit, një rinovim (ose risije, siç thoshin kohët e fundit kritikët), të tillë, që të ishte i aftë t'i bënte të panevojshëm të gjithë truket letrare, klisheetë, konvencionet, gjithë këtë ambalazh bezdisës, që e pengonte letërsinë t'i afrohej jetës.

Unë e kundërshtoja. Po ta merrje kështu, vetë akti i të shkruarit ishte artificial. Ca shenja e shenjëza mbi letër, mbi të cilat njeriu rri me orë të tëra seriozisht, si budalla. A s'është kjo gjë novacioni, a konvencioni, a marifeti (merre si ta duash) më i madh që ka shpikur njerëzimi, në krahasim me të cilin gjithë rinovimet e mundshme të gjinive letrare s'janë veçse cikërrima?

Ai hutohej një çast, po hutimi që i përkohshëm. E merrte veten më shpejt se ç'e prisja për të më kujtuar Floberin, i cili i pakënaqur nga ato që kishte krijuar, ëndërronte të shkruante një libër «për asgjë», po që do të ishte në të vërtetë një libër për gjithçka. A nuk e kishte joshur mendjen e kaq krijuesve të mëdhenj ëndrra e librit të përgjithshëm, përmbledhës, total, me fjalë të tjera, të një ur-libri? Bibla që përpjekur ta zëvendësonte atë, por ajo që ende larg, shumë larg. Të tjerë krijues, madje të kohës sonë si Ezra Paundi e Borghesi kishin rendur pas kësaj ideje, po pa e realizuar dot. Kishte dhe institucione të tëra që mërrëshin me këtë, si p.sh. në SHBA, ku në një bunker kolosal nën tokë, në fletore apo shirita të pafundme po regjistroheshin gjithë emrat e njerëzve që kanë jetuar e jetojnë në këtë planet. Është një gjë e hatashme, më kupton, vazhdonte ai. Gjithë emrat e racës njerëzore, siç janë gjetur në dokumente, libra, shënime «kujtesë», brez pas brezi e epokë pas epoke. Vetë ideja është e bukur: përfitim i botës si

një shtëpi, një familje, me të gjallët e të vdekurit e vet. Ide e bukur, pa dyshim, po prapë mbetet e mangët. Materiali është tepër i shtrirë, i palidhur nga mendimi. Është njëlloj si të përpiqësh ta kuptosh këtë botë vetëm nëpërmjet leximit të fjalorit ose të enciklopedisë. Kurse unë e mendoj këtë gjë ndryshe. E përfytyroj, përshembull, që kjo botë, ky trup qiellor, ku breznitë njerëzore erdhën e ikën, u shua një ditë, mbaroi dhe ti, për një lojë rrethana-h, shpëtove. Ti i vetëm pra, i ike vdekjes, shuarjes dhe ashtu vetmitar, dëshmitar unik i globit tokësor, ndjen për detyrë t'i rrëfesh universit atë çka u shua në globin e vogël të kaltërt, çka ndodhi atje gjatë mijëra vjetsh, si lindën e vdiqën breza njerëzish e gjallesash, shtete e popuj, pamje, ëndrra e tinguj. Ti nuk ke arritur të marrësh me vete asgjë nga ky planet: asnjë shtatore a kristal, asnjë dosje a gjymtyrë femre, asnjë fotografi, hartë, mineral, objekt të çfarëdoshëm, madje asnjë grusht dhe. Ti s'ke asgjë nga këto, po ti ke një libër të vogël ku je përpjekur të përmbledhësh tërë botën, një libër që e ke hartuar për një rast të tillë fatkeq. Me të nën sjetull ti do të dalësh përpara universit për të dëshmuar.

Mërrret me mend sesa i vështirë ka qenë shkruani i këtij libri. Atje s'duhej të kishte asgjë të tepërt e ndërkaq asgjë të mangët. Por edhe më e vështirë se kjo ishte ruajtja e raporteve të drejta për vendin që do të zinin në faqet e librit gjërat, gjallesat a dukuritë e ndryshme. Se nuk ishte e lehtë të gjeje ç'kishte qenë më e rëndësishme në këtë botë: oqeanët, ligjet, seksi femëror, mapua e qendrës, simfonitë e njëfarë Bethoveni, piramidat, elektriciteti, ulërima e erërave, pendimi njerëzor, përmbysja e shtetit, ankthi i letrës së vonuar, gjumi i miliardave, hyjnitë, çmenduria, alfabetet, kinezët, thika mbretvrasëse, ferri, sperma e njeriu, zbërthimi i uraniumit, kryqëzimi i Krishtit, revolucionet, mallkimi, pikëllimi vjeshtor nën pikat e para të shiut që s'ka rënë prej kohësh, egërsimi i tiranit, netët

me hënë, netët makbethiane, sipas emrit të njëfarë Makbethi, tërmetet, vetmia e Don Kishotit (kalorës endacak), komunizmi, krediti bankar, internimet, ankthi i kthimit të të vdekurit etj. etj.

Ndërsa fliste, ai përsëriste vazhdimisht «më kupton tani», dhe unë duhej të tundja kokën gjithmonë e më energjikisht në mënyrë që ai të mos më lodhte me atë «më kupton tani» të mallkuar.

Kështu e mbaj mend prej vitesh: të shqetësuar, në ankth, në kërkim të së pamundurës.

Ti mendon se një libër i tillë është i pamundur? — pyeti paspak. — E shoh që ashtu mendon, s'ka nevojë ta thuash.

— E mundur është vetëm ideja e tij, po mendoj që edhe kaq mjafton.

Ai tundi kokën.

— Kurse unë mendoj ndryshe. Kur lind ideja për diçka, ajo diçka është në prag.

— Ndoshta. — iu përgjegjja i lodhur. — Po ndoshta njerëzimi s'ka nevojë për librin total, kjo është ndoshta edhe arsyeja që ai s'është shkruar.

Ai prapë tundi kokën në mënyrë mohuese.

— S'mund të jetë ashtu. Shumë gjëra njerëzimi s'i ka arritur ende, po kjo s'do të lhotë se s'ka nevojë për to.

Përpiqesha të mos e acaroja nga që e dija se çdo shpërthim i tij e lodhte atë vetë më tepër se mua. Në të vërtetë kisha kënaqësi ta dëgjoja, kur fliste më i qetë. Kisha kënaqësi sepse shumë nga idetë e tij ishin të bukura, megjithëse të paralizueshme. Një vit më parë më kishte thënë se dëshëronte të shkruante një libër vërtet të jashtëzakonshëm: Historia e perandorisë osmane në TV, një libër pra hamendësuar, sesi do të ishte historia e këtij shteti sikur të ekzistonte rrjeti televiziv, ç'ngjarje do të shpejtoheshin, e ç'të tjera do të frenoheshin ose s'do të ndaleshin fare, e kështu me radhë. Për fat të mirë e kishte braktisur

shpejt këtë projekt për t'u dhënë pas një tjetri që mua m'u duk tepër i arsyeshëm: një libër për rrugën ku banonte, një libër i vogël ala Flober me përshkrimin e të gjitha hanesave e të gjithë banorëve që banonin në to, me të dhënat e plota për jetën, pasionet, hallet, sëmundjet, gjyqet, librezat e kursimit etj. etj. që plotësoheshin me kanalizimet e nëndheshme, rrjetin e ujësjellësit, rrjetin telefonik, faturat, defektet etj. etj. e gjer te të dhënat e tjera. që ngjanin si vocërrima: riparimet e ndryshme, vizitat e gjer te numrat që mbanin varret sipas regjistrimit në librin e varrezës së qytetit.

Një libër i tillë, pavarësisht nga teprimet, më qe dukur i mirë për arsyen e vetme se e lidhte atë me jetën dhe njerëzit. Mirëpo kurrsesi nuk e kisha menduar se ai do të ishte një shkallë, e cila do të shtynte atë drejt një synimi të ri: librit total.

II

Veç të mos jetë për atë, mendova, kur më mori pas disa muajsh në telefon dhe me një zë të rëndë, serioz më ftoi në kafe. Një parandjenjë jo e mirë më thoshte se ishte pikërisht për atë librin total. Dhe parandjenja nuk më gaboi. Porsa hyra në kafe, ku ai më priste, e kuptova që jo vetëm e kishte shkruar, po e kishte me vete librin.

E larguam sa mundëm të dy bisedën për të, unë me një shpresë të fundit, të vakët se ndoshta pendohej e nuk ma tregonte, ai, për ta shijuar ndoshta më shumë pritjen përpara lumturisë, gjersa erdhi çasti kur asgjë nuk mund të shtyhej më.

Kisha një nervozizëm të brendshëm, të shurdhër sa që fill për fjalëve të tij të para, e ndërpreva.

— Po si arrite t'i futësh të gjitha ato që më ke thënë: të gjallët, të vdekurit, zhurmat, sendet, me një fjalë tërë atë kazan që zien ditë e natë e që quhet botë?!

Ai më vështroi ngultazi.

— Unë nuk kam bërë asgjë nga këto, — tha ngadalë — Madje kam bërë të kundërtën.

— Të kundërtën?

Ai buzëqeshi me vete.

— Më tepër se pasuria e informacionit, librin tim e bëri total e kundërta e tij, domethënë mungesa.

— S'po kuptoj asgjë.

Ai buzëqeshi prapë, siç dukej kështu e kishte menduar këtë punë, sa më tepër që libri të shkaktonte habitje, mundësisht shastisje, të bashkëbiseduesit aq më origjinal ishte.

— E pra mungesa, heshtja, shkretimi, sidomos për tre-katër mijëvjeçarët e fundit të njerëzimit, atëherë kur ai ka qenë edhe më i zhurmshëm, është karakteristika kryesore, baza e strukturës së librit tim.

Ai priti që unë të lëshoja klithma të tjera habie ose mosbesuese, por unë e kisha mbledhur ndërkaq veten për të mos ia dhënë atë kënaqësi. Pa i hequr sytë nga çanta e tij e zezë, e fryrë pak në mes, si të ishte e mbartur me djallëzi, (pikërisht me një ton të tillë, sikur të thoshte «tregoma më në fund atë diall»), i thashë:

— Tregoma më në fund librin.

Ai e hapi çantën dhe me një lëvizje të kujdesshme nxori prej saj atë që gjer në grimën e fundit e prisja që të ishte gafore, shishe rakie, orë muri e ndrequr, a dreqi e di çfarë, sesa libri për të cilin më kishte folur.

III

^R Gjatë më shumë se një ore më shpjegoi strukturën e tij, e cila, duhet ta pohoj, se m'u duk më se e çuditshme.

Ishtë vërtet një libër total, për botën dhe njerëzimin gjatë njëqind mijë vjetve të fundit, domethënë nga njeriu i Nendertalit gjer në ditët tona. Gjer këtu s'kishte ndonjë gjë origjinale, përderisa ishin shkruar me qindra të tillë. Origjinale ishte tjetër gjë dhe pikërisht sasia e faqeve ose rreshtave që i kushtohej çdo periudhe. Kjo sasi ishte në raport të drejtë me gjatësinë e periudhës që përshkruante. Në bazë të këtij kriteri, përderisa të dyqind faqet e librit ngërthenin një kohë njëqindmijë vjeçare, çdo mijëvjeçari i takonin vetëm dy faqe, rrjedhimisht çdo shekulli rreth gjashtë rreshta. Gjithmonë në bazë të këtij kriteri gjithë historia e njohur e qytetërimit njerëzor (rreth katërmijë vjet) përmbli dhej në rreth tetë faqe, kurse shekullit të njëzetë mezi i takonin gjer tani pesë rreshta.

Ai priti me siguri që t'ia bëja unë pyetjen: «po pjesa tjetër e librit, pra njëqind e nëntëdhjetë e dy faqet e tjera, me se merret, po kur pa se unë vonova, e humbi durimin.

— Ti do të thuash, po pjesa tjetër e librit me se merret? Tani do të ta shpjegoj.

Ajo që më shpjegoi ishte edhe më e habitshme. Në të njëqind e nëntëdhjetë e dy faqet e tjera, domethënë në faqet që i përkisnin periudhës përpara qytetërimit, përshkruhej koha e gjatë, e errët e monotone e njerëzimit dhe kjo nuk bëhej as me ide, përfundime apo zhbirime shkencore, po thjesht në formë kronike. Dhe tamam këtu qëndronte kyçi i librit. Ndërsa sipas kriterit Luftën e Dytë Botërore autori duhej ta jepte me një të tretën e një rreshti (pra rreth dy-tre fjalë), mprehjen e kockave, fërkimin e drurëve për të ndezur zjarrin, ose veprime të tilla të ngjashme të njeriut primitiv ai i përshkruante me dhjetëra e dhjetëra faqe, dhe në një mënyrë të përsëritur, monotone e lodhëse që t'i përgjigjej pak a shumë kohëzgjatjes së tyre nëpër shekuj. Është e tepërt të nënvizohet se, ndërsa shpikjes së armës atomike, ose shpikjeve të tjera të mëdha, me vështirësi u takonin një ose dy rreshta, mprehjes së kockës

në formë thike i kushtoheshin gati dhjetë faqe të librit.

— Ti e kupton sesa mund më ka kushtuar e gjithë kjo, — më tha ai. — Mund i tmerrshëm për të dhënë tërë atë përsëritje cflitëse, të pafundme, skëterrore të përparimit të ngadaltë të njeriut nga njëra anë dhe po aq mund, në mos më tepër, për të dhënë në mënyrë sa më të dendur, ashtu siç ta shpjegova, kohën e re.

Ai më shpjegoi pastaj se kishte një mënyrë për të zgjeruar vendin që zinte koha moderne, po kjo sillte ndërlikime të tjera. Kështu p.sh. në qoftë se e rriste gjer në pesë herë kohën e re, duke i dhënë një shekulli jo gjashtë po tridhjetë rreshta, gjë që dukej një luks i madh, ishte i detyruar që librin nga dyqind ta kthente në njëmijë faqe. Rrjedhimisht mprehja e kockave ose fërkimi i drurëve nga njeriu primitiv, që edhe kështu siç qe ngjante i zgjatur e monoton, do të zinte qindra faqe.

— Ja në ç'mëdyshje ndodhem, — tha ai. — E vështirë, apo jo?

Porositëm edhe nga një kafe tjetër dhe unë më kot përpiqesha të kujtoja nga njohuritë e përcepta që kisha për psikiatrinë se në ç'lloj deliri mund të hynte shkrimi i një libri të tillë.

— E megjithatë kjo s'është dhe aq e vështirë për ta krahasuar me projektin e parë, të cilin, e pohoj sinqerisht, e braktisa nga që nuk ma mbante. — Sipas tij, në libër do të jepej jo vetëm koha që nga njeriu i Nendertalit, po që nga njerëzit e parë, me fjalë të tjera jo njëqind mijë, po një milion yjet. Dhe atëherë gjithashtu do të ishte shumë më e dendur dhe një shekulli nuk do t'i takonin gjashtë rreshta, po dhjetë herë më pak, domethënë pak më shumë se gjysmë rreshti, me fjalë të tjera, rreth dyzet shkronja. . .

Nuk e di ç'na shtyu të vështroheshim të dy në sy dhe në vend të ndriçimit të marrëzisë unë dallova në to një pikëllim të madh. Si të qe kapur në grackë, ai u përpoq

më kot ta hiqte vështrimin, pastaj befas zuri kokën me duar dhe u shkund i gjithi nga gulçi.

Nuk e pyeta «ç'ke», sepse m'u duk më e udhës ta lija të çlirohej. E kishte ende zërin të zbutur nga gulçimi kur më tha:

— Mua s'më do gruaja.

Qëndruam të dy në heshtje, duke mos i hequr sytë nga çanta e zezë, brenda së cilës ishte libri, ai që duhej të qe streha e tij e sigurtë kundër vogëlsive të jetës, pika madhështore e krahasimit, në raport me të cilin gjithçka tjetër duhej të dukej e përkohshme, e parëndësishme dhe kalimtare; ngushëllimi i tij, harresa, çlodhja, burimi i zilisë e i admirimit të të tjerëve: (sa lart, në ç'sfera të paarritshme endet mendja e tij) shkurt droga e tij, që për herë të parë ndoshta nuk po i bënte efekt.

Nuk di sa qëndruam ashtu, unë duke mos e hequr dot shikimin nga çanta e zezë, ai duke fshirë herë pas here sytë me shuplakat e duarve, gjersa erdhi kamerieri dhe ne për habinë e tij, porositëm nga një kafë të tretë.

11 korrik 1986

BALADË PËR VDEKJEN E J. G.

1

Spitali i ri i qytetit të vogël Untergruppenbah (ai në të cilin dhjetë muaj më vonë, pikërisht, në një ditë të ngjashme, do të vdiste J.G) u përrua në mbarim të dimrit. Ishte ftohtë dhe kishte ende dëborë të pashkrirë në kopshtin dhe rrethojën prej kangjellash të hekurta. Bardhësinë e saj, sidomos në ato vende ku ajo kontrastonte me tokën e zezë, kronisti i TV e shtrëzoi me mjeshtëri në marrjet e tij, duke u gërshetuar me kontrastin që krijonin përparëset e bardha të personelit shëndetësor me kostumet e zeza të zyrtarëve e të të ftuarve të tjerë në ceremoni. Ishte pa dyshim një rastësi, po në sfond të asaj pamje tingëllonin vërtet bindshëm fjalët e drejtorit të spitalit, i cili pasi falenderoi qeverinë e landit të Baden Vyrtenbergut për kujdesin e saj dhe pasi i siguroi qytetarët e Untergruppenbahut se ai bashkë me gjithë personelin tjetër do të bënin çmos që të përligjnin këtë kujdes, e përfundoi fjalën e tij me mbyllje disi patetike, që bëri shumë njerëz të përloleshin. Të jeni të bindur, tha ai, se në këtë spital jeta do të

luftojë kundër vdekjes, drita kundër errësirës, e mira kundër së keqes. Do të luftojmë dhe do të fitojmë.

2

Ministrisë së Punëve të Brendshme të Landit të Baden Vyrtenbergut, Drejtorisë së Emigrantëve.

Unë i nënshkruari J.G, ish-qytetar jugosllav, me kombësi shqiptare, me profesion gazetar, i arratisur nga RF e Jugosllavisë për arsye politike, duke falenderuar edhe një herë qeverinë e RF Gjermane për dhënien e strehimit politik, shfaq dëshirën time që, për arsye sigurimi, të vendosem në Untergruppenbah.

Siç kam deklaruar edhe në kërkesën time për strehim politik, krahas punës sime si gazetar do të merrem njëkohësisht, ashtu si edhe më parë, me letërsi dhe me muzikë.

Me respekt etj, etj.

3

Drejtorisë së spitalit të Untergruppenbahut. Në bazë të shkresës Nr. 311 dt. 3.V.1980 të Ministrisë së Shëndetësisë së Landit të Baden Vyrtenbergut, bazuar në protokollin e bashkëpunimit kulturor midis RF Gjermane dhe Jugosllave, nënshkruar nga qeveritë e të dyja vendeve (pika 14 C e aneksit mbi këmbimin e përvojës profesionale) mjeku jugosllav G. Vidiç, kirurg, dërgohet në spitalin tuaj për një afat njëvjeçar.

4

Nga hetimet private për G. Vidiçin. Vidiç? Ishte një burrë i gjatë, afër të pesëdhjetave, apo ndoshta dukej aq për shkak të tëmthave të thinjur. Ishte profesionist i mirë, madje unë disa herë kisha bërë me vete pyetjen vërtet përfiton ndonjë gjë të madhe në spitalin tonë? Fliste mirë gjermanisht, ishte i rregullt dhe kishte fituar simpatinë e një pjese të mjekëve për gatishmërinë që tregonte për t'i zëvendësuar në rojën e natës.

Në fillim ne ia kërkonim me druajtje një gjë të tillë, kishim përherë frikë se mos abuzonim me gatishmërinë e tij, po pastaj e kuptuam se e bënte këtë gjë me dëshirë. S'ka pse të druhe mi, tha një ditë kolegu ynë. Ai është i huaj këtu dhe, në atë mënyrë jetese të mbyllur që bën për kalimin e mbrëmjes, roja e natës është pa dyshim formula më e përshtatshme, për të përdorur një shprehje tepër të kohës.

Tjetër?

Çfarë të them unë tjetër? Ishte gjithmonë një tip i qetë. Veç e kapte një lloj trazimi, ndoshta kjo s'është fjalë e saktë, një lloj ankthi do të thosha, ndonëse edhe kjo s'është e saktë. S'di si t'jua shpjegoj, do ta quaja trazim, ndoshta edhe ankth, sikur të mos kishte një si pikë të ngrirë në vështrim. Afrohej te xhamllëku i madh i dhomës së pritjes, ja atje, dhe ashtu përhumbshëm vështronte rrugën automobilistike. Nganjëherë të dukej se priste diçka apo ndoshta e jepte këtë përshtypje ngaqë ishte i huaj dhe dihet që për një të huaj rruga do të thotë diçka më shumë se për vendësin: andej vijne letrat për të, ndonjë pako për Vitin e Ri, lajmet për të vetët.

Ah, me që ra fjala për postën. desha të them se ishte veçanërisht i ndjeshëm ndaj ziles të telefonit. Madje disa

herë po ta vëreje me kujdes të jepte përshtypjen se ishte në përgjim të paprerë të tij. Po kjo ishte gjithashtu e kuptueshme për një të huaj, megjithëse duhet thënë se nuk mbaj mend t'i kenë telefonuar ndonjë herë të vetët, me përjashtim të ndonjë rasti, në mos gabohem në kujtesën time.

Dhe ky përgjim i telefonit mos u shpeshtua kohët e fundit?

Nuk mund ta them një gjë të tillë, më kuptoni, ishte një gjë të them e rëndomtë, që edhe po të ndodhte vështirë se do të binte në sy. Një gjë mund të ishte me të vërtetë pakëz e habitshme, madje, që të jem i saktë duhet t'ju pohoj se tani që po ę sjell ndërmend, po më duket për herë të parë e tillë. Po, para se të vij te kjo, desha të them se ajo turbullira për të cilën fola pak më parë, domethënë xhamllëku, ngrirja e vështrimit, rruga automobilistike etj. ndodhte sidomos sa herë që dëgjohej sirena e makinës së ndihmës së shpejtë, e asaj që sillte të aksidentuarit. Ishte ndonjë kujtim personal, tronditja para operimit të ngutshëm apo diçka tjetër, vështirë ta përcaktosh. Ai nuk ishte mjek i ri, dorën e kishte të sigurt dhe veç kësaj dihet që operacioni i ngutshëm i një të aksidentuari të mbytur në gjak, ka gjithmonë më pak ankth se operimi i të sëmurit për të cilin ke ditë që përgatitesh.

Kështu që... ah, po e kisha fjalën, të gjeja e habitshme që e përmenda pak më parë. Pra, të gjitha këto ishin të shpjegueshme njëfarësoj. E vetmja gjë që mund të dukej e habitshme ishte fakti se kureshtja e tij për telefonin (nuk e di në se fjala kureshtje është e përshtatshme për këtë rast,) pra kureshtja e tij për telefonin, në vend që të zbehej, me afrimin e makinës së urgjencës të theksohej më tepër. Kështu, për shembull, e mbaj mend fare mirë rastin kur pasi kishte vënë dorezat e operacionit dhe maskën, për habinë tonë të madhe e hoqi në çast këtë të fundit për të pyetur «Mos po më kërkojnë në telefon?» Në të vërtetë

zilja e telefonit po binte në sallon, dhe ai nuk e vuri maskën vetëm pasi mori vesh se kërkonin dikë tjetër.

Po në ditën e shtatëmbëdhjetë janarit a foli në telefon me dikë?

Me sa di unë, jo.

5

Nga dëshmitë për natën e shtatëmbëdhjetë janarit, Zigfrid D., gjerman, banor i Untergruppenbahut, fqinj i viktimës.

Ora kishte kaluar dhjetën. Megjithëse nata ishte e ftohtë kisha dalë në ballkon për të marrë ajër të freskët. Rruga përpara shtëpisë sime ishte e shkretë, kështu që e dëgjova fare qartë gërvimën shkaktuar prej hapjes së garazhit të J.G. prej nga ai bashkë me dy të tjerë po nxirnin makinën. Një copë herë u morën me të ngazë siç dukej rruga kishte zënë akull dhe rrotat rrëshqisnin. Më në fund u futën të tre në makinë, po nuk arritën të nisen? Dikush u afrua nga e dashta dhe e qëlloi me breshëri makinën. Pastaj njeriu u largua me vrap. Dy-tri sekonda më pas, ndoshta nga qosnja prej nga ia kishte behur ai, ndoshta nga ndonjë drejtim që nuk e vura re, një tjetër njeri u afrua makinës, nuk ishte i pari, sepse ndryshonte nga shtati, veç kësaj në vend të armës automatike mbante në dorë diçka të vogël, me siguri revolver ose bombë. Sa mbërriti te makina hapi derën e prasme dhe në çast u tërhoq pas, sepse njëri nga viktimat u rrëzua në këmbët e tij. E kapërceu me këmbë trupin e tij dhe nëpër derën e hapur vështroi një grimë brenda makinës, pastaj u largua me vrap, njëllor si i pari.

Rruga vazhdonte të ishte e boshatisur dhe unë nura brenda për t'i telefonuar policisë.

Nga dëshmia e Peter S, polic. Kur mbërritëm ne (ora po i afrohej njëmbëdhjetës, në mos gaboj) njëri prej viktimeve gjendej ende i rrëzuar përdnë, me fytyrë nga toka. Tjetri ai, që ishte në timon. dukej menjëherë që kishte ngrirë në vend ashtu siç e kishte zënë çasti i vdekjes. Një grua, e shoqja, me sa dukej qante me kokën rrëzuar në timonin e makinës. I treti J.G, siç e morëm vesh më pas vazhdonte të rrinte gjysmë i përkulur te dera e prapme, si njeriu që bëhet gati të zbresë. E shoqja i fërkonte ballin si dhe njërin krah. Flisnin të dy në një gjuhë të panjohur (shqip, siç e morëm vesh më pas)

Sipas dëshmisë së Karl L., ndihmësmjek i spitalit të Untergruppenbahut. Makina e ndihmës së shpejtë mbërriti një minutë pas asaj të policisë. Dy nga viktimat kishin vdekur, madje ishin ftohur. I treti J.G. ishte gjallë.

Në kohën që po e ngrinin për ta vendosur në makinë ai tha: «Dua të bëj një deklaratë» gjë që tregonte se ishte në gjendje krejtësisht të ndërgjegjshme.

«Më vonë, thashë unë. Do të keni kohë më vonë».

Ndihej menjëherë që kishte shumë plumba në trup. Gjatë rrugës përsëriti edhe një herë dëshirën për të bërë deklaratën. Sic duket një ide e tillë e lehtësonte.

6

Nga dëshmia e S.G., bashkëshorte e J.G.

Sapo u dëgjuan krismat kunata (birri e para: «I vranë!») Isha e veshur dhe u sula jashtë pa e pritur. Makina ishte disa metra larg hyrjes së garazhit, me faret ende të ndezur. Po unë nuk i hiqja dot sytë nga një gjë e zezë, në anën e djathtë të saj. Kur u afrova dhe pak dallova që ish-

te një trup njeriu i rënë përmbys. Rrëshqita, gati u rrëzova mbi të. gjersa e ktheva mbarë. Ishte K.Z. i vdekur.

Nuk e mbaj mend si u ngrita. Mbaj mend vetëm që u gjenda te xhami i hapur nga ana e timonit. Ishte kunati i ngujuar në ndenjësë. Duart i kishte hequr nga timoni dhe i mbante mbi gjunjë. Sytë i kishte të mbyllur. Tepër i zbehtë.

I futa duart pas zverkut për t'i kërkuar plagët. S'kishte. Pa pritur i pashë brimat e plumbave në faqe. Edhe ai kishte vdekur. Brenda në makinë ishte gjysmë terr dhe në krye s'dallova kurrgjë, gjersa ndjeva zërin e J. që tha:

— Çikë, qe ku jam.

Kështu më thërriste zakonisht, «çikë». Zërin e kishte të qetë, të kthjellët. Apo ndoshta m'u duk ashtu prej fjalëve që shqiptoi. Kurse mënyra si qe mbledhur kruspull, me një dorë të mbështetur te shkallina e makinës. Jepte, në kundërshtim me zërin, një mundim të madh.

— Oh, — ia bëri kur e preka në shpatulla, — Aty i kam.

Kështu më tha, me siguri për plumbat.

Pastaj:

— Kjo dorë m'u mpi. Ma liro pak!

— J. më ndjen? — e pyeta.

— Në bark kam të tjera — lo... ai.

S'dija si t'ia lehtësoja dhimbjet.

— K. e shoh që ka vdekur — tha me vështrimin e ngulur nga kufoma në rrugë. — Shife B. te timoni.

U mata t'i thosha se vëllai ishte gjallë, po në atë çast u ndie kuja e kunatës, që porsa kishte mbërritur.

— Ka vdekur — tha ai.

— Ndoshta jo.

Që nga larg u ndie një sirenë makine. Duhej të ishte policia ose ndihma e shpejtë.

7

Bruga gjer në spital ishte vende-vende e mbuluar nga bora. Ashtu pjesë-pjesë e mbuluar, me mpirje riprodhohej ajo më vonë në kujtesën e S.G.

Meqenëse nuk e lejuan të hipte në makinën e ndihmës së shpejtë ajo e ndoqi atë me taksì. Dritat e prapme të makinës së spitalit regëtinin si të ngulura me turjelë në trupin e saj. Ishte e vetme. Kunata kishte mbetur me fëmijët që kishin arritur të dilnin gjithashtu nga shtëpia për të parë ç'kishte ndodhur.

Përpiqej të kujtonte faktet e ditëve të fundit. Gjëra që mund të kishin zgjuar dyshime, fjalë të J. për ndonjë rrezik të mundshëm; po nuk i kujtohej asgjë. Nuk i kujtoheshin as numrat e telefonave të miqve, të njerëzve të afërt. Qysh te shifra e tretë binte mjegulla. Pastaj te e katërta. te e pesta... Shifrat e fundit këputeshin në humnere.

I kujtoheshin vetëm ca parandjenja të këqia. Por edhe për to nuk ishte e sigurt në se i kishte dëgjuar diku apo i kishte menduar ajo vetë. Ishte thënë diçka për natën e 17 Janarit. Për 17 janarin e vitit 1467. Madje ishte përmendur J. Sot është dita e vdekjes së Skënderbeut. Kështu kishte thënë duke kthyer kokën nga kalendari ku ishte një pikturë e Degas, një balerinë aq e papërshtatshme për ditën e mbarimit të kryezotit mesjetar... E megjithatë, tani i dukej se pikërisht ajo balerinë i sulej nga grumbujt e borës ndanë rrugës, drejt xhamit të veshur të taksisë, si për t'i kumtuar diçka. Diçka që ngjante herë si shpresë e dhimbshme, herë si një hare misterioze.

8

Në orën 23.20 J.G. gjendej i shtrirë në tryezën e operacionit. Në kohën që narkozdhënësi po i afrohej ai i bëri një gjest me dorë, si për ta ndalur dhe për herë të tretë tha se donte të bënte një deklaratë në prani të mjekëve dhe të një përfaqësuesi të ligjit. E futën policin Peter S. pasi i veshën me shpejtësi bluzën e bardhë dhe në prani të tij e mjekëve tha, me një zë që për herë të parë jepte shenjën e lodhjes: «Deklaroj se mua, J.G., vëllanë tim B.G. dhe shokun tonë K.Z. i vrau policia e fshehtë jugosllave... për të vetmen arsye se ne luftojmë për të drejtat e shqiptarëve të Kosovës... dhe që Kosova të jetë Republikë... Kaq kisha».

Dy mjekët si edhe infermierët me maska, që gjatë deklaratës kishin qëndruar si të ngrirë. lëvizën pas fjalëve të tij «kaq kisha».

Në të vërtetë përpara se të vihej re lëvizja vetë, atë e dhanë rrezatimet e bisturive e duart e tyre.

Në valën e parë të turbullirës që i dha narkoza, i plagosuri i pa fytyrat e mjekëve si të ngjitura me njëri-tjetrin dhe emri «Vidiç» që mjeku i parë, që u përkul mbi të, e kishte shkruar te jaka, atij duhet të jetë dukur si Vilhem ose Vili përndryshe ishte ende në gjendje të bënte së paku një shenjë për të shmangur mjekun me emrin e rrezikshëm.

(Në të vërtetë ia nguli sytë një grimë për herë të dytë jakës së Vidiçit, tha më vonë infermierja Marta H po nuk pati në vështrimin e tij kurrfarë shenje pakënaqësie, pale pastaj frikë ose ankth. Pati vetëm një lloj habie, por edhe ajo e lehtë.

Që s'pati kurrfarë shqetësimi e pohoi edhe polici Peter S., që ende s'kishte dalë nga salla dhe që, për shkak të

deklaratës së porsaberë, hetonte me kujdes fytyrën e viktimës.

Mungesa e shqetësimit vërtetonte se i plagosuri nuk e kishte lexuar saktë emrin e Vidiçit. Habia për të cilën foli infermierja, dhe që nuk u kundërshtua prej policit, mund të jetë shkaktuar prej tërheqjes së vëmendjes nga diçka e atypëratyshme, për shembull përse emri Vilhelm, ose Vili i këtu shkruar me një V dhe jo me W

Në qoftë se kishte qenë kështu, atëherë kishte mundësi që në çastet e agonisë, në prag të humbjes së ndërgjegjes, V-ja ose V-të së bashku do të jenë vendosur e zhvendosur shumë herë mbi njëra-tjetrën, në përftyrimin e tij me shpejtësi të ethshme siç ndodh në gjendje delirante. Dhe gjithmonë siç ndodh në gjendje të tilla objektet e përftyruara, jo vetëm lëvizin me shpejtësi të çmendur po me të njëjtën shpejtësi marrin forma e kuptime simbolike nga më të larmishmet ka mundësi që këto V të kenë marrë dhjetëra e qindra pamje e kuptime të ndryshme aty për aty, gjithmonë po të ndjekim këtë pandehmë. ahëre mund të ketë ndodhur që midis qindra pamjeve atë V t'i kenë ngjarë viktimës, qoftë edhe për një grimë, me dhogat që vendosnin dikur pjerrtasi në varre, në vendlindjen e tij të largët, përpara se i vdekuri të mbulohej me dhe».

9

Nga hetimet krejtësisht private për Vidiçin.

Si qëlloi që Vidiçi kishte roje atë natë? Kishte radhën e tij apo si zakonisht zëvendësonte dikë?

Nuk më kujtohet saktë. Zëvendësimet që bënte ishin aq të shpeshta saqë s'binin në sy si të tilla. Më kuptoni ç'dua të them, zëvendësimet e tij prej kohësh na dukeshin të gjithëve si një gjë normale.

Ju kuptova. T'ju pyes për diçka tjetër. Atë mbrëmje kur mori rojën, a ishte po në atë gjendje si mbrëmjet e tjera? Desha të them a erdhi si zakonisht apo me ndonjë farë nguti, shqetësimi, apo me atë ndjenjë ankthi për të cilën folëm para ca ditësh?

Si të them, nuk vura re një gjë të tillë. Më kuptoni kur nuk e ke mendjen në diçka të tillë.

Ju kuptoj. Po më pas, në kohën që u dëgjua sirena e makinës së ndihmës së shpejtë dhe sidomos kur u pa se viktimë që ajo solli nuk ishte thjesht një i aksidentuar, po një viktimitë e bërë shoshë nga plumba, a pati ndonjë trazim të veçantë?

Si të them. Kur u dëgjua sirena nuk e pashë. S'di ku ishte, ndoshta pinte cigare në sallon. Kurse më pas, kur e zbritën të plagosurin, ne ishim aq të tronditur të gjithë, sa që vështirë që tronditja e dikujt mund të binte në sy. Qyteti ynë është i vogël dhe të masakruar të tillë nuk të bie rasti të shikosh shpesh.

E mori vesh Vidiçi ç'ishte i plagosuri?

Pa dyshim. Ai e bëri deklaratën në sytë e të gjithëve, midis një heshtje varri.

Në se ju kujtohet, në kohën kur viktimë bënte deklaratën ç'shpërhe kishte në fytyrë Vidiçi?

S'mund të them asgjë. Ne i kishim sytë të gjithë te fytyra e të plagosurit. Ishte aq tronditëse gjithçka sa që edhe tani ngjethem kur e kujtoj.

Operacioni i parë u bë prej Vidiçit dhe Weberit, asistentit të tij, apo jo? Pas këtij operacioni J.G. ishte gjallë dhe përgjithësisht në gjendje të mirë. Në qoftë se Vidiçi do të donte të...

O ju lutem, zotni, mos më bëni pyetje të tilla.

Unë po ju bëj një pyetje që është lehtësuese për Vidiçin... Pra në qoftë se Vidiçi do të donte t'i bënte atë... ai kishte mundësi qysh në operacionin e parë apo jo?

Natyrisht.

Ahere ç'ndodhi pas operacionit? Si ishte gjendja e tij shpirtërore? A ndihej mëdyshja, lufta e motiveve, lehtësi apo zymtësia?

O, ju bëni pyetje tepër të vështira, zotni, Ju më premtuat se do të më bënit disa pyetje të thjeshta.

Më falni, zonjushë që nuk e mbajta dot fjalën. Është fjala jo vetëm për një jetë njeriu, është fjala për shumë shumë më tepër, besoni!

Ju besoj, zotni.

A e kërkoi ndokush Vidiçin në telefon pas operacionit të parë?

Jo.

Po ai vetë a telefonoi? Kaldajisti thotë se ai mori në telefon dikë nga telefoni i bodrumit.

Ka mundësi të ketë marrë andej, unë nuk di gjë.

Dhe ka folur në gjuhën e vet.

Unë s'di gjë. S'e kam dëgjuar kurrë të flasë në atë gjuhë.

Si ishte gjendja e tij pas telefonimit? Desha të them gjendja e tij shpirtërore, aty rreth orës një pas mesnate?

10

Nga pohimi i rastësishëm i kaldajistit Johan T.

Vidiçi foli nga telefoni i bodrumit në orën një pas mesnate. Duhet të ishte fill pas operacionit të parë, sepse në mëngët e përparësës kishte ende njolla gjaku. Zërin e kishte të lodhur, të munduar. Ai sa vinte i dobësohej, kurse në fund të bisedës vuri dorezën e telefonit, mbështeti ballin mbi aparat dhe ndenji mjaft kohë ashtu. Kishte pamjen e njeriut krejtësisht të dërmuar, sa që një çast m'u duk se po qante dhe u bëra gati ta pyesja; «Ç'keni kështu, zotni?»

Por e mbajta veten ngaqë ai nuk më kishte vënë re dhe mendova se ndoshta do t'i vinte zor që po e shihja në një gjendje të tillë.

11

Në orën 1.10' pas mesnate në kujtesën e S. G. erdhi numri i parë i telefonit. Pas tij u çliruan të tjerët. Njëri pas tjetrit vinin nga sferat e panjohura ku ishin tërhequr.

Kur ajo formoi numrin e parë ndjeu duart t'i dridhe-shin dhe vetëm atëhere e kuptoi se sa fort i kishte copëtuar gishtat gjatë gjithë kohës që kishte vazhduar operacioni. Alo, jam S. Tim kunat e vranë para dy orësh K.Z. gjithashtu J. porsa doli nga salla e operacionit. Është plagosur rëndë. Narkoza ende s'i ka dalë.

Në orën 2 ende s'kishte mbërritur asnjë nga miqtë. Ishin larg në qytete të tjera dhe koha që krejt e papërshtatshme për të nxituar në rrugët e akulluara.

Në orën 2.30 pritej dalja e narkozës,

Në orën 2.40 asaj i dhanë përsëri një qetësues të reanacionit. Ç'është? mendoi ajo. Pastaj e bëri pyetjen me zë. Një ndihmësmjeko i tha që të mos shqetësohej. I plagosuri kishte një keqësim të lehtë dhe po i bënë një gjilpërë. Janë gjëra të zakonshme pas një operacioni të tillë, i tha ndihmësmjekja.

Në orën 2.52 trazimi nuk po qetësohej në reanimacion.

Në orën 3 ora ngjante si e mbetur në vend.

Në orën 3.10 truri i saj i lodhur kapi fjalën «operacion». Iu desh disa sekonda sa ta dallonte në se e kishte dëgjuar vërtet apo ishte brenda mendimit të saj.

Në orën 3.11, e kuptoi të vërtetën dhe pyeti me dënësë:

Përsëri operacion? A është e mundur? A është e nevojshme?

Asnjë nga miqtë nuk kishte mbërritur ende.

Ejani në sallon, zonjë. Ky është një operacion i thjeshtë. Shumë më i thjeshtë se i pari. Ka mundësi të ketë ngelur ndonjë plumb i fundit. Mos u shqetësoni.

Në orën 3.15 ajo ndodhej përsëri në kanapenë e sallës së pritjes. Duart i kishte të akullta dhe në mendje iu krijuan prapë zona boshe.

Iu duk se që jashtë u dëgjua frenimi i një makine. por e harroi sakaq.

Një infermiere, ajo që i dha çetësuesin e fundit, u ul pranë saj në kanape.

— Nga jeni? — e pyeti me dhimbshuri. — Nga e folura ndihetë që jeni e huaj.

— Jam shqiptare nga Jugosllavia, — tha ajo. — Nga Kosova.

— Nga Jugosllavia? — tha infermierja. — Sa mirë pas-ka qëlluar, mjeku që po e operon burrin tuaj është jugo-sllav?

— Si???

(Nuk kisha parë ndonjëherë vështrim që mund të shka-terrohet në çast, si në filmat me tmerre, kishte thënë infermierja).

E çmendur, gruaja kishte rendur përjashta nëpër korri-dor, tamam në kohën që mjeku Vidiç sapo kishte dalë nga salla e operacionit dhe po i thoshte diçka një të panjohuri.

Ajo nuk i dëgjoi fjalët e mjekut në fillim, as e njohu të porsaardhurin, njeriun që e kishte kërkuar të parin në tele-fon, në kohën kur u bë e aftë për një gjë të tillë. . . ajo dal-loi vetëm tre gishtat e mjekut të ngritura përpara fytyrës së të panjohurit, siç bëhet në rastet kur tjetri nuk e kup-ton mirë gjuhën.

— Çfarë? — pyeste me egërsi i panjohuri dhe mjeku vazhdonte të mbante përpara tij, skeptër të mynxyrshëm, çfurk tredhëmbësh të Posejdonit, tre gishtat e tij.

— Të thashë një herë, kanë vdekur të tre.

— Ç'po thua, rrezikzi, — thirri i panjohuri. — Po mua më thanë se njëri është gjallë.

Në atë çast ai ndjeu praninë e gruas dhe iu kthye asaj, për ta përqafuar, për ta ngushlluar, për ta pyetur se ç'ka po fliste ky i çmendur, kurse e vërteta, siç ia kishte thënë ajo në telefon, duhej të ishte krejt ndryshe.

Po gruaja nuk shihte kurrgjë. Sytë e saj vështronin vetëm një pikë te jaka e mjekut, atje ku në një pilakë të vogël plastike blu, ishte shkruar emri «Vidiç».

Ajo e afroi kokën edhe më shumë mbi atë pllakën, pastaj e kapi mjekun nga përparsjaja e bardhë si të donte ta rrëzonte atë.

— Ti e vrave! — klithi me zë të çjerrë. — Ti si za ubije W.

I bardhë në fytyrë si gëlqere mjeku u mbajt me një dorë nga muri, ndërsa gruaja vazhdonte të klithte në gjuhën serbe.

Gjatë gjithë kohës që vazhdoi kjo skenë e rëndë ai nuk iu përgjigj asaj asnjëherë në serbisht, pohuan dëshmitarët. Ishte tejet i tronditur; dukej çdo çast se do të rrëzohej, gjersa ndërhyjnë dhe e larguan gruan.

12

J.G., emigrant politik shqiptar, arratisur nga Jugosllavia, me nënshtetësi gjermane, gazetar, poet dhe muzikant, vdiq më 17 janar 1982 në orën 3.15 pas mesnate, gjatë operacionit.

Ky ishte shënimi për mbarimin e tij në librin e spitalit të Untergruppenbahut.

Policia nuk arriti asnjëherë të zkulonte vrasësin. Aku-

zat e bashkëshortes të tij kundër mjekut Vidiç, megjithëse të formuluar nga një avokat i dëgjuar, nuk u morën parasysh për mungesë provash.

Mjeku Vidiç u largua nga Untergruppenbahu qysh të nesërmen në ditën e ftohtë, të ngjashme me atë të cilën kishte ardhur. Veç se në ndryshim me ardhjen, largimi i tij nuk figuronte në asnjë shkresë, protokoll ose shtojcë protokollit.

Për të u fol një farë kohe në irtethe të ndryshme, por ato që fliteshin ishin në përgjithësi gojëdhëna. Delire të ndryshme të sëmurësh në spitale psikiatrike, pendesa, vrasje ndërgjegjesh, etj. u dhanë disa herë si të tilla pos asnjëherë nuk u saktësua kjo gjë.

J.G. u varros në varrezën e Shtutgardit. Ndërsa kërkonin një tekst sa më domethënës për t'ia gdhendur mbi varr, njerëzit e familjes dhe dashamirësit e tij dëgjuan me radhë disqet me këngë e balada që ai i kishte shkruar, kompozuar dhe kënduar vetë, pjesën më të madhe të shoqëruara me kitarë.

Duke i dëgjuar në heshtje, ata erdhën në një mendje, se shumica e këtyre teksteve, ishin të përshtatshme për t'u gdhendur në mermerin e varrit. Kjo binte në sy kaq qartë, sa që një ditë, në një nga ato ditë kur e qeshura dhe humori rifituan më në fund të drejtën të pranoheshin në bisedat për kujtimin e të ikurit, si për ta bërë edhe më brilante dhembjen, njëri nga miqtë e tij tha se kishin të drejtë të akuzonin J. se kishte përgatitur ai vetë vrasjen e vet.

Teksti i mbishkrimit u zgjodh më në fund prej njëres prej baladave të tij, po drejtorja e varrezës nguli këmbë që të bëhej një ndryshim në të. Ishte prerja, ose, për të përdorur një fjalë më të kohës, censurimi i fundit që iu bë J.G. në jetën e të cilit kishte patur disa herë ndërthurje të tilla, duke përfshirë këtu edhe vdekjen e tij, e cila, në fund të fundit, nuk ishte veçse një prerje.

LAMTUMIRA E SË KEQES

Beqir Aliu, qeveritari i N. e dalloi karrocën qysh se u shfaq në rrugën e madhe, në krye një brumbull i vogël e pastaj një sënduk i zi, që avitej me ngut.

Allah, mbromë, tha me vete kur shqoi shenjat zyrtare tmbi pupenë e saj. Atëherë e kuptoi se gjithë ai ankth i asaj pasditeje mestetori, asaj pasditeje të pafundme, që ai, megjithë frikën bestyde, e kishte mallkuar disa herë pa shkak, (nëna i kishte thënë dikur se në asnjë rast s'duhehshin mallkuar ditët, madje edhe atëherë kur dukej haptas se dita, më shumë se me xhinsin e vet, afronte me xhinsin e netve), pra befaz ai e kuptoi se gjithë ai ankth s'paskish qenë i kotë.

Pa lëvizur nga dritarja ndoqi me sy afrimin e karrocës te porta e shtëpisë, karrocierin që zbriti për të trokitur. pastaj kryeshërbëtorin e tij, që, pasi hapi kanatat, po ngjitej me vrap për të lajmëruar se kush kishte mbërritur.

Nga që i merrej fryma fjalët i tha gjysma-gjysma, po Beqir Aliu i kuptoi: një zyrtar i lartë, drejt e nga Dollma Bahçeja, pallati i Sulltanit.

Mbromë, allah i madh, përsëriti me vete Beqir Aliu dhe

megjithëse u përpoq të zbriste shkallët pa u mbajtur nga parmakët, dy-tri herë i preku ata.

I porsaardhuri qëndronte në këmbë në sallonin e madh. Beqir Aliu e ndjeu në çast se përvoja e gjatë nuk e ndihmoi dot këtë herë të kapte aty për aty rangun e vërtetë të zyrarit që kishte përpara. Atë ç'ka kumtonte xhybja e tij e pluhurosur e rrëzonte qëndrimi mospërfillës, ashtu sikurse këtë të fundit e vinte në dyshim vështrimi i tij. Në zgavrat jashtëzakonisht të thella ishin dy sy të lodhur, si në prag të përgjumjes. Beqir Aliu e kishte vënë re se ishte pikërisht pagjumësia që jepte një kapitje të tillë.

— Vij drejt e nga kryeqyteti me një mision të veçantë, — tha ai, duke nxjerrë nga një e çarë e xhybes një letër të mbështjellë.

Beqir Aliu e mori letrën, e çmbështolli, po nuk ishte në gjendje të dallonte asgjë veç rjalëve Pallati i Dollma Bahçesë, Zyra e Përgjithshme, si dhe vulën e njohur në fund të saj. Ai e puthi dokumentin tamam te vendi i vulës, u përul lehtë dhe pasi e mbështolli prapë ia ktheu mysafirrit.

— Mirseerdhe në konakun tim, gazi. Rruga besoj se të ka lodhur shumë.

Tjedri hapi krahët.

— Rruga ishte vërtet çfilitëse. Dhe hanet nuk janë për të qenë.

— Ashtu, ashtu, — i tha Beqir Aliu. — Sa herë që më duhet të vij gjer në Stamboll unë e di ç'heq. Veç Hanit të Vjetër, në të dalë të Janinës dhe një tjetri pranë Kavallës, gjithë të tjerët janë për faqe të zezë. Të pijnë morrat e tar-tabiqet.

Beqir Aliu e ndjeu se po fliste më shumë se ç'duhej, por ishte mbi forcat e tij për të kufizuar gojën. E kishte vënë re se kishte disa lloj njerëzish, prania e rëndë e të cilëve rëndohej edhe më shumë nga heshtja. I porsaardhuri ishte i tillë.

Duke iu shmangur kushedi pse syve të tij, Beqir Aliu, vazhdoi të fliste për pjesët e pamirëmbajtura të rrugës, për tyrben e Dervish Ulemasë, që, megjithë sinjalizimet e një-pasnjëshme, ende s'qe meremetuar, për ndërtesën e doganës në Ibrik Tebe, që, ç'është e vërteta, bashkë me doganierët krijonin një përshtypje të keqe për shtetin, sidomos në sytë e të huajve...

Nga që dyshoi se mos po e tepëronte ai e preu befaz të folurën, po ndërkaq vuri re se tjetri e dëgjonte me një mospërfillje të tillë, thua se nuk kishte kaluar kurrë nëpër atë rrugë.

Kjo vetëtitje mendimi e hutoi një grimë Beqir Aliun. Si shpëtim iu kujtua hamami.

— Besoj se pas një rruge të tillë, një banjë...

— Oh, me kënaqësi, — tha mysafiri.

Që nga veranda ku kishte dalë për të marrë ajër të freskët Beqir Aliu dëgjonte zhurmat e lehta të shtëpisë. Po sistemonin nëpër dhoma dy shoqëruesit e të porsaardhurit. Nga guzhina vinte një tringëllimë enësh. Allah, psherëtiu Beqir Aliu. Kjo pasdite s'donte që s'donte të mbaronte.

Ai solli ndër mend sytë e kapitur të mysafirit, pastaj xhyben e pluhurosur, në xhepat e brendshëm të së cilës kushedi ç'dokumente sekrete fshiheshin dhe prapë psherëtiu: allah, mbromë.

Një grimë mbajti hapat si në përgjim. Pastaj me çape të lehta u fut brenda. Gjithmonë duke shkelur lehtë eci nëpër një korridor të ngushtë, hapi një derë dhe u gjind në një kthinë të gjatë, të mbyllur, që mernte dritë nga një baxhë. Që pas murit vinte zhurma e ujit.

Beqir Aliu hoqi një pjatë bakri të varur në mur dhe vuri syrin te vrma e vogël. Për shkak të avullit lëvizjet e mysafirit iu dukën më të ngadalta dhe si të shoqëruara nga një stërmundim. Beqir Aliu ndjeu një këputje te gjunjët. Kishte përgjuar nga kjo vrimë inspektorët e ardhur nga kryeqyteti, sa herë që kishte dyshuar për fjalët e gjestet

apo qëllimin e udhëtimit të tyre. Kishte patur një bindje të verbër se atë çka fshihnin sytë ose goja e nxirrte trupi lakuriq. Atje midis avullit dhe pllakave të zhveshura njeriu e jepte më qartë se kudo enigmën e tij. Atje dilte ambicja dhe epshi, mëdyshja dhe gatishmëria për të mos u ndalur përpara asgjëje, tmerri i fshehtë, pendesa apo synimi për të shkelur mbi kufoma.

Beqir Aliu mezi e mbajti një psherëtimë të re. Trupi i mysafirit nuk jepte asgjë, me përjashtim të një vuajtje të brendshme, misterioze, thua se nuk ishin currila uji të ngrohtë që binin mbi gjymtyrët e tij, po kamxhikë të pa-dukshëm.

Ky njeri ose është i marrë, ose i shenjtë, tha me vete Beqir Aliu. Me lëvizjet e tyre gjymtyrët e tij nuk bënin gjë tjetër veçse një si pyetje, një së kërkim. Madje prej atij trupi nuk mund të merrje vesh edhe një gjë që kishte qenë përherë tepër banale për Beqir Alinë: në se i pëlqenin femrat apo dylberët, apo në se i pëlqente të ishte vetë dylber. Sa herë i kishte shfrytëzuar Beqir Aliu, sidomos këta të fundit, për të korruptuar zyrtarë që dukeshin të pakorruptueshëm.

Ai e hoqi syrin nga vrima vetëm kur tjetri matanë nisi të fshihej me peshqir.

Paspak ishin ulur të dy në minderin e dhomës së mysafirëve nga xhamllëku i së cilës dukej një pjesë e verandës. Beqir Aliu ndihej i pikëlluar. Mezi i gjente fjalët për atë pakëz bisedë që ai, si i zoti i shtëpisë, ishte i detyruar ta mbante gjallë. Tjetrit dukej hapur që i pëlqente më shumë të heshte. Jo mysafir, po korb tha dy-tri herë me vete Beqir Aliu. Vështronte mendueshëm ditën që po thyhej me ata sy që pas banjës ngjanin edhe më të kapitur.

— Ja pra, kjo qenka Shqipëria, — tha me zë të ulët, si të fliste me vete.

— Është herë e parë që vjen këtu? — pyeti i zoti i shtëpisë.

Mysafiri bëri «po» me kokë.

Ai e tundi kokën disa herë edhe pas kësaj, thua se po i përgjigjej në të njëjtën mënyrë një sërë pyetjeve që dikush brenda tij, djalli vetë ndoshta, ia bënte. E tundi sa e tundi kokën ashtu, pastaj me po atë zë të ulët tha:

— Gjynah.

Beqir Aliu ndjeu gjymtyrët t'i ftoheshin. Ç'ishte ajo «gjynah» e lëshuar si rastësisht midis heshtjes? Gjynah përse? Gjynah për kë?

Ai priti sa priti që mysafiri të shtonte diçka, po tjetri e kishte kyçur gojën. Vështronte mospërfillës përtej xhamllëkut, me ca sy të shuar, të pashpresë, që të ftohnin gjer në fund të shpirtit. Dy-tri herë Beqir Aliut i erdhi ta kapte për gryke e ti shfrynte: për kë të vjen gjynah ty? Për mus ndoshta, nga që më ke sjellë gjëmën? Fol, korb i zi!

Prej kohësh Beqir Aliu e dinte se mysafirët e lartë, që vinin nga kryeqyteti, sillnin shpesh me vete dekretin e dënimit për qeveritarin vendës. Qëllonte që pritej me nderime prej këtij të fundit, hante e pinte, dhe befas, aty nga mesnata, nga xhepi i brendshëm i xhybes nxirrte katil-fermanin. «Sulltani të kërkon kokën». Kjo ishte formula pas së cilës i dënuari i nënshtrohej fatit dhe e zgjaste vetë kokën në shiriti i mëndafshhtë, në mënyrë që t'i thyenin arzën e qafës, përpara se t'ia prisnin.

Sa herë e ka bërë këtë punë, tha me vete duke ia ngulur sytë. Po tjetri vazhdonte të shikonte përtej tij, sikur Beqir Aliu të mos qe aty.

Ndoshta gjatë darkës diçka do të nxjerrë, mendoi Beqir Aliu.

Gjatë darkës i ardhuri diçka tha vërtet, por ajo në vend që ta qelësonte e turbulloi edhe më shumë Beqir Aliun.

Sulltani është i shqetësuar për Shqipërinë. Këto fjalë të kryeqytetasit Beqir Aliu i përsëriti shumë herë me vete, pas çdo kafshate që kapërdinte. Prej tyre s'parandihej as-

gjë e mirë. Përkundrazi, pas deklaratave të tilla vinin zakonisht shkarkimet, dënimet.

E pse ta vriste kaq shumë mendjen, i jepte zemër vetes Beqir Aliu. Fundja nuk është ai qeveritari kryesor i Shqipërisë. Ai s'ishte veçse një qeveritar province Sipër tuj kishte pesë a gjashtë të tjerë që përgjigjeshin drejtpërdrejtë për gjendjen. Sa t'i vinte radha atij...

E ndjente se ky ishte një ngushëllim i kotë. E dinte fare mirë se çdo qeveritar i madh tërhiqte dhjetëra të tjerë pas vetes, në rrokullimë.

Duke e sjellë fjalën larg e larg u përpoq të merrte vesh se përse ishte aq shumë i shqetësuar sulltani i madh. Dy vitet e fundit, lavdi zotit, kryengritje s'kishte patur. Dhe taksat, me sa dinte ai, Shqipëria i kishte dorëzuar në rregull. Sasinë e rekrutëve gjithashtu.

— Eh, Beqir Ali, — e kishte ndërprerë mysafiri dhe për herë të parë gjatë darkës kishte buzëqeshur, — s'janë aq të thjeshta gjërat. S'është punë rebelimesh, taksash e ku di unë. Janë punë më të thella këto... Syri i sulltanit sheh më larg se sytë tanë...

Sikur të mos ishte fjala për sovranin Beqir Aliu do të nervozohesh, ashtu siç nervozohesh gjithmonë kur dikush i thoshte se «punët janë më të thella se ç'duken?». Këtë frazë, kushedi pse, nuk e duronte dot. Ç'janë këto punë të thella që më dërdëllis? E ndërpriste shpesh bashkëbiseduesi. S'ka punë të thella në këtë botë. E thellë është vetëm gropa ku do të shtrihemi një herë e mirë. Të tjerat janë gjepura.

— Kështu, Beqir Ali, — vazhdoi mysafiri, — shumë net sulltanit të madh i ka dalë gjumi për punën e Shqipërisë.

— Allah, — ia bëri i zoti i shtëpisë, ngaqë s'dinte ç'të thoshte. Mendimi se qindra zyrtarë të lartë të shtetit, për të mos përmendur mijëra të mesmit e qindra mijëra të vegjlit, flinin si derrat, në kohën që llamba e botës s'mbyllte dot sytë, iu përzie me zilinë për sytë e mysafirit, ata sy që e tregonin që larg pagjumësinë. Ndoshta pikërisht për këtë,

për shkak të atyre qeskave poshtë tyre, ai kishte fituar favorin mbretërorë, në kohën kur të tjerët, me sytë e fryrë nga e fjetura, kishin mbjellur zilinë, e më pas zemërimin e fshehtë të padishahut të pagjumë.

— Gjithë vendet e Ballkanit, njëri pas tjetrit, u shkëputën nga perandoria, — vazhdoi ai me zë të ngadaltë, të lodhur. — Vetëm Shqipëria ka mbetur. Dhe sulltanit të madh ajo po i dhembka më shumë, siç dhemb fëmija i pleqërisë.

Beqir Aliu lëshoi një psherëtimë. Tani merrej me mend përse i dilte gjumi natën sovranit. Madje pak a shumë merrej me mend edhe qëllimi i ardhjes së mysafirit. E po shyqyr, s'paska qenë për mua, tha me vete dhe i lehtësuar futi lugën në hallvë. Shyqyr, o perëndi, përsëriti me gojën plot.

Darka kishte mbaruar prej kohësh dhe ata e kishin pirë dhe gotën e dytë të sherbetit. Jashtë kishte nisur një shi i bollë, shushuritës. Beqir Aliut i flihej. E dinte që s'ishte mirë që mysafiri ta merrte vesh këtë, e aq më tepër kur pak më parë qe përmendur pagjumësia e sovranit. Megjithatë me zor të madh i mbyste gogësimat.

Një copë herë kishte ndjekur me sy lëvizjen e fenerëve në oborrin e shtëpisë, ku, me sa duket, shërbëtorët hënin ece-jaket e tyre të zakonshme, po kjo, në vend që t'ia largonte ia kishte ndjellë edhe më shumë gjumin. Madje, një herë ajo pamja gati iu ngjiti fillimit të një ëndrre që po ngjizej në trurin e tij. Shërbëtorët shpejtonin drejt një kali të sëmurë, të shtrirë në shtrat, nën një jorgan prej atllasi. Nga stalla që ishte në fund të oborrit erdhi vërtet një hingëllimë kali dhe Beqir Aliu shkundi kokën.

— Të vjen gjumë, eh? — e pyeti mysafiri.

— Jo, jo... Ç'është ajo fjalë...

— S'ka gjë. S'ka gjë. Edhe unë do të ngrihem. Gjumë s'kam, po rruga më ka këputur fare.

Beqir Aliu tha edhe ca fjalë të kota, duke lëvizur pak sofrën që tjetri të lironte gjurin.

Beqir Aliu eci përpara duke i bërë dritë tjetrit me një llambë bakri. Mendimi se a duhej t'i ofronte ndonjë dëfrim dhe në qoftë se po i ç'lloji duhej të ishte ai, me femër apo me çun, mendim që ashtu si te vrima e hamamit e kishte ngacmuar disa herë gjatë darkës, tani që po i afroreshin derës së dhomës së gjumit e vuri vërtet në një hall të madh.

Me shpejtësi, me ngut, solli edhe njëherë ndër mend trupin e tij, ashtu të turbullt e plot trazim si mëdis avujve të skëterrës dhe gjithsesi nuk e gjente dot se ç'duhej t'i ofronte.

Gjumë s'kam, i kishte thënë mysafiri... Atëherë, në qoftë se s'kishte gjumë, me se do ta kalonte atë natë të gjatë? Ky mendim i fundit ia hoqi ç'do mëdyshje Beqir Aliut.

Duke ngritur llambën për të ndriçuar më mirë derën e dhomës, po duke lënë në hije fytyrat, me një zë të ulët, ai tha:

— Allahu i ka bërë netët të gjata e të mërzitshme kur janë bosh... Në qoftë se mysafiri i shtrenjtë dëshëronte të engletisëj pak, aq më tepër që gjumë s'kishte... ai do të ishte i lumtur t'i çonte një vajzë apo një çun...

Tjetri vuri dorën ne doreza e derës.

— A thua Beqir Ali? — tha me zë pa ngjyrë dhe pa e kthyer kokën, hapi derën dhe u fut brënda.

I zoti i shtëpisë mbeti në këmbë me llambën e bakrit, që befas u rëndua dyfish në dorën e tij. A thua Beqir Ali? përsëriti fjalët e tjetrit. Edhe falltarët e Samarkandit flisnin më qartë. Ç'i kishte pjellë me këtë lugat.

U kthye me hapa të ngadalta te dhoma e mysafirëve dhe një copë herë vështroi shërbëtorët që po ngrinin mësa-llën. Tani gjumi i kishte dalë fare dhe s'dihej a do t'i vinte më. Cili djall të dërgoi në shtëpinë time? shfreu dy-tri herë me vete. Një herë mendoi të mos e vriste më mendjen.

Gjersa nuk kishte dashur të fliste në drejt të vente. Pse duhej të torturohej Beqir Aliu për... e tij? Të tjerët kishin qenë më të çiltër kur kishte ardhur puna te kjo pikë. Me thënë të drejtën, Beqir Ali, mua më pëlqejnë çunat. Ose: çfarë çunash, more, sa të vdes unë s'i ndahem femrës. E kështu me radhë sikush sipas qejfit të vet, si e ka dhënë zoti. Kurse ky këtu: A thua, Beqir Ali? Namusqar i madh për besë. Pt, të plaçin sytë, shau Beqir Aliu. Po prit se do të ta tregoj qejfin.

Kryeshërbëtori që nuk ia ndante sytë iu afrua sapo i zoti i bëri shenjë.

— E ke gati Merjemen?

— Gati, e kam bej. Edhe Lejlanë e kam gati po t'i pëlqejnë leshverdhat.

— Ç'leshverdha, more. Atij s'i merret vesh se ç'do mashkull apo femër. Ndaj për çdo rast gatit edhe Mehmetin.

— Si urdhëron, bej.

Beqir Aliu u mendua një hop.

— Për Lejlanë ke të drejtë, — i tha tjetrit. — Mbase i pëlqejnë leshverdhat.

Pas pak, duke shkelur sa më lehtë mbi dërrasat e dyshemesë, Beqir Aliu u gjend në dhomën fqinje me atë të mysafirit. E lëvizi me kujdes cohën me mbishkrimin e Kuranit, që mbulonte vrimën e përgjimit, dhe vuri syrin në të.

Mysafiri veshur me një rrobë të gjatë nate rrinte palëvizur mbi shtrat. E dinte tashmë nga përvoja se një njeri i përgjuar duket përherë më bosh e më i ngrirë se ç'është (trazimi i brendshëm i përgjuesit e theksonte ndoshta palëvizshmërinë e viktimës) po ky ia kalonte çdo përfytyrimi. Sikur të mos ishin tepijet që i lëvizte monotonisht në njerën dorë do të besoje se ishte një figurinë dylli.

Ai nuk lëvizi as kur dera e dnomës lëshoi një gërvimë pas së cilës hyri Lejlaja. Vetëm sytë ndoqën ecjen plot finesë të vajzës, që erdhi u ul pranë të huajit mbi shtrat. Kuçka ç'siguri që paska, tha me vete Beqir Aliu. Një gër-

vishtje zilie e përshkoi dobët. U duk në çast se ishte e sigurt që do të merrej vesh me kryeqytetasin, më mirë se me të, qeveritarin provincial. Hajde merre vesh ç'kanë në kokën e tyre femrat, mendoj. Nga kryeqyteti përveç dekretëve, thashethemeve e modës së veshjes, vinin me siguri edhe marifete të reja dashurie, të shpikura me siguri nga kaurët. Sa herë në kafene ai me shokët e tij i kishin sharë e mallkuar apo kishin bërë «ptu» me përbuzje, kishin pështyrë me neveri, po femrat e tyre ndoshta atje e kishin mendjen. Kishin dëgjuar për to e tani digjeshin nga padurimi që t'i provonin. Ja, kjo Lejlaja që hyri duke u tundur aq pa turp, me siguri priste diçka nga kryeqytetasi.

Me po atë vetësiguri me një lëvizje të qetë ajo e zgjidhi një nyje dhe rroba e saj e hollë i rrëshqiti nga trupi. Ashtu lakuriq u shtri përbri të huajt, me njerën këmbë të shtrirë e me tjetrin të përthyer, ç'ka i jepte diçka prej zone qëndrimit të saj. Sikur të mos mjaftonte kjo guxoi t'i fliste të panjohurit, madje t'i buzëqeshte me një buzëqeshje enigmatike që gjysma i kaloi atij e gjysma i mbeti asaj vetë.

Hë, kuçkë, shau nëpër dhëmbë Beqir Aliu. Nuk e kup-toi as vetë pse, por e ndjeu se nga të gjitha ato që mund të ndodhnin midis tyre, fjalët e shqiptuara prej saj ia nxitën më fort xhelozinë. Ç't'i ketë thënë vallë, kuçka, mendoj gjithë pezëm.

Nuk e pati mendjen të vinte re nëse ai iu përgjigj apo jo. Vuri re vetëm se shikimi i tij kaloi disa herë nga flokët e verdhë te njolla e zezë e pubisit (kishte vënë re se pothuajse pa përjashtim meshkujt i ngacmonte ky krahasim), po shikimi i mysafirit që i ftohtë.

Ai e vështroi sa e vështroi vajzën për një kohë të gjatë me po atë shikim të topitur, pastaj dora që rrotullonte tepihet i lëshoi ato, për t'u zgjatur drejt barkut të saj. Ai ia përkëdheli një copë herë pubisin, po me një përkëdhelje të qetë, ashtu si njeriu që kalon dorën mbi flokët e një fë-

mije, por e bën këtë gjë pa zemër sa për të kaluar radhën, si gjithë ata që kanë frikë mos i akuzojnë se nuk i duan fëmijët.

He, ç't'u bë mirë, kuçkë e drejt, shfryn gjithë triumf Beqir Aliu, kur vajza pas mospërfilijes së hapur të mysafirit u ngrit nga shtrati dhe me hap të pezmatuar doli nga dhoma pa patur as kujdesin të vishej.

Tani të shohim ç'do të na bëjë Mehmeti i vogël, tha me vete Beqir Aliu dhe kushedi pse, fërkoj duart. Ishte shumë kureshtar si do të përfundonte kjo histori. Hëm, ç'mysafir, tha dy-tri herë me vete. Me një kangur do të merrej vesh më mirë, për besë.

Mehmeti, me faqet që ia kishin tyer pakëz me të kuq, ndryshe nga Lejlaja, hyri kokëulur. Beqir Aliut i kishte pëlqyer gjithmonë ai djalë. Ishte më i turpshëm se një gocë dhe dalldisja e ashikëve pas tij as ia kishte rritur mendjen e as ia kishte shtuar nazet.

Musafiri, sikur ta priste, nuk shfacoj asnjë habi nga hyrja e tij. Dhe po aq i palëvizshëm mbeti kur djali, me lëvizje të druajtura hoqi shallvaret e mëndafshita, të qëndisura anash dhe u shtri si një qingj.

i huaji ia vështroi një copë herë trupin me po ate mospërfilije që kishte parë Lejlanë. Veçse këtë herë dora e tij nuk i lëshoi tespihet, kështu që rruazat prej fildishi rrëshqitën me një spërdredhje prej gjarpri mbi trupin e djalit, në kohën që e përkëdhelte.

Po kjo vazhdoi pak kohë. Ai e tërhoqi dorën dhe sytë e tij u bënë prapë tejet të humbur e bosh ndërsa kokrrat e tespiheve nisën të lëviznin prapë monotonisht, midis gishtave pa shpresë.

Nuk do, tha me vete Beqir Aliu. E mbante ende një shpresë e vakët, përderisa djali vazhdonte të rrinte shtrirë përbri mysafirit. Po shpresa iu zhduk përfundimisht kur i huaji, pasi i ciku me majat e gishtave vëthët, diçka i tha djalit. Ai u ngrit me po ato lëvizje të buta siç qe shtrirë

dhe duke futur në fillim këmbën e djathtë e pastaj të majtën në shallvaret, deli nga dhoma, siç kishte hyrë, kokulur.

Siç duket s'mundet, mendoi Beqir Aliu. I kishte mbyllur, siç duket hesapet me këtë gjë, një herë e përgjithmone dhe tani e dërgonin me misione sekrete andej-këndeje. Të ruaçin gradat që ke, tha me vete Beqir Aliu, të ruaçin edhe dosjet sekrete me të cilat punon.

Megjithëse syri i qe lodhur nga përgjimi ai nuk po e hiqte nga vrima. Ndoshta s'duhej ta gjykonte me përbuzje. Edhe ai vetë ndoshta vuante nga kjo gjë. Nuk e kishte më kot atë fytyrë aq të vrerosur.

Eh, tjetër lloj ishin një herë e një kohë zyrtarët e lartë. Të kishte lezet shpirti të dëgjoje hëmat e tyre në çdo gjë, si në sheshin e luftës a të politikës, ashtu dhe në dyshekun e dashurisë! S'i harrohej Beqir Aliut një javë që kishte kaluar në kryeqytet, në kohën e rinisë së tij. Shumë herë me vonë i kishte rënë rasti të shkonte atje, me shërbime të rëndësishme apo në festime madhësi toje, por ngazëllimi i asaj jave të paharruar nuk i qe përsëritur kurrë. Si tani e mbante mend gjithçka. Kryeqyteti i gjithë po përgatitej për festimin e «Natës së Fuqisë». Prëj gjithë festave të shtetit, kjo ishte ajo që ia ndizte më shumë fantazinë Beqir Aliut. Atë natë, sipas zakonisht, sulltani i madh do të flinte me një virgjëreshë. Gjithë kryeqyteti nuk kishte tjetër gjë në gojë. Edhe ata që nuk e flitnin e mendonin. Një përndezje e përgjithshme ndihej kudo. Nën shëmbullin e sovranit gjithë zyrtarët e lartë përgatiteshin gjithashtu. Hamamet ishin ngrohur qysh më parë. Kandilët vezullonin hareshëm. . . Beqir Aliu u end atë mbrëmje për një kohë të gjatë rrugëve. Nëpër shtëpi e nëpër pallate dritëzat regëtinin kudo. Atje, secili, sipas shijes e qejfit të vet, kush me femra e kush me çuna, po bëheshin gati për dashuri.

Shteti i bekuar tha Beqir Aliu tërë admirim për shtetin e vet. Zakone të bukura të madhërishtme. Dhe për herë të parë në jetën e vet ndjeu shijen e veçantë të pushtetit. Ajo

që në gjuhën e zakonshme quhej aq varfërisht «karierë» s'ishte vetëm kënaqësia e të ngrënit, e kapardisjes në karrocën e shtetit etj. etj. Ishte diçka më e thellë, që e ngrohte njeriun njësoj si epshi dhe e tërbonte më keq se ai.

As më parë kur kishte fjetur rastësisht me një kaurkë, dhe as më pas, gjatë muajit të mjaltit Beqir Aliu nuk kishte ndjerë asisoj dëshirë si atë natë. Të njëjtën zjarrmi iu duk se e pikasi edhe në sytë e kalimtarëve të tjerë. Me sa dukej lidhja që krijohej midis epshit madhështor të sovranit, me epshin e secilit, e rriste këtë të fundit në përmasa të papara. Ndoshta ndaj edhe qe krijuar kjo festë e bekuar, që secili shtetas, mashkull a femër qoftë, (këto të fundit për arsye që merreshin me mend duhej ta kishin edhe më shumë të ndezur fantazinë: në vend të paitnerit të përfytyronin sovranin etj. etj.), pra ndaj qe krijuar edhe kjo festë për t'u dhënë mundësinë shtetasve që një herë në vit të komunikonin në një mënyrë tejet intime me padishahun e madh.

Beqir Aliu vërtitej kështu i lektisur në një nga sheshet e qendrës, kur u dëgjua gjëmimi i topit, që lajmëronte sipas traditës se sovrani e zhvirgjëroi, më në fund, të zgjedhurën e vet.

Ecja e kalimtarëve u çrregullua në çast. Njerëzit ndalonin, kthenin kokën anej këndeje si për të gjetur se nga erdhi gjëmimi apo në ç'drejtim ndodhej pallati sulltanor.

— Eh, e... ashtu... për besë, — tha një i pirë, po nga që s'ia vuri kush veshin, i doli siç duket frika dhe e përsëriti atë që tha, po këtë herë me një fjalë të pistë.

Ngazëllimi e ndezja, kureshtja apo admirimi ndiheshin kudo.

— E çuno, ke qejf? — i pëshpëriti Beqir Aliut një grua me fereixe. Nga theksi i të folurit iu duk si jevgë. Za'en vetëm ato mund të bridhnin ende përjashta në këtë orë.

Pa i thënë gjë Beqir Aliu e ndoqi pas. Te një skutë e errët para se ta përfaqonte ajo i kërkoi një monedhë dhe Beqir Aliu pa e menduar fare ia dha.

— He, si t'u duk — i tha Beqir Aliu, kur u ngritën.

— Eh, ia bëri ajo, — ç'ka.

Jevgë e dreqit shau me vete Beqir Aliu.

— E po, mirë s'jam padishahu unë, — i tha.

— Si? Si? — ia bëri jevga dhe befasi ia plasi gazit si e marrë.

— Ç'ke që kukurisesesh ashtu? — e pyeti Beqir Aliu

Po ajo vazhdoi të qeshte dhe ai u largua qetësisht. Që larg nga errësira i erdhi dhe një herë një valë e fundit e të qeshurës së saj, por ai nuk e ktheu kokën.

Bashkë me lehtësimin ndjeu edhe një pikëllim. Në pallatet e larta, që ngriheshin drejt e mbi kokën e tij, në shtrojet e mëndafshta hanëmet e bardha e të parfumuara bënin tani dashuri me zotët e tyre, kurse ai, si një qen rrugësh kishte shkuar me një jevgë.

Zbrazëtia që ndjente së brendshmi Beqir Aliu ishte e pashpresë, gjithë qenia e tij dukej sikur lëshonte një ulërimë të mbytur gërryese. Më vonë, kur i qe kujtuar ajo natë ai kishte menduar se dëshira për karrierë, që ia behu befasi në jetën e tij, ai turbullim i verbër, për hir të së cilit ai kishte qenë gati të mbyste nënën e vet e kishte patur ndoshta zanafillën tek ajo natë.

Ndërsa vërtitej rrugëve (sipër kokës së tij bashkë me epshin shuheshin njëra pas tjetrës dritëzat e pallatave), atij i vinin ndërmend kureshtira për numrin e grave që kishin zyrtarët e lartë në haremët e tyre, ashtu siç i kishte dëgjuar në kafenetë e ndyta të porteve. Diçka nga mahnitja e atëhershme i kishte mbetur ende.

Perëndi, sa të fuqishëm ishin një herë e një kohë, tha me vete duke u ngritur nga vendi i përgjimit. Kurse tani fuqia iu ka rënë si në çdo gjë.

Një pikëllim i turbullt, nga ato që kapërcejnë caqet e shkakut që i polli dhe që e bëjnë shpesh njeriun të thotë: se ç'kam kështu, e kaploi Beqir Aliun.

Që mekanizmat e shtetit të madh osman lëviznin me

ngadalë, që mbi dekretet, nëpunësit, gjithë punët e shtetit ndihej një lloj lodhjeje e përtese, këtë mund ta vinte në syri i kujdo e aq më tepër i Beqir Aliut, që kishte njëzetë e ca vjet që shërbente në administratën e lartë. Po që kjo lodhje e përtese të depërtonte gjer në palcën e njerëzve këtë nuk e kishte menduar.

Nga të dhënat e spiunëve të tij që përgjonin ç'thuhej kafeneve dilte se, përgjithësisht, njerëzit mendonin se punët e shtetit shkonin keq për shkak të kaurëve. Një pjesë thoshin se perandoria pavarësisht se me të drejtë e luftonte kishterimin duhet të përfitonte nga përvoja e shteteve të kishterë. Të tjerë përkundrazi thoshin se prej kontaktit me kaurët vinin gjithë të këqiat, ndaj duheshin prerë ato pa mëshirë. Këta të fundit ishin zakonisht besnikë të shtetit e të fesë, që kishin dalë në pension. Në letrat e tyre, një pjesë me emra e një pjesë anonime, ata ankoheshin se ndikimi i kaurëve po shtohej dhe administrata tregohej tepër e ngathët për t'i vënë fre shturrjes.

Beqir Aliu ishte shpirtërisht me këta të fundit, megjithëse mendimet e të parëve, e tërhiqnin nganjëherë djallëzisht si tundimi i Satanait. Ai nuk shpejtonte t'i dënonte ata, por aq më pak t'u hiqte vërejtjen pensionistëve për syçeltësinë e tyre. Ai rrinte në pritje, kështu që të dyja palët nuk e donin dhe me siguri kishin dërguar letra kundër tij në kryeqytet.

Prej kohësh mendja e Beqir Aliut i kanalizonte shumë gjëra sipas modelit të atyre që fliteshin kafeneve. Edhe tani, që ulur në minderin e dhomës së mysafirëve vriste mendjen për rënien e fuqisë seksuale të zyrtarëve të lartë, atij i vetëtinte nëpër mend se ndoshta shkak për këtë ishin prapë kaurët. Thuhej se zakone të reja po dilnin atje në kryeqytet, të sjella me siguri nga Evropa e mallkuar. Flitej se femrat shkruanin letra dashurie, se e merrte burri i botës letrën dhe në qoftë se ajo i shkruante «të dua», «të pres» e dokrra të këtij lloji, atij i fluturonte mendja nga gëzimi,

e në qoftë se i shkruante të tjera, domethënë «s'të dua më» bëhej burri i botës pikë e vrer, e varte kokën e s'i hynte në sy femër tjetër.

Eh, ia bëri me vete Beqir Aliu. Një shushurimë e butë e shkëputi nga mendimet. Prapë paska nisur shiu. tha me vete.

Një copë herë e dëgjoi zhurmën e tij të shtruar. Ishte një shi i butë, rrënimtar. Të dua, të pres, përsëriti me vete fjalët e një letre të përfytyruar që, megjithëse e përbuzte, fshehtazi ëndërronte ta merrte.

Kur koka iu shkund paspak e kuptoi se kishte dremitur. Te qelqet e dritares ishte po ajo shushurimë e butë. Mendja e tij u përpoq të shkonte prapë te lodhja e përgjithshme, te rrënimi i ngadalshëm, i pashmangshëm i gjithçkaje, kur befas mendimi i ngriu në një pikë: e sikur të mos ishte ashtu? E sikur mysafiri të kishte kthyer mbrapsht ofertën e tij jo për ato shkaqe që kishte kujtuar Beqir Aliu, po thjesht ngaqë kishte një gjë të ligë në mendje?

Nuk u desh veçse një grimë që dyshimet ta përmbytin prapë trurin e Beqir Aliut. Sa naiv ishte treguar pak më parë, kur me të dëgjuar se sulltani s'e zinte gjumi për punën e Shqipërisë, ishte qetësuar në çast. S'e paska me mua, po me Shqipërinë, kishte menduar si budalla. Kishte harruar se pavarësisht se ai nuk ishte qeveritar kryesor i Shqipërisë, ishte megjithatë një nga qeveritarët e saj. Dhe pak herë kishte ndodhur kjo sulltani i madh, për të qetësuar një vend, kishte shkuar në satër gjithë qeveritarët e tij, pa përjashtim, duke nisur nga më i larti e gjer te më i ulti?

Beqir Aliut iu mblodh një komp në grykë. A mund të kishte pagjumësi mbretërore që të mos e kishte mëngjesin plot kufoma dhe gjak?

Beqir Aliu e përfytyroi veten, kushedi pse, të rrëzuar anash, me grykë të prerë, jo si me jatagan a sëpatë, po si

me gërshërë (Më vonë iu kujtua se kështu e kishin gjetur, para një jave, një burrë të vrarë nga gruaja).

Hingëllima e një kali e shkëputi nga mendimet. Pa e ditur as vetë përse, si ta kishte ndjellë ajo hingëllimë, që ai e kishte njohur në çast se ishte e huaj në stallën e tij, Beqir Aliu zbriti shkallët dhe doli në oborr.

Pa u kujdesur të mbulohej me diçka eci drejt stallës. Një llambë vajguri ndriçonte zbehtë oborrin. Kur ai shtyn derën e stallës drita e llambës e ndihmoi të dallonte siluetat e kuajve. Aroma e kashtës së përzier me bajgë, shkroftimat dhe zhvendosja e shurdhër e shkaktuar nga prania e njeriut, të gjitha këto ishin tejjet familjare për Beqir Aliun. E ndryshme ishte vetëm ajo që kishte në kokë.

Përse e ke bërë njerinë aq të lig. allah, tha me vete. Në trurin e tij të lodhur mendimet mezi ngjizeshin. Gjithë urdhrat sekrete vinin të tërhequra nga kuajt, por ata vetë s' dinin asgjë. Hareshëm vraponin kur sillnin sihariqin dhe po aq hareshëm kur sillnin vdekjen.

Dora e Beqir Aliut përkëdheli njerën nga kokat. Asnjë kalë në këtë botë s'ka dënuar ndonjë herë një kalë tjetër, tha me vete. Kurse njerëzit nuk ëndërronin veç për këtë...

I dërmuar ai doli nga stalla dhe po aq ngadalë u fut në shtëpi. U shtri në shtrat, e la kokën zbuluar për të dëgjuar shushurimën e shiut, që në çdo rast tjetër do t'ia shpejtonte gjumin dhe ndjeu dëshirën të shkruhej në vaj. Një herë vimë në këtë botë, o perëndi, tha me vete. Përse nuk na i jep të gëzueshme këto pesë ditë të shkreta?

Mesnata duhej të kishte kaluar prej kohësh, ndoshta po afronte gdhinti, po gjumi nuk ipte ndonjë shenjë. Dy vjet më parë i kujtohej, kështu me ankth, i kishte gdhirë shumë net. Porse ishte rrëzuar vezuri i madh Jusuf dhe çdo ditë priteshin shkarkime dhe dënime të tjera. Një të shtunë, si për të davaritur disi ankthin, ai shkoi të kalonte fundin e javës te një kushëri, i tij në fshat. Por ankthi në vend që t'i largohej, e pushtoi edhe më keq. I dukej se

tani që mungonte e keqja do ta gjente edhe më shpejt. Gjithë natën s'e kishte mbyllur dot syrin. Ndaj të gdhirë, midis gjumit që mezi e kishte zënë, kishte dëgjuar një britmë të largët. I dukej se thërrisnin «Beqir Ali, Beqir Ali». O zot, erdhën të më marrin, kishte thënë me vete. Dyll i verdhë qe ngritur nga shtrati dhe ashtu, më këmbë pranë dritares kishte pritur arrestimin. Vetëm kur kishte dëgjuar zërin e të zotit të shtëpisë që po pyeste që nga dritarja e vet: «Kush je ti, more? dhe pastaj përgjigjen e tjetrit: «Ka vdekur Bakir Aliu» atij i kishte ardhur zemra në vend. Asnjëherë s'e kishte dëgjuar me aq lehtësim vdekjen e një kushëriri.

Allah, kishte kaluar kaq kohë dhe ai ankth ngjante si i ditës së djeshme... Po dale, i bënin veshët kështu apo dikush i thërriste prapë, këtë herë me emrin e tij vërtet: Beqir Ali, Beqir Ali.

U ngrit përgjysmë në shtrat. U sigurua që nuk ishte në ëndërr dhe vuri veshin. Zëri u përsërit, pak më i ultë se ç'i qe dukur në fillim dhe fare pranë, ndoshta pas dorës së dhomës së tij, Beqir Ali, Beqir Ali.

S'kishte asnjë dyshim, ishte zëri i mysafirit. Për çudi Beqir Aliu nuk ndjeu ndonjë tmerr. Megjithatë murmuriti: Allah, në dorën tënde.

Eci drejt derës, e hapi dhe vërtet te pragu i saj pa mysafirin.

: gjatë dhe më i bardhë në fytyrë, ndoshta nga rroba e natës.

— Po flije? — tha ai. — Sigurisht që po flije. Më fal, Beqir Ali.

— Ç'ishte?

— Asgjë, Beqir Ali. Më fal edhe një herë që të zgjova...

— S'ka gjë, s'ka gjë... Po ç'ka bërë vaki?

— Asgjë Beqir Ali. Në të vërtetë të thirra kot... fare kot... Sa për të bërë një çikë muhabet... po të duash ti... Më shumë se mbi fytyrën e mysafirit, sytë e Beqir

Aliut Ishin ngulur te rroba e natës, për t'u bindur se në të nuk ishte vërtet asnjë xhep prej nga mund të nxirrej katilfermani.

I çmendur, tha me vete për tjetrin. Kërkon muhabet në këtë orë. Po shyqyr, o zot, që më dërgove një të çmendur, se sa...

— Erdha, o gaz, — i tha me gjallëri. Sa të hedh diçka krahëve dhe erdha të bëjmë muhabet sa të duash.

— Më fal, Beqir Ali, — tha prapë mysafiri kur zunë vend në minder, pranë mangallit ku njeri nga shërbëtorët kishte arritur të sillte ca prush të mbetur diku nga ndonjë kënd i shtëpisë.

— Ç'është ajo fjalë, — u përgjigj Beqir Aliu, — Për mua është një kënaqësi biseda me ty. Madje, po ta dije që s'flije, do të vija vetë.

— Siç thashë edhe më parë, gjumin e kam të vështirë. Po sidomos kur ndërroj vend... Natën e ka bërë të gjatë allahu në vjeshtë. Thashë një herë të hedh ca rreshta në raportin tim, po dora s'di sepse, s'më punonte.

— Ç'raport, në më lejohet të pyes? — tha me një fije zëri Beqir Aliu.

— Ah, nuk ta thashë? Po ky është edhe qëllimi i udhëtimit tim: përpilimi i një raporti për punën e Shqipërisë.

Beqir Aliu vështronte si i shastisur.

— Është fjala për të ardhmen e saj?

Mysafiri tundi kokën.

— Pikërisht. Një raport, ose më mirë një promemorje, siç i thonë tani. Siç mund ta marrësh me mend, i dashur Beqir Ali, sulltanit të madh, i kanë ardhur kohët e fundit shumë raporte e propozime lidhur me Shqipërinë, po asnjë prej tyre nuk e ka kënaqur.

Beqir Aliu tundi kokën si të thoshte: merret me mend që s'është i kënaqur gjersa të nisi ty në udhë të gjatë.

— Raporti yt, inshallah, do të jetë me hajër, — tha ai.

— S'dihet, — u përgjegj mysafiri. — Raporti ose më mirë promemorja ime do të jetë një gjë krejt e veçantë dhe gjërat e veçanta, i dashur Beqir Ali, e kanë fatin o fort të bukur, o fort të hidhur.

— Meazallah — ia bëri i zoti i shtëpisë.

— Po unë, sido që të ndodhë e kam shpirtin të qetë: Unë i shërbej me besnikëri vendit tim dhe Islamit dhe pëlqehet, a s'pëlqehet raporti im aq më bën. Kryesorja për mua është që përpara Allahut të jem i pastër si floriri.

Hm, ia bëri me vete Beqir Aliu, që nuk i pëlqente aspak drejtimi që mori biseda. Atij i erdhi zemra në vend vetëm kur tjetri nisi të fliste konkretisht për raportin. Siç ia kishte përmendur shkitazi edhe gjatë darkës ishte fjala për kohën kur ushtria dhe administrata turke do të detyroheshin të linin Shqipërinë ashtu siç e kishin braktisur gjithë Gadishullin. Ky ishte edhe thelbi i çështjes: si të mbahej pranë Shqipëria, duke qenë e shkëputur?

Beqir Aliu prishi buzët. Ai nuk e qaste dot një mënyrë të tillë të arsytuari. Mos ardhte puna gjer atje, mendonte. Përndryshe në u shkëputtë një vend nga perandoria mëmë, atëherë ç'më ha malli mua nëse më qëndron pranë apo larg? Është njëlloj si ata burrat qaramanë që pasi e ndajnë gruan mendjen prapë e kanë tek ajo: më kë fle, më kujton apo jo, e dokrra të tilla. E ndave gruan, hiqe mendjen prej saj. Në djall të vejë. Në djall të vejë dhe Shqipëria nëse do të shkëputet.

Po mysafiri, me sa duket mendonte ndryshe. Ai vazhonte ti shpjegonte se fryma osmane, sado baza të forta të kishte krijuar në Shqipëri, (ai përmendi fenë islamike që e kishte përqafuar gjysma e shqiptarëve, pashallarët vendës të lidhur me një mijë fije me sulltanin, një inteligjencë të tërë proislamike, organizatën e fuqishme «D.B.» (Dum Babën) që ishte gati në rast përmbysjeje të gjendjes, të shpërthente një rebelim proturk etj. etj.) pra sado baza të tilla të kishte, këto nuk mjaftonin për mbajtjen e saj.

Mysafiri e ndjeu më në fund se Beqir Aliu deshi te ndërhynte.

— Mbase të duket e çuditshme e gjithë kjo?

— Hm. Si të them... Natyrisht ... Është herë e parë që dëgjoj gjëra të tilla, kaq të ngatërruara. Ti e di, unë s'jam veç një qeveritar provincial... Megjithatë, të them të drejtën, ajo punë e frymës osmane më duket vërtet pakëz e çuditshme. Në qoftë se ky vend shkëputet nga ne, atëherë, ç'na hyn në punë ç'frymë mbetet atje, osmane apo dreqi e di si quhet ajo tjetra?

U duk sikur mysafiri mezi e kishte pritur këtë çast për të shpërthyer në një të qeshur të gjatë çlodhëse.

— Këtu është edhe ndryshimi thelbësor midis meje dhe teje, Beqir Ali — tha ai pasi mbaroi së qeshuri (ajo ishte kaq absurde, sa që Beqir Aliut iu duk se pas mbarimit të saj tjetrit iu desh njëfarë kohe sa të sillte në gjendjen e mëparshme tiparet e fytyrës, si njeriu që pasi ka ngrënë një drekë të mirë, fshin një copë herë buzët dhe faqet me peshqir). Pikërisht këtu është edhe ndryshimi: ti je një zyrtar, një burokrat, siç thonë tani në kryeqytet, kurse unë jam një ideolog. Fjalë të vështira, ë?

— Eh, — ia bën Beqir Aliu.

— Unë i shoh gjërat shumë më thellë, Beqir Ali. Ana shtetrorë është një gjë e sipërfaqshme. Atë mund ta vendosësh e ta zhvendosësh lehtë në një vend. Kurse ajo tjetra, fryma po u ngjit një herë nuk shkulet kollaj. Për atë frymë unë kam vite që mendoj e punoj, Beqir Ali. Dhe thelbi i promemorjes sime është pikësisht ajo... Po dale, të përpiqem të ta ftilloj më mirë.

Mysafiri bëri një nga ato frymëmarrjet e gjata që s'di si t'i marrësh si thithje ajri apo si psherëtimë.

— Siç ta thashë më parë unë jam një fetar i thellë. Beqir Ali. Madje fjala fetar është pak në këtë rast. Unë jam më shumë se fetar. Unë jam aziatik i thellë. Qysh në rini i kam urreyer për vdekje Evropën dhe evropianët. I

kam urryer qytetet dhe gratë e tyre, kishat, kafenetë, gazetatat, babëzinë për të marrë vesh çdo gjë, votimet, parlamentet, logjikën e tyre të ftohtë mënyrën si ecin, si vishen, si arsyetojnë, shpirtin e tyre, kundërshtues, polemist, krenarinë, trazimin e përhershëm, gjithçka që ka të bëjë me atë që ata i quajnë «të drejta të njeriut» dhe që në të vërtetë s'janë veçse demoni i tij gjumëprishës. I urrej pra të gjitha këto, në kohën që më digjet shpirti për përgjumjen e bekuar të Anadollit, për stepën gjysmë të zhveshur që s'ka fund, mbi qytetet, fshatrat e qiellin e së cilës sundon vetëm një njeri prej të cilit varet fati yt, me mijëra fije të lidhura në mister dhe ti vetë nuk e di nga mund të të vijë e mira ose e keqja, ngritja ose rrënimi, se gjithçka është në dorë të tjetërkujt dhe gjithçka i ka rrënjët gjysmë në jetë, gjysmë në ëndërr, gjë që ty të çliron plotësisht nga trazimet, dilemat, sepse asnjëherë nuk kërkon të zbulosh shkaqet e gjërave dhe kështu i përgjumur siç vjen, ashtu dhe ikën nga kjo botë, pa u zgjuar kurrë plotësisht... Kështu pra, Beqir Ali, e kam urryer herët botën e tyre dhe qysh atëherë, në rininë time të parë, nuk ëndërroja veç të shkatërroja atë botë evropiane, të rrënoja tempujt, tërbimin dhe lirinë e tyre dhe në vend të tyre të ngrija mbretërinë tonë qetësuese, shkurt të ktheja vendet e krishtera në muslimane. Ngjante si ëndërr e pamundur? Kështu mund të dukej, madje kjo ëndërr mund të mos lindte kurrë në qoftë se nuk do të nxitej nga një shëmbull. Dhe ky shëmbull, i dashur Beqir Ali, është pikërisht Shqipëria.

Mysafiri i ra me dorë minderit si të tregonte një truall dhe për disa çaste në mendjen e Beqir Aliut u vërtit një nga ato persiatjet budallaqe, të pavend e të pakuptimta që sajohen shpesh në trurin e njeriut e që janë aq vetëtimisht të marra sa që askush nuk merr mundimin t'i tregojë, pra në mendjen e tij u sajua pyetja nëse trualli mbi të cilin qe ngritur shtëpia e tij ishte Shqipëria dhe se a

mund të quheshin kështu munderi si dhe qilimat që ai i kishte sjellë nga Anadulli?

Mysafiri vazhdonte të godiste me dorë minderin:

— Kjo ëndërr kishte ndodhur vërtet... Shqipëria e krishterë, mu në mes të detit të kaurëve, vetëm njëqind milje larg Vatikanit, ishte bërë jona, domethënë aziatike. E kupton se ç'gjë madhështore ishte kjo, Beqir Ali? Ajo ishte shenja e sigurtë e Allahut se Islami e kishte udhën e hapur për pushtimin e botës... Kështu pra, katërqind vjet më parë ëndrra ishte kryer... veçse ... veçse... gjithë puna ishte që ajo të mos ndërpritet... e kupton ç'dua të them, Beqir Ali. Gjithë puna është që ajo të vazhdojë, domethënë... që Shqipëria t'i mbetet Azisë... Ja përse nuk e zë gjumi sulltanin e madh.

Beqir Aliu e mbajti pa mëshirë një gogësimë që si për drejtdeshi të ngjitej pikërisht në atë çast në pjesën e sipërme të trupit të tij.

— Është e vështirë s'ka dyshim. — vazhdoi mysafiri. — Ndjaj po e vrasim mendjen të gjithë se ç'duhet bërë dhe raportet vërshojnë si lumë në zyrat e sovranit. Ka ardhur ora e provës, Beqir Ali. Evropa e krishterë përpiqet ta marrë prapë Shqipërinë. Është imja, thotë, kthemani. Pra ka ardhur vërtet ora e provës. Sepse prova e vërtetë është çasti kur lëvozhga, domethënë ushtria dhe administrata jonë do të tërhiqen nga ky vend. I ke parë arat kur u thyen lëvozhgën? Atëherë duket se ç'ka brenda: kokrrën e shëndoshë, apo të bërë pluhur nga krimbi. Kështu është dhe puna e një vendi të pushtuar pas mbarimit të pushtimit. Kur lëvozhga të thyhet (mos e prish ashtu atë fytyrë, Beqir Ali, ushtria dhe administrata jonë do të tërhiqen së shpejti nga ky vend, kjo është si një e një bëjnë dy, por unë s'po zgjatem të të shpjegoj arsyet e kësaj), pra kur lëvozhga të thyhet, do të shohim ç'ka në të: një Shqipëri të zbutur, të aziatizuar, apo një tjetër Shqipëri të huaj e të patrajtueshme. Të them të drejtën, më parë kam besuar se

pas katërqind vjetësh nën pushtimin tonë Shqipëria do të qe magjepsur më në fund prej nesh dhe do të qe bërë ashtu siç e donim të gjithë. Kjo do të ishte me të vërtetë një mrekulli. Sepse është vërtetë mrekulli kur një vend, që ti ia ke hedhur me aq zor frerin e nënshtrimit, mësohet më në fund me të, dhe, kur ti ia heq atë frë, në vend që të të largohet, të ndjek pas. Atëherë po, mund të thuash se e ke fituar atë vend.

Ai tundi kokën sa djathtas, majtas i ngrysur.

— Siç të thashë, unë besoja se kështu do të ndodhte me Shqipërinë, po, siç tregojnë bethët, punët qëndrojnë ndryshe. Pas katër shekujsh bashkëjetese, shqiptarët vazhdojnë të mos na duan dhe këtë ti e di më mirë se unë, Beqir Ali.

Beqir Aliu bëri «po» me kokë

— E megjithatë unë prapë besoj në ëndrrën e vjetër, — tha mysafiri, duke trazuar prushin e mangallit. Nga përndritja e tij unazat iu flakëruan në dorën që mbante mashën. — Unë besoj ende në aziatizimin e Shqipërisë, veç me një kusht: që ai të bëhet prej vetë shqiptarëve, pa u shtyrë drejtpërdrejt nga askush, e aq më pak nga ne. Të duket e çuditshme? Të duket e pamundur? Nganjëherë janë tamam këto të çuditshmet, të pamundurats, që ndodhin në këtë botë.

Ai trazoi prapë mangallin, me sy të ngulur në të. po ndriçimi i prushit nuk ia arrinte fytyrën.

— Thelbi i raportit tim merret pikërisht me këtë: vet-aziatizimin e shqiptarëve. Kur ky proces të fillojë, atëherë do të nisë në Shqipëri Azia e vërtetë dhe katërqind vjetët e para të marrëdhënieve shqiptarë-turq nuk do të duken më pas veçse si prologu i përgjakur i paqes së ardhme. Të tingëllon e pabesueshme e gjithë kjo? Ke të drejtë, Beqir Ali. Tani do të përpiqem të ta shpjegoj më shtuar.

Ai e trazoi prushin më gjatë se herët e tjera dhe vezullimi dhe shuarja e gurëve të unazave në dorën e tij i

kujtuan Beqir Aliut një ndjesi të përafërt me parandjenjën e fatkeqësisë.

— Një njeri mund të bëjë atë që nuk e bën dot as ushtria, as hoxhallarët dhe as vezirët tanë, — tha ai pas-pak. — Veç me një kusht: që ky të jetë shqiptar dhe që shqiptarët ta pranojnë për udhëheqës të tyre.

Mysafiri kapi përsëri mashën, po kushedi pse, nuk e trazoi prushin dhe Beqir Aliu, gjithashtu, pa e kuptuar për-se, tha me vete: shyqyr.

— Katërqind vjet më parë një njeri i hapi një plagë të pashërueshme perandorisë sonë. Besoj se e kupton se për kë e kam fjalën, për të mallkuarin Gjergj Kastrioti. Ka shekuj që është bërë baltë e dhe, as varri nuk i dihet, po sa para bën. Kujtimi i tij jeton dhe bashkë me kujtimin rron ideja e tij. Ishte ky demon që e riktheu rrotën e historisë së këtij vendi nga kahja e bekuar që porsa kishte nisur në atë të nëmur, drejt Evropës. Siç mund ta dish ai vetë u kthye nga Skënderbe në Gjergj dhe u shpall kalorës i parë i krishterimit.

Eh, psherëtiu Beqir Aliu dhe ndjeu edhe ai dëshirë të trazonte mangallin, gjë që do ta bënte sikur masha të mos ishte në duart e mysafirit.

— Ajo që u bë, u bë dhe s'është koha për vajtim, — tha mysafiri. — Koha kërkon tjetër gjë: të gjendet një njeri, një tjetër prijës, që të jetë i kundërt në çdo gjë me Gjergj Kastriotin. Të gjendet pra një Tersgjergj, ose një Antigjergj, siç i thonë kaurët.

Një antikrisht, mendoi me vete Beqir Aliu. Iu kujtua se një letër denoncimi në dosjen e poetit N.B. e kishte hasur këtë fjalë. Sytë e mysafirit i kishte tani më pranë se më parë, po, për fat të mirë, prushi që zbehur mjaft për t'i ndriçuar ato.

— Një hoxhë në vend të princit, ja ç'i duhet këtij vendi, — vazhdoi tjetri. — Kur Azia të tkurret, të bëhet sa një bërthamë, ashtu siç thonë se tkurret gjithësia në ciklet

kozmike, kur Azia pra të tkurret, në këtë vend, ajo do të strehohet e gjitha, në qënien e tij. Le të rrënohen ligjet tona, skllavëria dhe minaretë, mjafton që ato të jenë në trurin e atij njeriu. Sepse do të vijë dita, kur ashtu siç bymehet prapë gjithësia e zvogëluar do të shpërthejë e do të bymehet gjithë Azia e tkurrur: prangat, ankthi, tirania. Nuk e di nëse më kuptove, Beqir Ali. Në trurin e një njeriu dhe askund tjetër ne duhet ta lemë bërthamën tonë.

Beqir Aliu nuk e fshihte habinë e tij. Kishte qenë kaq vite qeveritar krahine, dinte lloj-lloj të fshehtash e marifetesh që i mëson njeriut posti i sunduesit, po të tillë jo. Në trurin e një njeriu dhe asgjëkund tjetër, përsëriti me vete fjalët e mysafirit.

— Ti do të thuash, kush do të jetë ky njeri, ç'fytyrë do të ketë. Ky është edhe thelbi i çeshtjes, Beqir Ali, për këtë kam net të tëra që nuk fle dot.

Ai trazoi mangallin më gjatë se zakonisht. Në përndritjen e dobësuar të prushit, kishte lodhje dhe qesendi, si qesënditë para vdekjes.

— Që fytyra e tij duhet të jetë e mynxyrshme, e ububushme, kjo merret me mend, — tha mysafiri, — po a mjafton kjo?

Ai u mendua gjatë, pa e lëshuar mashën nga dora. E tundi kokën një copë herë si të kundërshtonte një mendim të brendshëm, pastaj e tundi prapë, si të pranonte një pjesë të tij.

— Pesëdhjetë vjet më parë, mistiku Haxhi Halil Ruholaku, udhëtoi për katër muaj rresht, që nga shpella e tij gjer në kryeqytet, për t'i parashtruar sovranit mendimin e tij lidhur me një krahinë, emrin e së cilës s'dua ta zë ngoje tani. Ajo krahinë që bërë në atë kohë, problemi numër një i shtetit. Kishte kohë që kërkonte shkëputje dhe kërkesa e saj përkrahej nga disa shtete evropiane, fqinje të saj. Politika e madhe e shtetit tonë kërkonte pajtim me këto shtete, po, nga ana tjetër, sulltanit i dhimbsej kjo krahinë,

ashtu siç i dhimbset Shqipëria tani. Ç'të bënte? Mëdyshja zgjati shumë kohë, gjersa në kryeqytet mbërriti eremiti Haxhi Halil Ruhollaku. Ai kërkoi takim me sovranin dhe priti një javë rresht te porta e Dollma Bahçesë, gjersa u pranua më në fund. Ai i propozoi sovranit një gjë që u duk e çuditshme, të bëhej çmos që në krye të lëvizjes për pavarësi të krahinës në fjalë të vihej një renegat. Beqir Aliu mezi ç'po priste këtë çast për ta marrë mashën e për ta trazuar e trazuar një copë herë mangallin, si njeriu që mezi ç'pret çastin për t'u kruar; kushedi pse nuk e zgjati dorën. Turbull iu duk se duke mos e marrë në dorë mashën vetvetiu shmangte rrezikun që të bënte ndonjë të pabërë; në vend që të trazonte hirin, t'i binte në fytyrë mysafirit një herë, dy herë, tri herë. Allah, pse më dërgon mendime të tilla, psherëtiu së brendshmi.

— Ti mund të pyesësh se a është e moralshme që shteti ynë i bekuar të shfrytëzojë gjëra të tilla të pista e të shëmtuara për të siguruar aleatët e vet.

Ai e vështroi Beqir Aliun drejt e në sy, si për të përsëritur heshturazi pyetjen:

— Eh, si të them... jo xhanëm... — mërmëriti Beqir Aliu.

— Ke të drejtë ta bësh një pyetje të tillë. Dhe nuk ke faj. Të gjithë ata që njihen së pari me këtë problem e bëjmë. Përgjigjja, Beqir Ali është e thjeshtë: s'ka gjë që nuk lejohet kur është fjala për forcimin e Islamit. Më kupton?

Beqir Aliu bëri «po» me kokë. Masha ishte ende në anë të mangallit, por ai nuk po guxonte ta merrte atë.

— Eh, — mori frymë thellë mysafiri. — Që të kthehemi te puna e Shqipërisë... Ja një gjë të tillë mendoj unë edhe për këtë vend. Një gjë të ngjajshme, më kupton, Beqir Ali? Të gjendet një njeri i tillë si ai që të tregova dhe Shqipërinë do ta kemi tonën përjetë. Ajo do të na dojë vetë, madje më shumë se ç'e duam ne veten tonë. Dhe kur Islami të sigurojë disa aleatë të tillë, si unazë mbrojtëse

rreth e rrotull tij, atëherë mund të thuhet se ai e ka fituar davanë me krishterimin. Ky do të jetë, siç të thashë, edhe thelbi i raportit tim. Në qoftë se ai do të miratohet prej sovranit, atëherë do të jetë detyra juaj të kërkoni e të gjeni njeriun për të cilin fola. Ndoshta do të jesh ti i pari që ta gjesh, Beqir Ali.

Sytë e tyre mbetën të mbërthyer një copë herë te njëri-tjetri.

Të gjej Antikrishtin mendoi Beqir Aliu. Turbull, ashtu siç qe njohur me to nëpërmjet denoncimeve e dosjeve betimore, atij i vetonin ndërmend grimca nga historia e të krishterëve.

Mysafiri vështroi një copë herë nga dritaret.

— Më duket se po gdhin, — tha.

Beqir Aliu tundi kokën.

— Është mesi i tetorit dhe koha është ftohur si në dimër.

Mysafiri vazhdoi të vështronte qelqet e errët.

— E di si i thonë kaurët kohës që jetojmë? — tha paspak. — Shekulli i njëzetë...

— Ah, po, e kam dëgjuar nga këta karafilët e këtu-shëm, poetët...

— Shekulli i njëzetë... — përsëriti tjetri. — Tingëllon për të qeshur, apo jo? Ka disa vjet që sipas tyre ne, jetojmë në këtë shekull...

Beqir Aliu priste që ai të shqyhej gazit, ashtu si pak më parë, po fytyra e tjetrit qe zymtuar edhe më.

— Tani që e nxora këtë helm e ndjej se mund të fle, — tha ai dhe mbështeti njerën dorë te shpina e minderit, për t'u ngritur. — Natën e mirë, Beqir Ali.

— Natën e mirë, gaz — u përgjigj i zoti i shtëpisë.

Ai qëndroi për një kohë të gjatë në këmbë, pa lëvizur. Pastaj iu afrua njerës prej dritareve, pikërisht asaj së cilës pak më parë i kishte ngulur sytë mysafiri dhe qëndroi atje, krejt i mpirë. E ndjente si nga qelqet vinte ftohtësia e natës. Larg regetinin ca dritëza të zbehta. Ishin dritare shtëpish në të cilat njerëzit, për një shkak ose një tjetër, ishin çuar herët.

Në mendjen e tij vazhdonin të rrezellonin grimca nga historia e të krishterëve. Urdhri i mbretit Herod për gjetjen e krishtit foshnjë. Ardhja e mbretërve magë. Larja e duarve të Pilatit...

Ai mbylli sytë i lodhur. Në qoftë se raporti i mysafirit, do të miratohej... në qoftë se fjalët e tij nuk ishin thjesht përçartja e një të marri, si do ta gjente renegatin e zot dashnorin e vogël të Azisë?...

Nuk i kujtohej mirë ç'kishte bërë mbreti Herod për gjetjen e Krishtit. Duhej të hapte prapë dosjet, letrat anonime, të zbrishte ndoshta në qelinë e burgut ku mbanin njerin prej poetëve... Ai do të mësonte hollësisht të mëtejshme nga kjo histori e vjetër, të tilla që mund t'i hynin në punë, pavarësisht se Herodi kishte kërkuar Krishtin për ta zhdukur, e ai do kërkonte Antikrishtin për të kundërtën.

«Po a s'është e njëjta gjë», — tha me vete pas një ngurimi. A s'është e njëjta gjë, o allah, përsëriti dhe zgjati dorën të mbahej pas pezulit nga që iu duk se po i merreshin mendtë.

Tiranë, 13 tetor 1987

KUJTIMET E HUMBURA

Që pas xhamave të dritares, nuk mund të dalloje ende mirë në kish pushuar shiu apo jo. Qielli po çahej aty-këtu nga retë përsëri drejt hapësirave të kaltra të porsaçelura dhe duke shtyrë njëra-tjetrën i mbulonin ato si me cmirë. Në rrugë u ul një ombrellë, pastaj një tjetër, një plakë doli nga streha ku qe futur dhe vazhdoi të ecte mbi pllakat e lagura. Furtuna e shkurtër pranverore kish pushuar.

Dy ushtarë kufiri qëndronin te dritarja e madhe e korridorit të spitalit dhe vështronin jashtë, pa u kthyer nga njëri-tjetri dhe pa këmbyer fjalë. Korridori i shkretë dukej edhe më i heshtur nga ato perde të rënda, të gjelbra që u vareshin dritareve si rrobdëshambër. Dhe dritaret ngjnin si gra të mëdha të përgjumura dhe duke shkuar korridorit u ndalën për një çast të vështrojnë a po pushon shiu.

Por ja dera e sallonit u hap dhe që nga brenda dolën një grup infermierësh krejt në të bardha. Kufitarët u duk sikur u gjallëruan menjëherë. Ata u kthyen drejt grupit të heshtur të njerëzve veshur me të bardha dhe në fytyrat e tyre rrëshqiti ankthi i pritjes së lajmit të gëzuar apo të humbjes që s'ka kthim.

Doktori u ndal para tyre, i vështroi një herë drejt në sy pas syzeve pa tel dhe foli ngadalë:

— Nëntogeri rron, po ka humbur kujtesën.

Një mbrëmje të errët marsi, në postën kufitare N. nëntoger Mojsiut i erdhi një letër. Ai e rrotulloi një grimë në duar zarfin e përlyer, i hodhi një sy adresës së shkruar pa kujdes, pullave të ngjitura shtrembër dhe vulave dhe pastaj e grisi.

Po binte nata dhe në malet kish rënë një mjegull e dendur. Mojsiu iu afrua kandilit dhe filloi të lexonte. Në fillim rrudhi ballin, rifilloi përsëri nga rreshtat e para, pastaj filloi t'i dridheshin duart. Letra i ra përtokë. Ai lëvizi krahun e majtë, dejtë iu frynë në t'ëmbëlët dhe dora iu drodh përsëri. E lexoi përsëri dhe gërmat e shtrembra, shkruar me bojë të zezë, filluan të vallëzonin para syve të tij, të thurreshin e të shturreshin në ato fraza aq fatale që kishin vrapuar diku që pas maleve, larg nga jugu, dhe e kishin gjetur atje, në atë grykë të egër, për t'i prishur qetësinë.

«Mojsi, harroje atë, Rita të tradhtoi me Skënderin».

Ai mbylli sytë ngadalë dhe para tyre u dukën gërshetat e zez, që u drodhën si gjarprinj, dy sy të zez të njomur lotësh, siç i kish parë natën e fundit, duke i premtuar dashuri të përjetshme.

«Tradhtoi»... murruriti djaloshi pa kuptuar mirë. Sa herë e kish dëgjuar ai fjalën e pashpirt «tradhtoi» në dashuri. Dhe ja tani po i ndodhte atij, vetë atij, jo më në tregime dhe në filma. Në kapanonin e vogël ishte qetësi. Drita e kandilit mezi arrinte gjer në muret e bardhë, kurse poshtë atë dukej sikur e thëthinin batanijet e errta mbi shtretërit prej druri. Vetëm pushkët dhe mitrolozat shkëlqenin në armatura.

Mojsiu u lëshua mbi një shtrat, mbështeti bërrylat mbi jastëk dhe u mundua të mblidhte mendimet e përziera e të shpërndara. Si ato trupat që marshojnë të rregullta në xhade dhe befaz shpërndahen në panik prej alarmit ajror, ashtu u shthurrën mendimet e tij.

«Ajo të tradhtoi, ajo të tradhtoi...»

... Pas mesnate nëntogeri që i pari që dëgjoi britmën e rojës dhe krismën e një automatiku. Ai u hodh siç që i veshur nga shtrati dhe vrapoi te dera me kobure në dorë. Dy mitroloza filluan të rrahin në errësirë përnjëherësh. Plumbat vërshëllyen nga dritaret, shuan kandilin, thyen xhamin e gazetës së murit. Ndërkaq ushtarët kishin dalë jashtë dhe u shtrinë në llogoren e hapur para postës. Mitrolozat s'pushuan. Mojsiu vrapoi nëpër hendek për të kërkuar oficerin e rojes. Po një plumb e goditi në kokë. Duke iu marrë këmbët ai vuri dorën në tëmbël dhe ra pa lëvizur më.

— Shoku nëntoger... shoku nëntoger!... — e thirri dikush në errësirë.

— Çun-o, a të çon kjo rrugë për në X?

— Jo, e ke ngatërruar, duhet të kthehesh nga e majta, ja aty ku çohen ata tre plepa.

— Faleminderit.

Djali i vogël, i zbathur, e vështroi me kureshtje oficerin e ri pa kapele dhe pa rrip që kishte ngatërruar një rrugë kaq të njohur në mes të ditës.

Mojsiu u vrenjt. Vështroi prapë rreth e rrotull dhe u kthye përsëri drejt tre plepave. Shenja e dëshpërimit të thellë që të përtërin një kujtim të hidhur, u pasqyrua në fytyrën e hequr zeshkane.

«Edhe rrugën e kam humbur... po, të gjitha, të gjitha. Plagë e mallkuar!»

Ecte ngadalë, i lodhur, duke mbajtur çantën ushtarake në kurriz. Çizmet i qenë lyer krejt me baltë, balta kish spërkatur me njolla të mëdha e të vogla cepat e kapotës së zbërthyer.

Rruga zgjatej në mes të arave dhe pyjeve të vegjël, aty-këtu humbiste ose mund ta gjeje vetëm nga gjurmat e thella të rrotave të qerreve, që qenë mbushur me ujë. Fletët e zverdhura kalbeshin aty në atë të rrugës, përzier me baltën e zezë, vajtonin e trishtoheshin për kohën e lumtur, kur fëshfërinin nga era.

Moisiu e vështronte çdo gjë përreth si për herë të parë. Këto ishin vendet ku ai kish bredhur në fëmijni, kish luajtur e ish rrahur me shokët e vegjëlisë. Këtu kish bleruar një pjesë e jetës së tij; në këto pyje të dashura, të ulta, të shtrira mbi fushën gjithmonë të qetë, gjithmonë të lagur. Po pse e vështronin ashtu të pikëlluara, të huaja e të ftohta, ato vende të dashura? Nëntogeri më kot mundohej të sillte ndër mend qoftë një kujtim të vetëm të së shkuarës. Një mjegull e dendur, e errët, e pamëshirshme e ndante atë nga jeta e tij. Atij i dukej se të gjitha këto vende rreth e rrotull ruanin një të fshehtë që vetëm ai nuk e dinte. Dhe e mundonin për këtë të fshehtë dhe u vinte keq për të që s'mund t'ia tregonin dot.

Atëherë mos flisni, ruajeni të fshehtën tuaj dhe mos e vështroni me mëshirë nëntogerin. Ai do të ecë rrugës pa kthyer kokën nga ju, duke ngulur vështrimin në këto gjurmë të pambaruara qerresh, të mbushura me ujë.

Era e vjeshtës, pasi rrëzoi fletët dhe zhubraviti ujërat pellgjeve, pasi i gleturoi kashturinat dhe përplasi kanatat me forcë, doli të frynte nëpër fushë sikur të shikonte mos

kishte mbetur ende ndonjë gjethe në degë të ndonjë plepi, apo ndonjë lere me ujë të kthjellët.

Pylli ish braktisur. Zogjtë kishin fluturuar prej kohësh dhe vetëm degët kërcisnin tek-tuk, sikur grindeshin me njëra-tjetrën.

Kushedi, i zinte malli ndoshta për zogjtë këngëtarë dhe grindeshin nga mërzia. Ja, me këtë pyll të braktisur ngjante zemra e Moisiut. Kujtimet e jetës fluturuan të gjitha për të mos u kthyer më. Do t'i vijne zogj të tjerë pyllit. Do të vijne kujtime të tjera.

U bënë tri ditë që kish ardhur në fshat. Në këtë kohë kaq të shkurtër ai provoi kaq ndjesi të shumta sa s'kish provuar ndonjë herë në jetë. Ai kish njohur menjëherë nënën dhe babanë, po të tjerët mezi i sillte në mendje. Kur i takonte kish frikë t'u përmendte emrat se mos i ngatërronte. Vetëm Rita nuk ishte zbehur aspak në kujtesën e tij, po vetëm kaq, të gjithë të tjerat qenë zhdukur. Ai nuk e dinte se ajo i kishte thënë një herë «të dua», se ai e kish puthur atë qindra herë dhe më në fund se ajo e kish tradhtuar me një tjetër. Shoku që i kish shkruar në letër për këtë, kish ikur prej kohësh në Tiranë dhe Moisiu kishte mbetur në fshat vetëm, pa shokë, pa ditur kujt t'ia hapte zemrën.

Po pse nuk e kish parë vallë Ritën këto tri ditë? Ata kishin qenë bashkë, të afërt më parë, shokë të mirë, ndoshta miq. Ai kish kohë që e donte, ai e kish thirrur shumë herë emrin e saj përçart në spital: kurse ajo, siç duket, nuk e kish kuptuar ende këtë. As që bëre kurioze ta shihte pas kthimit nga spitali. Po çdo gjë mund të ndodhë në jetë. Mundet që një vajzë mos të ta vërë veshin, megjithëse ti je gati të hidhesh në zjarr për të. Ndoshta kjo vjen se ajo nuk e di këtë dhe kështu ëndërron për një tjetër, kur ti e thërret përçart në errësirë.

Kështu gabohej me mendjen e tij Moisiu, duke ecur ngadalë nëpër rrugën me baltë jashtë fshatit, me kapotë zbrërthyer, të hedhur krahëve. Doktor i kish këshilluar shë-

titje të tilla të vetmuara në natyrën e qetë fusharake. Por ai do të shëtiste kështu edhe sikur mos ta këshillonte mjeku.

Nuk mund të duronte dot vështrimet e dhimbshme të fshatarëve, përlotjen e syve të nënës kur e shihte të heshur e të kredhur në mendime. Ai kurrë nuk e kishte duruar mëshirën në jetë dhe aq më shumë tani që ish i plagosur.

Mbrëmjeve sidomos i kish pëlqyer gjithmonë të bridhte fushën që humbte tutje në perëndim, kur nata rëndonte plot me mjegull. Gjithmonë ecte ngadalë me duar në xhepa duke ngacmuar me çizme ndonjë copë baltë të tharë, a fije bari.

O, sa do të donte të kujtonte tani diçka nga e shkuara, nga fëmijënia... Ç'kish bërë vallë ai 20 vjet rresht në këtë fushë të veshur me pyje, ku nxinin shtëpitë dhe kasollet e fshatit të tij? Ç'kish kërkuar, ç'kish ëndërruar, përse qe trishtuar ndonjëherë...

Sa do të donte të kujtonte diçka.

Edhe unë doja të thosha diçka për jetën e tij, por atij asgjë s'i kujtohej. Dhe mua më ranë ndërmend vargjet:

Meqenëse lule dimrit s'ka

Edhe për të s'duhet trishtuar...

Një qerre e vjetër e braktisur kish kohë që lagej nga shirat e tetorit, aty përpara gardhit. Rreth e rrotull vendi qe mbushur me gjethe të rëna, që zverdhnin e nxinin të kalbura nga ujërat. Vetëm nën shtratin e qerres toka qe e thatë dhe e panjolllosur nga fletët.

Mojsiu u ul mbi njëren nga rrotat e thyera dhe ndezi një cigare.

Ishte një mëngjes gjysmë i vrenjtur. Tutje, nga ana e detit përsëri po çohet mjegulla e bardhë. Rrugëve të fshatit nuk dukej njeri se të gjithë qenë në fushë. Tutje dëgjohej buçitja e dy traktorëve që herë ngrihej e herë ulej nga era, kurse gardhet dhe kopshtet qenë të heshtura. Vetëm Taqoja i vogël ulërinte i shtrirë në mes të baltës, me libra e fletore të flakura sa andej-këndeje. Siç dukej përsëri s'donte të shkonte në shkollë.

Pastaj edhe britmat e tij u shuan pak nga pak dhe në fshat ra prapë qetësia. Moisiu nuk dinte ç'të mendonte. Ndezi edhe një cigare tjetër dhe u mat të ngrihej, kur vuri re të kalonte, matanë gardhit, me hapa të gjata e të shpejta një djalë. E vështroi ashtu kot duke u munduar të sillte ndër mend dhe një çast vështrimi i tij indiferent praku shikimin e druajtur e të shpejtë të djaloshit që u mundua të mos binte në sy. Po kurioziteti e tradhtoi. Ai e pa dhe një grimë Moisiun dhe pastaj, duke ndaluar buzëqeshje si ai fëmija që ka bërë faj dhe para se t'i tregojë prindit buzëqesh hidhur dhe druajtur.

— Si je, Moisi, si shkon?... Kur erdhe? Të shkuara!

— Faleminderit...

Ata i shtrënguan dorën fort njëri-tjetrit dhe pastaj sikur të qenë marrë vesh fshehurazi, bruan gishtrinjtë dhe duart rrëshqitën ngadalë e u ndanë.

Djali përsëri uli sytë dhe një ngjyrë e zbehtë, si ato fletët që kalbeshin për tokë, i mbuloi fytyrën e bukur. Frymëmarrja iu çrregullua. Me dorën e djathtë trazoi flokët e zez, si i shastisur dhe duke ngulur sytë anash mezi e mblodhi veten.

— Më fal që po largohem. Më presin në shkollë.

— Adio...

Moisiu thithi cigaren dhe e vështroi për një kohë të gjatë djaloshin që po largohej.

«Çudi se ç'njerëz ka kjo botë», mendoi dukë qeshur me

vete i habitur. «U zverdh e u trondit sikur të më kish vrarë babanë».

Nëntogeri mblodhi supet dhe u nis për në fushë. Filloi një shi i hollë. Ai kishte shumë qejf të ecte nëpër shiun e butë, që shushurinte mbi fletët dhe përbalte rrugicat. Duke ecur donte të mendonte diçka dhe bashkë me mendimet shpejtonte dhe hapat. gjersa përsëri pushonte me ndonjë vend i lodhur.

Ai ngjante me erën që herë frynte e furishme, duke hapur dogët e duke vërtitur fletët pa mëshirë, dhe herë qetësues e qlodhej aty afër.

I erdhi turp që po bridhte kështu pa një punë, por i erdhi dhe eudi që njerëzit s'po e shoqëronin. S'mund ta kuptonte ai se fshatarët s'e merrnin me mend sëmundjen e tij, se ata qenë të prekur në sedër që ai s'i mbante mend. Shekujt i kanë bërë ca skeptikë fshatarët tanë.

Po Rita pse s'e takonte Rita?

Era që ish qetësuar filloi të frynte e të vërshëllente prapë. të shkundte drurët e të ndiqte tutje ato fletë pa qenë rregulluar përtokë, t'i shpente larg si nga inati për të mos i lënë aty afër drurëve, nga ranë, se drurët ndoshta cmaleshin me to e nuk brengoseshin.

— Rita, ti je, ndalu pak.

— Ç'më do?

Një djalosh u shkëput si hije që pas kapërcyellit dhe i doli përpara vajzës. Ajo qëndroi e vështroi dhe uli kokën, duke parë mënjanë, si pa e pasur mendjen aty.

— Ç'më deshe? — Zëri i saj ish i dobët, i vuajtur.

— Rita.

Hëna rrëshqiste shumë shpejt pas reve. Rruga që braktisur dhe vetëm tutje ulërinte një qen.

Edhe ai uli kryet. Sytë e tyre s'guxonin të takoheshin, ata sy që kishin përplasur qepallat dhe përzier lotët bashkë kaq net. Ai vështroi vjedhurazi sytë e saj të bukur, të thellë, magjepsës, buzët e fryra pak të përthara, faqet pak të hequra, atë fytyrë çapkëne, që shkëlqente bukur dhe tani qëndronte e hutuar para tij, e bardhë si mermeri nën dritën e papastër të hënës së ftohtë.

— Fol, ç'më deshe? pyeti ajo prapë dhe psherëtiu me një psherëtimë të qetë.

Ai e mbante kokën ulur, sikur një peshë e rëndë e përulte drejt tokës, drejt baltës së zezë.

— Rita, ti më thuaj drejt a më do më?

Ajo nuk foli. Se ç'vështronte nën këmbë në rrugë ndonjë fletë, a ndonjë gjurmë pa e patur mendjen aty. Qeni nisi përsëri ulërimën larg.

Ai i hapi duart e saj plot me frikë dhe ia shtrëngoi fort

— Rita, më thuaj, ti do një tjetër, ti do Moisiun? — zëri i tij dridhej jo nga mallëngjimi, po nga ankthi.

Ajo përsëri s'u përgjigj. Në faqen e zbehtë mezi shkëlqeu një lot. I hoqi ngadalë duart nga duart e tij, si për të mos e kuptuar ai, dhe foli me zë të ulët, sikur i fliste vetes, sikur fliste në ëndërr.

— Vetëm atë kam dashur unë në botë.

Djali u drodh.

— Ashtu? — Ai u mat të thoshte diçka të rëndë, të ftohtë, përbuzëse, po kur e pa se ajo qante pa u ndjerë, heshti. I erdhi keq për të, e mëshiroi. Ai deshi që në atë çast të frynte erë e fortë, të bëhej zhurmë e rrëmujë, për të mos dëgjuar atë ngulçim të mbytur që i pikonte në shpirt. Po nata ish e qetë dhe erën sikur e kish zënë gjumi.

— Skënder, — foli befas vajza, duke u kthyer nga ai e duke i kapur duart, — të lutem, bëje këtë, më paç në qafë.

— Çfarë nuk të kuptoj.

— Ti më ke dashur, bëje këtë. Largohu nga fshati. Dikur më the se do të shkoje në një kurs në Fier.

Këtë herë ai ia shtyri duart ngadalë.

— Po, unë do të iki, e kam vendosur këtë ditë. Do t'ju lë të qetë...

Pa mbaruar mirë fjalën, u kthye dhe u nis me hap të shpejtë, duke e lënë vetëm në mes të rrugës.

Një qen filloi të lehte, thua se i përgjigjej atij që ulërinte, sikur e qortonte.

Dy vajza ecnin në rrugën pa njerëz me hap të shpejtë, me kokat të lidhura me shami. Ishte vonë dhe ngaqë zhurmat e ditës qenë shuar, dëgjoheshin vetëm tingujt e këngëve të dasmës, dhe gazet. Kasollet dhe gazetat ishin të strukura në hijen e natës, sikur u zhdukën nën jehonën e largët të këngëve të vajzave, që fluturonin rrëshqitazi mbi fushë. Sa mirë është të flesh nën këta tinguj të mbushur me një ton të trishtuar, që të kujton diçka nga e shkuara. Unë e kam provuar këtë kur mbuloja kokën në shtratin tim prej konviktori dhe më mbylleshin sytë, (ose nuk më zinte gjumi gjithë natën), duke dëgjuar së largu këngët e vajzave. Dhe kasolleve dhe gardheve sigurisht diç u kujtonin këta tinguj që vinin nga një dasmë tjetër.

Rita me shoqen e saj kalonin rrugëve të errta dhe që së largu panë fenerët që ndrinin te porta ku bëhej dasma. Ca fëmijë bridhnin rrotull. Një plakë e kërrusur, veshur me të zeza po ngjiste pragun e mbajtur për krahu nga një burrë. Nga brenda se kush u hodh për ta përsëndetur. Dy vajzat shkuan si të druajtura anës murit dhe u ndalën te porta pa guxuar të hynin. Nja dy djem vinin të vrenitur në errësirë, duke pirë cigare e duke u hedhur sytë vajzave që shkonin. Ato të dyja kaluan duke shtyrë njëra-tjetrën,

duke ulur kokën e duke qeshur mbyturazi, siç e kanë zakon vajzat kur hyjnë në dasmë (ato të fshatit), apo në mbërmje vallëzimi ato të qytetit. Brenda dhomat dhe korridori zienin nga njerëzit. Dukej një rrëmujë e madhe, siç të duket gjithmonë kur hyn në një vend dëfrimi. Vajzat me të shpejtë u drejtuan në kënd ku qenë mbledhur shoqet e tyre, të gjitha veshur e stolitur për dasmë. Kushedi pse nuk këndonin më. Vështronin rreth e rrotull, flisnin kot dhe dukej se çdo njëra prej tyre ndihej e shqetësuar. Herë-herë s'flisnin fare, me mendje të humbura, duke lëvizur sytë vjedhurazi nga këndi tjetër, i përtejme, këndi i dashur, ku ngatërroheshin djemtë me njëri-tjetrin pinin e bërtisnin duke u ngrënë me pleqtë.

Dhe kënga tretej në tringëllimën e gotave, zërat e grave, qeshjen e mbytur të vajzave.

*...Të kesh mall të flesh me gunë,
Se djalë më s'bëhesh kurrë...*

Rita pas hutimit të parë, hodhi një sy rreth e rrotull sikur kërkonte diçka. I gjithë ky gaz, këta njerëz të gëzuar i dukeshin të huaj e të ftohtë. Ajo nuk kishte ardhur për ta.

Sytë e mëdhenj, të zez i hodhi ngadalë nga këndi i djemve. Nuk e vuri re se shoqet e vështronin me ngulm, me një vështrim jo zilizar e djallëzor, siç vështrojnë vajzat shoqen e dashuruar, por e vështronin thellë, me keqardhje, ndoshta edhe me përbuzje.

Befas Rita u drodh, zemra iu ndal, vështrimi iu mje-gullua dhe ktheu kokën anash. Nga këndi tjetër dy sy të njohur, veshur me një mjegull ëndërrimi, e shikonin siç duket prej kohësh.

«Ai, ai, ai»... murmuriti një zë nga brenda. Dhe kaq. Asgjë tjetër. Mendimet, arsyeya fluturuan.

Shkuan disa minuta të turbullta dhe ajo përsëri i ngriti sytë, i ngriti duke mposhtur turpin, djegur nga malli i

dymbëdhjetë muajve. Ai se ç'fliste me agronomin e fshatit, duke buzëqeshur. Rita nguli sytë e etuar dhe të pangopur mbi të, sikur do t'ia merrnin që andej, sikur e shihte për herë të fundit. Zemra i rrihte herë ngadalë, herë shpejt. Vëzhtronte e humbur fare, pa dëgjuar asgjë, pa menduar asgjë. Ja, ai lëvizi pak kokën dhe në tëmthin e majtë iu duk shenja vertikale e plagës. Sytë e tij të errët u drejtuan përsëri nga ajo, po pa e kapur dot shikimin e saj që humbi dikur në dysheme. në këmbët e njerëzve që vallëzonin. Asnjë forcë në botë s'do të mund t'ia hiqte sytë prej tij, përveç syve të vet.

Dasma vazhdonte e qeshur, e zhurmshe, e dehur.

— Pina, ikim? — i pëshpëriti Pina shoqe.

— Unë, budallaqe. jo. jo. — dhe ajo se kujt i buzëqeshi andej tutje pa e dëgjuar më.

Rita ndjeu përsëri vetminë e akullt. Ngadalë e mblo-dhi veten dhe plot guxim i hodhi sytë përsëri andej nga djemtë. Ajo priti, priti gjër sa at e pa dhe të dy, pas një viti, u vështruan për herë të parë. Ajo uli kokën. Zemra filloi t'i ngadalësonte të rrahurat, diçka e shtrëngonte në gjoks. diçka e shtypte.

«Pse vallë s'më vështron me vërejtje? Ai i di të gjitha.»

Rita prapë kërkoi me sy një shteg midis vallëzuesve që mbushnin dhomën, e sigurtë se edhe ai po kërkonte atë shteg. Dhe prapë nuk u gabua. Sytë e tyre u takuan përsëri, këtë herë më gjatë, më thellë. Një botë e tërë oshëtinte në atë vështrim të heshtur. Dhe këta njerëz që i rrethonin s'dinin gjë, qeshnin e këndonin pa i vënë re. Ja një sup doli përpara, një bërryl, një shami. Ajo uli kokën dhe pëshpëriti, duke e ndjerë veten shumë të dobët.

— Pina, — pëshpëriste pa dashur. — të ikim, a ikim?

Po shoqja nuk ia vinte veshin. Ajo se ç'këmbente she-nja me një djalë matanë. Ai pinte lhe s'e kuptonte që ajo i thoshte të dilnin nga kopshti.

Rita u mbështoll me pallto, rregulloi shaminë dhe doli jashtë me hap të shpejtë, duke u ngjethur nga të ftohtët. Te porta djemtë se ç'thanë pas saj. Ajo me nxitim kaloi nëpër rrugicat e shurdhta. Filloi të binte një shi i hollë. Nxinin përreth plepat dhe mullarët. Qërrja e vjetër matanë një gardhi ngjante me një kafshë të përgjumur, që po ngrihet mbi dy këmbët e para. Rita ngulçoi. Aty tek ajo qerre ai e kish puthur për herë të parë në një natë të thellë e me shi, si kjo. Netve kur kish kaluar këndeje i ish dukur sikur ajo do të lëvizte, do të çohet t'i hidhej. Dhe ish trembur.

Ja këtu qenë zënë një herë. Ja atje, te kasollja e pri-shur ajo mezi e bindi një natë që të mos e trazonte... Kështu ishin ndarë natën e fundit...

«Oh...»

Vivere, militare est.¹⁾

Moisiu hoqi sytë nga fleta e grisur, ku qenë shënuar këto fjalë dhe vështroi, ndoshta për të qindën herë, pikturën që paraqiste Ostrovskin e sëmurë. Këto kohët e fundit ai pa dashur sillte ndër mend gjithmonë njerëzit e sakatosur në jetë. Tirteun dhe Binon-in e çalë, Bethovenin e shurdhër, Emineskun e çmendur... Në gjimnaz kish studjuar për ta, ish entuziazmuar për jetën e tyre, optimizmin dhe gjëninë krijuese. Po sa milionë të tjerë kishte si ata, e një nga ata ish edhe ai.

Megjithatë është e vështirë të jetosh pa kujtime e sidomos kur s'ke kujt t'i hapesh.

Moisiu vështronte jashtë, pas xhamave të dritares, ku trokëllinte shiu dhe s'të linte të dalloje mirë jashtë se ç'bënte era me fletët e shkreta.

1) Të jetosh, është si të luftosh — Seneka.

Mendimet e tij përsëri fluturuan te Rita.

Në dysheme zbardhnin copërat e një letre të grisur që ai desh t'ia dërgonte asaj. Por e kish grisur pa e mbaruar mirë. E pse t'i shkruante, ajo nuk dinte asgjë, ndoshta e kish vështruar kot, në dasmë, ndoshta...

Po sidoqoftë do ta gjej, do t'ia them me gojë të gjitha... Mos jam bërë vallë i frikshëm që më druhet...

Shiu rifilloi më me forcë përjashta.

Moisiu përgatiste valixhen.

Në shtëpinë e vogël vinte rrotull sa andej-këndeje, nga një dhomë në tjetrën, me gjëra nëpër duar.

Për të tretën herë ai nxori gjërat nga valixhja, pa e kuptuar dhe vetë pse që bërë nervoz.

Nesër do të ikte që në mëngjes për në Tiranë. E kishin thirrur në Ministri. Siç duket shpejt do të fillonte punën e re.

Në fytyrën e tij dukeshin shenjat e mërziisë dhe të padurimit ndërsa trazonte plaçkat. Një gur i rëndonte në zemër: po ikte pa takuar Ritën. Si ai gjethi që e shmang era nga rruga vjeshtore, ashtu i ish shmangur ajo atij ato ditë. Dhe i rëndonte si plumb Moisiut kjo shmangie.

Pasdite kish bredhur nëpër fshat si për t'u çmallur, po gënjente veten sepse kish bredhur me shpresë të fshehur se do ta gjente mbase rrugës. Çudi sa shpresë kishte, i dukej e pamundur që të ikte pa e takuar dot.

Por ja që s'e takoi. Në të dalë të fshatit pa Skënderin hipur mbi kalë që po nisaj për në qytet. Nëna e të motrat po e përcillnin. Skënderi e kish parë, kish kthyer kalin dhe i ish afruar pranë.

— Mirupafshim, Moisi, do të shkoj në kurs në Fier, — ai u përul mbi shalë dhe në sytë e shkëlqyer dukej si dri-

dheshin lotët e fshehur. Edhe ai diçka konte me sy tutje rrugës...

I ra kalit dhe duke kthyer kokën që nga larg thirri:
— Po ju lë të qetë, siç e sheh...

Se ç'tha dhe diçka tjetër, po Moisiu s'e mori vesh. Ai u çudit nga fjalët e fundit, po nuk kish nge të mendohej për to. Çdo dru dhe çdo gardh e kasolle dukej se fshihte brenda Ritën, ëndrrën e tij, që nuk donin t'ia jepnin, që do t'ia mbanin përjetë.

S'kish zbardhur ende mirë, kur ai doli jashtë fshatit. Në dorë mbante valixhen dhe në krah trastën ushtarake, hedhur mbi kapotë.

Qielli ish i errët dhe retë s'lëviznin fare.

Ai ktheu edhe një herë kokën nga fshati, kërkoi diçka pa shpresë dhe vazhdoi të shkelte me çizme baltën e njomur.

Përsëri po ato gjurmë të thella qerresh të mbushur me ujët, që zgjateshin në vijë të pambaruara fushave. Po ato ledhe arash të njollosura nga fletët e thata. Po ato peligje të qetë.

Ajo mbeti pas. Gjer në minutën e fundit ai pati besim të pakufishëm se do ta shihte. Ndoshta te porta e shtëpisë, ndoshta te mulliri, ndoshta te...

Po siç duket kjo ndodh vetëm nëpër filma.

Dhe ai, futur në mendime, nguli përsëri sytë në vijat e qerreve që hidheshin fushës, që çonin tek ajo...

natë, 23 tetor 1955

DITË KAFENESH

Më në fund shoku im ma mbushi mendjen. Ai s'do ma kishte mbushur mendjen kurrë, sikur mos të ishte tamam koha pas provimeve. Bile nuk ishte çështje vetëm te provimet, sepse në fakt ai ma kish mbushur mendjen më përpara, dhe pikërisht atë ditë që binte shi dhe breshër përjashta dhe ne rrinim në auditor si të nemitur, duke dëgjuar një leksion për Çajupin. Merita e shokut tim (dhe kjo ishte hera e parë që unë i njihja atij një meritë, megjithëse e kisha shokun më të ngushtë), ishte që pikërisht në atë kohë, kur përjashta binte shi dhe breshër dhe ne dëgjonim të nemitur leksionin, ai më tha idenë e tij.

Ç'është e vërteta kishte nja dy javë që mua dhe shokun tim na kish kapur një frymë pak si aventuroze. Ne e ndjenim se duhet të bënim një ndryshim në jetën tonë. A ishte shkak për këtë koha mjaft e zyrtë e gjysmës së dytë të dhjetorit, apo afrimi i provimeve, apo ndonjë shkak tjetër, më i çuditshëm, unë dhe shoku im nuk e morëm dot vesh kurrë, megjithëse të dy jemi të fortë në analiza psikologjike. Ne dinim vetëm një gjë: unë dhe shoku im ishim filozofikisht të mërzitur dhe e ndjenim se duhej të ndërrohej diçka në jetën tonë. Të futej diçka e re, e freskët. Mos

vallë ishte ndonjë punë femrash. Jo. Unë me shokun tim kishim ca kohë që i kishim vënë pikë punës me femrat. Ne të dyve, për punë femrash, nuk na i hante qeni shkopin dhe kishim bërë bashkë mjaft palaçollëqe me vajzat gjer ditën kur në shtëpinë e shokut tim u rrahën për ibret, duke bërë shtëpinë rrëmujë, me xhajallarët dhe tezet e një vajze që e dashuronte shoku im dhe që atë ditë vendosëm t'i vinin pikë punës me femrat. Ne donim diçka tjetër, më interesante.

Kuptohet që ne të dy, gjatë kësaj kohe, kishim pirë mjaft konjak në heshtje, nëpër lokale të ndryshëm dhe ditët tona të gjysmës së dytë të dhjetorit kalonin si fletë romanesh modernë. Kushedi sa do të vazhdonte kjo sikur pikërisht atë ditë të zymtë dhjetorit, që binte shi dhe breshër përjashta, dhe ne dëgjonim të nemitur një leksion për Çajupin, shoku im të mos më thoshte idenë e tij.

Ishte sigurisht merita e shokut tim që tamam në këtë periudhë krize në jetën tonë, kur ditët tona kalonin si fletë romanesh modernë, ai pati një ide, gjë për të cilën nuk mund të them se e pata unë. Po ndoshta nuk do të ndodhte kështu, megjithëse ishte ditë e mërzitur dhjetori dhe shiu e breshëri binte përjashta dhe ne ishim të nemitur, ndoshta nuk do të ndodhte kështu, sikur profesori të mos thoshte, midis të tjerash, me një ton tragjik «e pra kjo vepër e rëndësishme poetike humbi dhe gjer më sot nuk është gjetur».

— Ç'humbi? — pyeti shoku im një student tjetër, sikur e parandjeu (dhe kjo ishte merita e tij më e madhe), se ajo që humbi do të kish kaq shumë rëndësi për ne, se do ta ndryshonte jetën tonë në këtë gjysmë të dytë dhjetori, jetën tonë plot me gota konjaku të heshtur dhe do të fillonte ngatërresa jonë e madhe me Sinodhin e shenjtë.

— Qetësi ju atje, — tha profesori. — Çfarë keni?

— Ç'humbi? — thirri shoku im.

Profesori vështroi shokun tim dhe përtëriti me ton tragjik: «Vepra e rëndësishme poetike e Andon Zako Çajupit! «Këngë dhe vome për luftën e madhe»».

Shoku im u lëshua mbi karrige me zhurmë dhe pikërisht në atë moment që ai ra si trung në karrige, mua m'u duk se diçka po ndryshonte në jetën tonë moderne, në këtë dhjetor shirash dhe konjaku. Dhe parandjenja nuk më gënjëu. Pas pak shoku im më tha idenë e tij.

Provimet mbaruan dhe ne po bëheshim gati për udhë. Unë dhe shoku im faktin që do të niseshim në qytetin krahinor N. për të kërkuar dorëshkrimin e veprës së humbur të Çajupit, nuk ia treguam asnjëri. Të fshehtëm tonë e mori vesh vetëm konjaku, i cili mbushte përsëri ditët tona jo moderne, sepse konjakun tani nuk e pinim më në heshtje dhe ditët tona nuk ishin më si më parë, pa një qëllim. Mund të them se ditët tona ishin kthyer në ditë romantike, megjithëse vazhdonte të binte shi. Pasditeve ne strukeshim në qoshe të ndonjë lokali plot tym dhe njerëz dhe bisedonim gjerë e gjatë për planet tona. Kur dëlnim jashtë zakonisht ishte natë, shiu trokiste mbi ombrellë dhe ne vazhdonim të flisnim për të fshehtëm tonë nën ombrellë.

Po ne nuk kishim vetëm fjalë. Unë dhe shoku im kemi qenë gjithmonë njerëz të veprimit si në punë femrash, megjithëse punës me femrat i kishim vënë pikë, e gjer në gjërat më të vogla. Ne u përgatitëm në mënyrën më të fshehtë për udhëtimin tonë në N., që ishte vendlindja e shokut tim dhe ku banonte akoma xhaxhai i shokut tim bashkë me nënën e tij, domethënë gjyshen e shokut tim. Ne do të shkonim tek ato mysafirë për dy javë. Ishim të sigurt se dy javë do të na mjaftonin. Ne ishim kaq optimistë saqë nga ditët tona moderne tani nuk kish mbetur asnjë gjurmë. Në përgjithësi, me përjashtim të ditëve të gjysmës së dytë të dhjetorit, ne kemi qenë gjithmonë optimistë. Ne kemi qenë optimistë dhe atëherë kur shokut tim një xhaxha i së

dashurës së tij ia ngjeshi me grusht dhe një teze e së dashurës së shokut tim më shkuli mua një tufë flokësh, pikërisht atë ditë pas së cilës ne vendosëm t'i vëmë pikë punës me femrat. Po këtë herë optimizmi ynë ishte i paparë. Shpesh nën ombrellë ne kishim biseduar për bujën që do të bënte aksioni ynë, për kthimin tonë fitimtar në Tiranë dhe për gjërat e çuditshme, të cilat i dinim vetëm unë, shoku im dhe ombrella. Megjithëse shoku im nuk ishte kaq i fortë në mbajtjen e së fshehtës, siç ishte në analizat psikologjike dhe në punët e femrave, këtë herë u tregua shembull dhe asnjëri nuk mund të mburret e të thotë se e dinte ku po shkonim ne, atë mëngjes të ftohtë janari, plot mjegull e lagështirë. Ne dolëm nga shtëpitë tona dhe u drejtuan nga agjencia e autobusave në mënyrën më misterioze.

Ishte vërtet një mëngjes i ftohtë, me shi dhe ne dridheshim përpara agjencisë, duke pritur autobusin tonë. Kjo gjë vazhdoi mjaft kohë, por optimizmi ynë nuk u trondit sepse ai ishte si ato orët që nuk pyesin nga uji.

— Ja më në fund dhe N.

Mua, që po dremisja në kolltukun e fundit. ... ranë si bombë këto fjalë. E zgjova shokun tim që po dremiste gjithashtu dhe të dyja fytyrat tona, të zverdhura nga rruga e gjatë gjashtëmbëdhjetorëshe, u zgjatën te xhami i lerosur me baltë i autobusit. Larg, shumë larg, dalluam drita të shumta që dridheshin sikur të vuanin nga nervat. Pasa-gjerët që ishin lodhur e këputur nga rruga u gjallëruan përnjëherësh. Tre a katër zëra të ngjirur ia morën përsëri këngës që e kishin kënduar gjithë rrugës:

N. o N. qytet me vulë

Që nxore Shemo hajdunë!

Autobusi ngjitej me uturimë të mbytur në xhadenë që dukej si litar i flakur pa kujdes mbi kurrizin e malit dhe unë nuk i hiqja sytë nga xhami. Pas çdo kthese dritat e

qytetit ku kishte lindur shoku im shkëlqenin më qartë, sikur t'i lante shiu. Xhamat e autobusit ishin lerosur fare, po megjithatë unë nuk i hiqja sytë.

Unë vija për herë të parë në N. dhe po më mahniste pamja e dritave të tij, ndërsa shoku im as nuk e çante kokën për këtë pamje dhe bënte gati valixhet.

Kur autobusi ndaloi, ne ishim aq të lodhur, sa nuk kishim asnjë mendim në kokë dhe me siguri nuk na kujtohej asgjë nga ato që kishim thënë qoftë nën ombrellë, pranë konjakut, në ditët tona moderne apo jo moderne. Një grumbull i madh njerëzish e rrethoi autobusin. Ca figura të errta ngulnin sytë që përjashtë xhamave, si ata peshqit që vështrojnë me sy të palëvizur brenda skafandres së një zhytësi. Unë po i vështroja i çuditur ata që lëviznin përjashtë dhe po më pëlqente kjo gjë, meqenëse nuk kisha asnjë mendim në kokë dhe nuk më kujtohej asgjë nga jeta ime. Vetëm kur gjyshja e shokut tim më puthi në të dyja faqet dhe shoku im më njohu me xhaxhanë dhe gruan e xhaxhait, erdha në vete.

- Hamalli, hamalli, — dëgjohej përreth.
- Fatorino, — thirri një zë, — erdhi gazeta?
- Erdhi, erdhi.
- Ka gjë për Çomben?
- Po llotarinë e ka, biro?
- E ka, nënë, e ka.

Ne të pestë duke folur për gjëra të ndryshme u drejtua për në shtëpinë e xhaxhait të shokut tim. Atje u ulëm këmbëkryq rreth vatrës me zjarr dhe ia shtruam muhabetit. Ishte vërtet një natë e bukur dhe era vërshëllente në oxhak dhe gruaja e xhaxhait, që ishte mjaft e re dhe tërheqëse, na shtroi meze me raki. Ne me shokun tim, që nuk ishim më pak të fortë në të pirë, se sa në analiza psikologjike dhe në punë femrash, pimë bashkë me xhaxhanë e shokut tim mjaft raki të fortë dhe kështu që u ngatërruan fare ditët e gjysmës së dytë të dhjetorit, të fshehtat e ko-

njakut e të ombrellës, si dhe mjaft gjëra të tjera, të çuditshme, të cilat i dinim vetëm unë, shoku im dhe ombrella, apo konjaku, unë dhe rakia, ose diçka e tillë e ngatërruar midis zhurmës së konjakut mbi ombrellë dhe shokut tim dhe meje në gjysmën e dytë të ditëve moderne.

Të dehur tapë na çuan për të fjetur.

Nëpër gjumë ndjeva se dikush po më shtynte në brinjë. Mezi hapa sytë dhe pashë shokun tim që po ma bënte me shenjë të çohesha. Ishte shumë herët dhe nga dritaret e mëdha mezi hynte drita e përhimtë e mëngjesit. Nëpër oxhakët e shtëpisë vërshëllente era dimërore dhe, në përgjithësi, e gjithë shtëpia e madhe kishte një atmosferë të frikshme, me musëndrat dhe hajetet e saj të ngarkuara me gjysmë errësirë.

Ora mund të ishte nja pesë e mëngjesit, kur ne të dy, unë dhe shoku im, duke zbritur me kujdes shkallët e drunjta, që mos të zgjonim të zotët e shtëpisë, dolëm në rrugë. Ne dridheshim nga të ftohtit, fytyrat i kishim të zbehta nga pagjumësia, kokën të trashë e të turbullt dhe, në përgjithësi, nuk e kishim të qartë se ku po niseshim që me natë. Dalja jonë që me natë tregonte se ne ishim njerëz të veprimit dhe se rakia nuk mund të na bënte të harmonim ato që kishim ëndërruar pranë konjakut.

Në rrugët me kalldrëm, jehona e hapave tona tringëlonte e mbytur dhe me një ritëm të dyshimtë. Muret dhe portat e mëdha e të rënda rrinin të mbyllura varg, në një heshtje të rëndë e të ftohtë. Vetëm kur dolëm në krye të rrugës unë e pyeta shokun tim;

— Ku po vemi?

Shoku im ndaloi për një çast dhe ne të dy u vështuam për një kohë të gjatë sy më sy. Ne e kuptuam menjëherë,

meqenëse ishim që të dy të fortë në analiza psikologjike, se kjo pyetje nuk duhej bërë. Çdo gjë ishte e qartë. Ne po shkonim për të kërkuar të fshehtën e dorëshkrimit të humbur dhe çdo pyetje ishte e kotë, sepse ne kishim biseduar gjerë e gjatë shumë gjëra lidhur me ekspeditën tonë, në ditët e konjakut dhe të ombrellës, por asnjëherë nuk kishim menduar konkretisht sesi dhe seku duhej ta kërkonim dorëshkrimin. Ne nuk e kishim menduar asnjëherë këtë, sepse ishim shumë optimistë, më shumë bile se dhe në shtëpinë e shokut tim me xhajallarët dhe tezet e së dashurës së shokut tim, që nuk dua t'i kujtoj.

Kështu pra po ecnim në rrugët e fjetura të N. dhe secili nga ne të dy mendonte faktin që asnjëri nuk mendonte asgjë dhe që secilit prej nesh aq i bënte për këtë gjë. Ç'është e vërteta i kishim mendimet mjaft të turbullta dhe qepallat po na mbylleshin nga gjumi. Seku do të shkonin kështu asnjëri s'mund ta dinte, sikur në atë çast të mos binte këmbana e kishës së vetme të N. Në qiellin e turbullt, tingujt e këmbanës vinin vërdallë të ngadaltë e të zvargur. Vetëm tani mua dhe shokut tim na u kujtua që ishte e diel, dhe erdhëm në vete.

— Ku po vemi? — pyeti shoku im.

— Nuk e di. Ti na zgjove.

Këmbana vazhdonte të binte dhe nuk mund të them se ishte meritë e shokut tim që propozoi për të shkuar në kishë për të kërkuar dorëshkrimin e humbur. Si mund të ishte kjo një meritë e shokut tim, kur këmbana shpërndante kudo tingujt premtues dorëshkrimesh të humbura në thellësitë e shekujve.

— Në kishë, — tha shoku im.

— E pse në kishë? — pyeta unë.

— Si pse në kishë? Nëpër kisha kërkohet gjithmonë. Kallogjerët kanë qenë mbledhës dorëshkrimesh.

— Ti më duket se e ke parë në film.

— Në asnjë film nuk e kam parë.

— Unë nuk vij në kishë, — thashë unë. — Çajupi ka qenë ateist dhe dorëshkrimet e tij s'mund të jenë në kishë. Në kishë mund të gjejmë letrën e murgut Brokhart, për shembull, po jo Çajupin.

— Murgun Brokhart? E pse jo? — thirri shoku im.

Këtu shoku im kishte të drejtë. E pse jo murgun Brokhart? Sa mirë që m'u kujtua. Është e vërtetë që ideja e kërkimit nuk do të na lindte, në qoftë se nuk do të rrinim të nemitur, duke dëgjuar leksionin për Çajupin atë ditë dhjetori, kur jashtë binte shi dhe breshër, po kjo nuk do të thoshte asgjë. Ne mund të kërkonim edhe murgun Brokhart. Pse të mos gjendet letra e atij murgu të shkretët? thamë ne të dy, unë dhe shoku im, dhe u nisëm me shpejtësi për në kishë. Tani na u zhduk përgështia dhe mendimet i kishim më të qarta se kurrë. Filloi shiu tamam kur po kapërcenim një urë të vjetër. Përtej urës ishte një udhë nga të dyja anët me qiparisa dhe në fund të udhës ngritej porta e madhe e kishës. Të lagur qull ne trokitëm në portë. Shiu binte me zhurmë dhe ne trokitëm përsëri, porse asnjëri nuk na u përgjigj. Këmbana kish kohë që nuk binte më dhe porta e kishës as që tundej fare nga të shtyrat tona.

— Basho Jorgo, o Basho Jorgo! — thirri shoku im dhe zëri i tij u përhap gjer tutje varrezave, që i rrihte shiu. Ne vumë veshin mos dëgjonim përgjigje, po më kot.

Ndenjëm një copë herë tërë inat, duke vështruar shiun që binte mbi qiparisat e zhveshura dhe na kapi një trishtim krejt i ndryshëm nga ai i gjysmës së dytë të dhjetorit modern. Tani po më vinte keq që dolëm kaq herët nga shtëpia e xhaxhait të shokut tim në këtë kohë të keqe. Sa mirë sikur tani të hanim mëngjes rreth vatrës dhe era të vërshtëllente në oxhak dhe gruaja e re e xhaxhait të shokut tim të na e thekte bukën në prush.

— Pse na zgjove kaq herët? — i thashë me inat shokut tim.

— As vetë nuk e di. Nuk më durohej.

Ne heshtëm për një kohë të gjatë, duke parë pellgjet e vogla që krijonte shiu në udhën e trishtuar, me qiparisa anëve.

— Sa të pushojë pak shiu dhe vemi në shtëpi, — tha shoku im.

Presje, pikë, pikëpresje. Ne me shokun tim pinim duhan të shtrirë mbi minder dhe tështinim. Nga forca e tyre unë i krahasoja tështimat me shenjat e pikësimit, në përdorimin e së cilave unë dhe shoku im ishim po aq të fortë sa dhe në të pirët dhe në punët e femrave. Ne tështinim dhe pinim duhan në heshtje, të mërzitur që ishim ftohur dhe që nuk mund të dilnim dot në qytet. Nuk na pëlqente fare që ditët tona po ktheheshin në ditë duhani dhe tështimash. Kjo ishte dita e dytë që ne pinim duhan dhe tështinim.

Pikë, vijë, kryeradhë...

Vërtet ishte një gjë e mërzitshme dhe era vazhdonte të vërshëllente nëpër mazgallat dhe oxhaqet e shumtë të shtëpisë së vjetër të xhaxhait të shokut tim. Nga dritarja e madhe dukej lumi që kishte vërshuar në luginë poshtë dhe serrat që fluturonin në oborrin e zhveshur të fqinjit të xhaxhait të shokut tim.

Presje, pikëpresje, mbyll kllapat.

Kjo gjendje pasive mua dhe shokut tim, që kishim qenë gjithnjë njerëz të veprimit, po na nervozonte pa masë. Vura re se shoku im filloi të sillej me arrogancë me njerëzit e shtëpisë së xhaxhait të tij. Edhe unë fillova të sillem me arrogancë. Ne të dy filluam të ankohehim për dyshekët, për gjellët dhe gjëra të tjera që i mendonim maidis duhanit dhe tështimave. Bile një herë shoku im tha se gjoja dysheku i tij kishte tartabiqe. As vetë ne nuk e kuptonim pse sa vinte

gjithë kjo gjëndje shpirtërore grindavece. Kulmi arriti kur unë përplasa një pjatë me fasule, duke thënë se ato ishin të paziera mirë.

Kushedi si do të vazhdonte kjo situatë nervoze, kur era dimërore vërshëllente në çati dhe ne grindeshim, duke brendhur nga njëra dhomë në tjetrën, me siguri puna do të përfundonte në ndonjë rrahje, më keq se në shtëpinë e shokut tim me xhaxhallarët, që nuk dua t'i kujtoj.

Sidoqoftë të zotët e shtëpisë u treguan me ne mjaft të duruar, megjithëse xhaxhai i shokut tim rrinte mjaft i vrenjtur, deri në atë çast kur unë i thashë shokut tim në sy të gjyshës së tij, se më pëlqente gruaja e xhaxhait të tij, megjithëse punës me femrat i kishim vënë pikë.

Pas pak dëgjova se shoku im po grindej me xhaxhanë në dhomën tjetër me zë të lartë, por era vërshëllente kaq shumë në çati sa nuk mund të dëgjoja dot mirë se ç'thoshin. Vetëm kur u hap dera dhe doli i skuqur shoku im, dëgjova se si i thirri ai xhaxhait:

— Fanatik, Turqi!

Dhe xhaxhai që ulëriu:

— Maskarenj, spiunë!

Këto ishin fjalët e fundit që u thanë në shtëpinë e xhaxhait të shokut tim atë ditë dimri. Kuptohet që ne u ngritëm menjëherë, veshëm palltot tona, morëm valixhet dhe duke tështitur e duke pirë duhan, dolëm nga porta e madhe në rrugën e ftohtë. Nga të dyja anët e rrugës njerëzit na shikonin nga dritaret me çudi dhe disa kalamanj thirrën prapa nesh: «Zvingu, zvingu!», megjithëse ne nuk e çanim aq shumë kokën për modën, vetëm se pantallonat i kishim shumë të ngushta.

Në hotel zëmë një dhomë në katin e katërt. Menjëherë u futëm në dyshekë dhe vazhduam të teshtinim dhe të pinim duhan.

Ne, unë dhe shoku im, rrinim në kafene në një tryezë në qoshe dhe vështronim se si përjashta, pas xhamave të lagura shkonin e vinin kalimtarë. Ishte mbrëmje dhe ne, nga që nuk dinim nga të venim, dhe në hotel bënte mjaft ftohtë, u futëm në kafene. Kafeneja qe plot me njerëz dhe tym. Një shitës gazetash vinte vërdallë tryezave duke shitur gazeta që njerëzit i shfletonin me zhurmë. Siç duket persa kishte ardhur autobusi nga Tirana.

Ne i blemë të gjitha gazetat e ditës, që të kishim ç'të lexonim në hotel, dhe vazhdonim të pinim duhan. Në tryezën përmbri nesh nga e djathta ishin ulur tre njerëz. Ata nuk blenë gazetë dhe vazhdonin të bisedonin me zë të ulët. Njëri prej tyre, e vura re që vazhdimisht na vështronte me dyshim, me ca sy dinakë që dukej se përmbante me zor një nënqeshje, sikur thoshte: «i di unë, i di të gjitha.»

— E shikon atë me mustaqe? — tha shoku im, duke treguar njeriun që rrinte përballë atij që dyshonte. Në të njëjtën tryezë. — Është matrapaz i madh. Çalon pak nga njëra këmbë ndaj e quajnë Eksiqi.

Në një tryezë, përtej ne pamë që u ul xhaxhai i shokut tim me nja dy shokë. Ai bëri sikur s'na pa dhe na ktheu kurrizin, duke shfletuar gazetën si të tjerët.

Ne e ndjenim veten mjaft të vetmuar dhe me sa dukej po fillonin prapë ditët moderne, sepse heshtja po vazhdonte.

Në tryezën nga e majta jonë gjithashtu nuk kishin blerë gazetë dhe ne dëgjonim gjithë muhabetet e tyre. Ata flisnin për kohën e Luftës. Pastaj e rdërruan bisedën dhe filluan të flasin për kalanë e vjetër të N.

— Kur isha parvjet në Tiranë, — tha njëri, — një miku im më tha se kalaja është antihigjenike për qytetin tonë. Ajo bën shumë hije, se pengon as... as... as...

— Asimilimin klorofiljan.

— Po, të cilit nuk i është dhënë asnjë rëndësi në regjimet e kaluara.

të ketë ndonjë aluzion për kthimin e luftës imperialiste në luftë civile.

— E pamundur, — ma preu shoku im.

— E pse e pamundur?

— E pamundur, sepse kjo është tezë e Leninit dhe si ka mundësi që Jupi (kështu e thërrisnim ne nganjëherë me përkëdhelje) ta ketë shpikur këtë gjë?

— Ç'do gjë bën vaki, — thashë unë me një ton mistik, — sa ka ky kozmos.

— Atëherë kjo gjë e nxjerr Jupin nga përcaktimi si poet demokrat-revolucionar me tendenca antimonarkiste dhe e fut në një përcaktim tjetër, — tha shoku im.

Për një kohë të gjatë ne u munduam të formulonim përcaktimin e ri.

— Revolucionar-demokrat me tendenca antiimperialiste dhe antikurbet, — tha shoku im.

— Jo. Nacionalist-revolucionar, ku duken simptomat e para të luftës të së kundërtave, — thashë unë.

— S'është e saktë, — tha shoku im dhe ne kthyem me një frymë edhe nga një gotë.

— Rilindas borgjez, me tendenca antiturqi.

Ne kthyem përsëri nga një gotë.

— ...Anticifut, — tha shoku im.

— ... Antifestival, — thashë unë.

Kamerieri na ra supeve që të ngriheshim, sepse kafe-
neja e boshatës po mbyllej. Ne shkua në hotel duke u
lëkundur dhe duke murmuritur «antigrip, antibuxhet».

Ne u zgjuam herët. Për çudi çdo herë kur pinim, ne
agjoheshim herët. Jashtë kishte rënë dëborë. Në jetën tonë
po hynte dëborë. Ne u veshëm dhe dolëm përjashta tamam
në kohën që po binin sirenat e dy fabrikave të N. Ne, mua

dhe shokut tim, na pëlqente mjaft jeta e gjallë me sirena, dhe fabrika, dhe lokomotiva. Mirëpo tamam sikur të na shtynte djalli, ne gjithmonë na çonin këmbët nëpër kafenera. Në mëngjes talleshim me kafenetë, si mkteturina të Turqisë, po kur vinte pasditja, në kokën tonë zbrisnin parime të tjera, të cilat megjulloheshin me afrimin e mbrëmjes dhe zhdukeshin përpara konjakut.

Më kujtohet se shumë herë në Tiranë ishim përpjekur të bënim jetë interesante, sidomos pas asaj dite që nuk dua ta kujtoj, kur i vumë pikë punës me femrat. Mirëpo çdo herë rrugët tona kishin përfunduar në kafene.

— Ky është fati ynë, — kish thënë më në fund shoku im plot fatalizëm dhe ne nuk e vramë mendjen më për ca kohë të hynim në jetën e madhe. Po ne nuk u përkulëm me kaq.

Përpjekjen e fundit e bëmë pak përpara ditëve të glysmës së dytë të dhjetorit. Më kujtohet se ne u njohëm me një kompani moderne djemsh dhe vajzash dhe u gëzuam tepër, sepse menduam që më në fund po i vëmë pikë jetës së kafeneve. Ata na ftuan në shtëpinë e njërit prej tyre dhe ne shkuam tërë qejf. Aty ishte mbledhur tërë shoqëria e tyre dhe ne u njohëm me të gjithë. Dhe në ato momente ne kujtuam me përçmim vizionin e tymit të kafenesë, së cilës, me siguri, i kishim vënë pikë. Menjëherë e kuptuam se krenaria e gjithë kompanisë ishte një magnetofon, ku ata kishin regjistruar muzikë xhazi dhe muzikë sentimentale. Ne me shokun tim e pëlqenim shumë muzikën e xhazit, megjithëse nuk ishim shumë të fortë në punë të modës, si ishim në punët e të pirit dhe në analizat psikologjike. Kurse muzikën sentimentale ne e urrenim. Po ndoshta nuk ishte çështja e muzikës sentimentale, sepse fundi i fundit njeriu e duron një copë herë edhe një muzikë që e urren. As nuk ish çështja e pranisë së vajzave në atë kompani, sepse në qoftë se i kishim vënë pikë punës me femrat, kjo s'do të thoshte se nuk mund të hapnim kllapa, dhe në përgjithësi

asnjëherë nuk kemi qenë parimorë të tepruar unë dhe shoku im. Gjithë puna ishte me siguri të muhabetet që bënin ata. Ne në fillim nuk kuptuam asgjë. Bile kujtuam se po flisnin për të njohurit e tyre, kaq me familjaritet i thoshin emrat.

— E çë, — tha njëra nga vajzat, — ku do të gjente Ivi më të mirë nga Simonia.

— Ajo s'i dihet, — tha një djalë, — kështu thanë dhe për Arturin.

— Mor, po Arturit ia bëri mirë Merilini, aman me gjithë ato rrudha dhe ai.

Ata vazhduan një copë herë, gjersa unë dhe shoku im e kuptuam ku rrihte muhabeti. Ne e kuptuam kur ata përmendën Koni Frencin dhe na u neveritën menjëherë, sepse unë dhe shoku im i kemi urreyer gjithmonë snobët dhe imituesit.

— Ju kujtoni se bëni jetë të madhe, por ju s'bëni veçse jetën më të ngushtë dhe më mikroborgjeze në botë, — tha shoku im në kohën kur ne kishim filluar të grindeshim me ta.

— Jeta juaj është më e ngushtë se pantallonat tuaja — thashë unë me përbuzje.

— Ikni, or sherrxhinj! — na thanë ata.

— Palaço, snobë! — ua ktheu shoku im, dhe ne ishim gati ta çonim gjer në fund këtë sherr që na u paraqit. Por ata siç duket qenë frikacakë dhe nuk na dhanë shkas. Vetëm kur dolëm, njëri, me siguri ai më trimi prej tyre, na thirri që sipër shkallëve:

— Gomerë, pijanecë!

— Pederastë! — thirri shoku im dhe me këtë fjalë mori fund puna me kompaninë «moderne» dhe ne u gjendëm prapë në kafene.

Kështu pra kur dolëm në rrugët e N. ne na kapi përsëri malli për jetën e lokomotivave dhe debora ishte kaq e bukur dhe e pastër sa harruam çdo gjë. Brodhëm tërë mëngjesin duke thënë disa mendime për arkitekturën e N; dhe bëmë

dy-tri hipoteza. Po pasdite u mërzitëm dhe vendosëm të fillonim kërkimet.

Unë, shoku im dhe basho Jorgoja, ishim ulur mbi një tabut bosh; po pinim shishen e rakisë që e kishim siellë ne të dy me vete.

— Po ju nuk e dini si e kapa Taqin e Skurajve, — tha basho Jorgoja.

— Jo, nuk e dimë.

— Ja, jua tregoj tani.

— Vetëm bjeri ca shkurt se s'kemi kohë. — tha shoku im. — shkurt si Heminguej.

— Më plaçin sytë në ju gënjej, — u betua basho Jorgoja dhe nisi të tregonte, duke i zgjatur fjalët tërkuzë.

— Kështu, o djem, që thatë ju, ish një natë, e errësirë, e dëborë qamet. As gëk, as mëk në varreza. Xëc kudo. Dal nga qimiteri për atë punë kur fap-fup se ç'pashë që ndriti në varre. Bëra kryqin tri herë dhe përgjova prapë. Ama për t'u trembur nuk u tremba fare. Jam mësuar me këto punë. Të vdekurit janë çapkënë të mëdhenj, ndjesë paçin. s'u rri b... rahat, fu se rashë në gjynah. E që thatë ju, vështro prapë: një zjarr regëtin në ines plakës Eftiqi e Kiço Llapës që s'kish as dy ditë varrosur. Ah! thashë, more Kiço Llapa, që tërë jetën shite uthull dhe bëra sherre, ç'ke që s'rri rehat, se plakë Eftiqia s'bënte marifete të tilla, ishte qengj e urtë e varfra. Dhe bëra kryqin prapë. Po zjarri regëtin e s'suhet. Jorgo Palikari, thashë, ke dyzet vjet që fle me të vdekurit, kurrë s'të bëri tërë syri, o burra të març vesh ç'hall ka Kiço Llapa që nuk dergjet siç e ka dhënë zoti. Se helbete edhe të vdekurit kanë halle, jo s'u pëlqen varri, jo s'e honepsin dot gjitonë që kanë pranë e ku di unë. Kështu thashë dhe u sula përmes varreve, duke u fshehur pas kryqeve. Afrohem, ç'të shoh? Varri i Kiço Llapës i hapur, një kandil ndriçon mynxyrën. Brenda në varr sekush e kish kapur për fyti Kiço Llapën dhe mundohej ta mbyste. **Bo bo!** thashë, filloi çapkënlleqet. Kiço Llapa, ende pa vdekur

mirë, dhe nisi sherret me të vdekurit e tjerë. Do më bëjë varret rrëmujë. Pa le ku e gjeti kohën, tamam kur do të bëhej inspektimi i përgjithshëm nga peshkopi i Tiranës, dhe unë isha i dalluar dhe kisha dalë në gazetën e murit të kishës. O burra, thashë, të hyj t'i ndaj. «Ej, thirra, ç'kenë o burra, ndjesë paçi?»

— Bjeri shkurt si qe puna, — tha shoku im, — se na ngrive gjakun.

— Unazën, — tha basho Jorgoja, — unazën e Kiço Llapës donte ta vidhte Taqi.

— Aha, komedi e madhe. Ktheje, basho Jorgo, — thashë unë.

Ne bëmë mjaft muhabet me basho Jorgon, deri sa e bindëm të na hapte derën e kishës. Porsa na hapi derën u sulëm si të tërbuar në kishë duke përmbysur qirinjtë, duke trazuar altarin, duke hequr ikonat nga muret e duke flakur andej-këndej kateqizmat, ungjillët e ç'gjenim përpara. Basho Jorgoja bërtiste e shante, po ne nuk ia vinim veshin dhe vazhdonim batërdinë tonë. Nuk besoj që muret e kishës së vjetër të N. të kishin parë barbarizëm më të madh që nga koha e Atilës. Kurrë nuk na i priste mendja se me gjithë atë vrull dhe egërsi që kishim unë dhe shoku im, nuk do të gjenim asgjë në atë kishë të ftohtë e të mallkuar.

— Gjete gjë? — pyeste shoku im nga altari.

— Jo, — i përgjigjesha unë nga ajodhima. Zërat tonë jehonin në kubenë e kishës me një tingull mistik.

— Do të thërras policinë, — bërtaste basho Jorgoja, — edepsëzë, antikrishtë, do t'i bie këmbanës, të mbledh miletin.

Ne s'përgjigjeshim fare dhe vazhdonim batërdinë, gjer-
sa u lodhëm e u këputëm, dhe dolëm nga kisha.

Jashtë kishte rënë mbrëmja. Ne ecnim të mërzitur mbi dëborë dhe dëgjonim sirenat e dy fabrikave të N. Po ndërrohej ndërresa e mbrëmjes. Ne ecnim pa folur dhe të dy ndjenim se po shkonim drejt fatalitetit tonë: kafenesë.

— Duhet të ndalohet menjëherë feja, — tha shoku im, — të mbyllen kishat.

— S'mund të mbyllen me forcë, — i thashë unë. — e ndalon kushtetuta.

— Atëhere të bëhen kooperativa, ose diçka e tillë, diçka duhet të ndodhë. — tha shoku im:

— Nesër do të shkojmë në xhami, — thashë unë se vërtet po e ndjeja që më zinte urrejtja për kishën.

Pastaj ne të dy heshtëm dhe të dy po mendoheshim në heshtje për fatalitetin tonë, dhe për faktin që ditët tona po ktheheshin në ditë mistike në këtë gjysmë të parë janari me dëborë.

— Shkojmë në kinema, — thashë unë papritur.

— Mirë e ke, — m'u përgjigj shoku im, — ishallah ka ndonjë film kundër fesë.

Përpara kinemasë që quhej «10-vjetori i themelimit të Ushtrisë Popullore të R.P.SH» vërtitej një turmë e tërë, duke kërkuar biletë. Shfaqej seria e dytë e një filmi mongol me ngjyra. Pranë biletarisë pashë atë që dyshonte për ne. Porsa sytë tanë u takuan ai ktheu kokën.

— Shoko, a ka luftë? — na pyetën dy kalamaj.

— Nuk e dimë.

— Asnjë të puthur, — tha një djalë duke kaluar me nxitim.

Ne mundëm të gjenim dy bileta dhe u afruam të hynim. Pritëm pak, sepse portieri i kinemasë. Miço Qulli, grindej me një.

— Mua do më tregosh ti, mua që ia kam kushtuar gjithë jetën kinematografisë? — bërtiste Miço Qulli, — Po unë edhe i madhi vetë të vijë nuk e lë të hyjë pa biletë, e jo ty.

Unë me shokun tim zëmë vendet tona dhe rrinim mjaft të menduar. Dy-tri veta pëshpëritën për ne. Pastaj se ku kaloi ai që dyshonte.

— Filloje, Sherif, ç'pret akoma! — thirri një zë.

U bë një shamatë atje në llozhë. Portieri nxorri një për zverku jashtë. Befas dritat u shuan. Filloi filmi me ngjyra. Një i vonuar trokiste te dera, duke e sharë Miço Qullin në tre breza. Mua më bëri përshtypje që i vonuari e dinte mirë tërë farefisën e Miços dhe nuk ngatërronte shkallën gjenealogjike.

Kishin kaluar nja dhjetë minuta kur u ndezën dritat. Filmi u ndërpre. Nisën fërshëllimat. Ne me shokun tim nuk po merrnim vesh asgjë. Dritat u shuan. Po fërshëllimat u bënë më të tërbuara: filmi kish nisur që nga e para. Unë dhe shoku im ishim të fortë në të fërshëllyer dhe tërhoqëm admirimin e fqinjve.

— U qorrofsh, o Sherif mizerja! — thirri një.

Fërshëllimat pushuan vetëm pasi u projektua gjithë filmi i përsëritur. Ne më vonë e morëm vesh se në kinema kish ardhur me vonesë shefi i agjencisë së autobusëve të qytetit, me gjithë gruan dhe Sherifi e filloi filmin nga e para.

Një femijë nisi të qante.

— Plaç de! Të rëntë sputniku në kokë, — i thirri Miço Qulli.

Përpara nesh ish një tip i paduruar që pyeste shokun çdo minutë: «Po tani ç'do të ketë?» Shoku ia shpjegonte të gjitha. Shoku im e paralajmëroi dy herë. Të tretën herë do t'ia hiqja me shpullë, por u ndezën dritat. Bëhej pushimi i aktit të parë, siç e quanin këtu në N. Dolën të gjithë në korridor duke komentuar filmin. Dolëm dhe ne me shokun tim dhe ndezën nga një cigare.

— Futuni, ore, se e fillova, — thirri pas pak Sherifi.

— E ç'na ngut, a derëzi, — tha njëri.

Duke u futur në sallë pashë xhaxhanë e shokut tim, me gjithë gruan e tij të re që kaluan para nesh. Gruaja e xhaxhait të shokut tim më hodhi kalimthi një vëshurim të hutuar dhe unë ndjeva papritur një trishtim dhe një mall për shtëpinë e madhe të xhaxhait të shokut tim, ku

era fërshëllente mbi oxhakët e lartë dhe sorrat vërtiteshin në oborrin e shkretuar dimëror.

Filmi mbaroi dhe ne me shokun tim u çuditëm që asnjëri nuk po lëvizte nga vendi.

— Ç'do të bëhet? — pyetëm ne, por asnjëri nuk u përgjigj. Dritat u shuan prapë. Filloi të shfaqej dokumentari. Siç duket Sherifi shfaqte dokumentarin si t'i vinte për mbarë, herë në fillim, herë në fund.

Ne dolëm nga kinemaja të mërzitur dhe për një kohë të gjatë nuk na zuri gjumi.

Kush mund të parashikojë se ç'mund të ndodhë në jetë dhe ç'embrion për të ardhmen përmban fenomeni i së tashmes. Kush mund të parashikonte se tamam në atë ditë dhjetori, kur shiu dhe breshri binin përjashta dhe ne dëgjonim të nemtur leksionin, filloi ajo gjë, e cila do të zhvillohej më vonë gjer në atë shkallë, saqë ne të na quanin grabitës kishash dhe monumentesh kulturore të popullit shqiptar, në një kafene të qytetit krahinor N., qindra kilometra larg nga Tirana. Nuk do të na vinte keq sikur të ndodhte kështu në ndonjë sherr të ndershëm, megjithëse ne sherrxhinj nuk ishim, po kur na paraqitej rasti i çonim sherrret gjer në fund. Nuk do të na vinte pra fare keq sikur kjo thënie, qoftë dhe e padrejtë, të vinte si rezultat direkt i ndonjë shr. (kështu e shkruanim ne shkurtimisht ngandonjëherë fjalën sherr midis nesh). Por e keqja është se kjo erdhi tërthorazi dhe pa kuptuar, në rrethana ku ne u gjendëm rastësisht dhe ku rriheshin probleme të poezisë, për të cilën ne as nuk çanim kokën fare.

Ne të dy, unë dhe shoku im, mësuam se në N. kishte një Raxh Kapur, një boriç e ca figura të tjera, po që të kish poetë të tillë, nuk na e merrte mendja kurrë. Ndoshta

nuk do të ndodhte asgjë dhe ne të dy nuk do të plekseshim me poetët e mallkuar të N., sikur drejt e nga xhamia, ku më kot shpresuam të gjejmë qoftë edhe ndonjë divan të Nazim Beratit, të ktheheshim në hotel dhe të vazhdonim të tymosnim, duke kaluar kështu orë të tëra të ditëve tonë mistike. Po ne nuk shkuam në hotel, sepse, me gjithë për-
pjekjet shpirtërore, nuk mundëm t'i shmangeshim dot fatalitetit tonë, kafenesë. Ne ishim bërë fatalistë si Edipi mbretë dhe në sy na vallëzonin mijëra shkronja arabisht të qitapeve që trazuam.

Kur hymë në kafene, atje kish një gjallëri të jashtëzakonshme. Ne mezi gjetëm një tryezë në një qoshe dhe porositem konjak dopio. Konjaku na u duk i hidhur, megjithatë porositem prapë. Në kafene kishte më shumë tym se çdo herë. Tymi qëndronte lart sikur nuk donte të përzihej me njerëzit. Në kafene ne tani pothuaj i njihnim të gjithë klientët. Ishin ata të kalasë, me një shprehje të menduar në fytyrë sikur të thoshnin: «ah, atomi po, po ç'e do...» Kaluan midis tryezave tre burrat tullacë, me fytyra të inatosura. Pas pak u dëgjua: «Jo kafeja, po kafea». Ai që dyshonte për ne më hodhi, nga një qoshe, një shikim dinak.

Në kafene po hynin vazhdimisht njerëz të tjerë, që nuk ishin klientë të zakonshëm. Njerëzit po grumbulloheshin rrotull dy tryezave në fund. Ne u ngritëm pak në këmbë të shohim; në dy tryezat e bashkuara rrinin poetët e N. Njerëzit vërtiteshin rrotull tyre. Shumë zhvillim të paparë ka marrë poezia në N., mendova unë. Gjatë ditëve të fundit ne me shokun tim ishim njohur përciptazi me dy prej tyre, me Qëthë Hajdarin (d.m.th. Q. TH. Hajdari, ose emri i plotë Qani Thoma H.) dhe Lame Senicën. Këta të dy na kishin shpjeguar se përfaqësonin korrente të ndryshme letrare. Qëthë-ja mbështetej në folklor dhe kishte kthyer në vargje vendimet e dy mbledhjeve të B.P. të rrethit, si dhe një qarkore të komunales së qytetit, dhe kishte shkruar një poemë për rëndësinë e femrës në përgjithësi. Lame Senica

ishte, me sa dukej, poet i mendimit dhe shkruante vjersha që nuk kuptoheshin lehtë.

Po ne nuk e kuptuam se ç'ishte gjithë ajo rrëmuje në kafene. Qëthë-ja mbante në duar një gazetë «Bashkimi» dhe Lamja rrinte i menduar.

— Ç'bëhet? — pyeta njërin përbri.

— Ç'bëhet? Hap sytë, në ballë i ke.

— Ngadalë, bre! — tha shoku im dhe ne pyetëm një tjetër.

— Po ti ç'je, i huaj? — m'u drejtua mua tjetri.

— I huaj jam.

— Ah, më fal pesë për qind. I sheh këta të dy?

— I shohim.

— Këta janë shkrimtarë dhe do të bëjnë garë. Qëthë-ja premtoi se do të kthejë gazetën «Bashkimi» në vjershë për dy orë e gjysmë. Kjo domethënë, siç i thonë ata, përsosja e madhe artistike.

— Nise, Qëthë, se na mërzite, — thirri matrapaz Eksiqi.

— Qetësi! — thirri dikush.

— Mizerje, — tha shoku im, — parazitizëm.

Qëthë-ja hipi mbi tryezë dhe koka i përzihej me tyra. Ai hapi gazetën dhe filloi nga faqja e katërt:

Ullan Bator

Më 9 dhjetor

Këtu u bë

Një mbledhje qe

Qani Hajdari bëri një pauzë dhe mori frymë në mënyrë madhështore.

U bë këtu

Një mbledhje blu.

— Sa bukur i gjen qerratai! — tha Eksiqi.

— Keq! — thirri papritur shoku im, megjithëse ne të dy kurrë nuk e kishim çarë kokën për punët e poezisë; po si duket djalli që na shtyu të vinim në këtë kafene, e shtyu shokun tim të bërtiste: «keq».

— Pse keq! — tha Q.TH. Hajdari.

— Keq, — përsëriti shoku im, — ç'do me thënë kjo «Mbledhje blu»?

— Janë punë të zanatit, — u përgjigj krenar Qëthë-ja.

— Këto janë rrufjanllëqe, — thurri shoku im dhe këtu Qani Thoma Hajdari mori prapë fryrë thellë dhe u skuq. Nga goja e tij në këtë çast prisja që të dëgjoja çdo gjë, po kurrë nuk ma priste mendja se do të thoshte atë që tha. Dhe pikërisht atëherë, kur unë prisja që ai të thoshte çdo gjë, Q. Th. Hajdari tha:

— Nuk dua të diskutoj me vjedhës kishash dhe monumentesh kulturele të popullit shqiptar.

Pa mbaruar mirë këtë frazë unë u sula drejt tij dhe vendimet e rrethit nuk do të përjetësoheshin më në vargjet e Qani Thoma Hajdarit, sikur të mos më mbanin duart e fuqishme të matrapazit.

Ne na nxorën jashtë.

— Si poema jote unë bëj një në një çerek ore, që këtu e gjer në komitetin ekzekutiv të gjatë, — dëgjuam ne, duke dalë, zërin e Lame Senicës.

— Mjaft më, mos u zini, filloni nga e para, — sekush tha.

Ne ishim kaq të nervozuar saqë e perceptonim botën pjesë-pjesë. Jashtë kishte filluar të binte dëborë. Te dera e kafenesë dy të dehur po diskutonin. Njëri i thoshte shokut se do t'i jepte një grusht ta hidhte në Azerbajxhan, kurse tjetri i propozonte ose ta kthenin nga një gotë, ose të shkonin në Teatrin Popullor, një nga të dyja. Duke dalë u përplasëm me një të tretë, i cili, si na pa me një vështrim të zjarhtë, na murmuriti në vesh në mënyrë misterioze:

— Shekulli i njëzet është shekulli i Izraelit.

Ne ishim mjaft të mërzitur e të inatosur dhe nuk i vinim më veshin askujt. Te xhami i kafenesë pashë atë që dyshonte dhe pastaj u drejtuam në hotel, duke ecur mbi dëborë.

Kështu të qëllon nganjëherë në jetë, që punët të shkojnë në ters e më ters dhe pa e kuptuar mirë edhe vetë gjendesh në mes të dimrit, në një dhomë të ftohtë hoteli, të një qyteti të vogël krahinor, duke tymosur duhan gjithë ditën dhe duke parë në spiralet e tymit të duhanit një mishërim artistik të deziluzioneve të tua.

Unë me shokun tim kishim dy ditë që nuk po dilnim fare nga hoteli, sepse ishim ende shumë të zemëruar dhe, në përgjithësi, kishim vendosur t'i vinim pikë punës së zbulimeve dhe gjithë punëve të tjera që kishin lidhje me N. Me paret tona të fundit kishim blerë biletat për Tiranë dhe tani po e kalonim gjithë kohën shtrirë mbi dyshekët tanë, duke pirë duhan dhe duke kujtuar ngjarje të ndryshme nga jeta jonë, që nga fëmijëria, e gjer ditën kur ne u quajtëm publikisht «grabitës kishash e monumentesh kulturele të popullit shqiptar». Spiralet e tymit ngriheshin drejt tavanit dhe ne rrinim të shtrirë mbi shpinë dhe me sa dukej kishin filluar ditët horizontale.

Në mëngjes dhe në mbrëmje dëgjoheshin sirenat e dy fabrikave të N., si diçka krejt e jashtme e jetës sonë dhe ne na merrte malli për jetën e lokomotivave, të cilën e kishim tani më larg se kurrë.

Pas xhamave dukeshin flokët e dëborës, që i vërtiste era dimërore dhe ne vazhdimisht rrinim shtrirë.

Unë me shokun tim nuk e kishim patur kurrë zakon të shqyrtonim shkaqet e fenomeneve dhe të nxirrnim konkluzione, sepse nuk donim që jeta jonë t'i ngjante një mble-

dhjeje të mërzitshme. Kështu që dhe mbrëmjen e fundit që po kalonim në N. vazhdonim të rrinim shtrirë dhe të tymosnim në heshtje, duke admiruar flokët e dëborës pas xhamave.

Pikërisht ishim në këtë gjendje kur për herë të parë gjatë gjithë qëndrimit tonë në N., trokiti dera e dhomës së hotelit.

— Hyr, — thamë ne.

Dera u shty dhe në prag u duk për çudinë tonë të madhe, xhaxhai i shokut tim. Fytyrën e kishte fare të ngrysur dhe mbi pallton e madhe kish flokë dëbore.

— Ulu, xhaxha, mirëserdhe, — tha shoku im pa lëvizur nga shtrati dhe duke treguar një karrige, mbi të cilën ne kishim hedhur mjaft çorape dhe këmbishë të palara.

— Nuk do të ulem, — tha xhaxhai i shokut tim, — se nuk kam ndër mend të rri. — Ai i hodhi një shikim kritik dyshemesë së dhomës sonë të mbushur plot me bishta cigresh dhe u ngrys edhe më tepër.

Ne prisnim në heshtje ç'do të thcshte dhe e ndjenim që në dhomën tonë ishte një situatë e vështirë.

— Detyra ime si xhaxhai yt, — tha i sapoardhuri duke iu drejtuar shokut tim, — unë shtyn që të vij sot këtu dhe të të them ca gjëra të cilat i quaj të nevojshme t'i them. — Ai heshti mjaft kohë për të mbledhur mendimet

— Ti erdhe këtu me një person të panjohur, — vazhdoi xhaxhai i shokut tim, — dhe nuk dua të zë ngoje këtu ato që ndodhën në shtëpinë time, po gjëra të tjera që kanë lidhje me nderin tonë familjar në sytë e botës dhe për të ardhmen tënde. Ti erdhe këtu pra, me një person të panjohur për mua, dhe unë që në fillim sikur e ndjeva që ardhja juaj kishte një qëllim të dyshimtë. Parandjenja ime u forcua kur ndodhi ajo gjë, pas së cilës ju të dy nuk mund të rrinit më në shtëpinë time. Po kjo s'ishte asgjë përpara të tjerave. Ju erdhët këtu, ti dhe shoku yt, person i panjohur për mua, me qëllime të errta.

— Mbjaj gojën, xhaxha, — thirri shoku im.

— Kam fakte, — tha xhaxhai i s' okut tim, — dhe kjo nuk është më sekret, këtë e di gjithë qyteti, të gjithë për këtë flasin dhe ti na turpërove fisin tonë që ka jetuar gjithë jetën me nder.

— Cilin fis kam turpëruar, — tha shoku im. — Unë nuk njoh asnjë fis. Dhe në përgjithësi ç' do me thënë fis?

— Kjo është e kuptueshme, — tha xhaxhai i shokut tim, — plotësisht e kuptueshme. Kjo rrugë atje të çon, në mohimin e fisit. Por unë si vëllai i babait tënd e kam për detyrë të them atë që është e nevojshme dhe të lutem të më dëgjosh.

Xhaxhai i shokut tim mori frymë thellë dhe u ngryse edhe më shumë.

— Gjithë qyteti e ka marrë vesh se ju keni ardhur këtu me një qëllim të paracaktuar. Se cili është qëllimi juaj i vërtetë këtë nuk e di njeri. Disa thonë se ju keni ardhur të vidhni muzeun e qytetit tonë, disa se doni të vidhni dokumente me vlerë të madhe në të holla, në formë testamentesh ose në formën që e dini vetem ju. Me sulmin që i bëtë kishës së qytetit tonë, ju demaskuat veten tuaj, dhe ti i nxive faqen gjithë fisit tonë.

— Këto janë të gjitha shpifje, — tha me përbuzje shoku im.

— Përse keni ardhur atëherë në qoftë se më lejoni t'ju pyes, — tha xhaxhai i shokut tim me një ton ironik.

— Ajo është puna jonë dhe asnjëriut nuk i japim llogari.

— Ajo është puna juaj? Po të grabitësh kishën e shejnitë në mes të ditës, si të duket ty, po të përpiqesh natën të hysh në shtëpitë e njerëzve të ndershëm, si të duket?

— Në asnjë shtëpi nuk kemi hyrë natën, — tha shoku im, i qetë.

— Ka edhe më, — vazhdoi me ton të rëndë xhaxhai.

— Ka tri ditë që zien kjo gjë. Ju keni nxitur pasionet e

këqia në qytetin tonë. Njerëzit shohin në ëndrra gërmadha dhe thesare.

— Cilët njerëz? — i preu fjalën shoku im. — Janë një grusht parazitësh, ju, klientela e kafenesë.

— Mbaj gojën, — tha xhaxhai i shokut tim, dhe vazhdoi me ton të ngadaltë. — Parmbrëmë u panë dy hije me fener në dorë, që vërtiteshin afër muzeut, mbrëmë dy qytetarë u rrahën për një fletore të vjetër me shkrime që e gjetën.

— Fletore, dorëshkrim? — thirrëm ne të dy. — E gjetën? Kush?

— Po, — tha xhaxhai i shokut tim, — e gjithë kjo është tepër e çuditshme dhe e pabesueshme, është e pabesueshme që dy njerëz rrihen për fletoren e hesapeve të të ndjerit Kiço Llapa. Prapa kësaj diçka fshihet me siguri. Dhe disa thonë se prapa kësaj jeni ju.

— Çne ne!

— Si çne ju. Ti dhe shoku yt, person i panjohur për mua, e filluat tërë këtë fushatë të dyshimtë natën, në qytetin tonë të ndershëm, — tha xhaxhai i shokut tim.

— Përdorni një fjalor pak më të pranueshëm për të dyja palët, — tha shoku im.

Xhaxhai i shokut tim na vështroi një copë herë në heshtje.

— Po ka edhe më, — vazhdoi xhaxhai i shokut tim, — një njeri, që s'dua t'ia them emrin, këtu, më kapi sot pasdite dhe më tha se pranon të këmbëjë 1 me 250. Domethënë se merreni me kontrabandë valute, — thirri xhaxhai i shokut tim.

— Kush është ky njeri, — pyeti shoku im. Xhaxhai i shokut tim na përshkroi fizionominë e tij.

— Është ai që dyshon për ne, — thashë unë dhe këto qenë fjalët e mia të para dhe të fundit, atë mbrëmje janari në hotel.

Pasoi një heshtje e rëndë, të cilën e prisni prapë xhaxhai i shokut tim:

— Dhe tani do t'ju them të fundit, — tha ai me një ton të trishtuar. — Pas asaj që ndodhi thonë se prifti i kishës së qytetit tonë i është drejtuar policisë dhe Sinodhit të shenjtë në Tiranë dhe, me sa duket, puna juaj do të përfundojë atje.

Këto ishin fjalët e fundit që tha xhaxhai i shokut tim në hotel. Ai ndenji një copë herë në këmbë, me një pamje të dëshpëruar; ne tymosnim në heshtje, duke dëgjuar fërshëllimën e erës përjashta dhe një derë që përplasej diku në hotel. Pastaj, pa thënë asnjë fjalë, xhaxhai u kthye e doli nga dera dhe ne dëgjuam hapat e tij, që po largoheshin në korridorin e gjatë të hotelit.

Ne dolëm nga hoteli në ora gjashtë, tamam në kohën kur po binin dy sirenat e fabrikave. Mëngjesi ishte i ftohtë dhe me mjegull. Duke mbajtur valixhet në duar ne ecëm shpejt, midis mureve të larta të rrugës së ngushtë, sepse për një moment, mua dhe shokut tim, na u duk sikur këto mure të vjetër do të na rrëzoheshin mbi kokë.

Kur kaluam përbri kafenesë që porsa ishte hapur, ne kthyem kokën për herë të fundit dhe mezi dalluam turbull, prapa xhamave të mjegulluara, siluetat e njohura që po përkuleshin mbi kafe. Ne provuam një ndjenjë keqardhjeje për siluetat dhe vazhduam rrugën me hapa të mëdha drejt agjencisë. Unë me shokun tim po largoheshim nga N. të vetmuar, përcjellë vetëm nga zhurma e hapave tona të mëdha.

Kur autobusi nisi të largohej dhe në një mënyrë ose në një tjetër po i linim lamtumirën N., gjendja jonë shpirtërore ishte e gjallë dhe vetëm për një çast ne u ngrysëm kur që nga larg pamë, për herë të fundit nëpër mjegull, këmbanoren e kishës dhe minarenë e xhamisë, që dukej sikur na i bënë me dorë, si dy të njohur të vjetër, të mër-zitshëm.

Unë me shokun tim nuk i bëmë me dorë, as ndonjë përshëndetje tjetër lamtumire qytetit të vjetër N. Ne vështro-
nim të heshtur përpara xhadenë dimërore dhe ndjenim një
lehtësi në shpirt.

1962

SHËNIME NGA KAPITENERIA E PORTIT

E mërkurë. 1 shtator

Qyshse jam emëruar me punë këtu, s'më ka ndodhur të kaloj natë më të keqe. Një angushti ma largonte gjumin, po pa ma hequr krejtësisht. E kam vënë re se këto janë netët më të këqia, kur gjumi as të vjen, as të ikën. po rri aty mënjanë si për të të torturuar.

Sikur të mos mjaftonte kjo, herë-herë më dukej se nga deti vinte një rënkim. Dy-tri herë u ngrita dhe përgjova në dritare. S'ndihej asgjë, veç kur shtrihesha rënkimi përsëritej.

Zot, psherëtiva, çliromë nga këto parandjenja të liga dhe u luta me zjarr si asnjëherë tjetër. Disi i qetësuar nga lutja, më tepër ndoshta prej agut të ditës që po shfaqej më në fund, aty ndaj të gdhirë më zuri gjumi.

Gjatë ditës qepallat i kisha të rënda plumb. Dy herë shefi më tërhoqi vërejtjen gjatë përpilimit të procesverbalit për kapjen e një sasive kripe kontrabandë në anijen «Jupiter». Megjithëse është njeri tekanjuz, duhet të them se këtë herë kishte të drejtë. Më e keqja ishte se nuk dija si ta përligjja mefshtësinë time. T'i thosha se gjatë natës nuk kisha

fjetur fare ngaqë më bëhej se dëgjoja rënkime nga deti, kishte rrezik të më merrte për të lajthitur.

E shtunë, 14 shtator.

Bregu i detit plot me leshterikë ngjyrë kafe të nxjerra nga dallgët e dy ditëve të fundit. Shkumba që formohet e shpërbëhet në një përsëritje lodhëse përpara syve të mi. Përsëri kontrabandë, këtë herë stofrash, procesverbale, gjobitje, raporte për më lart.

Njëllëj si javën që shkoi. Njëllëj si javën tjetër përpara kësaj. A mund të ketë monoton: më topitëse se kjo?

Përpara një muaji, kur më ngarkuan edhe me një detyrë të veçantë: matjen çdo ditë të temperaturës së ujit, furisë së dallgëzimit si dhe shpejtësinë e erës dhe drejtimin e saj, m'u duk se diçka do ta thyente mërzinë e njëtrajtshme të ditëve. Po nuk ndodhi ashtu. Ato më shtuan vetëm telashet, po monotoninë nuk e prekën.

E martë, 17 shtator

Udhëtarë të një anijeje që vinte nga Shqipëria dhe që ndaloi gjysmë dite, sa për t'u furnizuar me ujë, sollën që andej lajme të këqia. Kështjellat shqiptare po bien nëra pas tjetrës. Me sa duket së shpejti gjithçka do të marrë fund atje. Thuhet se kryeqyteti i vendit, Kruja, ka rënë këto ditë dhe se së shpejti do të bjerë Shkodra. Një murg venedikas, me të cilin bisedova vetë, më tha se ka të ngjarë që pranverën që vjen truqit të nisin sulmin e madh kundër krejt Evropës. Dhe Italia jonë do të jetë e para që do të bjerë. Duhet të jesh i verbër që të mos e shikosh këtë, kë-

shtu më tha fllitet se sulltani i emërshem i turqve, Mehmeti, paska deklaruar se pranverën që vjen do ta lidhë kalin e tij te portali i kishës së Shën Pjetrit në Romë.

U llahtarisa nga gjithë këto.

E shtunë, 21 shtator.

Dje më hoqën vërejtjen lidhur me shënimet e temperaturave dhe të erës që sipas kërkesës së qendrës i kisha dërguar atje. I kishin gjetur jo fort të plota e të sakta.

Gjithë natën s'më zuri gjumi. Vrisja mendjen të gjeja nëse ishin vërtet të pakënaqur nga kjo, apo s'ishte veçse një shkas për të më hequr qafe. Ky mendim i fundit sa ç'm'u duk bindës në krye, aq më ngjau qesharak pastaj. E kush do ta lakmonte këtë punë të trishtueshme, buzë këtij bregu gati të shkretë, ku togjet e leshterikëve, me atë ngjyrë kafe jo tokësore, i ngjajnë një makthi?

Kështu e qetësova veten njëfarësoj, megjithëse shqetësimi më rifilloi shumë shpejt. Në qoftë se nuk ishte kjo, atëherë ç'ishte shkaku i pakënaqësisë? T'u ishin dukur vërtet të tilla, domethënë të pasakta, shënimet e mia, kjo ishte krejt e pabesueshme. Kush e mori vesh ftohtësinë e ujit dhe lartësinë e dallgëve në këtë breg të nëmur, para tridhjetë ditësh, para njëzetënëntë ditësh, e kështu me radhë, që na paska dërguar matjet e tij të fshehta, të cilat pasi qenkan krahasuar me të miat, na i paskan nxjerrë, këto të fundit, si jo fort të sakta?

E aq më tepër po të mendosh punën e erës, e drejtimit dhe e furisë së saj... Është vërtet për të luajtur mendsh e gjithë kjo.

Po ne jse. Kohët e fundit përgjithësisht punët e mia po shkojnë mbrapsht dhe s'kam pse ta marr aq fort për zemër këtë mbrapshti të re.

E hënë, 23 shtator.

Anije tjetër nga Durrësi i Shqipërisë. Limani më i madh i vendit është në katrahurë të plotë. Atje nën mbrojtjen e Venedikut janë mbledhur një pjesë e familjeve të princave e baronëve shqiptarë që po thyhen njëri pas tjetrit në kështjellat e tyre fatkeqe.

Megjithëse Venediku ka premtuar mbrojtjen e tyre, ata ndodhen në alarm të vazhdueshëm. E sikur turqit pa pyetur traktate e marrëveshje t'i sulen një ditë qytetit?

Atë punën e kalit të sulltan Mehmetit te portali i kishës së Shën Pjetrit ma tha një tjetër udhëtar sot. Ç'tmerr.

E enjte, 26 shtator

Ujë i mjelmët, që herë më duket më shumë i ftohtë e herë më pak, brezare dallgësh që thërrmohen me zhaurimë në vija të shtrembëra, me kreshta të paqëndrueshme. Dhe erë. Erë që fryn herë në një drejtim, herë në tjetrin, që e ndërron e ndërron drejtimin papritur, sipas trilleve të saj pa lënë gjurmë kurrkund. Kurse unë gjurmoj si i shastisur të gjitha këto dy herë ditën, në mëngjes dhe në muzg, «në orët e çmendurisë», siç kanë nisur t'i quajnë me ironi kolegët e mi.

Po të vazhdoj edhe ca muaj, në mos u çmendsha, kam për t'u idiotizuar me siguri.

E mërkurë, 2 tetor

E mora vesh më në fund shkakun e interesimit aq serioz për ato që më dukeshin si punë budallenjsh, domethënë për ujin, dallgët dhe erën.

Dje erdhen nga kryeqyteti një grup njerëzish, gjy-më civilë, gjysmë ushtarakë që u vërtitën gjithë ditën në breg të detit. Vizituan malin e vjetër, depot e ujit e të doganës, pastaj i ranë me këmbë plazhit të shkretë përtej skelës, hetuan zhavorin, shkëmbinjtë, madje disa përveshën veshjet e u futën në ujë, megjithëse uji qe akull.

Aty nga pasditja u mor vesh arsyeja; këtu mendohet të ngrihet një port i madh ushtarak. Matanë detit, në tokën shqiptare tashmë të pushtuar, turqit paskan nisur zgjerimin e një baze të vjetër detare bizantine-shqiptare, për ta përdorur si pikënisje në sulmin e tyre kundër krishterizmit evropian. Kështu ia paskan vënë edhe emrin «Pasha-Liman», që në gjuhën e tyre do të thotë: Pashai i Limaneve, si të thuash Liman i parë ose Liman-Gjeneral.

Si kundërpeshë për këtë monarkët e krishterë të Evropës kanë vendosur të ngrenë këtu limanin e tyre të mbrojtjes. Madje thonë se pak a shumë edhe emrin ashtu do ta ketë «Porto Princeps».

Siç duket të dhënat e mia për të cilat (zot i madh, dridhem tani kur i kujtoj) kam shfryrë kaq herë duke i quajtur trille të çmendurish, për këtë qenkan kërkuar.

E martë, 8 tetor

Sot mbërriti anija e parë me refugjatë shqiptarë. Jo vetëm nëpunësit e portit, po gjithë gjindja që ndodhej në rrugët përreth u sulën në molo për t'i parë

Pikëllimi që sillnin me vete dukej që larg. Kanxhat e sepeteve të rëndë, stolitë e grave, madje dhe kopsat e veshjeve përndritnin që tej si të qullura nga lotët.

Pastaj kur u afruam, pamë sytë e tyre dhe ato ashtu ishin: plot me lot. Ca lot të rëndë që ndihej menjëherë se rridhnin mbi lot të vjetër, të thatë, ashtu siç kishin rrje-

dhur edhe këta të fundit; o perëndi, të çahëj zemra dësh tek i shikoje.

Kishin dalë për t'i pritur përfaqësues të mbretit Alfons të Napolit, aleatit të madh të Skënderbeut, i cili thuhet se do t'u jepte të gjithëve toka dhe prona në mbretërinë e tij.

Pikërisht për këtë flisnin njerëzit, ndërsa refugjatët ecnin drejt karrocave që i prisnin më tej. I lumtë mbretit Alfons. Gjithsesi duhej ta bënte, ata janë heronjtë e Evropës, martirët e saj. Ashtu është, është më e pakta gjë që mund të bëhet për ta: t'u jepet një copë truall në kontinentin për të cilin u flijuan. Për perëndi e the mirë: një copë Evropë për ata që e humbën atë për jetë. E tani si mund të quhet Shqipëria? Shqipëria, ajo tani u bë Azi. si mund të quhet tjetër? Ajme, ç'mjerim.

E premte, 11 tetor

Mot i keq. Nga që gjithë kohës kam përpara syve rrokullimën e pareshtur të dallgëve, ajo më ndjek edhe në ëndërr. Ca ëndrra të mundimshme, që të lenë në mëngjes shijen e rrënimit. Ndoshta katastrofat kështu e dërgojnë qysh më parë pamjen e tyre në trurin e fjetur të njeriut

Ka ca ditë që dallgët, për shkak të kreshtave të shku mbës, më ngjajnë si me çallma nga ato që mbanin dikur çifutët (së paku kështu i kam parë në piktura), e që tani i mbajnë turqit.

E hënë, 14 tetor

Prapë anije nga Shqipëria. Dhe prapë ajo lotësi tejet e pikëlluar në sytë, në karficat dhe unazat e refugjatëve, sidomos të grave.

Te tarraca, përskej ndërtesës së doganës, një grumbull kureshtarësh ndiqnin me sy e me fjalë zbritjen e të ardhurve.

Këta duhet të jenë nga familja e dukës së Gjinit, thoshte dikush.

E nga i ditke ti me kaq hollësi vulat e shenjat e se-njorëve shqiptarë? e pyeste një tjetër.

Njeriu që iu drejtua pyetja vështroi habitshëm, me ca sy të trembur, sikur çdo gjë mund të priste nga gjindja përreth përveç asaj pyetjeje.

I di ai, i di, u hodh një i tretë. Ka qenë kaq herë me shërbim në Shqipëri dhe këto gjëra i di ndoshta më mirë se shqiptarët vetë. Meqë ra fjala, iu drejtua njeriut që porsa kishte marrë në mbrojtje, ti na ke thënë se luani i kurorëzuar është shenjë e kontëve Topijas.

Pse luan të kurorëzuar paska të gdhendur ai sepet? Atëhere qenkan Topijas e jo dukët e Gjinit. Më falni, vëllezër. Sytë s'i kam mirë kohët e fundit.

Ja kështu flisnin. Sidomos e komentuan gjatë një sepet të veshur me kadife ngjyrë jargavani, i cili dukej që tej që ishte i rëndë plumb. Mund të jenë brenda eshtrat e Skënderbeut, tha ai që kishte pikasur i pari emblemën e Topijajve, po një tjetër e kundërshtoi paq. Ende s'e di, o qyqar, se turqit me të pushtuar vendin ku qe varrosur heroi gjëja e parë që bënë ishte ta zhvarrosnin atë e t'i ndanin kockat e tij si hajmali? Kështu që edhe po të duash s'e mbledh më dot eshtërinë e Skënderbeut. Është shpërndarë anekënd si era.

Po, po ç'na dëgjojnë veshët, psherëtiu një plak.

E premte, 18 tetor

Sa herë që mbërrin ndonjë anije nga Shqipëria shkoj te tarraca për të dëgjuar kureshtarët. Nuk e di si më pu-

shtoi edhe mua kureshtja. Është vend i huaj, s'kam patur kurrë punë me të, e megjithatë dalëngadalë më pushton.

Kjo erdhi ndoshta ngaqë më duket se ai vend po jeton gjëmën tonë të ardhme. Apo ngaqë për herë të parë po shoh një hierarki të tërë senjorësh të shkukur nga trojet e tyre, në rënie e në dëshpërim. Të përzhitur i kanë flamurët, të copëtuara vulat e sundimit dhe humbja duket në çdo gjë të tyre.

Malafioria, kështu quhet ai njohësi i Shqipërisë. Na shpjegon çdo herë gjëra interesante. Për dy zonja të bukura e hijerënda, që mbërritën dje, pasi pyeti shoqëruesit e tyre, na tha se i përkisnin dy familjeve rivale prej kohësh në mëri, për çështje krushqie. Për çudi pas gjithë kësaj gjëme, zonjat dukeshin ende të zemëruara dhe iu shmangën sa mundën njëra-tjetrës në kohën që po zbrisnin.

E enjte, 24 tetor

Dje më erdhi, më në fund, lavdërimi i parë për shënimet e mia. Nuk e fsheh që në fillim u gëzova. Them në fillim, se pastaj mendimi i mallkuar se e gjithë kjo ka të bëjë me ujin e sidomos me erën, ma tiroi gëzimin.

Ka kohë që në jetën time gjithçka më duket e paqëndrueshme. Tejet e përkohshme. Dhe kjo, me sa duket, për shkak të profesionit. Ato ç'ka thonë njerëzit në gjuhën e përditshme: fjalë në erë, ose punë në erë, ose fjalë që i merr era për mua janë një farë gjëje ku mbështetet jeta ime.

E gjithë kjo më shkakton një lloj humbje peshe, e cila, pse ta fsheh, qëllon që më jep kënaqësi. Të përkohshme natyrisht, kuptohet përse. Ndoshta kënaqësi s'është fjala e saktë. Më tepër do të thosha një shkujdesje, mospërfillje, sidomos kur e gjithë kjo lidhet me ndjesi të tjera, të pa-

përcaktueshme, si ajo p.sh. që era më ngjan si imja, gati-gati një lloj kushërire, një lidhje e tillë, e veçantë. Vërshëlle, vërshëlle, bukuroshe, them nganjëherë me vete kur e dëgjoj tek rri pranë oxhakut. Mendime të tjera, përherë e më të çakërdisura, ndjekin njëra-tjetrën. Të jesh i lidhur me të, p.sh. të të mbrojë kur të jetë nevoja. He, he, e ç'mund të të mbrojë ajo, veç në ditët e pleqërisë, të fishkëllejë, ja si sonte, te oxhaku i ftohtë, duke të munduar me kujtime të kota?

E martë, 29 tetor.

Anijet me refugjatët nga Shqipëria u shpeshuan si asnjëherë tjetër ditët e fundit. Tani nuk zbrisnin familjarë të kontëve e të baronëve, por edhe njerëz të tjerë, të zakonshëm: nëpunësa, murgjër, piktorë të sëmurë, gjindje e gjithfarshme.

Te tarraca Malafioria e pranoi që nuk orientohej dot më.

Edhe dengjet që shkarkonin ishin më të larmishme tani. Bashkë me relike të ndryshme, sillnin gjithfarë sendesh, disa herë të çuditshme si pragje shtëpish, këndeze metalikë, nga ato që rrotullon era majë pirqjeve, djepe druri, kllamike vatrash ose oxhakë të shkukur.

Mbrëmë, me anijet e fundit shkarkuan arka të rënda hekuri, ku thuhej se ishin arkivat e kancelarive të princave kryesorë.

Sot refugjatët e anijes së mëngjesit ranë në gjuhë me kokën e kthyer nga lindja dhe ia morën një gjysmë kuje, gjysmë vaji që të këpuste shpirtin. Midis tyre qe një zonjë hijerëndë, veshur me të zeza. Në fillim u pëshpërit se qe vejusha e Skënderbeut, po pastaj u mor vesh se ishte dukësja e Durrësit, që e kishte lënë më në fund qytetin në duart e Venedikut.

E martë, 5 nëntor

Gjithë javës, vazhdoi vala e pafundme e refugjatëve. Dje zbarkuan katër anije rresht. Thonë se një pjesë e flotës së Venedikut ka marrë përsipër shpërnguljen e shqiptarëve.

Pasdite, me anijen e parafundit, zbriti baroni Matranga, i cili na paska dy emra. Kështu edhe e thirrkan në Shqipëri: Dyemërshi. Kuptohet që këtë na e tha Malafioria. Ai na tha edhe emrat: Zef Matranga dhe Mehmet Pasha. Kështu pra u quaka baroni, me emrin evropian dhe aziatik. Kuptohet që nuk qenka vetëm dyemërsh, por edhe me dy fé.

Ne të gjithë qeshëm në fillim dhe kujtuam se Malafioria bënte shaka, por ai na i shpjegoi fare seriozisht se kjo dukuri ka nisur të shfaqet në Gadishullin Ballkanik vitet e fundit dhe lidhet me marrëdhëniet tepër të ngatërruar të këtij Gadishulli me perandorinë turke, përpara shpalljes së luftës së hapur. Malafioria na kujtoi pastaj se vetë prijësi legjendar i shqiptarëve kishte dy emra: njërin musliman, Skënderbej dhe tjetrin të krishter, Gjergj Kastrioti.

Ah vërtet, tha dikush, dhe të gjithë u kujtuam se e dinim këtë, ndaj s'kishim pse të habiteshim shumë me dyemërinë e baronit.

Veç ka një ndryshim, tha Malafioria. Ndërsa Skënderbeu u thirr prej sulltanit turk qysh kur ishte fëmijë, dhe më vonë kur u ngrit kundër turqve, bashkë me vasalitetin flaku edhe emrin e vet islamik, për të rimarrë emrin e vërtetë, Gjergj Kastrioti, kontët dhe baronët shqiptarë, që ndërruan emrat, e bënë këtë në kahje të kundërt; domethënë flakën emrin e tyre të vërtetë për të gënjeshtërtin, islamikun.

Malafioria deshi të na shpjegonte edhe arsyet, po në tarracë të priste era dhe ne ikëm para rënies së muzgut.

E enjte, 14 nëntor.

Pas stuhisë së tmerrshme bregu i detit u shkretua. As anije as gjurmë pëlhurash në horizont. Porsa hapi koha dolën në tarracë dhe përgjuam një kohë të gjatë detin. Malafioria i kishte sytë me lot.

E hënë, 18 nëntor.

Lavdi zotit rifilloi ura detare Itali-Shqipëri. Kjo do të thotë se zërat, sipas të cilave turqit kishin arritur të bllokounin evakuimin e shqiptarëve. Ishin të gënjeshtërtë.

Gjashtëmbëdhjetë anije brenda tri ditëve. Mijëra refugjatë. Flitet se tokat e mbretit Alfons, të caktuara për ta, kanë mbaruar dhe po kërkohen vise të tjera për ngulitjen e tyre në Kalabri

Kjo valë e re ishte si e përzhitur nga shkrumbi. Kup-tohej menjëherë që shumë nga burrat vinin drejt e nga muret e kështjellave, që porsa ishin pushtuar. Shkretia e bregut dimëror të detit s'është gjë përpara zbrazëtisë që ata kanë në sytë e tyre. Tek i shikoja dije pasdite që nga tarraca, befasi thashë vetes: është e para herë që po shoh njerëz që kanë humbur atdheun. Qoftë e fundit!

Si përherë zbarkojnë bashkë me reliket e tyre. Po par-dje u çuditëm të gjithë kur pamë të shkarkonin dy këmbana të mëdha. Sipas Malafiores njëra duhej të ishte e katedrales së Shkodrës. Tjetrën s'e gjente dot.

Ndoshta do t'i vendosnin në ndonjë kishë të këtushme. Ose i morën me vete thjesht që të mos binin në duart e muslimanëve.

Shkarkimi i këmbanave shkaktoi një mallëngjim të veçantë. Njerëzit pyesnin «është ndaluar krishterimi atje?», por askush s'qe në gjendje të jepte një përgjigje të saktë.

Ndërkaq te bregu i detit, fëmijët e refugjatëve, që si zakonisht arrinin të miqësoheshin të parët me vendasit, sec vizatonin diçka në rërë, në kohën që prindërit merreshin me zbritjen e sendeve. Rreth tyre qenë grumbulluar shumë kureshtarë dhe një prej nesh, që kishte shkuar gjithashtu të merrte vesh se ç'bëhej, u kthye e na tha se shqiptarët e vegjël po u shpjegonin vendasve se ç'janë minaretë, ato që do të zëvendësonin kishat në Shqipëri.

C perëndi, tha dikush, arritën vallë t'i ngrejné të tillat?

Gjersa fëmijët i kanë parë do të thotë se ndërkaq janë ngritur, u përgjigj një tjetër.

Kjo është e natyrshme, tha një i tretë. Atje tani është Azi dhe çdo gjë është ndryshe.

Zot, ç'na dëgjojnë veshët, u hodh i pari. Ti thua se çdo gjë është ndryshe... Mos do të thuash se edhe lulet, edhe bari, edhe qielli janë ndryshuar?

Azia nuk fillon kurrë me to, u përgjigj tjetri. Azia filloj te njerëzit.

M'u kujtua baroni dyemërsh dhe u rrëqetha së brendshmi. Thuhej se një tjetër senjor i tillë kishte mbërritur, konti i Kashnjetit ose Aqif Pashai.

E enjte, 28 nëntor.

Këtë javë mbërritën rreth dyzet anije. Dhe njëlloj si të tjerët edhe këta kishin me vete pragje shtëpish, copa vatrash, oxhakësh, djepe fëmijësh, thjesht torba me baltë nga dheu i tyre.

Duket tamam sikur duan të mbjellin këtu, në tokën italiane, atdheun e tyre.

Po a mbillet vallë atdheu? Ç'pamendë do ta bënte këtë?

Sot në mëngjes qielli u hap papritur. Dola te dritarja

e zyrës dhe vështrova nga lindja kthjelltësinë që të lëbyrte sytë. Mendimi i parë që më erdhi ishte: vallë është e mundur që atje, në bregun matanë, disa dhjetëra milje larg, tani fillonte Azia?

Dhe m'u kujtua befasisht ajo natë me ankth disa javë më parë. Ai rënkim që vinte nga deti... Zot, perëndi, ç'shenjë të qartë kishe dërguar.

janar, 1986

KALIMET E NËNDHESHME

Ç'mendoni lidhur me fjalët e hapura për kalimet e nëndheshme në N.? Sigurisht i keni dëgjuar. Ka një javë që nuk flitet veç për to, apo jo? Mendoni se e gjithë kjo ka ndonjë arsye, domethënë ka lidhje me shkaqe, si të themi, objektive, apo është diçka e pashpjegueshme, si të thuash, misterioze për të përdorur një fjalë disi jashtë kohe.

Kalimet e nëndheshme? Hm. Sigurisht që kam dëgjuar. S'ka njeri që mund të thotë se s'ka dëgjuar për to. Sa për arsyet, ato më duken më shumë të pashpjegueshme se të shpjegueshme. Shkurt do të thosha të njëjtën fjalë që përdorët ju, misterioze.

Herë të tjera është folur për to?

Mund të them se po... Nëna ime, përshembull, më ka treguar. Gjyshja gjithashtu, dëgjuar ndoshta nga nëna e vet.

Domethënë është një pëshpërimë që hapet herë pas here. Në formë ciklike, po të përdornim një term të sotëm. Pikërisht për këtë doja edhe të pyesja: a mendoni se pëshpërima nxitet ose kushtëzohet nga shkaqe objektive, si p.sh. dëshira për t'u fshehur, në periudha lëvizjesh ilegale ose terrori, ose në kushtet kur njerëzit krijojnë sekte të fshe-

hta, shoqëri masonike e të tjera gjëra të kësaj natyre?
 Hm. S'mund ta them. Herën e fundit p.sh. kur shpërtheu thashethemja për to, para njëzet vjetësh në mos gaboj, qyteti ynë ishte më i qetë, për të mos thënë më i fjetur se kurrë. Dhe ja midis amullisë ia dha papritur...

Gazetari, me gishtat e ngrirë nga të ftohtit, çka i jepte lëvizjes së tyre një lloj mospërfilljeje, reflektonte shënimet e mbledhura gjatë asaj jave të mërzitshme në qytetin e vogël provincial. Një qytetth në ethe. Kështu mendonte ta titullonte shkrimin, ndërsa me vete thoshte; O zot, edhe në delirin e tij ai është i mërzitshëm.

Nga dritarja e vetme dukeshin dritëzat e zbehta që regëtinin humbshëm. Ai i la shënimet për të ndezur një cigare, të cilën e shoi parakohe për të hapur prapë shënimet. Ishin aty gjithfarë të dhënash të nxjerra nga muzeu i vogël, nga arkivi i bibliotekës, copa nga gazetatat e vjetra, si edhe intervistime njerëzish të moshave e punëve të ndryshme. Nga të gjithë dilte pak a shumë e njëjta gjë: që psikoza për kalimet e nëndheshme as shpjegohej dhe as lidhej me ndonjë rrethanë të dukshme.

Gazetari e kishte ndier se karriera e tij lidhej me këtë shkrim dhe ky shërbim që shansi i fundit që po i jepte kryeredaktori, pas një sërë dështimesh. Ideja se ndoshta nuk do t'ia dilte as këtë herë i jepte qysh tani dëshirën të ulërinte.

Nga gjithë të dhënat dilte se në këtë qytet (me zor e mbante veten të shkruante «në këtë qytet të mallkuar»), thashethemja për kalimet e nëndheshme shpërthente herë pas here papritur. Ishte me sa dukej një lloj tërmeti i brendshëm të njerëzit, një lloj dëshire për riorganizim, për të ndryshuar në qytet diçka, për të zëvendësuar rrugët e

dukshme me të tjera, të mjegullta e të padukshme. Shkurt për të krijuar një hartë urbanistike të re, të dyzuar.

Si lindte kjo, ç'e nxiste, ç'e kthente në psikozë të për-bashkët, ishte vështirë të shpjegohej.

Ëndërr për një metro? Ai e kishte shkruar dhe nën-vizuar disa herë këtë frazë dhe sado që i ngjante e palogjikshme, i vinte keq të ndahej prej saj. Qyteti kishte më pak se njëzet mijë banorë dhe sado të ngushta e të këqia t'i kishte rrugët, ato ishin në gjendje të përballonin të gjithë lëvizjet e banorëve të tij, qoftë edhe në rastet më të skajshme si p.sh. në turbullira, ikje me panik nga qendra, ose dyndje drejt qendrës, madje edhe më keq, në raste të mundshme të një dehjeje ose lajthitjeje mendore të një pjese të banorëve, pra në kushte kur mund të përfytyrohej një lëvizje e tyre krejt e çmendur dhe pa kurrfarë logjike (vrapim me krahë të hapura, ecje mbrapsht si gaforrja, ecje me kokëposhtë etj.etj.)

Ideja e metrosë, sado joshëse të dukej, nuk qëndronte. Vetë fakti që kronika e psikozës së kalimeve të nëndheshme në N. ishte më e vjetër se gjithë metrotë e botës, e hidhte poshtë pandehmën.

Ai u ngrit dhe iu afrua dritares. Nga qelqet vinte e ftohta e hidhur e qytetit, me të cilin atij i dukej se nuk mund të kishte veçse një raport armiqësor. I mallkuar, shfryu më në fund me vete, s'të mjaftojnë rrugët e shtrembra ku kalimtari mund të thyejë kokën, po na tani, na shpikë edhe kalimet nën tokë.

Dukesh i qetë, vazhdonte të shfrynte kundër qytetit, po gjithë këto pandehma për kalimet nuk dëshmonin veç për pasione të nëndheshme, sekte, përbetime. Dhe njerëzit ndaj ecnin si të shushatur në rrugë, ngaqë një pjesë të mendjes e kishin nën tokë.

Prej kohësh kishte rënë nata dhe kërkimet e kalimeve të nëndheshme me siguri kishin filluar. Tani me dhjetëra banorë të N., me sy të çakërritur nga kureshtja dhe lakmia,

duke mbajtur në duar fenerë apo llamba vajguri zbritnin nëpër bodrume apo stere të braktisura, çokitnin muret, gërvishtnin aty-këtu suvanë e tyre duke kërkuar dyert e fshehta, të maskuara me kujdes të kalimeve të nëndheshme. S'dinin as vetë ç'kërkonin; floring të fshehur, kufoma të humburish apo kryqe të dikurshme. Gazetari që i bindur se pasioni për gjetjen e kalimeve i mbulonte gjithë të tjerat.

Thuhej se një nga kalimet bashkonte shtëpinë e Shtinove me atë të Xhulajve. Kishte zëra që ngulnin këmbë se një kalim i fshehtë zgjatej nën thertoren e qytetit për të dalë në lagjen matanë kështjellës. Të tjerë flitnin për tunele që niseshin nga shtëpia e Shametëve dhe e Hankonatëve për të dalë te kisha e vjetër, dhe që andej në Sheshin e Zinxhirëve e ndoshta më larg.

Dy ditë më parë ai kishte bërë një hartë të thjeshtësuar të qytetit, ku kalimet e mundshme nëntokësore i kishte shënuar me vija të kuqe, të ndërprera. Gjatë atij mëngjesi që përpjekur të bënte një hartë të dytë, përsëri me kalimet e përfytyruara, po këtë herë të dikurshme, domethënë përpara njëzet vjetësh. Duke i krahasuar të dyja hartat, (kalimet e vjetra qenë shënuar me vija blu), përpiquej të gjente një lidhje midis të dyjave. Herë-herë i dukej se lidhje kishte, madje mjaft të qartë, po paspak dyshonte se ai përkim ose largim itinaresh s'ishte veçse një rastësi.

Në shënimet e tij kishte disa të dhëna për shtysën e parë që flitej se paskësh nxitur fillimin e psikozës. Herën e fundit, përpara njëzet vjetësh, dyshohej se zhdukja e një nuseje, të Mezinate, që bërë shkas për trazimin. E kishin kërkuar trupin e nuses në sterenë e shtëpisë (vendi i parë që i shkonte gjithkujt ndër mend për të kërkuar një nuse të mbytur), dhe meqenëse pas zbrazjes së steresë nuk që gjetur asnjë gjurmë e saj, u hapën fjalë se ajo qenkësh arratisur nga shtëpia nëpërmjet një kalimi të nëndheshëm. Edhe më përpara, në psikozat më të hershme, flitej se disa herë qenë bërë shkas ëndrrat ose fanitjes. Iu bë në ëndërr

Shën Kozmai, rrëfenin, dhe i tha se në aksh vend, midis Urës Njëharkshe dhe Sokakut të të Marrëve, ndodhej një ikonë e florinjte, fshehur aty që nga koha e ndjekjes së parë të të krishterëve. Po të gjitha këto s'ishin fort të sakta. Për të njëjtën psikozë rrëfenin fillime e shkaqe të ndryshme, madje në shumicën e rasteve, kaq e fuqishme ishte vetë psikoza sa që shtysa e parë ngjante e pabesueshme, siç do të dukej e pabesueshme tërheqja e një bualli prej një insekti.

Sytë e gazetarit nuk i ndaheshin vijës së kuqe të ndërprerë që bashkonte shtëpinë e Hankonatëve me atë të Shametëve. Shumica e të intervistuarve ishin në një mendje se për psikozën e fundit që bërë shkak pikërisht përçartja e plakës Miriam të Hankonatëve. Në shtratin e vdekjes pak çaste përpara se të jepte frymën, ajo kishte thënë: «Shkoni të hapni shtegun e nëndheshëm për te Shametët. Hiqeni ujët me kovë, kujdes se ka gropa. E bëtë gati fenerin? E keni derën në të djathtë të lëfytit të steresë. Është mbuluar vetëm me një gisht suva».

E kishin kërkuar vërtet derën fill pas varrimit të saj (gazetari kishte parë me sytë e tij suvanë e hapur), po nuk qe gjetur asnjë gjurmë dere apo kalimi.

Gazetari ishte interesuar për plakën Miriam, por nga të dhënat nuk dilte të kishte patur kurrë ndonjë turbullirë mendore apo traumë të shkaktuara nga ndonjë fatkeqësi. Përkundrazi kishte famën e njerës prej grave më të bukura e më të lumtura të derës së vjetër të Hankonatëve. Ashtu dhe kishte vdekur, e rrethuar nga fëmijët dhe mbesat e saj, madje dhe sëmundja e tillë i kishte ardhur, e qetë, thua se kishte qenë më shumë lodhje se sëmundje, saqë shumë njerëz, duke e parë ashtu të bukur e luksoze në arkivol, me dylbitë e vëna mënjanë, (o zot, ç'do të shikojë me to në varr të zj, kishte thënë plaka Shano), shumë njerëz pra, duke e parë për herë të fundit, kishin psherëtirë: lum ajo!

Mirëpo ja, pa zbritur mirë në varr, në bodrumet e shtë-

pive kishte krisur kazma e çekiçi. Dhe bashkë me zhurmat e para, njerëzit kishin thënë: ç'qe ajo fjalë që na the duke likur, moj Miriam?

Gazetari qe ngritur dhe po ecte poshtë e përpjetë nëpër dhomë. Përpara se të thoshte «jo!» me zë, ai e mendoi atë «jo» shumë herë, por e menduar ajo ishte shumë më e fuqishme.

Jo, tha më në fund dhe kërkoi në xhepa paketën e cigareve. Kjo punë s'mund të ishte kaq e thjeshtë.

Ai, që kur kishte mbërritur natën e parë në N., kishte thënë me vete: o zot, sa të kalojnë këto dy-tri ditë shërbimi e të iki këndeje nga sytë këmbët, as që kujtohej tani për kthimin. Telegrameve të redaksisë nuk u përgjigjej më, madje i hidhte në kosh pa i lexuar. Kaq shumë qe i përpirë nga hulumtimi që po bënte saqë ishte i bindur se kur t'ua tregonte të tjerëve do t'ia falnin gjithçka.

Qyteti N. ishte plot arkiva familiare, një pjesë, të shkruara me alfabetë të fshehtë, zakonisht i kishin gjithë shtëpitë e vjetra. Në to gjendeshin gjithfarë dokumentesh letërkëmbime, dëshmi gjyqësore, kopje testamentesh ose kronika të ngjarjeve kryesore të familjes.

Ai e nisi hulumtimin pikërisht nga arkivat e Hankonatëve e të Shametëve. Për të arritur t'i shfletonte iu desh të harxhonte aq shumë energji, lajka e premtime, sa ç'nuk kishte harxhuar as për fejesën e vet të parë, atë më të vështirën. Pas kësaj pati idenë, që gjithë shënimet e nxjerrra t'i krahasonte me pëshpërimat që mund të kishin qar-kulluar nëpër qytet për këto dy shtëpi. Kjo gjë nuk ishte e vështirë, ngaqë pothuajse gjithë shtëpitë e vjetra të N., kishin patur me njëra-tjetrën ndonjë histori të gjatë ose të shkurtër. Kështu ai nuk e pati vështirë që ato dy letra të arkivit të Hankonatëve, ku flitej vagëllimthi për fisin e Shametëve, pandehmë që një syri të jashtëm do t'i kalonte e pavërejtur ose së paku do t'i dukej e pavend, pra ai nuk e pati të vështirë që, prej krahasimit të këtyre dy letrave

me një thashetheme të hapur shumë kohë më parë për një krushqi të mundshme midis dy shtëpive, të vinte në përfundimin se një krushqi do të qe menduar vërtet, por prej saj qe hequr dorë më pas, pas të dhënave të mbledhura prej Hankonatëse për një sëmundje të trashëgueshme në fisin e Shametëve. Po zbulimi i vërtetë i gazetarit ishte një letër tjetër, këtë herë e Shametëve, ku thuhej: «Sa për H., ajo punë u mbyll tani dhe është vërtet gjynah, ngaqë të dy, e pëlqenin njëri-tjetrin, e sidomos vajza, sipas të dhënave të sigurta që kemi».

Prej letrës së fundit dilnin dy të dhëna të reja, e para, që vajza «sidomos» e pëlqente dhëndrin, dhe. e dyta, se vajza ishte nga Hankonatët.

Mendimi i parë i gazetarit ishte që këtu s'ishte fjala për krushqi, po për një lidhje dashurie. Ndryshe si ishte e mundur të pëlqeheshin, e «sidomos» ta pëlqente vajza?

Lidhja e dashurisë u përzie aty për aty me ngut, me padurim, në mënyrë të pazgjidhshme me kalimin e nëndheshëm, nëpërmjet të cilit ata takoheshin. I përfytyroi të dy duke kërkuar njëri-tjetrin nëpër terr, me fener në dorë, duke shkelur nëpër pellgje të zeza, sipër gropave, thollë nën tokë...

Vrapoi prapë te stereja, por atje s'ishte veç muri, me suvanë e gërryer nga kërkimet, i ftohtë, i fortë, simbol i pengesës së pakapërcyeshme, i ndërprerjes dhe i izolimit.

Dhëndri i mundshëm, një burrë i pashëm me «kalçunja të bukura» (ndriste rruga si flakë kur kalonte, sipas të dhënave), kishte vdekur prej kohësh. Asnjë lidhje s'kishte patur kurrë midis tij dhe ndonjë gruaje tjetër.

Gazetari kalonte ditë të tëra në mejhane, më tepër për t'u trullosur dhe vetë, sesa për të mësuar ndonjë gjë. Një ditë, me një gjysmë buzëqeshje ndiqte një bisedë që lidhej me fjalën «randevu». Ca thoshin se ishte një fjalë e re, po kasapi Hill ngulte këmbë se fjalën e kishte sjellë njëzet vjet më parë një aeroplan. Ju kujtohet kur u hap aeroporti?

thoshte ai. Që me aeroplanin e parë zbriti një grua. U hap fjala se ajo «kishte një randevu». Askush s'e dinte në atë kohë atë fjalë, po pastaj u përhap kaq shumë saqë edhe hamejtë jevgj, kur porosisje qymyrin, pyesnin: kur do ta lemë randevunë, zotni?

Gazetari u kthye në hotel dhe nga fytyra s'i ndahej nënqeshja e lodhur. Ai u ul mbi shtrat, nxori fletoren dhe shkroi: «Zbulohet enigma e kalimeve të nëndheshme» Ai u mendua për një kohë shumë të gjatë përpara se të shkruante vazhdimin. Ai do të shkruante se një ëndërrim dashurie kishte shkaktuar psikozën e fundit të kalimeve të nëndheshme në N. Ai do të shpjegonte se si plaka Miriam H. në çastin e fundit para vdekjes, kishte folur përcart për kalimin e nëndheshëm. të ëndërruar prej saj gjithë jetën. që do ta conte drejt njeriut të vetëm që kishte dashur në këtë botë. Në të vërtetë ky kalim. ashtu si shumë gjëra të tjera të njerëzve, kishte qenë vetëm në mendjen e saj.

Gazetari e mori shumë herë lapsin, dhe shumë herë e la përsëri. Më në fund ai vuri një kryq sipër titullit të shkrimit dhe e mbylli fletoren. Një ndjesi e brendshme, i tha se ndoshta ishte më mirë që të nderonte një pakt të vjetër. E futi fletoren në çantë, si për të bindur veten në vendosmërinë e tij. Ideja se e fshehta e udhës së nëndheshme të së vdekurës do të mbetej e pazbuluar, për çudinë e tij, i dha qetësi.

Tiranë, shkurt 1990.

NË PERIFERI PRANË AEROPORTIT

— Ky është Tu.

— Jo, ky është Karavell.

Ne ndoqëm me sy një copë herë aeroplanin e madh që kaloi fare ultas, plot zhurmë dhe sinjale të gjelbra mbi kokën tonë dhe siç duket u ul në aeroportin ndërkombëtar, disa kilometra larg, përtej pyllit të errët.

Rrinim në errësirë, në anën e prapsme të vilës së drunjtë, pranë gardhit me kallama dhe pinim cigare.

— Ke ftohtë? — tha ajo.

— Jo.

Ajo ishte me një fustan të bardhë vere, nga ata që mbajnë zakonisht vajzat në periferi.

Në errësirë nuk ia dalloja mirë fytyrën dhe më vinte keq, se ajo ishte e bukur dhe nuk mërziqtesha kurrë ta vështroja. Vetëm kur thithte cigaren, dhe ajo e thithte shumë, si të gjithë ata që nuk pijnë duhan, në dritën e dobët, kuqe shihja buzët e saj dhe sytë që vështronin majër e shtegares.

— Nga mund të ketë fluturuar Karavella? — pyeti.

— Ku ta dish? Ndoshta nga Parisi.

— Po nga Kopenhageni?

— Ndoshta nga Kopenhageni.

Kurse fustani i bardhë dukej mirë në errësirë. Mua gjithmonë më pëlqenin vajzat me fustane të bardha, të thjeshta, që zbrisnin nga trenat elektrike diku nëpër stacionet e shumta të periferisë, me nga një çantë të vogël të bardhë ose blu, që ta bënin me dorë pa të njohur dhe mbeteshin pastaj prapa dhe nuk i takoje kurrë më në jetë.

— Ky është Tu.

— Po, ky është Tu.

Ne nuk folëm deri sa aeroplani kaloi mbi kokat tona me një zhurmë therrëse, sikur binin një milion zile bashkë.

— Ndoshta ky është juaji, — tha ajo.

Herë-herë mua më dukej se nuk ishte ajo, po dikush nga ato vajzat e panumërta të trenave të periferisë, me fustan të bardhë, që gjithmonë ta bëjnë me dorë. Dhe prisja derisa ajo të thithte cigaren dhe të shikoja prapë në refleksin e kuq buzët e saj dhe sytë gjysmë të mbyllur që vështronin poshtë.

Larg u dëgjua boria e trenit elektrik dhe zhurma e mbytur e binarëve.

— Kurse trenat nuk mund t'i njohësh, — tha.

— Po, është e vërtetë. Këtë s'e kisha menduar asnjëherë.

— Edhe unë kam plot gjëra që s'i kam menduar kurrë në jetë.

— Çdo njeri ka gjëra që nuk i ka menduar asnjëherë në jetë, — thashë dhe ndeza një cigare tjetër.

— Unë nuk i kam frikë trenat. Trenat nuk të çojnë kaq larg.

— Ka trena që të çojnë larg.

— Megjithatë nuk i kam frikë.

Por edhe sikur ajo të mos ishte ajo, po njëra nga ato vajzat me fustan të bardhë, prapë mua do të më vinte keq që po ndaheshim. E aq më shumë që ishte ajo.

Nata ishte e freskët dhe qentë lehnin tutje, atje ku udha të çonte në errësirë.

— Të vjen keq që do të ndahemi? — më tha.

— Po.

— Le të mos bisedojmë më për këtë, — tha. — Më thuaj ndonjë gjë tjetër, diçka për atdheun tënd.

— Të gjitha t'i kam treguar.

— Diçka tjetër. Diçka që të mos ketë lidhje me këtë.

Unë nuk dija ç'të thosha dhe tani nuk ia shihja më fytyrën, sepse ajo e kish mbaruar cigaren. Tani më dukej se nuk ishte ajo dhe asgjë nuk më vinte ndërmend.

— Të lutem, — tha, — asnjë fjalë për ndarjen.

— Sigurisht, kjo është nata jonë e fundit, pse të mër-zitemi kot?

— Po. Po s'ka nevojë.

— Ndiz një cigare, — thashë. — Përndryshe nuk ta shikoj fare fytyrën.

Ajo ndezi cigaren dhe tani e thithte edhe më fort dhe unë ia shikoja më mirë buzët dhe vështrimin e pjerrët rën refleksin e kuq.

— Thuamë diçka, — tha. — Tregomë ndonjë gjë.

Ç'të tregoj, mendova, Asgjë s'më vjen ndër mend, ose më mirë çdo gjë që më vjen ndër mend nuk duhet treguar. Ne kështu ramë dakord.

— Fol, diçka, të lutem.

— Tani, — thashë. — Tani do të tregoj diçka. A ta kam treguar kur kemi udhëtuar një natë me tren të dehur tapë?

— Jo, nuk ma ke treguar.

— Ishim dyzet veta në kursin tonë, nga njëzet e dy kombësi të ndryshme.

— Sa shumë.

— Pse shumë? Ne jemi vetëm dy veta dhe jemi dy kombësi.

Ajo e mbaroi cigaren dhe tani unë nuk ia shikoja më

fytyrën, po vetëm dëgjoja frymëmarrjen e saj të lehtë.

— Vazhdo, — tha.

Unë i tregova se si ne, i gjithë kursi, do të shkonim në një qytet tjetër për ekskursion dhe treni u nis në orën dhjetë e gjysmë të mbrëmjes, kurse ne kishim ardhur të gjithë të dehur dhe zoti e di se si e gjetëm vagonin tonë. Pastaj treni ish nisur dhe ne vazhdonim të pinim dhe shishet i flaknim nga dritarja në errësirë..

Në qiell u dëgjua përsëri zhurma e një aeroplani.

— Tu, — tha ajo.

— Jo, është Il.

— Nga e dallon ti?

— Nga zhurma, — thashë.

— Të gjithë ata të shurdhojnë, — tha dhe pas një pauze pyeti: — Ku e ke ti vendin?

— Nuk e di, s'e kam parë biletën.

— E ke në xhep?

— Po, e ç'rëndësi ka vendi?

— Është e vërtetë, s'ka asnjë rëndësi. Vazhdo — tha, — më trego për vagonin e dehur.

— Vagon i dehur, ti e the bukur, vërtet çdo gjë ishte si e dehur atë natë, dhe treni, dhe shinat, dhe vetë shishet.

Dhe unë vazhdova të tregoj se si ne pinim e këndonim dhe thyenim shishet, kurse konduktorët kishin mbyllur dyert me çelës që të mos hidhej ndonjë përjashta dhe vajzat tona ishin mbyllur në kupetë e tyre dhe s'ndiheshin fare, ndërsa ne nuk e kuptonim ku ishin zhdukur. . .

— Përsëri aeroplan, — më ndërpreu ajo. — Ky është Tu.

— Po, ky është me siguri Tu. Tani ti fillove t'i dallosh.

— Unë duhej t'i dalloja mirë, sepse ne kemi kaluar shumë muaj në këtë vilë, pranë aeroportit. — Ajo e preu fjalën dhe ndezi një cigare. — Po vetëm kohët e fundit më kanë interesuar aeroplanët. Ti e di.

— Po. Po.

— Tregomë, — tha. — Vazhdo.

Unë tregova se si ne pinim dhe secili fliste në gjuhën e tij dhe merreshim vesh fare mirë, ndërsa nuk e dinim fare ku shkonim. Bile ne mendonim se, në përgjithësi, nuk shkonim gjëkund dhe as ktheheshim nga ndonjë vend, por ishte diçka tjetër midis këtyre dy kuptimeve që ne nuk e merrnim dot vesh dhe prandaj pinim akoma.

Ty të mbuloi prapë errësira, mendova, dhe nuk kisha më ç'të tregoja.

— Ti tani e flet mirë gjuhën tonë, — tha ajo. — dhe bën pak gabime, vetëm në gjininë femërore të vetës së tretë. Po mua më pëlqen kështu me gabime.

Unë buzëqesha.

— Kurse kohët e fundit mua më kanë tallur shoqet disa herë sepse kam filluar të bëj gabime.

Unë qesha.

— Gabimet e tua, — tha.

E dashur, mendova, e shtrenjta ime.

Larg këndonin bulket e natës dhe udha nuk dukej fare. Unë shikoja vetëm fustanin e saj të bardhë dhe më dukej sikur qysh tani ajo po më largohej dhe bëhej e pakapshme, si një kujtim. Qëndruam mjaft kohë pa folur dhe asgjë nuk mund të thosha sepse nuk mendoja veç për disa flokë dëborë që binin diku pakuptim, në thellësi të kujtesës sime.

-- Deri në ç'orë ulen aeroplanët? — pyeti.

— Deri në mesnatë.

— Mesnata po kalon.

— Siç duket nuk do të ketë më, — thashë.

— Ndoshta.

Unë u mendova të gjeja ndonjë gjë tjetër për të thënë, dhe cigaret ishin mbaruar të gjitha.

Ti s'do të dalësh më sonte nga errësira, mendova, ti do të shkosh pas pak në dhomën e prindërve të tu dhe unë

do të shtrihem në dhomën tjetër, në krevat portativ dhe ky do të jetë fundi.

— Ndoshta ti duhet të flesh tani, udha është e gjatë dhe e lodhshme, — tha vajza.

— Do të shkoj pas pak.

Ndjeva larg një zhurmë të mbytur.

— Më duket se po vjen i fundit, — thashë.

Ne vumë veshin të dy dhe dëgjuam se si në thellësi të natës po rritej një zhurmë e mbytur.

— Kushedi pse është vonuar.

— Po. Është vonuar shumë.

Ne prapë nuk folëm derisa aeroplani u duk në horizontin e errët dhe fluturoi me zhurmë shurdhuese mbi kokat tona, me barkun dhe krahët plot sinjale që shuheshin e ndizeshin si të gjalla, dhe asnjëri prej nesh nuk e njohu se ç'aeroplan ish.

— Mbaroi, — tha ajo. — Tjetër s'do të ketë.


Unë nuk dija ç'të thosha dhe më dukej se errësira sa vinte bëhej më e dendur.

— Shkojmë të flemë, — thashë, — është vonë.

— Po, i dashur, — tha ajo.

Unë e putha në buzët e ftohta dhe ne i thamë njëri-tjetrit natën e mirë.

Tiranë, 1961.



NDËRTIMI I PIRAMIDËS SË KEOPSIT

I

Zanafilla. Një ide e vjetër, e rizbuluar me vështirësi.

Kur një mëngjes nëntori, faraoni i ri Keops, që nuk kishte veçse disa muaj që ishte ngjitur në fron, tha se ndoshta nuk do të ngrinte një piramidë për vete, ata që e dëgjuan, astrologu i pallatit, disa nga ministrat më të afërt, këshilltari i vjetër Uzerkaf dhe kryepriifti Ptahhotep, që ishte njëkohësisht kryearkitekt i Egjiptit, u nxinë në fytyrë si të kishin dëgjuar një gjëmë.

Një copë herë ata hetuan fytyrën e sovranit me shpresë se do të gjenin në të shenjën e shpotisë, pastaj, siç i rrëfyer më pas njëri-tjetrit, u përpoqën t'i jepnin zemër vetes duke kujtuar fjalën «ndoshta», që faraoni e kishte shqiptuar si nëpër dhëmbë. Po fytyra e Keopsit mbeti e pazbërthyeshme dhe shpresa e tyre se kjo ishte një frazë e rastit, nga ato që mbretit e rinj kanë qejf t'i lëshojnë gjatë ngrënies së mëngjesit, sa vinte venitej. Disa javë më parë a nuk kishte mbyllur dy nga tempujt më të vjetër të Egjiptit dhe fill pas kësaj a s'kishte urdhëruar të përgatitej dekreti që

do t'u ndalonte këndeje e tutje egjiptianëve të bënin flijime?

Keopsi gjithashtu hetonte fytyrat e tyre. Nga sytë nuk i ikte një ndriçim ironik, dhe sa më shumë që thellohej lesh-tja, vështrimi i tij dukej sikur thoshte: kaq shumë u trishtuat? Thua se s'është fjala për piramidën time, po për tuajën. Perëndi Re, qysh tani ata janë shfytyruar nga servilizmi. Si do të bëhen vallë më vonë, kur unë të jem më i vjetër dhe më i egër?

Pa thënë asgjë, madje pa i vështruar fare u ngrit dhe u largua.

Me të mbetur vetëm ata kthyen fytyrat e dëshpëruara nga njëri-tjetri. Ç'është kjo që na gjeti, pëshpëritnin. Ç'që kjo zezonë! Njëri nga ministrat u mbështet te muri i terracës, ngaqë i merreshin mendtë. Kryepriifti i kishte sytë me lot.

Një copë herë murmuritën me njëri-tjetrin, pastaj u shpërndanë. Dy prej tyre shkuan të kërkonin një takim me Khentkausën, nënën e sovranit, të tjerët, më të mençurit, zbritën në bodrumet, ku ruheshin arkivat e vjetra për të gjetur shkruesin plak, gjysmë të verbuar, Ipuurin.

Biseda për piramidën nuk u hap më në asnjërën nga ditët e vjeshtës, madje as në pritjen e ambasadorëve, kur Keopsi, i nxitur nga pija, foli gjëra që zakonisht nuk thuheshin nga një faraon në sy të të huajve.

Ata ende i mbante shpresa se ajo ishte një shpoti e rastit, madje nganjëherë mendonin se mos ndoshta ishte më mirë të mos ia përmendnin më, thua se kështu ai mendim do të varrosej, mirëpo, pandehma për të kundërtën ishte kaq tmerruese, saqë ditë e natë nuk mendonin veç të përgatiteshin për t'i bërë ballë.

Disa kishin shpresë te nëna mbretëreshë, e cila gjith-

ashtu s'kishte kthyer asnjë përgjigje, kurse shumica vazhdonin hulumtimet në arkiv. Sa më shumë që zhyteshin në to, aq më të vështira bëheshin ato. Një pjesë e papiruseve kishin humbur, të tjerët ishin dëmtuar, por edhe midis dosjeve të ruajtura kishte pjesë të shuara, ose të prera, shpesh me një shënim anash «me urdhër nga lart», ose pa kurrfarë shënimi.

Megjithatë, edhe pse të përgjysmuara, papiruset jepnin gjithfarë dëshmish për atë që ata kërkonin. Atje mund të gjeje pothuajse gjithçka për piramidat: varret e parë, *mastabatë*, që kishin qenë zanafilla të piramidave, historia e piramidës së parë, e së dytës, e së pestës, ndryshimet shkallë-shkallë, rritje e bazës, e lartësisë, formula sekrete e balسامimit, orvatjet për vjedhje, projekte për pengimin e tyre, dëshmi të tjera për mbartjen e gurëve, të granitit, të portave, dekrete për dekorime të kryemjeshtrave, mbeturina llogarish, dënime me vdekje, skica të pakuptueshme, ose të bëra me qëllim të tilla etj. etj.

Të gjitha këto ishin pak a shumë të qarta, ndërsa ajo që ata kërkonin më me ngulm përcpiqej t'u ikte midis papiruseve, shfaqej aty-këtu për t'u fshehur në çast, si një akrep që lëviz shumë shpejt. Ata kërkonin idenë e fshehtë të piramidës, arsyen e të qenit të saj, por ajo u rrëshqiste papushim. Fshihej sidomos në pjesët e shuara të papiruseve dhe, nëqoftëse vetonte prapë, kjo zgjaste vetëm një grimë.

Koka u dhimbe ngaqë asnjëherë nuk kishin qenë të detyruar të mendonin aq shumë. Megjithatë, ndonëse ajo që kërkonin u vidhej papushim, ata arritën dalëngadalë ta kapnin.

E biseduan gjërë e gjatë gjithçka dhe ajo që i habiti më shumë nuk ishte zbulimi që bënë, se sa fakti që ata e dinin ndërkaq atë. Ata e kishin ditur gjithmonë thelbin e çeshtjes: idenë dhe arsyen e ndërtimit të piramidës. veçse ajo rrinte në ndërgjegjen e tyre jashtë gjuhës, madje jashtë

mendimit. Papiruset e arkivit s'kishin bërë gjë tjetër veçse e kishin veshur befasi me fjalë dhe mendim.

Po kjo është fare e qartë, kishte thënë, në bisedën e tyre të fundit përpara takimit me faraonin, kryepriifti. Në e dinim thelbin e çeshtjes ndryshe nuk do të tmerroheshim kur mbreti tha fjalët që s'dua t'i kujtoj më.

Pas dy ditësh, me fytyra serioze dhe të prera nga pagjumësia iu paraqitën Keopsit. Faraoni ishte jo më pak i ngrysur. Dyshimi i tyre i fundit, mos mbreti e kishte harruar atë punë dhe ata po i frynin kot zjarrit, u davarit aty për aty. Kur kryepriifti tha fjalët: «erdhëm të bisedojmë për mendimin tuaj lidhur me piramidën», Keopsi nuk shtoi as habi, as befasi, as pyeti «çfarë?».

Ai bëri vetëm një shenjë me kokë, që donte të thoshte «po ju dëgjoj!», dhe ata nisën të flisnin, i pari kryepriifti dhe pastaj me radhë gjithë të tjerët.

Ata folën gjatë dhe lodhshëm për të gjitha ato që kishin mësuar nga papiruset, të torturuar orë e çast nga ideja se mos po flisnin më shumë ose më pak se ç'duhej. Për mendën piramidën e parë, të ngritur nga faraoni Gjoser dhe që ishte vetëm njëzetepesë këmbë e lartë, pastaj zemërimin e faraonit Horus Sekhem-Khet, që e shtroi në kamzhik arkitektin e vet, kur ai i paraqiti projektin e piramidës së tij, ngaqë iu duk e ulët. Folën pastaj për ndryshimet e projekteve të mëtejshme të bërë sidomos nga arkitekti Imhotep, për galeritë, dhomën e sarkofagut, kalimet e fshehta dhe mbylljet e tyre me blloqe graniti, për tre piramidat që ngriti faraoni Snefru, njëra prej të cilave e kishte brinjën gati pesëqind këmbë, kurse lartësinë treqind këmbë, e që mund të quhej vërtet marramendëse.

Pas çdo shifre që përmendnin prisnin që ai t'i ndërpriste duke u thënë: «e ç'më duhen mua këto», madje kaq të sigurt kishin qenë për këtë, saqë kur nuk pati ndërpreje, kryepriifti, me zë të ngjirur tha: «mbase ju do të thoni, ç'më duhen mua këto. Dhe keni të drejtë... Ndoshta këtu

nuk ju duhen, po këto nuk ishin veçse një hyrje për gjënë kryesore».

Të nxitur nga heshtja e faraonit ata folën për kryesorin më gjatë se ç'e kishin parashikuar. Pa u lajthitur aspak shpjeguan se sipas hulumtimeve të tyre ndonëse piramida ishte një varr i madh, ideja e saj fillimisht nuk kishte patur lidhje aspak me varrin dhe me vdekjen. Ajo kishte lindur veçmas, domethënë përtej tyre, dhe përqsasja me të ishte veç një rastësi.

Ishte hera e parë që fytyra e Keopsit dha një shenjë gjallërie. Ai tundi kokën dhe për gëzimin e tyre tha: çudit

Është vërtet ashtu, vazhdoi kryeprifti. Shumë gjëra në këto që do të themi ashtu ngjajnë, të çuditshme.

Ai mori frymë aq thellë, sa që mushkëritë e tij të vjetra i dhembën.

Ideja e piramidës, madhëri, lindi në një kohë krize.

Kryeprifti e dinte mirë se ç'rëndësi kishin pushimet midis frazave. Ato e theksonin peshën e hijeshinë e mendimit, njëlloj si lyerja dhe hija poshtë syve të gruas e shtonin misterin e shikimit.

Pra ishte kohë krize, vazhdoi ai paspak. Pushteti faraonik, siç dëshmojnë kronikat, ishte dobësuar. Kjo padyshim ishte ndonjë gjë e re. Papiruset e vjetra janë plot me kësisht brengash. E re ishte tjetër gjë. I ri dhe i çuditshëm, madje tejet i çuditshëm, ishte shkak i krizës. Një shkak i mbrapsht, i paparë ndonjëherë. Kriza nuk shkaktohej nga skamja, vonesa e Nilit, murtaja, siç kishte ndodhur përherë, po, përkundrazi, nga mirëqenia.

Nuk qe e lehtë të kapej menjëherë kjo. Shumë mendoje të ndritura, njerëz të afërt të faraonit, që e pikasën të parët, e paguan me kokë ose me internim zbulimin e frikshëm. Po shpjegimi që ata dhanë, se mirëqenia duke i bërë njerëzit të pavarur dhe më të lirë në shpirt, i bënte rrjedhimisht më të pabindur ndaj zyrtarëve dhe krejt pushtetit faraonik, ndonëse në krye u flak me vërejtje, dalëngadalë

nisi të pranohej. Dita-ditës për të gjithë po bëhej e qartë se kjo krizë e re ishte më e rrezikshmja e të gjithave. E paqartë mbetej një gjë: si të gjendej rrugëdalja.

Magjistari-astrolog Sobekhotep, që i dërguar prej faraonit në Saharë për të përsiatur në vetmi të plotë për këtë çështje, u kthye pas dyzetë ditësh i shfytyruar krejt si shumica e atyre që shkonin për të dhënë e për të marrë me shkretëtirën e për të sjellë kumtin e saj. Ai kumt qe më i tmerrshëm se ç'pritej: të prishej mirëqenia.

Faraoni dhe pas tij gjithë pallati ranë në mendime të thella. Të prishej mirëqenia, po si? Përmbytja, tërmeti, shterja e përkohshme e Nilit, të gjitha këto u shkuan e u stërskuan ndërmend të gjithëve, por ato s'vareshin prej tyre. Lufta? Ishte thikë me dy presa, aq më tepër në një gjendje të tillë. Po atëherë ç'të bënin? Nuk mund të rrinin duar kryq përpara kërcënimit. Duhej dëgjuar gjithsesi zëri i shkretëtirës, ndryshe rrëzimi do të ishte i pashmangshëm.

U fol se ishte mbikqyrësi i Haremit, Renferefi, që për çudi, hodhi idenë që të gjendej diçka, e cila të çonte dëm një pjesë të pasurisë së Egjiptit. Raportet e ambasadorëve në vendet e Lindjes flisnin për punimet madhështore hidraulike asyro-babilonase, përmasat e të cilave, sipas pëshpërimeve e kapërcenit përfitimin ekonomik. Nëqoftëse ishte kështu, dhe me siguri kështu ishte, le të gjente edhe Egjipti diçka që të harxhonte energjitë e tepërta të njerëzve. Të bëhej diçka e pazakonshme, e cila, sa më kolosale të ishte vetë, aq ngushtuese, zvogëluese do të ishte për egjiptianët. Me një fjalë, diçka shterruese, kapitëse për trupin e për mendjen dhe krejt e panevojshme. Ose më saktë aq e panevojshme për shtetasit, sa ç'do të ishte e domosdoshme për shtetin.

Faraonit iu bënë shumë parashtrime nga ministrat e tij: një vrimë të pafundme në tokë, në kërkim të portave të ferrit, një mur mbrojtës rreth Egjiptit, një katarakt artificial, po sado që ato mbështeteshin mbi një ide sublime,

patriotike ose mistike, ai i hodhi poshtë. Muri do të mbaronte një ditë dhe vrima në tokë mund t'i zemëronte njerëzit me pafundësinë e saj. Ai kërkonte një gjë tjetër, diçka me të cilën njerëzit të merreshin ditë e natë, të harronin vetveten. Por ndërkaq diçka që edhe të mbaronte, edhe të mos mbaronte kurrë. Shkurt, të përsëritej vazhdimisht. Dhe veç kësaj të ishte e dukshme.

Kështu dalëngadalë ai dhe ministrat e tij, siç dëshmojnë papiruset, erdhën te ideja e një varri të madh. E një stërvarri.

Faraoni ishte magjepsur nga kjo. Ngrehina kryesore e Egjiptit nuk do të ishte pra kurrfarë tempulli ose pallati mbretëror, por një varr. Dalëngadalë Egjipti do të njëjësohej me të dhe ai do të njëjësohej me Egjiptin.

Gjeometrat parashtruan shumë skica dhe forma, gjerësa erdhën më në fund te piramida.

Ajo i plotësonte të gjitha kushtet e kërkuara. Mbështetje mbi një ide sublime: faraoni dhe vdekja. Ishte e dukshme, madje që larg. Dhe e treta dhe kryesorja: ishte e mbarueshme dhe e pambarueshme. Çdo faraon do të kishte piramidën e vet, kështu që pa e marrë veten një brez njerëzor nga kapitja dhe mpirja, vinte faraoni tjetër me piramidën e vet për t'ia ulur kokën përsëri. Dhe kështu përherë dhe kështu pambarimisht, madhëri, në jetë të jetëve.

Kryepriifti Ptahhotep bëri një heshtje më të zgjatur se gjithë të tjerat.

Kështu pra përpara se të ishte për atë jetë piramida ishte për këtë jetë, faraoni im, vazhdoi ai. Me fjalë të tjera, përpara se të ishte për shpirtin, ajo ishte për trupin.

Ai heshti përsëri dhe u mbush me frymë përpara se ta ngadalësonte ritmin e së folurës

Ajo është në radhë të parë pushtet, madhëri. Ajo është shtypje, kamzhik, para. Po aq sa ç'është trulllosje e turmës, ngushtim i mendjes, vyshkje e vullnetit, monotoni dhe humbje. Ajo është roja jote më e mirë, faraoni im. Policia

e fshehtë. Ushtri. Flotë. Harem. Sa më e lartë të jetë ajo, aq më i vogël ngjan shtetasi nën hijen e saj. Dhe sa më i vogël të jetë shtetasi, aq më i lartë je ti, madhëri.

Zëri i Ptahhotepit qe ulur edhe më, sipas një sekreti që e dinte vetëm ai, se kishte raste që sa më shumë e ulje zërin, aq më qartë dhe kërcënueshëm dëgjohej.

Piramida është direku që mban pushtetin. Po lëvizti ajo, gjithçka do të shembet.

Ai bëri një lëvizje misterioze me duar; sytë i kishte të zbrazët, si të kishte përpara tyre vertet rrënoja.

As mos e mendo atë gjë, faraoni im, të ndryshosh traditën... Do të shëmbesh ti e bashkë me ty ne të gjithë.

Ptahhotepi bëri një tjetër lëvizje me duar dhe, nga mënyra si i mbylli sytë, u kuptua se nuk do të fliste më.

Të tjerët thanë pak a shumë po ato gjëra dhe me po atë ton të përzishëm. Piramida ishte, veç së tjerash, kryekujtimi i këtij vendi. Gjithçka do të mjegullohej më pas nga largësia. Do të vjetëroheshin papiruset dhe gjërat e përditshme, do të harroheshin luftërat, uria, epidemitë, vonesa e Nilit, aleancat, dekretet, skandalet e pallatit; vetëm ajo, piramida e lartë, e pambulueshme nga asgjë, e paqortueshme, e pashpërbërshme nga kurrfarë force ose rrjedhje e kohës, do të ngrihej sipër shkretëtirës. gjithmonë e njëjtë gjer në mbarim të botës. Kështu, madhëri, ka qenë e kështu duhet të mbetet. Bile as forma e saj s'ishte rastësi. Ishte një formë hyjnore, që vetë providenca ua kishte kumtuar gjeometrive të lashtë. Aty je ti, në krye, në majë, në kulm dhe në gurët pa emër që të mbajnë, njëri pas tjetrit, sup për sup, madhëri.

Sa herë që vinin te kjo pikë ata përmendnin shembjen e mundshme të gjithçkaje, dhe Keopsit i erdhi ndërmend ai mëngjes nëntori kur kishte kujtuar se pikëllimi i tyre për piramidën s'kishte qenë gjë tjetër veç shenjë servilizmi. Tani e kuptonte se s'kishte patur të drejtë dhe se dëshpërimi i tyre kishte qenë mëse i përligjur. Tani ishte i

bindur se piramida do të ishte e tyrja, njëlloj sa do të ishte e tij, në mos më tepër.

Ai ngriti dorën e djathtë për t'u bërë të ditur se nuk donte të dëgjonte më.

Me zemër të ngrirë si rrallë herë ata dëgjuan vendimin që ai ua tha me fjalë të thata dhe fare ftohtë: Piramida do të bëhej. Më e larta e të gjithave. Më madhështorja.

II

Fillimi i punimeve. Një piramidë e ka fillimin të ndryshëm nga çdo ngrëhinë tjetër.

Lajmi i ndërtimit të piramidës u shpërnda me një shpejtësi të pabesueshme, që u shpjegua dy llojesh: prej gëzimit të popullit, që mezi i kishte pritur shpalljen, ose, e kundërta, prej dëshpërimit kur gjëma e shumëpritur, që ti shpresojë se ndoshta nuk do të mbërrinte, ia behte më në fund.

Pa arritur kasnecët nëpër pjesët e ndryshme të mbretërisë lajmi ishte ndërkaq aty, i shpërndarë kudo, ashtu si rëra e lëshuar një natë më parë prej erës gjithë shqetësim.

«Faraoni Keops, dielli ynë, vendosi t'i ngarkojë popullit të Egjiptit një punë të madhe e të shenjtë, më të madhen e të gjitha punëve e më të shenjtën e të gjitha detyrave: ndërtimin e piramidës së tij.»

Daullet binin kështu katund më katund dhe pa u larguar mirë zërat e kasnecëve, zyrtarët e zonës mbledheshin kokë më kokë, për të vendosur ç'do të bënin me nismë të tyre gjersa të mbërrinin udhëzimet nga qendra. Në fytyrat kishin një si lyrë ngazëllimi dhe fjalët, më në fund, sikur ta dinim, o zot, sikur ta dinim, më në fund ia arritëm kësaj

dite, i përsëritnin tek largoheshin nga sheshi kryesor për në banesat e tyre. Menjëherë në ecjen e tyre rrekej të hynte një ritëm tjetër, dhe në lëvizjet e duarve gjithashtu dhe në mbajtjen e qafës. Ca si deje të fshëta u tendoseshin nëpër trup dhe grushtet u mblidheshin vetvetiu. Piramida hyri aq shpejt në jetën e tyre saqë nuk u desh veçse kalimi i pak ditëve që ata të psherëtinin; zot, si jetonim pa të.

Ndërkaq, pa pritur mbërritjen e udhëzimeve nga kryeqyteti, ata bënë atë që kishin bërë paraardhësit e tyre në vitet e kaluara me piramidat e mëparshme: të shtypnin të pakënaqurit. Mendimi se ishin me mijëra ata që në vend që të lumturoheshin nga lajmi, binin në zi dhe rënkonin: zot, filloi prapë!, i tërbonte.

Kujtuat se shpëtuat, hë? Kujtuat se gjithçka do të ndryshojë, se piramida s'do të ketë dhe ju do të bëni ç'të doni, he? Na tani, uleni kokën, uluri!

Ndërsa në qendër grupi i arkitektëve, i astrologëve e i mjeshtrave të ndryshëm nën kryesinë e Ptahhotepit paralelisht me projektin e piramidës, punonin ditë e natë për projektin e udhëve prej nga do të vinin materialet, punishtet e kamzhikëve ishin të parat, që pa pritur kurrfarë porosie nga shteti, dyfishuan, në kokë të tyre, prodhimin.

U prit të ndëshkoheshin për hapje paniku, mirëpo jo vetëm që s'pati ndëshkim, por u fol për një letër të fshehtë, të ardhur drejt e nga kryeqyteti, ku lavdëroheshin se ishin njerëz që e kuptonin drejt kohën.

Në gjithë Egjiptin nuk flitej veçse për piramidën dhe gjithçka, çdo njeri e çdo ngjarje vihej vetvetiu në një lidhje me të.

Përherë e më tepër bëhej e qartë se thënia që shtrimi i udhëve për një piramidë kërkonte afërsisht dhjetë vjet, kishte një kuptim të dyfishtë. Në të vërtetë të shtrimi i udhëve futej veç hapjes vërtetë të tyre edhe përgatitja e gjindjes për veprën e madhe, mbajtja gjallë e përndezjes, lufta kundër squlljes, fjalëve plot helm e gjer të shtypja e sabotimit.

Po aq e qartë bëhej për të gjithë se ndonëse asgjëkund nuk dukej ende ndonjë pluhur ndërtimi, piramida ndërkaq kishte filluar.

Në pallatin e tij Keopsi, pasi kishte parë skicat e para të veprës, orientimin, përmasat dhe hollësira të tjera, qe kujtuar përsëri për bisedën e dikurshme të mëngjesit dhe kishte dhënë urdhër që të shfaroseshin të gjitha ato papiruse ku gjendej, qoftë edhe turbull, kuptimi i vërtetë i piramidës. Pas kësaj, kishte thënë se kushdo nga të pranishmit që do të pëshpëriste qoftë edhe gjysmë fjale për këtë, do të linte kokën.

Hapja e udhëve nisi si përherë në rajone të ndryshme në të njëjtën kohë. Udhët e vjetra të piramidave të mëparshme ishin zhdukur prej kohësh. Mezi u dukeshin gjurmët aty-këtu, si ca shenja plagësh të mbyllura kah mot. Por edhe sikur të ishin ende, vështirë se do të hynin në punë për piramidën e re. Secila piramidë kishte patur udhët e saj, një pjesë e të cilave vareshin nga gjendja e guroreve të dikurshme si edhe nga guroret e reja, që do të hapeshin, nga graniti që do të përdorej, i Asuanit apo i Hatnubit, nga zgjedhja e alabastrit dhe e bazaltit për veshjet e brendshme ose të majës së piramidës, piramidionit, si dhe vendimi se prej çkaje do të bëhej sarkofagu: prej guri, graniti të kuq apo bazalti. Materialet e vjetra që do të vinin të gatshme si kollonat, pllakat blokuese, portat granitike bashkë me piedestalet e pllakat me tekste të gdhendura mund të silleshin nëpër po ato udhë, po mund të kërkonin edhe udhë të tjera, gjithçka varej nga vendi ku do të punoheshin.

Po ndonëse të gjitha këto ishin pjesa më e zgjedhur e fine e piramidës. kryesorja mbeteshin gjithmonë gurët. Nxjerrja dhe sidomos mbartja e tyre ua nxirrnin gjumin

dhjetëra zyrtarëve që drejtonin punimet. Të nervozuar nga që ishin të detyruar t'ia kushtonin energjitë kryesore morisë së pafundme anonime, ata rrinin megjilhatë ditë e natë të tëra mbi skicat dhe llogaritjet e ndryshme që s'kishin fund.

Nuk ishte vetëm puna të përllogaritej saktë numri i gurëve që do të duheshin, as koha mesatare që kërkonte secili gur për t'u prerë prej gurores dhe për t'u ngarkuar. Pas ngarkimit ishte udha dhe këtu gjithçka ndërlikohej. Meqenëse në mbartjen e gurëve, si edhe të materialeve të tjera, ishin të detyruar të shfrytëzonin Nilin, të gjitha projektet e udhëve duhej të bëheshin në varësi të vërshimit ose të tij. Ishin rrekur edhe më parë që për të qenë të sigurtë të mos e futnin Nilin në këtë punë, po llogaritjet tregonin se kjo e dyfishonte, për të mos thënë e trifishonte kohën e mbartjes, kështu që, (ule zërin sa më shumë), faraoni mund të vdiste me varr të pambaruar.

Si në gjithçka Nili ishte i domosdoshëm. Mirëpo një llogaritje goje ishte të parashikoje se gjer në ç'vend mund të vijnë trapet e ngarkuar me gurë ose granit një stinë e gjer në ç'vend stinën tjetër. Parashikimet duheshin bërë për të gjitha rastet, e sidomos kur qe fjala për udhët e largëta që shkonin gjer në Deir-el-Medineh, madje dhe më larg, gjer në Nubi.

Të zhytur kokë e këmbë në këto, zyrtarët dhe mjeshtrit që merreshin me mbartjen e materialeve kujtonin me të drejtë se barrën kryesore të piramidës e kishin ata dhe po të thoshte dikush se grupe të tjera e bënë natën ditë ndërkaq për piramidën, si p.sh. projektuesit që ende s'kishin zgjidhur qeshtje të ndryshme si pjerrësia ose orientimi sipas yjeve, apo grupi i punimeve të brendshme e i gdhendësve, ata do të qeshnin me mllef: Punë zonjushash, filozofime dhe dantella. Piramida është këtu, ku të ha pluhuri e vapa dhe vdekja të përgjon në çdo hap. Mirëpo të njëjtën qeshje ironike do të kishin për ta arkitektët projektues, e sidomos grupi që merrej me pjesët e brendshme misterioze, që të zhytur në

skicat e galerive, kalimeve e portave të fshehta, e kishin harruar fare që mbartësit e kishin mbuluar ndërkaq me pluhur gjysmën e Egjiptit: punë vulgare hamejsh!

Ishte ndoshta vetë natyra e punës që bënte që secill grup të mendonte se ai ishte kryesori. Ja, arkitektët që merreshin me përcaktimin e orientimit dhe për të cilën shprehja «e bëjnë natën ditë» s'kishte vetëm kuptim simbolik, ngaqë një pjesë të kohës ata punonin vërtet natën, kur vinin në truallin ku do të ngrihej piramida, jo pa një farë përbuzje shikonin niveluesit. Ndonëse që vërtetuar përfundimisht se për të shmangur çdo gabim orientimi i saktë duhet të bëhej vetëm me një yll të palëvizshëm, psh me një yll të Arushës së Madhe dhe kurrsesi me yllin polar, ata prapë vinin pothuajse çdo mbrëmje te trualli pikërisht në kohën kur niveluesit mblidhnin veglat. Eh, mendonin këta të fundit, të merresh me yjet është punë e pastër vërtet. Ylli as të shpif, as të kallëzon. Kurse kjo këtu, (dhe i binin tokës), eja merru vesh me këtë këtu, kur të vijë kontrolli përfundimtar. Dy gisht të jetë më lart ose më poshtë se niveli që duhet të ikën koka.

Sa për rrezikun e ikjes së kokës ishte një tjetër grup që kishte të drejtë të qahet më fort. Ai që merrej me projektimin e kthinave të brendshme të piramidës: hyrjet dhe daljet e fshehta, mënyrën e bllokimit me granit të dhomës së sarkofagut, si dhe porta kallpe për çorientimin e grabitësve. Qysh në kohën e piramidave të para dihej se asnjë nga pjesëtarët e këtij grupi nuk mbetej gjallë për shumë kohë. Gjendeshin gjithfarë shkaqesh për dënimin dhe zhdukjen e tyre, po të gjithë e dinin shkakun e vërtetë: e fshehta duhet të varrosej bashkë me ta.

Akoma më në fshehtësi punonin njerëzit e magjistarit Horemheb së bashku me astrologët. Merreshin me diçka që jo vetëm s'e dinte, po as nuk e merrte dot me mend askush, ndoshta as ata vetë, po t'i pyesje në befasi. Flitej se kishte lidhje me shifra misterioze, që të vëna në raport me orienti-

min e piramidës, shenjëzat qiellore dhe të dhënat e tjera kalendarike do të mund të jepnin kurstin e fshehtë e të përsëritshëm që piramida do të ndrynte brenda saj në jetë të jetëve.

I vetmi grup që dukej se punonte disi mënjanë rreziqeve ishte ai që merrej me piramidën e vogël, satelite, atë që do të ishte për ka-në e faraonit, pra për djizimin e tij. Duke mos patur sarkofag e dhoma ushqimesh e orendish ajo nuk kishte as hyrje e as dalje të fshehta, kështu që të çliruar nga mjegulla e sekretit, pjesëtarët e saj punonin tërë gazmend. Po kjo ndodhi vetëm në fillim. Shumë shpejt ata e kuptuan se zilia me të cilën nisën të rrethoheshin ishte po aq e keqe, në mos më shumë, se rreziqet që vinin prej sekretit, kështu që dalëngadalë u zymtuan edhe ata njëlloj si të tjerët

Merrej me mend që hijen më të rëndë e kishte grupi qendror, ai që kryesohej nga Ptahhotepi dhe që drejtonte e kishte në urdhër gjithçka. Ditë e natë atje hynin e dilnin korrierët që çonin udhëzime e binin lajme nga të gjitha skutat e mbretërisë. Biseda e piramidës bëhej kudo në Egjipt, por ajo vetë ende nuk shfaqej, aq sa dukej se do të vinte një çast që njerëzit nuk do të besonin nëse vërtet po ndërtohej një piramidë dhe se gjithë kjo s'ishte veçse zhurmë e kotë dhe pluhur.

Nganjëherë dukej se piramida ishte mbjellë nën tokë e s'dihej kur do të dilte në sipërfaqe, dhe stërmundimi prej saj ishte qysh tani kaq i madh, sa që të vinte të besoje se toka vuante e kështu do të lëngonte e ndoshta do të trandej nga tërmetet, nëqoftëse nuk e pillte me kohë.

I vetmi vend ku me sa dukej dihej me saktësi si shkonte puna ishte shtabi i Ptahhotehut. Si ata që shikojnë hijen e pavërejtur prej të tjerëve, ata ishin në gjendje, që midis rrëmujs dhe pluhurit, të kapnin qysh tani spikamën e piramidës.

Një herë në javë, në një takim kokë më kokë, kryepifti i raportonte faraonit vetë si shkonte puna. Dhe sikur të

mos mjaftonin telashet e pafundme ndodhi që pikërisht atje, në qendër, të zbuloheshin edhe komploti i parë, që tonditi mbarë të dy Egjiptet, të poshtmin e të lartmin.

Gjithçka nisi si rastësisht nga një gjë në dukje e zakonshme: një bllok bazalti i harruar gjoja rastësisht në shkretëtirën e Saharës. Mirëpo ishin net me hënë të plotë dhe bazalti jepte ndriçime të frikshme në një drejtim që s'duhej. Siç doli më pas, kështu dhe që llogaritur, që të merrte e të jepte vezullime të mbrapshta, në mënyrë që kur të ndryhej brenda piramidës, të keqen ta ndillte aty.

U dyshua qysh në fillim për magjistarin Horemheb, po ndërsa ky priste arrestimin, përfundoi në pranga veziri i hambarëve, Sahathori. Po ky nuk që veçse fillimi. Njëri pas tjetrit ranë në burg këshilltarët Seth dhe Dudumesju, fill pas tyre ai që më pak se kushdo dukej se s'mund të kishte lidhje me këtë punë, mbikqyrësi i haremit, Reneferefi. Megjithatë vetëm kur u arrestuan ministrat Antef dhe Mineptah u kuptua se nuk ishte fjala thjesht për një grup sabotatorësh, po për një komplot të vërtetë kundër shtetit, nga ata që kishte kohë pa u zbuluar.

Gjithë vendi u drodh nga tmerri. I pakënaqur me hetimet, Keopsi kërkoi që t'i zbuloheshin degëzimet e komplotit gjithkund. U dërguan hetues e spiunë anëmbanë Egjiptit, madje edhe jashtë kufinjve, sidomos në mbretërinë armike të Hittiteve, me të cilën komplotistët dyshohej se ishin në lidhje.

Një kohë të gjatë u duk se u harrua e u la mënjanë çdo gjë tjetër, ngaqë të gjithë merreshin me komplotin. Egjiptin e tërë do ta kthej përmbys, gjersa t'ia zbuloj rrënjët, kishte deklaruar Keopsi. Burgjet e hetuesisë dhe dhomat e torturave ishin plot. Dënimet e para, sharrimet e gjalla dhe shtypjet me gurë nëpër sheshe kishin nisur ndërkaq. Dëshët të sabotonit piramidën, hë? ulërinin fanatikët që nuk ngopeshin së pari grumbujt e gurëve nën të cilët i dënuari tepete shpirt. Nganjëherë ato u ngjanin vërtet piramidave të

vogla, çka jepte shkas për tallje të hidhura, sidomos kur nga dridhjet e fundit të vdekëtarit ndonjë gur lëvizte aty-këtu.

Po shumica e gjindjes ishte në ankth. Me mijëra prisnin arrestimin, ndërsa të tjerë kërkonin të shkonin në gurorë ose në shtrimin e udhëve. Kishin gjetur gjithfarë mënyrash për t'iu shmangur kësaj sëmundjeje, arsye familjare etj. kurse tani nisëshin pa bërë zë, me shpresa se atje, midis vapës dhe humbëtirës do të harroheshin. Dhe vërtet, pak kohë më pas pluhuri, djersa dhe frika ua ndryshonin kaq shumë fytyrat sa që edhe hetuesit vetë kishte mundësi të mos i njihnin më.

S'dihej sa do të vazhdonte ky makth, sikur të mos ndërhynte Keopsi vetë. Do të bëjmë piramidë, apo jo? Kështu flitej se i kishte thënë Ptahhotepit një mëngjes të ftohtë. Përmendej dhe përgjigjja e këtij të fundit: «po kjo është pjesë e piramidës, madhëri,», fjalë që tingëllonin si të shpikura më pas.

Një gjë ishte e vërtetë: vrulli i dënimeve e i zhbirimit të komplotit ra papritur dhe vëmendja u përqendrua prapë te piramida. Ceremonia e dekorimit të kryepriftit Ptahhotep, ceremoni që vërtetoi përfundimisht pëshpërimën se ishte ai që e kishte zbuluar komplotin, ishte edhe shenja e një lloj zbutje dhe orientimi të ri.

Fill pas kësaj punimet për piramidën u rigjallëruan si asnjëherë në të gjithë sektorët. Një ccejake e ethshme e një rrëmujë e pafund i përfshiu të gjithë. Reja e pluhurit rrinte pezull mbi rrafshin sipër të cilit punonin niveluesit, te kazemat që po ngriheshin me shpejtësi për strehimin e njëqind mijë njerëzve dhe sidomos te sheshet ku nisën të mbërrinin gurët e parë.

Ndihej se koha e fillimit të piramidës po afrohej. Tani pluhuri dhe vapa në vend që t'i molisnin njerëzit dukej se shtonin një lloj përndezejeje. Veç ai ankth të na hiqet, thoshnin me njëri-tjetrin, pa të gjitha durohen. Dhe ndërsa i ki-

shin zemrat plot mirënjohje ngashëryese për faraonin shpëtimtar, venin e vinin si në ethe, bënë më shumë rrëmuje e ngrinin më shumë rorë se ç'duhej të bindur se kështu, midis mishmashit dhe pluhurit, edhe e keqja do të hutohej e do të humbte rrugën.

Po shpresat nuk vazhduan gjatë. Shi në prag të vendosjes së gurit të parë u zbulua përbetimi tjetër, më i rrezikshëm se i pari.

Këtë herë ishte kryepriifti Ptahhotep që për befasimin e të gjithëve ra në fatkeqësi. Pas tij shefi i policisë së fshehtë, Ugaf, me vezirin e punëve të jashtme. Pas tyre një turmë zyrtarësh të tjerë. Emrat e të arrestuarve merreshin vesh çdo mëngjes me një drithërimë tmerri. Ndërkaq pritëshin arrestime të reja, madje tani që Ptahhotepi i paprekshëm kishte rënë, gjithkujt i dukej normale rënia e çdokujt.

Një farë kohe të afërmit e të dënuarve të përbetimit të parë u gjallëruan ngaqë kujtuan se dënimi i Ptahhotepit do të shoqërohej me faljen e tyre, por shumë shpejt u mor vesh se kjo nuk do të ndodhte kurrsesi. Në një mbledhje të rëndësishme një zëdhënës i faraonit kishte shpjeguar se ndonëse Ptahhotepi kishte denoncuar komplotin e parë, kjo s'do të thoshte aspak se ai komplot kishte qenë i paqenë. Ptahhotepi kishte qenë në dijeni prej kohësh për komplotin e parë, por e kishte zbuluar atë në një kohë që i qe dukur e përshtatshme për t'i hedhur hi syve të faraonit dhe për të larguar çdo dyshim të mundshëm prej komplotit të vet, që ishte më i kobshmi i të gjithëve.

Javë të tëra vazhdoi zhbirimi i përbetimit të ri. Shpesh ndodhte që emrat e të arrestuarve të ardhshëm përfliteshin qysh më parë çka e shtonte edhe më shumë ndjesinë e përgjithshme të ankthit. Për çudi bashkë me të njerëzit provonin një lloj kënaqësie djegëse të mbrapshtë. Me shpirtrat të bërë si shollë e lagur nga një squllje ngashërimi të sëmure njerëzit flisnin si në delir, dënonin armiqtë e shtetit me një lloj dehjeje të singertë, që edhe vetë nuk e kuptonin

nga u vinte, dhe po aq sinqerisht i përgjëroheshin faraonit sovran.

Ndërkaq pëshpërma nga më të habitshmet nisën të përhapen për piramidën. Disa ua hidhnin fajin komplotistëve që punimet ishin zgjatur kaq shumë pa asnjë përfundim. Të tjerë thoshin se projekti qysh në fillim ishte bërë i gabuar, natyrisht me qëllim dhe kushedi sa kohë do të duhej për qortimin e tij. Pati dhe zëra të tjerë që ngulnin këmbë se gjithçka ishte bërë mbrapsht: zgjedhja e truallit, skicat, shtrimi i udhëve, madje dhe hapja e gurorëve, kështu që piramida s'do të bëhej kurrë. Mirëpo këta të fundit, pas disa dënimeve, e mbyllën gojën shpejt. Piramidën nuk kishte asnjë forcë ta ndalte. Kështu u tha në një mbledhje tjetër të rëndësishme. Komplotistët qenë përpjekur vërtet ta dëmtounin atë, po dëmtimi i tyre s'mund të ishte gjer në atë shkallë që të rrezikonte ndërtimin. Syrit të Keopsit nuk mund t'i shpëtonte asgjë, kështu që komplotistët, sado të djallëzuar të ishin, nuk mund të guxonin për devijime trashanike.

Të topitur përfundimisht pas një heqje shprese të fundit, që ndonëse tepër e turbullt, i kishte gjallëruar përkohësisht, njerëzit u kthyen në vendet e punës për të harruar, midis duhmës së vapës e të pluhurit, gjithçka.

Një mishmash e katrahurë e fundit mbështolli krejt rrafshin e madh. Thuhej se dita e fillimit që fare pranë, por askush s'dinte asgjë më tepër. Një mëngjes u vunë në kryq katër nivelues, (s'mbahej mend asnjë piramidë ku të mos dënoheshin niveluesit), pastaj, befas mëngjesi tjetër gdhui nën gjëmimin e daulleve, çka tregonte se dita e përrurimit, më në fund, kishte mbërritur.

Në ceremoni erdhi vetë Keopsi. Për një pjesë të ministrave dhe të obortarëve të rinj kjo ishte paraqitja e parë në publik. Në krye, me fytyrë të bardhë që ia shtonte ngrirjen, ecte kryepriifti Sethakt, që kishte zëvendësuar Ptahhotepin. Ambasadorët e huaj, si dhe të ituarit e tjerë që rrinin

nga të dyja anët e futores së përkohshme prej druri. të ngritur enkas për kremtimin, zgjatnin kokat tërë kureshtje për të parë faraonin. Një turmë tjetër të ftuarish, që rrinin më pas pas një gardhi të dytë rojesh, lëviznin si një ujanë e paqetë. Ngaqë ishin mjaft larg nga faltorja, bënë më shumë zhurmë se ç'pritej. përfllitnin ljerjen e tepërt të leshrave të ministrave të rinj, ose ndërronin të rejat e fundit, shumica e të cilave lidheshin me piramidën. Thuhej se kur ia kishin çuar ftesën shkruesit plak Ipuur, ai pasi e kishte marrë vesh se në ç'përrurim e ftonin paskish klithur: Piramida? Ende s'ka mbaruar ajo?

Ndonëse e tregonin si një çudi, aty për aty rrinin një grimë të mpirë dhe me siguri gjithkush e ndjente se fjalët e plakut s'ishin dhe aq të pazakonta. Shumëkush kishte patur çaste, kur i qe dukur se piramida ishte ngritur ndërkaq, në mos krejt, pjesa kryesore e saj. E kishin prej kohësh mbi supe, madje më thellë, brenda vetes dhe sikur dikush që nga faltorja të shpallte se kjo që po niste të ndërtohej sot, në sytë e tyre, nuk ishte piramida vetë, po dyzimi, shëmbëlltyra e saj, fjalët s'do të tingëllonin dhe aq të pabesueshme.

III

Kronikë e përditshme. Krahu i djathtë, brinja perëndimore

Vendosja e gurit të njëmbëdhjetëmijtetreqindeshtatëdhjetekatërt u krye në hënë e dytë pas eklipsit. Koha e vendosjes ishte pak më e gjatë se e gurit të mëparshëm, po pati më pak vdekje. Si të shpejtonte të plotësonte vdekjet që la mangut paraardhësi, guri i njëmbëdhjetëmijtetreqindeshtatëdhjetëpestë bëri kërdrinë te bartësit. Vdiqën njëri pas

tjetrit pa shkak muratorët Mumba, Ru, Thutset dhe nëntë skillevër të tjerë pa emër, i ra pika grekut Astiks, u shtypën nga një anim i papritur i gurit gjithë libianët e ndërresës së dytë, si dhe vëllezërit Tur-Tur, gjithsej katërmbëdhjetë veta. Kur guri kishte zënë vend dhe u duk se seria e vdekjeve qe mbyllur, vdiqën ndihmës-mjeshtri bashkë me tre skalitës nga Nubia. Kishin mbetur të shtrirë mbi gur, ashtu siç bëjnë njerëzit kur duan të pushojnë pak. Është u kuptua që kishin mbaruar vetëm kur u afrua mbikqyrësi me kërbac në dorë, me sa duket, për t'i rëndëshkuar për pushimin e gjatë. Guri i njëmbëdhjetëmijtetreqindeshtatëdhjetegjashtë megjithë shpresën, shpeshherë të kotë, për një pakësim të vdekjeve pas një kërdie të saponododhur, ishte po aq i prapë sa paraardhësi dhe çoi në atë botë përafërsisht po kaq shpirtra. Më i qetë qëlloi guri i njëmbëdhjetëmijtetreqindeshtatëdhjeteshtatë, gjatë vendosjes së të cilit numri i vdekjeve nuk e kaloi numrin e gishtave të këmbës e të dorës. Gurët e njëmbëdhjetëmijtetëreqindeshtatëdhjetetë, e njëmbëdhjetëmijtetreqindeshtatëdhjetenëntë dhe e njëmbëdhjetëmijtetreqindetëdhjetë mund të thuhet se ishin të zakonshëm për nga ngjarjet dhe vdekjet. Me përjashtim të shkarkimit dhe dërgimit në gurore të mieshtrit Unas, sepse lejoi që këmbët e prera të dy skalitësve që guri i zuri nën vetë gjatë vendosjes, të mbeteshin aty ku u shtypën, me shpresën e marrë se kjo do t'i shpëtonte syrit të mbikqyrësit, pra me përjashtim të masakrimit të tij, nuk ndodhi ndonjë gjë për t'u mbajtur mend. Vdiqën afërsishti aq njerëz sa ç'pritej dhe për po ato shkaqe të zakonshme që ndërpresin jetën njerëzore. Sa për këmbët e muruara të të dy fatkeqëve, (trupat pa jetë të tyre ishin harruar ndërkaj nën dhë), u desh të kryhej një punë e mundimshme për të ngritur pakëz gurin e për t'i nxjerrë copa-copa me ndihmën e kanxhave të gjata. Mjeshtri i porsaemëruar që mbikqyrte këtë punë u shpjegoi ndihmësve se mbetja e gjymtyrëve të njeriut midis dy gurore mund të linte pas tretjes së gjymtyrëve një boshllëk

prej të cilit mund të shkaktohej një lëkundje, e cila sa do e pavërejtje të dukej, ishte e palejueshme në strukturën madhështore të piramidës. Si i ndjekur nga një duhmë sëmundjeje erdhi guri i njëmbëdhjetëmijetreqindetetëdhjetenëntë. U fol se njerëzit në guroren e largët ia kishin ngjitur sëmundjen dhe ashtu dunej të ishte vërtet, sepse kushdo që e prekte mbushej sakaq me puçrra të frikshme. Me padurim u prit guri i njëmbëdhjetëmijetreqindetetëdhjetëedytë, që duke u vendosur përbri dukej se do t'i vinte njëfarë kufiri flamës së tjetrit. Mirëpo ky që një qetësim i vogël, sepse pjesa më e madhe e gurit të molepsur mbetej e zbuluar. Përveç vdekjeve nga lëngata e mësipërme vdiqën te ky gur, njëri pas tjetrit, ilirët Teut e Bardhyl, të dy flokëverdhë, i pari prej kafshimit të akrepit, i dyti prej dëshpërimit. Po te ky gur ndodhi vrasja, që ishte vërtet misterioze, e babilonasit Supiluliuma prej një skllavi pa emër. Ky i fundit për ca kohë e fshehu shkakun e vrasjes, gjersa e nxori një natë vere dhe pikërisht atëherë kur iu ndërpre në torturat. Ngasja që e kishte çuar në vrasje kishte qenë emri i babilonasit, të cilin, skllavi, si i paemër që ish, ia lakmonte prej kohësh. Duke kujtuar se s'kishte mënyrë tjetër për të gjetur një emër e për t'u thirrur me të veç duke ia marrë një tjetri, madje pa e lënë të gjallë, (mendja me sa dukej i thoshte se vetëm kështu mund të merrej emri), e vdiq tjetrin dhe bashkë me të mori më qafë veten. Me të vërtetë ngatërresa, grindja, madje edhe tregti me emrat kishin ndodhur edhe më parë, midis atyre që i kishin dhe të paemërve, të cilët emri i trondiste, ua prishte drejtpeshimin shpirtëror, i linte pa gjumë më keq se guri i çmuar kopracin, megjithatë puna s'kishte shkuar asnjëherë gjer në vrasje, veç në kishte ndodhur ndonjë e tillë dikur përpara gurit të dhjetëmijtë, ndoshta më thellë. Sado që për të shmangur ngatërresat ishte ndaluar rreptësisht shitja e emrave, huazimi ose lënia si trashëgimi pas vdekjes, fshehtazi vazhdonin të gjitha këto. Mbërritja e gurit të njëmbëdhjetëmijetreqin-

qindetetëdhjetetë e zbehu dhe e ishiu kujtimin e vrasjes. Ishte tamam në kohën e këtij guri që pati çmendje më shumë se çdo herë tjetër deri në fillim pas çmendjeve vdekje nga pika e diellit. Thuhej se kështu kishte ndodhur edhe kohë më parë, gjatë vendosjes së gurit të dhjetëmijëntëqindëntëdhjetëntë, gur i cili do të mbahej mend gjatë, ngaqë ishte një nga më të rrallët që plasi nga vapa e jashtëzakonshme. U mor në fillim si çmenduri, po doli se s'ishte aspak e tillë (dhe kjo për fat të keq të rrezikziut thebanit Siptah), kur ky i fundit, nisi të bënte vizatime në rërë duke u përpjekur të kuptonte përmasat e asaj që po ngrinin. Ia thyen kockat me mokra, siç bëhej zakonisht me ata që bënin pyetje të pavend. Guri i njëmbëdhjetëmijëtetreqindetetëdhjetekatërt ishte ende larg në shkretëtirën e përvëluar kur mbërriti thashethemja ogurzezë për të: ai bashkë me gjashtë gurët e tjerë që vinin pas, pra gjithsej shtatë gurë, ishin orëliq. Ishte damari i gurores ku qenë prerë i tillë, domethënë i keq, apo ashtu kishin qëlluar vetë, këtë s'mund ta thoshte askush. Sa më tepër që bartësit po i afroni, (ata vetë e kishin mbledhur mendjen, e quanin veten të humbur, ndaj dhe pothuajse ishin çliruar tashmë nga frika, ngaqë çdo ditë që kalonte e quanin dhuratë), pra sa më shumë që gurët afroreshin, aq më e thatë, mbytëse dhe pa rrugëdalje bëhej angushtia. Ata që i kishin parë (gjendeshin përherë udhëtarë apo korrierë që për shkaqe të ndryshme venin e vinin nëpër shkreti), pra ata që iu kishte rënë rasti t'i shihnin thoshnin se gurët, në pamje të parë, dukeshin të zakonshëm, përveç ca si damarëve vërtet të errët që i përshkonin, të ngjashëm me shenjën që njeriu mund të ketë në ballë dhe që vetvetiu i jep një pamje më kërcënuese fytyrës së tij. Në të vërtetë si përherë, kur pritja e diçkaje të mynxyrshme zgjat shumë, ndaj dhe kur mbërrin ajo vetë s'duket aq e tmerrshme sa ç'është përfytyruar, mbërritja e gurëve u solli një farë lehtësime të gjithëve. Pati vdekje vërtet, madje më shumë se në gurët përpara tyre, por

ishte ligështimi i shkaktuar prej pritjes ndoshta, se sa vetë prania e gurëve, që shpeshtoi kosën e mortjes. Kështu u fol megjithëse askush s'mund ta dinte të vërtetën, sepse askush s'mund ta dijë kurrë nëse e keqja që shoqëron një send i rri atij sendi ngjitur, i vjen pas apo rend përpara tij si qentë e gjahut. Guri i njëmbëdhjetetreqindenëntëdhjetenjë, që pritej të sillte qetësinë, meqenëse seria e gurëve me damar të errët kishte mbaruar, nuk solli veç një topitje midis së cilës vdiqën heshtazi si mizat shumë skllëvër, pjesa më e madhe të paemër. Ishte duke u vendosur guri i njëmbëdhjetëmijetreqindenëntëdhjetedytë, kur erdhi kryeinspektori i piramidës që e rrahu me kamzhik përpara të gjithëve mbikqyrësin e brinjës perëndimore. Përparimi i ngadaltë i punimeve thuhej se ishte shkak i kësaj rrahjeje që e çoi në varr para kohe mbikqyrësin. Shpejt u mor vesh se rrahje të tilla qenë bërë edhe në tre brinjët e tjera, në guroret e mëdha si edhe në të katër rrugët e shkretëtirës, prej nga vinin karvanet që sillnin gurët. Merret me mend se këto ndërkime do të shpejtonin si mbërritjen e gurëve, si vendosjen e tyre, dhe ashtu ndodhi vërtet. Por ajo që nuk u parashikua dot ishte pëshpërima ogurzezë që u shkaktua pikërisht nga shpejtimi i punimeve. Dhe ajo ishte vërtet më e zeza dhe më e fundbotshmja e të gjithave. U hap pra fjala se gjithë ky shpejtim i etshëm i punimeve, ky padurim pra për të mbaruar varrin mbretëror, nuk tregonte gjë tjetër veçse atë që shteti ishte përpjekur ta mbante të fshehtë gjer tani: sëmundjen e faraonit. U ndërморën veprime nga më të ndryshmet, që nga më të thjeshtat: dënimet me vdekje, mbytjet, torturat e gjer te dërgimi i kasnecëve kudo për të përgënjeshtuar thashethemin, por ai, si zakonisht në kësi ndërhyrjesh, në vend të fashitej, gufmohej edhe më. Gjatë vendosjes së gurëve të njëmbëdhjetëmijetreqindenëntëdhjetetretë dhe të njëmbëdhjetëmijetreqindenëntëdhjetekatër u krijua vërtet një gjendje e pazakonshme. Njerëzit nuk dinin ç'të bënin: të shpejtonin pu-

nimet në kohën kur një zell i tepruar për këtë mund të merrej si përpjekje për të nxitur pëshpërimën, apo të tregoheshin mospërfillës, megjithëse shenjat e kamzhikëve e torturave, të shkaktuara pikërisht prej mospërfilljes, i kishin ende në trup. Disa mendonin se ishte më mirë të vazhdonin punën sikur s'kishin dëgjuar asgjë e disa të tjerë përkundrazi mendonin se nga dy të këqijat ngadalësimi i punimeve ishte më pak i rrezikshmi. Me sa duket shumica i dha të drejtë këtyre të fundit, sepse kudo u ndie një molisje e përgjithshme. Lëvizja e gurëve nëpër shkretëtirë ditë pas dite u ngadalësua, po ashtu vendosja e tyre. Të ngadalta u bënë lëvizjet e ndërtesve dhe jo vetëm lëvizjet që kishin lidhje me punën, po lëvizjet e gjymtyrëve përgjithësisht, madje edhe kthimi i kokës, e folura, e gjer te frymëmarrja. Kaq e dukshme ishte kjo saqë nganjëherë ngjante se moria e pafundme e njerëzve bëhej gati për të rënë në gjumë. Guri i njëmbëdhjetëmijetëreqindentëdhjetepesë dhe tjetri që erdhi pas tij këshu dhe do të kujtoheshin, si gurët e qetimit. Mjeshtrit dhe mbikqyrësit e vinin re padyshim, hanin veten përbrenda, por askush s'guxonte të ngrinte kamzhikun për të kërkuar shpejtim, pa rrezikuar që ai kamzhik të kthehej kundër tij. Kështu vazhdonte gjendja e përgjumshme, në kundërshtim me të cilën, brendapërbrenda, njerëzit ishin të shqetësuar. Flitej shumë si asnjëherë tjetër për piramidën në përgjithësi, për madhësinë, formën e saj, sasinë e pafundme të gurëve që do të kërkonte. Ishte e vështirë ta kuptoje nëse këto gjëra u përhapën prej pëshpërimës së përgjithshme që i vinte vërdallë si erë e nxehtë të katër brinjëve të saj, apo diheshin qysh më parë dhe, nga stërmundimi i punës, vapa dhe frika e ndërshtimit, ishin aq shumë të topitura në ndërgjegjet e njerëzve, saqë ngjanin si të paqena. Që ata dhjetëra, mijëra njerëz do ta shkonin tërë jetën duke ndërtuar një varr, këtë e dinte i madh e i vogël, brenda dhe jashtë Egjiptit, megjithatë kjo nuk ishte shprehur kurrë me fjalë, e aq më tepër me fjalë të zvergura prej melodisë, që bënë përshtypje të

dyfishtë po t'i dëgjoje: «do ta ngrys jetën duke ngritur një varr, eh, nëna ime» etj, etj. Të tjerë bënë pyetjet gjithë kureshtje: e ç'do të bëhet pas mbarimit të piramidës? pyetje së cilës dikush iu përgjigjej: «ç'të duhet ty, or qyq, ç'do të bëhet pas saj, ti s'do të jesh më në këtë botë», e dikush tjetër shpjegonte se pas kësaj piramide do të bëhej piramida tjetër, për djalin e faraonit, e pastaj tjetra për djalin e djalit, e kështu me radhë, e kështu gjithmonë, në jetë të jetëve. Përfytyrimi i jetës si një varg i pambarim piramidash zgjonte te shumica një dëshpërim lodhës, kurse te disa më të paktë një mllef të turbullt. Ishte ndoshta ky i fundit që më shumë se ngadalësimi i punimeve i mërziste mbikqyrësit dhe mjeshtrit. Prej mbikqyrësve të mëparshëm e këta prej të mëparshmëve, kishin dëgjuar se nuk ishte hera e parë që ndodhte diçka e tillë, se një gjendje e tillë çtendosjeje që krijuar diku përpara gurit të shtatëmjëtë, ndoshta të katërmjëtë, kur puna kishte shkuar gjer atje saqë ishin thyer disa nga gurët. Kështu kishte ndodhur, po pastaj qenë marrë masa, gojët qenë frenuar e pas tyre mendjen dhe çdo gjë ishte vënë në vend e kishte zënë vend ashtu si gurët e paluejtshëm të piramidës. Të sigurtë se do të kalonte edhe kjo lëngatë mbikqyrësit dhe mjeshtrat prisnin me siguri kohën e tyre, përderisa gjithçka që ndodhte në piramidë ishte e përsëritshme, pra e përkohshme. Do të vinte kohë tjetër, me gurë të tjerë dhe gjithçka do të bëhej si më parë. Ndërkaq flitej se raportet për atë që po ndodhte kishin shkuar gjer lart, ndoshta gjer te faraoni, se ishte pritur më kot një ndërhyrje prej tij dhe se më në fund gjithçka ishte lënë ashtu siç qe. Me sa dukej që bërë syri i verbër e veshi i shurdhër për të nënvizuar idenë se faraoni do të jetonte gjatë, shumë gjatë, ndaj s'kishte asnjë arsye të shqetësohej për ngadalësimin e ndërtimit të varrit të vet. U fol madje se kaq larg paskësh shkuar zhbirimi i kësaj ideje saqë pati edhe një guximtar rrezikzi, nga rrethi i qeveritarëve që në vazhden e saj kishte propozuar që të prishej tradita e të ndërpritej

fare ndërtimi i piramidës, për të treguar se faraoni që i pavdekshëm. Mirëpo si çdo gjë e treguar që sjell shpesh të kundërtën e asaj që do, guximi i qeveritarit i kushtoi atij jetën. E sharruan të gjallë, duke nisur nga gjuha që kishte shqiptuar ato fjalë, pastaj nga fyti, mushkëritë, duart me lëvizjen e të cilave kishte shoqëruar fjalët, e kështu me radhë, gjersa i kishte mbetur fare pak gjë pa u prerë. Ky sharrim shënoi edhe kthesën e menjëhershme. Në qendër që zbuluar një përbetim i ri. Asnjë shpallje dhe asnjë nga urdhrat s'kishte mbërritur gjer te ne, kur u ndie era e frikës. Ajo ndryshoi aty për aty çdo gjë. Një tendosje që duhej t'i kalonte si drithmë të katër brinjëve të piramidës u ndie përnjëherësh. Me të bashkë erdhën lëvizja më e shpejtë rrotull gurëve, mekja e erërave, ulja e syve përdhe. Pëshpërimat dhe fjalët përgjithësisht u pakësuan. Dhe jo vetëm fjalët; mendimet, ato që ushqenin fjalët, po shteroan. Kështu e jepnin shenjën thatësirat e mëdha: çikrikët pakësonin çdo ditë nxjerrjen e ujit, gjë që tregonte se pusët po thaheshin. Një erë e thatë, që më shumë se frynte vërtet, ndihej në tëmthat e njerëzve kërkonte të fshinte kujtimet e turbullta. Po harrohej çdo ditë, dukej si një lumturë e mallkuar, koha e gurëve njëmbëdhjetëmijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë e njëmbëdhjetëmijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë kur në mënyrë mëkatore që folur, shpresuar, ëndërruar. (Më pas, për një kohë të gjatë mbikqyrësit duke goditur me kamzhik të ndërshkuarit, do të turfullojnë: he, kujtuat se erdhi koha e nëntëdhjetepesës e nëntëdhjetegjashtës, he, na tani, ulëri!) Në këto e sipër i rëndë, i shurdhër, i pandryshueshëm nga mijëra e mijëra të tjerë që kishin zënë vend tashmë në bazën e piramidës, erdhi guri i njëmbëdhjetëmijëtetreqindennëntëdhjeteshtatë. Shëmbëlltjërë e rregullit të rivendosur, e pandryshueshmërisë dhe e monotonisë madhështore, ai i bëri të psherëtimë mbikqyrësit dhe mjeshtrit. Koha dhe ditët u bënë të ngjashme me kohën dhe ditët e mëparshme, madje dhe vde-

kjet, kafshimet e akrepëve, çmendjet, pika e diellit, dhe gjer te emrat e pësimitarëve ishin gati të njëllota. Guri i njëmbëdhjetëmijetreqindenëntëdhjetetë pati përafërsisht po aq vdekje e gjymtime sa i mëparshmi. Në natën para vendosjes mbi të, kishte fjetur kutullaç një gjarpër, por asnjë s'kishte dashur të shprehej nëse ishte a s'ishte kjo ndonjë shenjë, e aq më pak nëse shenja ishte e mirë apo e keqe, ngaqë askush nuk priste më asgjë. Kështu si gjithë të tjerët, kishte zënë vend edhe ky gur, në kohën që larg, pluhuri i rërës kumtonte se po afrohej guri tjetër, i njëmbëdhjetëmijetreqindenëntëdhjetëenënti; dhe pas tij të tjerë, e kështu me radhë, e kështu gjithmonë, gjer në mbarimin e jetëve tona, o perëndi.

IV

Mbarimi i ndërtimit. Piramida kërkon mumjen e vet.

Ndërtimi vazhdoi më gjatë se ç'pritej. Sipër rrafshit të madh, mbi të cilin vërtiteshin çdo ditë si miza dheu rreth njëqindmijë vetë rrinte përherë një re pluhuri. Ajo dukej nga dhjetëra milje larg, aq sa banorët e katundeve të mëngjanuar, që çdo mëngjes e kthenin kokën vetvetiu në atë drejtim, nuk do të habiteshin po t'u thoshte dikush se një pjesë e kantierit ndodhej në qiell.

Piramida ishin ndërtuar edhe më parë, po çfilitje e trullosje si kjo s'mbaheshin mend. S'ishte vetëm lodhja dhe frika e dënimeve dhe e dërgimit në gurre që i kishin bërë njerëzit si të mpirë. Një prapësi e madhe e përshkonte si era tejmbanë vendin. Çdo gjë bëhej së prapthi dhe e mira dhe e liga nuk dalloheshin më nga njëra-tjetra. Mbi Egjipt ka rënë mallkimi i hyjve, thoshnin të gjithë. Dhe

kjo piramidë, që u tha se veç të tjerash do t'i fisnikëronte njerëzit, i kishte bërë egjiptianët më të ligj se kurrë.

Kishte njerëz, ndonëse të rrallë, që atë e bënë fajtores për gjithçka. Një varr kaq i madh mu në mes të Egjiptit s'ka si të mos ndjellë prapësi, thoshin me zë të ulët. Dhe veç kësaj një varr jo për së mbari, si gjithë varret me gropën poshtë, por një varr me gropën përjetë, shkurt një varr i kthyer përmbys. Ishte e tepërt, vërtet. Perëndia Re kishte duruar sa kishte duruar *mastabate* e piramida të tjera, me shpresë se ndoshta egjiptianët do të hiqnin dorë nga kjo marrëzi e do t'i kallnin të vdekurit në tokë si popujt e tjerë, po pastaj kur kishte parë se ata jo vetëm s'hiqnin dorë, por po i shtonin edhe më lartësitë e varreve, kishte vendosur, siç duket, të ndërhynte.

Ishte pikërisht kjo e fundit, lartësia e piramidës së re, që disa, duke mos dashur të përgojnin piramidën në përgjithësi, e bënë fajtores për të keqen.

Lartësia ishte në të vërtetë e frikshme: tre herë më e madhe se e zakonshmja. Qysh në gjysmën e saj njerëzit nuk e ndjenin veten mirë kur e shikonin. Merrej me mend se ç'do të ndodhte më pas. Thuhej se kur shtati i varrit të arrinte treqind këmbë do të kishte çmendje masive. Kurse në katërqind këmbë e sidomos në katërqind e pesëdhjetë, që do të ishte dhe lartësia e fundit e piramidës, veç zoti e dinte ç'mund të ndodhte.

Megjithë dënimet e njëpasnjëshme pëshpërimit kundër piramidës nuk rreshtte. As fjalimet lavdëzuese që mbahehin për të nëpër tempujt dhe as humnet që i kushtoheshin prej poetëve dhe magjistarëve nuk e fashitnin dot mërmërimin kundër saj. Në fjalime përmendeshin shpesh deklarata të të huajve, madje edhe të armiqve të Egjiptit, që ishin të detyruar të pranonin se gjithë bota i kishte sytë të kthyer nga Egjipti, sepse ajo që po bënte ky vend ishte mrekullia më e madhe e dheut.

Njëra pas tjetres dërgatat e huaja, të shoqëruara nga

ambasadorët e saj, vizitonin kantierin, duke lëshuar lavdërime pa kursim për madhështinë e piramidës, për të zotin e saj, Keopsin, si dhe për tërë popullin e Egjiptit që ishte në gjendje të ndërtonte këtë vepër kolosale.

Kjo nuk i pengonte ambasadorët që në raportet e dërguara qeverive të tyre të shkruanin të tjera gjëra.

Prej kohësh dyshohej për këtë, po gjithçka u bë e qartë, kur arriti të haqej letra e ambasadorit të Babilonisë. Stili pak i zgjatur i të shkruarit të tij, që jo një herë ia kishin qortuar eprorët, qe bërë shkas për t'ia ngritur kurthin. Ndërsa karroca e postës po çonte letrën që peshonte sa një gjysmë deveje (megjithë përpjekjet e ambasadorit për t'i bërë sa më të holla pllakat prej argjili, s'kishte mundur ta lehtësonte më tej peshën), kishte qenë e lehtë për shërbimin e fshehtë egjiptian të shkaktonte rrëzimin e karrocës, me anë të një grope të maskuar m'u në rrugën e madhe. Në rrëmujë e sipër tek po i jepej nq:hma e parë korrierëve të plagosur, nuk qe e vështirë të vidheshin disa nga pllakat e shpërndara në udhë, po edhe ato kishin qenë të mjafta për të parë se sa i hidhur kishte qenë helmi babilonas.

Plot një javë pas deshifrimit, në një drekë zyrtare, Keopsi tha fjalët e famshme: «Piramidën e kanë halë në sy armiqtë tanë, po sa më shumë të shqetësohen ata, aq më lart ne do ta ngremë atë drejt qiellit.»

Të pranishmit mezi e fshihnin dridhjen e duarve. Çdo ditë që kalonte faraoni zyntohej më shumë. Flitej se një përбетim i ri ishte duke u zbuluar, por ende s'dihej asgjë e saktë.

Piramida mbaroi në mënyrë disi të pabujshme. Nuk pati as ceremoni, as fjalime. Keopsi vetë, për një kohë të gjatë, nuk shkoi ta shikonte. Askush nuk e shpjegonte dot

shkakun. Disa thoshnin se ishte i pakënaqur prej saj Të tjerë zëra ngulnin këmbë se qe bërë një gabim në orientimin yjor, apo më thellë akoma, në shifrat e kumtit misterioz. Mirëpo askush s'mund të jepte shpjegime më tej. Gjithë ata që kishin punuar për kthinat e fshhta të brendshme dergjeshin prej kohësh, bashkë me sekretet, nën dhe E kishin ditur qysh më parë fatin e tyre, megjithatë një shpresë e marrë i kishte mbajtur se ndoshta faraoni do t'i kursesente. Fill pas mbarimit të galerisë së fundit, qenë akuzuar për komplot. Qenë arrestuar të gjithë brenda një nate dhe në mëngjes qenë gdhirë me gjuhë të prerë që kurrsesi të mos nxirrnin asnjë nga të fshhtat.

Kishte dhe njerëz, nga ata që ndonëse e shihnin se punët venin zi e më zi, që nuk hiqnin dorë nga shpresa, dhe në çdo rast, edhe në tërbimin e së keqes, kërkonin të gjenin një fije shkakun dhe logjike, një fill të hollë që do t'u jepte të drejtën për të shpresuar rrugëdaljen, kishte pra njerëz që mosbujën dhe heshtjen që e rrethoi para kohe piramidën e shpjegonin me faktin që ajo prej kohësh dukej si e mbaruar, ngaqë maja e saj ishte tashmë tepër larg dhe syri i njeriut e kishte vështirë të dallonte ç'bëhej kohë e fundit atje.

Të tjerë tundnin kokat me mosbesim. Mos kërkojmë shkaqe atje ku s'ka, thoshnin ata. Është heshtja e varrit kjo dhe asnjë tjetër. Çdo varr e ka heshtjen nën tokë. Piramida e ka sipër.

Faraoni qe i pikëlluar. Brenga kishte provuar edhe më parë, madje shpesh, mjaftonte njëra prej tyre, ajo e vajzës që i kishte marrë rrugë të keqe, për ta korrusur njeriun, por kjo brengë ishte tjetër lloj. Jo mërzi, po një Saharë e tërë mërzie, çdo kokërr e së cilës të bënte të klithje.

Për një kohë të gjatë bënte sikur s'e kuptonte nga i vinte, madje bënte sikur s'e dinte ç'qe. Pastaj, një mëngjes, nuk ia fshehu më vetes: ajo ishte brengë dhe i vinte prej piramidës.

Tani që kishte mbaruar e ndillte. I dukej se nuk kishte udhë tjetër veçse drejt saj. Natën sidomos zgjohej nga gjumi qull në djersë dhe me vete përsëriste: të iki, të iki. Të ikte, po ku? Ajo ishte aq e lartë, saqë shihej nga gjithkund. Që larg dukej se do t'i bënte zë: ku ikën ashtu, Keops, kthehu!

Kishte dënuar njerëz duke i akuzuar se ngadalësonin punimet. Pastaj kishte dënuar për të kundërtën, se i kishin shpejtuar. Pastaj prapë për të kundërtën. Pastaj pa dhënë kurrfarë shkak.

Ditën që i sollën lajmin se ajo më në fund kishte mbaruar, qëndroi i mpirë krejt, duke i lënë pa mend lajmësit. Pritën një fjalë të mirë prej tij, në mos të gëzueshme, një formulë të zakonshme lavdërimi. Por ai s'e hapi gojën. Sytë iu zbrazën krejt, pastaj heshtja kaloi prej tij tek ata dhe përreth u bë bosh dhe shkreti.

Askush nuk guxoi t'i thoshte a do të shkonte ta shihte. Dalëngadalë pallati ra në të zeza, si të kishte ndodhur një vdekje. Ditë të tëra askush nuk guxonte t'ia zinte ngoje piramidën.

Ai vetë kishte një ndjenjë të dyfishtë ndaj saj; e donte e njëkohësisht e urrente. Për shkak të saj pallati kishte nisur t'i neveritej. Por as tek ajo nuk donte të shkonte. Ishte ende i ri për të shkuar matanë, por jo aq sa për të qëndruar këtej.

Ndërkaq kishte ditë që ajo e tërhiqte, po turbull, dinakërisht. Disa herë e ndërroi dhomën e gjumit, por valët e saj e arrinin kudo.

Gjatë hënës së re u mbyll net të tëra me magjistarin Gjedi. E tërholli sa e tërholli bisedën, gjersa ia bëri pyetjen e frikshme: a mund të gënjehej piramida nga një mumje tjetër?

Magjistari kishte shqyer sytë nga tmerri. Por faraoni ishte ende aq i kujdesshëm sa t'i sqaronte gjërat. I tha se e kishte fjalën për mundësinë e zëvendësimit më pas të

mbajes së tij prej armiqve. Por ndërkaq sytë e turbullt nuk i ndante nga krahët dhe magjistarit iu duk se do t'i hidhej në grykë, ta mbyste dhe pastaj ta mbështillte me fasho prej lini, siç e donin rregullat e balsamimit.

Një copë herë faraoni foli për rrezikun e ardhshëm. Herë-herë si në delir përsëriste pyetjen: a mund të mash-trohej piramida? Sa më shumë përpiqej ta përlligjte shqetësimin, aq më tepër magjistani bindej se sovranit i kishte lindur mendimi të vdiste dikë tjetër për ta vënë në vend të vet në piramidë.

Magjistani ia nguli sytë një copë herë të gjatë për ta qetësuar. Pastaj me zë të ulët, të thellë i tha: «Piramida pret, madhëri.»

Faraoni nisi të dridhej. Djersë të ftohta i venin çurg në ballë. Jo, rënkonte, jo, magjistar, nuk pret!

Tronditja mendore e faraonit u mbajt e fshehtë gjer në fund. Kishte ditë që rrinte i topitur, pa folur me kërkënd, por vinin ditë të tjera e sidomos net, kur truri i çakërdisej. Në një nga këto net e tmerroi magjistarin Gjedi, duke i thënë se do të shkonte të hynte në piramidë. I gjallë, vetëm. Ta pyeste ç'ke që ulërin natën, pse s'të durohet?

Magjistani mezi ia mbushi mendjen të hiqte dorë nga kjo. Megjithatë një natë shkuan vërtet, të shoqëruar nga fare pak roje, për ta parë nga jashtë.

Piramida ishte e qetë. Që nga maja e saj hëna rridhte nëpër pjerrësi për të mbytur krejt shkretëtirën.

Keopsi vështronte i heshtur. Dukej i qetë. Vetëm një herë i pëshpëriti magjistarit: «E ndjej që më do.»

Në ditët e pastajme u bë edhe më i pikëlluar. Orë të tëra fliste me vete. Nganjëherë lëvizte duart si njeriu që jep shpjegime, që do të përlligjë diçka që s'mund ta bëjë

dot, kurrsesi s'mund ta bëjë dot, ndërsa tjetri, ndonëse nuk ia thotë, s'e beson që s'e beson.

Vdiq plot tre vjet pas mbarimit të ndërtimit.

Kur pas dyzet ditësh trupin e tij të balsamosur e vendosën, më në fund, në sarkofag pas ritit mortor, mijëra njerëz qëndruan orë të tëra përjashta me sy të ngulur mbi piramidën.

Ajo dukej tani e plotë me mumjen që, më në fund, e kishte brenda. Kishte përmbysur kaq fate njerëzish e kishte ngrënë kaq koka dhe tani mospërfillëse e plot triumf shkëlqente nën diell.

Ndërsa e soditnin, një pjesë e gjindjes, e sidomos ata që kishin patur të afërm të dënuar, kujtonin ankthin e tyre të gjatë, pritjen e arrestimit, natën e fundit para internimit ose dërgimin në gurrORE, kur qenë ndarë me ta për së gjalli.

Shumica tani ishin nën dhé. Kishin kujtuar se piramida do të ishte mbrojtja e tyre, por ajo ua kishte ngrënë kokën. Megjithatë, thuhej se njëri prej të dënuarve dhe pikërisht një prej ministrave që kishte ngulur këmbë për ngritjen e saj në atë mëngjes të largët nëntori, në çastin e fundit para varrimit kishte thënë se nuk ishte i penduar aspak për këshillën fatale. Pa piramidën do të ishim një lloj të humbur, kishte thënë. I vetmi ndryshim ishte se pa të do të rrënoheshin të gjithë, kurse me të, vetëm një pjesë, ata që s'kishin lindur me fat.

Një pjesë të asaj që kishte ndodhur, hetimet, pohimet nën torturë, çmendjet i kishin marrë vesh të afërmit. Megjithatë, për çudi, nuk ndjenin dot urrejtje. Turbull e ndjenin se sa të ishte piramida aty, në horizont të jetës së tyre, as urrejtja, madje as dashuria nuk ngjizeshin dot. Ishte një përzierje e sëmurë, një ligështim mallëngjyjes që zëvendësonte ndjenjat e tjera, ashtu si bathët e mërzitshme që prej kohësh zëvendësonin ushqimet e mira të dikurshme.

Ata që kishin humbur u faniteshin tani fare zbehtë.

Darka të gëzueshme me miqtë, histori dashurish, skandale ose tuhafë që flisin ç't'u vinte në kokë mejhaneve. Ishin mënjeluar të gjitha nga jeta, njëra pas tjetrës, si hije. Sa më lart piramida ngrihej, aq më shumë ato largoheshin, thuajse ajo që nga lartësia vigjëllonte kudo.

Një mëngjes dimri faraoni i ri, Didufriu, shpalli përpara ministrave dhe këshilltarëve të ngushtë ndërtimin e piramidës së vet. Ishte aty djali tjetër i Keopsit, Kefreni, si edhe vajza e vetme, Heteferes, ajo që prej kohësh nuk kishte shkelur në pallat për shkak të shturrjes.

Të gjithë me fytyra të palëvizshme dëgjonin fjalët e faraonit. Ai nuk dha ndonjë mendim të veçantë as për gjatësinë e brinjës, madje as për lartësinë e piramidës, dhe ata nuk ishin në gjendje të kuptonin nëse ishte e mirë apo e keqe kjo gjë.

E motra me një mospërfillje të hapur vështronte gjithçka. Flitej se kohët e fundit, duke përfituar nga trullësja e të atit, po bënte një proçkë të re, një piramidë për vete. Flitej se secilit dashnor i kërkonte një sasi gurësh, kështu që një zot e dinte se sa dashuri duhet të bënte ende gjersa piramida të lartësohej.

Një pjesë e kryeqytetit nuk merrej veçse me të. E quanin piramidë femër, hija e seksit të Heteferes, thellësia e tij, projektimi mbi sipërfaqe, phallusi veginhondshmues, apo seksut etj. etj. Ajo i dëgjonte të gjitha dhe aq i bënte. Madje flitej se kishte thënë «meqenëse gratë e Egjiptit janë ftohur e kanë hequr dorë nga dashuria, do të bëj unë sa për të gjitha. Dhe piramida le të dëshmojë se nuk jam mburrur kot.»

Faraoni po i afrohej fundit të fjalës së tij. Vëllai i vogël, Kefreni, me flokët e krehur në një stil disi të çudit-

shëm, po i dhimble gjoksi nga mllafi dhe zilia. Veç të vijë dita ime, mendonte gjithë vrer. Veç të më vijë.

Mendonte vërtet ditën kur mund të bëhej faraon, me atë brengë që mendohen gjërat e paarritshme dhe i vinte t'ia plaste të qarit.

Veç t'i vinte dita e piramidës së tij pa e dinte ç'do të bënte. Kishte gjetur një statujë të vjetër sfinksit që e ruante si gjënë më të shtrenjtë. Kur shokët e pyesnin ç'ishte ky model krehjeje, nga e ke zbuluar këtë, buzëqeshte në mënyrë enigmatike. Ishte e krehura e sfinksit.

Qysh tani e ndjente se ajo e krehur kishte një fuqi të turbull. Atë do ta mbante tërë jetën edhe kur flokët t'i rralloheshin. Dhe më pas, kur të bënte piramidën e tij, mu në këmbën e saj do t'i gdhente një sfinks vigan. Një luan të ulur që do të kishte fytyrën e tij. Ç'je ti, do t'i thoshnin me mijëra vizitorë, nëpër mijëra vjet. Ç'je ti, Kefren? Si arrite të bëhesh faraon? Ç'i bëre Didufriut? Por nga sfinksit, siç dihet, s'vjen kurrë asnjë përgjigje.

V

Dhunimi

Ndërmjetësia e tyre midis tokës e qiellit, siç kumtohej në papiruset e vjetra, spikaste sidomos në netët me hënë. E mblidhnin hënëzimin turbullues vjeshtor për ta pikuar thellë nën tokë, te gurët e zezë pa çmër të boshësisë. Te balta dhe diamantet që verboheshin brenda për brenda tyre ngaqë s'kishin mundësi të lëshonin dritë. Mbusheshin me të kafkat e të vdekurve, gropat e syve të cilave ndriçoheshin vetëm një grimë për t'u errur në çast. Kurse drejt qiellit, majat e ngrehinave, me piramidionin e errët prej graniti

arratisnin kushedi ç'tmerre, nga ata që toka i kishte përherë tepër dhe që herë pas here i duhej të lehtësohej prej tyre.

Piramida e Keopsit. Piramida e dyzimit të tij, shumë më e vogël, në këmbët e së madhes. Piramida e Kefronit me sfinksin përpara. Piramida femër. Më tutje, pak mënjane, piramida e Didufriut, e pambaruar.

Piramida femër ishte e para që u hap nga grabitësit. Ishte një natë e errët me zagushi. Levat u dridheshin në duar ngaqë ishte e para herë që hapnin një piramidë. Natë të tëra kishin vrarë mendjen se ç'piramidë të sulmonin. Ishin mëdyshur midis piramidës së Didufriut dhe piramidës femër, nga që të dyja s'mund ta kishin të përkryer bllokimin e hyrjeve të fshehta, për arsye se e para, si varri i çdo sovrani të vdekur para kohe kishte mbetur e pambaruar, dhe e dyta, ngaqë ishte ngritur prej dashnorëve të Heteferes, të cilët sado të kënaqur të ishin prej saj, s'mund të ishin të kujdesshëm sa ç'duhej, aq më tepër që gjysmën e gurëve e çonin pasi kishin fjetur me të, atëherë kur edhe dashnorit më të përvëlur i bie një pjesë e zjarrmisë.

Qenë lëkundur pra gjatë, për shkak se të këqijat dhe të mirat i kishin të barabarta, gjersa së fundi kishin vendosur të dhunonin piramidën femër, ngaqë në çastin e fundit iu duk se së paku ajo e kishte hijen më pak të rëndë, dhe veç kësaj, të mësuar me përdhunime femrash, vetvetiu iu duk kjo si një gjë më e natyrshme.

E gjetën dhe e çbllokuan më shpejt se ç'e prisnin gjerinë kryesore dhe mëngjesi i zuri pranë dhomës së sarkofagut. Atje, të këputur nga lodhja, u shtrinë mbi pllakat e ftohta duke pritur ardhjen e natës.

Kur iu duk se kishte rënë terri, Nofulla e Keqe, siç ia kishin ngjitur nofkën më të vjetrit prej tyre, provoi i pari levën e rëndë të hyrja. Graniti i zi as që lëvizi.

— Hë, kurvë, — shau ai dhe i mëshoi përsëri.

Lëvizja e portës dhe pastaj hapja e saj i sflitën aq shu-

më saqë kur shpërthyen më në fund brenda s'kishin më fuqi të rrinin në këmbë.

I pari u ngrit Nofulla e Keqe, pastaj Sethi me Qorrin. Nga përvoja e dinin se nën dritën e pishtarëve stolitë dukeshin përherë më të vlefshme se ç'ishin, ndaj nuk gëzoheshin para kohe. Nofulla e Keqe i prekte me radhë duke murmuritur papushim: *hë, kurvë*. Pastaj pasi i erdhi disa herë rrotull kthinës sytë iu ngulën te sarkofagu. Të tjerët qëndruan në këmbë rreth e rrotull, në kohën që ai i vuri levën.

Ashtu siç e kishin parashikuar stolitë më të çmuëra ishin vërtet brenda në sarkofag. Kur i mblodhën për t'i futur në çantat e lëkurta, sarkofagu bashkë me mumjen u dukën të varfër e të hirnosur.

— Mos e lëviz ashtu atë pishtar, — i tha Sethi atij që mbante pishtarin, ngaqë nuk e duronte dot fytyrën e mumjes. Nga përvoja e grabitjes së varreve e dinte se pas hapjes së arkivolit qëllonte që mumjet nxiheshin aty për aty. megjithatë nuk mësohej dot me një gjë të tillë.

Ndërsa ai bashkë me Nofullën e Keqe po çukitnin muret për të gjetur ndonjë portë tjetër, ndoshta atë të kthinës së dhuratave, Qorri rrinte në këmbë, sipër sarkofagut të hapur.

— Ç'bën aty? — i tha Nofulla e Keqe.

Qorrit i vezullonin sytë.

— Dua t'ia heq fashot dhe t'i shikoj seksin, — tha me zë të ulët. — Kaq herë kam thënë me vete: ç'ka qenë vallë ai seks që e tregojnë si përrallë.

— Një seks kurve dhe asgjë tjetër, — tha Nofulla e Keqe, pa kthyer kokën. — Eja më mirë të na ndihmosh të gjejmë portën tjetër.

— Ej, ç'ke ndër mend të bësh? — thirri Sethi i llahtaritur, ngaqë iu duk se Qorri ishte përkulur mbi mumjen e po bëhej gati vërtet t'i hiqte fashot.

— Fytyra po i nxihet dalëngadalë. — tha Qorri. — Kujtoja se mumjeve mbretërore nuk u ndodhte kjo.

— Lëre, pash zotin, mumjen dhe eja këtu, — tha Sethi. Me bisht të syrit ai përgjonte shokun ngaqë i dukej se në çdo çast do t'i sulej mumjes. Po Qorri në vend të kësaj kishte gjetur një mbeturinë pishtari dhe me të nisi të shkarraviste nëpër mure fjalë e vizatime të ndyra.

— I lajthitur, — tha Nofulla e Keqe, duke vazhduar çokitjen e murit. Kur erdhën te muri përballë ku Qorri, kishte bërë shkaravinat ata panë dy rreshta hieroglifesh dhe në fund një si organ mashkullor, gjysmë phallus, gjysmë piramidë të vizatuar trashë.

— Ç'ka shkruar? — pyeti Nofulla e Keqe që nuk dinte lexim.

Sethi afroi kokën për të parë më mirë.

— Hm, Qorri i dreqit.

— M'i lexo edhe mua, pastaj zgërdhju, — tha Nofulla e Keqe.

— Hi, hi, hi, — ia bëri prapë Sethi. Në të vërtetë fjalë të ndyra, d.m.th. që vajza e faraonit e donte phallusin sa një piramidë.

— Ka lajthitur vërtet, — tha Nofulla e Keqe.

— Kjo është një bejte e vjetër, — tha ai që mbante pishtarin. — Ju kujtohet Shatabaka që bënte bejte për të marrë lëmshë? Më duket se këto janë bejte të tij.

— Keni lajthitur të gjithë, — tha Nofulla e Keqe. — Tani lërinini grafitë dhe bejtet dhe shikoni më mirë punën, se mbetëm këtu brenda.

Kur kthyen prapë kokën, ata panë Qorrin me një dorë të mbështetur te sarkofagu, si njeriu që bëhet gati për të vjellë. Fytyrën e kishte dyll.

— Ç'pate? — pyeti Sethi.

Qorri tundi kokën.

— S'e ndjej veten mirë.

— Largohu që andej, — tha Nofulla e Keqe. — Ti e di

që era e mumjeve të sjell të përzier. Edhe unë nuk ndjehem mirë.

— Mbase është më mirë të ikim, — tha Sethi.

— Ashtu është. Veç nuk e dimë ç'është përjashta, ditë apo natë.

— Së paku të largohemi këndeje. Mund të presim në galeri.

— Ke të drejtë. Hajde, djema, mbliidhni veglat.

Pas pak dolën njëri pas tjetrit dhe te pragu Qorri ktheu odhe një herë kokën nga sarkofagu. «Kurvë e mallkuar, shkrofëtiu gjithë mllef. Më shpëtove»

Hapat e tyre gjëmuan shkretueshëm për një kohë të gjatë nëpër galeri.

Ishin betuar të mos hapnin më piramida, po nuk kaluan as dy stina kur e ndjenë se mendjen e kishin aty. Nuk kënaqeshin më me hapjen e varreve të zakonshëm ashtu si tigrat që pasi provonin një herë mish njeriu i merrte malli prapë për të.

Këtë herë, bashkë me mprehjen e levave e përgatitjet e tjera qepën ca pëlhura në formë maskash që të qullura me lëng rrushti të thartuar, do t'i vinin në fytyra gjatë hapjes së sarkofagut. Ishte e vetmja mënyrë për t'u mbrojtur nga turbullira që shkaktonte mumja.

Ende nuk qe pikasur vjedhja e piramidës femër, ose piramidës-kurvë, siç e quanin midis tyre, dhe kjo i shtynte të shpejtonin. Ndoshta dhunimi i saj s'do të zbulohet kurrë sepse dashnorët e fundit të Heteferes, ata të pleqërisë, prej kohësh kishin vdekur e ishin kthyer në pluhur. Kishin vdekur gjithashtu mbikqyrësit, madje ata e kishin braktisur mbikqyrjen qysh në gjallje, ngaqë paratë e caktuara për atë punë qenë mbaruar. Megjithatë për shkaqe të papritura grabitja mund të zbulohet çka do ta bënte të vështirë sulmin e dytë.

Një natë më parë, i dhanë zemër vetes duke u kujtuar se për piramidën e Dudifriut prej kohësh gjithashtu nuk

kujdesej njeri, ndryshe s'do të kishte mbetur e pambaruar. Ata ishin vjedhës varresh brez pas brezi dhe asnjëherë nuk qenë marrë me politikë, veç ç'u kishte zënë veshi rastësisht nëpër mejhane. Dëgjonin përshembull se filan faraon ndërrohej më shumë se faraoni tjetër, ndonëse të dy prej kohësh ishin kthyer në mumje, mbyllur së bashku në piramidën e vet. Mirëpo kalonte ca kohë dhe qëllonte e kundërta, ai që ishte nderuar më shumë lihej në harresë dhe tjetrit, të braktisurit, i thurreshin lavde e i ngriheshin statuja. Thuhej se kjo lidhej me politikën, por atyre e gjithë kjo u dukej qesharake e pakuptim, njëlloj si të ngriheshin dy mumjet e të përlesheshin për leckash.

U gjendën pra në mesnatën e errët te këmbët e piramidës dhe pa e bërë të gjatë i vunë levat gurit që pas mendjes së tyre bllokonte hyrjen e fshehtë. U munduan shumë gjersa pas lëvizjes së njëzet e ca gurëve, ndaj të gdhirë e gjelën më në fund galerinë.

Kjo ishte dhe pjesa më e vështirë e punës. Më tutje gjithçka kaloi si në piramidën tjetër. Përpara se të hapnin sarkofagun mbuluan fytyrat me pëlhurat e lagura, mbi të cilat kishin hapur dy vrima për sytë dhe një copë herë u tallën e e trembën njëri-tjetrin.

Ndërsa të tjerët mblidhnin stolitë e vendosura nëpër kamaret, Qorri si zakonisht u vonua te sarkofagu.

Nofulla e Keqe ishte i pari që ktheu kokën.

— Ç'po i bën ashtu mumjes?

— Ejani ta shihni këtu, — tha Qorri.

Kur u afruan panë se Qorri i kishte hequr fashot e linjta nga qafa e mumjes. Sethi dhe pishtarmbajtësi shtrembëruan fytyrat me neveri.

— Shikoni këto shenja këtu, — tha Qorri. — Duket menjëherë që janë shenja mbytyjeje.

— Hm, — ia bëri Nofulla e Keqe duke u përkulur. — Keqë të drejtë për besë. Ia paskan përdredhur kokën si të zogut.

— Si? Si? — ia bër: pishtarmbajtësi.

— Si? — tha edhe Sethi. — Një faraoni?

Nofulla e Keqe u ngrys në fytyrë.

— Dëgjoni këtu, — tha. — Ne jemi grabitës dhe nuk kemi punë me këto. — Zëri i tij sa vinte bëhej më i mprehtë. — Këto janë gjëra politike dhe ne s'kemi punë me to, e morët vesh? Dhe ti, — iu drejtua Qorrit, gati me ulërima, — s'ke punë të hetosh qafat e mumjeve. S'të ka vënë kush ty të gjykosh për ta, more vesh?

— E, mirë, mirë, — tha Qorri, — mjaft ulërive sa tunde piramidën.

— Do të ulërij edhe më, more vesh? Ti e di se për këto gjëra të shkon koka, apo s'e di? Nga se e pësoi Tut Këmbaci, nga se e pësuan Kuqsi me të vëllanë? Gjithë jetën shpërthyen dyert e shtëpive pa i hyrë gjembi, por mjaftoi gjysmë fjale në mejhan për politikë që të shkonin në dreq. Politikë me mua s'ka, e qartë? Kujt i kruhet të merret me të, udha mbarë, veç me mua s'piqet më në këtë botë. E qartë?

— E mirë, mirë, — tha prapë Qorri. — E morëm vesh.

Ai qe përkulur prapë te qafa e mumjes dhe po i mbësh-tillte pa kujdes fashot e hequra.

Kur iu afruan daljes ishte ende natë. Yjet po zbeheshin. I hodhën maskat në galeri dhe dolën njëri pas tjetrit. Ishte ftohtë. Sethi që ishte stërvitur të ecte pa lënë gjurmë të qarta fshinte edhe gjurmat e të tjerëve. S'e merrte dot veten nga ajo që kishte dëgjuar. Një faraon me fyt të përdredhur... Horrat, kishte shfryrë Qorri nëpër dhëmbë, qonkeshin grindur me njëri-tjetrin më keq se ne për stolitë

Ndaj të gdhirë kaluan prapa piramidës së Kefrenit. Sfinksi dukej ende i zi. Në zbardhimin e agut i shquhej veç krehja, për të cilën qe folur aq shumë.

Të gjithë shpejtuan hapat ngaqë nuk e duronin dot vështrimin e tij. Thoshin se kur kishte hënë mund të çmendesh.

Qorri ecte i fundit. Koka mend i çanej. Shenjat e mby-
tjes në qafën e mumjes nuk i shqiteshin nga mendja. Do t'i
shihnte me siguri në ëndërr.

Për herë të fundit ngriti kokën dhe pa nga sfinks. Ndri-
çimi i mëngjesit ia kishte arritur më në fund sytë. Zbrazëtia
e tyre e ngjethën si asnjëherë tjetër. Deshi t'i thërriste: «ç'i
bëre tët vëllai, Sfinks? Qysh ia hëngre kokën?» Po zëri nuk
i dilte.

VI

Antipiramida

Kur u arrestua një grup shkruesish, ai që më pas, atë-
herë kur pasionet u ftohën dhe nofkat e këqija ranë si
dregëza nga plaga e përtharë, kur u arrestua pra ai që më
pas u quajt «grupi i historianëve të -inj» (në dosjet filles-
tare fjalët «akrep» dhe «helm» ishin aq të shpeshta sa do të
besoje se më shumë se me një hetim kishte të bëje me një
udhërrëfyer për prodhime barnash), askujt nuk i shkoi ndër-
mend se hetimi, zgjatja e të cilit kishte shkaktuar aq thu-
mba ironike në kryeqytet, do të nxirrte në dritë një gjë sa
befasuese, aq edhe ngjethëse: vjedhjen e dy piramidave.

Kishin pritur të gjithë një proces të llojit të veçantë,
si gjithë gjyqet e njerëzve të ditur, ku zakonisht më shumë
se ata vetë dënoheshin idetë e tyre, si ai i arkitektit Reni-
seneb, gjykimin e të cilit e ndoqi tërë ajka e kryeqytetit,
bashkë me trupin diplomatik, ose i shkruesit Harakhti, që
nuk u mor vesh pse u dënua, kaq mishmash ngjanin idetë
e tij.

Si zakonisht në kësi rastesh pikëllimi e ankthi u përha-
pën në rrethet e njerëzve të ditur. Priteshin gjyqe të tjera,

pas të cilave kishte përherë, përveç dënimeve, largime nga kryeqyteti, që ndonëse nuk quheshin dënim, qenë njëlloj të këqija si internimet.

Kështu pra, pritej një dimër i hidhur, kur rrufe në të kthjellët, u përhap lajmi se çështja e historianëve s'lidhej aspak me ndonjë gjë të lartë mendore a politike, po kishte të bënte thjesht me një vjedhje. Një gjë e tmerrshme, e padëgjuar: vjedhje mumjesh. Një parandjenjë e zezë i kapulloi të gjithë. Ishte fjala për vjedhje e dhunim mumjesh. Pra e keqja kishte kapërcyer një prag të ri, qe hedhur në zonën e hijes, dhe kjo jo në sfera të zakonshme, por në ato mbretërore.

Ishte kaq e rëndë saqë ngjante e pabesueshme. Kaq shumë qenë zvetënuar historianët e Egjiptit sa të linin veglat e shkrimit e të kapnin levat për të grabitur në shkretëtirë të madhe?

Mirëpo pas lajmeve të para, të turbullta e të rrëmujshme, erdhën të dytat, të qeta e të sakta. Hetuesit kishin gjetur të shkallmuara jo vetëm hyrjet e fshehta të piramidave, por edhe sarkofagët. Madje edhe maskat me uthull që kishin përdorur banditët ishin ende aty, siç i kishin hedhur para se të iknin.

Mumjet, lavdi zotit, i kishin lënë në vend, po kjo s'qe veçse një rastësi. Pikërisht me to do të bëhej kobi. Të ngjethej mishtë ta dëgjoje. Kishin një plan të tërë për t'i vjedhur mumjet, për t'i nxjerrë fshehtazi jashtë Egjiptit e për t'i çuar në vende të huaja, të largëta, si në kryeqytetet armiq Artasumara ose Bogazkoy dhe më larg akoma, në ca qytete të rinj barbarë me emra të frikshëm si Athinë, Epydamnos, Trojë.

Kjo kapërcente çdo kufi. Ngjante vërtet si një delir të çmendurish, po salla e gjyqit qe atje, në mes të sheshit dhe po të doje mund të veje të tmerroheshe.

Po ç'i donin mumjet? Ç'do t'i bënin? T'i digjinin si barbarët? T'i shisnin apo t'i nxirrnin në ndonjë çardak për t'i

bërë sehir turmat, që të turpëronin kështu Egjiptin në këtë e në atë jetë? A?

Askush s'dinte të jepte përgjigje për këtë. Ata që dinin më shumë zyrtoheshin në fytyrë dhe e ulnin zërin: lëre më mirë këtë bisedë. Çeshtja është më e thellë se ç'duket.

Megjithatë diçka nisi të merrej vesh. Grupi i historia-nëve (në të vërtetë ato ishin dy, po ngaqë qysh në film u quajt «grup», kështu edhe mbeti, ndoshta ngaqë fjala «grup» në kësi rastesh kishte hije të keqe), grupi pra kishte patur ca ide të tjera, disi të çuditshme për historinë e shtetit. që binin ndesh me mendimin zyrtar për të.

Një letër anonime (lavdi zotit që ishte shpikur papirusi dhe mund të shkruheshin e kryesorja të dërgoheshin lehtë letra të tilla, ndryshe. për një hitit, kjo punë do të kërkonte së paku nja dhjetë a pesëmbëdhjetë pllaka, për të mos përmendur popuj të tjerë që përdornin ende gdhendjen në gur, kështu që letrën anonime duhej ta çonin të tërhequr së paku nga dy buaj, pa llogaritur vështirësi të tjera, si zhurma e daltës, që ndërkaq do t'i kishte nxjerrë gjumin një javë të tërë gjithë lagjes), një letër anonime pra e kishte paralajmëruar faraonin Mikerinos për rrezikun e ri.

Kaq kishte mjaftuar që puna të ftillohej shpejt. Një spiun, dy provokatorë të futur në grup kishin mbledhur të dhënat e nevojshme, gjersa pastaj, një mëngjes pa gdhirë mirë, kishte ndodhur ajo që dihej: arrestimi.

Hetimet u bënë në fshehtësi të plotë dhe pa ndërprerje. Synohej sidomos të gjendej se si u kishte lindur fillimisht ideja për të vënë në dyshim historinë e shtetit. Kur pas shumë torturash historianët pohuan më në fund se kishte qenë biseda me një hajdut varresh që ua kishte ndërruar përfundimisht pikëpamjet për historinë, kjo u mor si tallje e hapur. U vunë prapë në torturë, madje qenë të parët mbi të cilët u provua një lloj i ri torture që sapo ishte miratuar nga këshilli përkatës, por ata ndonëse fjalët i shqiptonin pak ndryshe për shkak të dhëmbëve të thyera dhe

enjtjeve të gjuhës nga thumbat e akrepëve, në thelb ripohuan të njëjtën gjë, domethënë që idenë për rishkrimin e historisë ua kishte dhënë rastësisht, një hajdut varresh i dehur në mejhanen «Te gaforrja». I torturuan prapë, por ata, (tanimë me anë të shkrimit ngaqë ajo që flisnin s'merrej vesh fare, thuajse ishte hitilishte) përsëri ngulën këmbë si mushka te pohimi i parë, madje dhanë dhe emrin e hajdutit, një farë Abd El Gurna, i njohur me nofken «Qorri».

E gjetën keqbërësin plak, dhe ndonëse ishte gjysmë i dehur kur i vunë prangat, pati aq kujdes sa të thoshte se shenjat e mbytjes në qafën e mumjes së Didufriut i kishte parë, në të vërtetë, në ëndërr.

Mirëpo ndaj të gdhirë kishte treguar gjithçka, pikërisht në ag të asaj dite, kur hetuesit, duke e zvarritur nga zinxhirët, ia behën bashkë me të te piramida e dhunuar. Kishte zhvendosur gurin që fshihte granitin bllokues, kishin hyrë në galeri ku maskat me uthull ishin ende të hedhura në një kënd, dhe me sy të çakërritur po shihnin sarkofagun e hapur, kur mbërriti me ngut kryekorrieri i pallatit për të sjellë urdhrin e faraonit që të ndalohej në çast shqyrtimi i mumjes.

Që nga ai çast një vello e re misteri ra mbi hetimet. Megjithatë si zakonisht në rastet kur sa më shumë dalja e sekretit quhet e dënueshme, aq më tepër ai del, u mor vesh pak a shumë plani i historianëve. Ai ishte vërtet makabër: të vidheshin mumjet nga të gjitha piramidat, të çoheshin në një vend të fshehtë, brenda ose jashtë Egjiptit dhe atje t'i nënshtroheshin një shqyrtimi të imët, gjymtyrë për gjymtyrë. Nga shenjat që do të gjendeshin në to: mbytje, prerje thike, vurata helmimi etj., do të hidhej një dritë e re mbi shumë ngjarje, shpjegimi i ndryshëm i të cilave do të lidhej me të tjera ngjarje, të përparshme ose të mëvonshme, çka do të vinte në dyshim gjithë historinë e gjeratëhershme të shtetit. Ajo do të shkruhej kështu krejt ndryshe, madje thuhej se gjatë bastisjes, në shënimet e të arrestuarve

qenë gjetur shprehje të tilla në formë titujsh librash apo shpalljesh si «Historia e qortuar nga mumjet» ose «Mum-historia», ose thjesht «Historia e re».

Një frymë e sëmurë u përhap kudo. Ndonëse historia-nët bashkë me grabitësin El Gurna ishin kallur prej kohësh nën dhe, turbullira që ata shkaktuan vazhdonte. Mendime të pandeshura më parë shfaqeshin aty ku nuk i prisje. Një-rëz me fytyra të lyera me gëlqere vërtiteshin kushedi pse, natën nëpër qytet. Falltarët dhe delirantët qenë shtuar. Në-për kryqëzime udhësh ata flisnin e flisnin papushim dhe vetëm pamja e ruajtësve të rendit i bënte të heshtnin.

Vihej në dyshim gjithçka, e në radhë të parë vetë pi-ramidat. Tani që ishin dhunuar dukej se qe më lehtë t'i gjykoje. Dyshohej nëse qe gjetur orientimi i saktë, yjor, trualli, këndi i pjerrësisë. Dyshohej edhe më thellë, për shi-frat misterioze dhe kumtin që ndrynin brenda. Nëqoftëse ai ishte vërtet ai që duhej të ishte, përse rrezatonte që andej një humbje drejtpeshimi?

Ejani në vete, thoshin të tjerët, ata që gjithmonë e në gjithçka kishin qenë në anën e shtetit. madje edhe kur qenë goditur prej tij, a mund të vihej në dyshim piramida?! Ajo mëshironte Egjiptin vetë. Pa të Egjipti do të ishte tjetër lloj. Ndoshta as Egjipt nuk do të quhej. Budallallëqe, përgjigjeshin të tjerët. Egjipti ka qenë edhe kur s'kishte pira-mida. E ç'pësuan babilonasit, grekët e trojanët që s'i kanë ato? Shët, mbylle gojën, me ca trojanë e grekër të pagdhen-dur dashke ta krahasosh ti Egjiptin tonë? Të isha në vendin tënd do të kërkoja ndjesë për këto fjalë.

Pati një periudhë që mishmashi u ngatërrua aq shumë saqë u shkua gjer atje që të dyshohej se ato ishin të vër-teta. U quajtën hije, gënjimpamje e përbashkët, mirazh që një mëngjes do të avullohej. Të tjerë e stërhollonin edhe më shumë mendimin. Thoshnin se ato vetë ishin, po shëm-bëllimin e dërgonin të pavërtetë, ngaqë diçka u mungonte ose diçka e kishin tepër.

Sado të marra të tingëllonin këto, përherë e më shpesh dhe jo vetëm në mbrëmje, në prag të perëndimit të diellit, ose në ag të thellë, por edhe gjatë ditës, piramidat nisën të duken si prej avulli. Aq shpesh po ndodhte kjo sa që në mëngjes shumë njerëzve u ishte bërë zakon që me të hapur sytë të kthenin kokën, në horizontin e tyre, thuajse dyshtin se s'do t'i gjenin më në vend.

Dihej se ideja e përkohshmërisë së një gjëje parathohte një ide tjetër, më të rëndë, atë të shkatërrimit. Ndonëse turbull, ajo po ngjizej aty-këtu ende tepër e druajtur, si të trembej edhe nga vetvetja: a mund të jetonte Egjipti pa piramidat? Dhe më pas: a s'mund të zhbëheshin për ta çliruar hapësirën nga ato gunga të lemerishme?

Faraoni ishte në dijeni për të gjitha këto. Raportet që sillnin rropamën njerëzore bëheshim përherë e më të zymta. Spiunëve u dhimbnin veshët nga të përgjuarit, po kjo s'ndryshonte asgjë.

Një mëngjes përpara faraonit sollën një njeri që kishte parë një ëndërr të rëndësishme: piramidën e Keopsit të mbuluar me dëborë!

Askush nuk guxonte t'i jepte shpjegim. Trembeshin nga dëborë, vetë Mikerinosi kishte zënë kokën me duar. Kurrsesi nuk e kapte dot nëse ishte e mirë apo e keqe kjo. Që piramida jepte e merrte me gjithë botën, kjo ishte e qartë. Gjersa kishte mundur të tërhiqte dëborën që nga viset e frikshme veriore, do të thoshte se kishte kohë që edhe vetë shkonte gjer atje, në mendime, në ëndrra, në udhë të tjera ndoshta.

Faraoni ndenji një kohë të gjatë ashtu. Ishte mbi fuqinë e mendjes së tij ta gjykonte ëndrrën. Vetëm dy-tri herë psherëtiu: Zot, mos më lërë!

VI)

Kronika e pleqërisë. E ndritshmja.

Nga afër, e sidomos po të ishe brenda tyre, brezat njerëzorë ngjanin të papërsëritshëm, po për syrin që i shikonte nga jashtë, atë sy që nuk ekzistonte veç në një shtatore, ato nuk kishin nga njëri-tjetri më shumë ndryshim se valët ranore të shkretëtirës.

Kishin ardhur e shkuar me dhjetëra breza me piramidat përherë sipër tyre. Ishin gjëja kryesore që gjenin dhe kryesorja që linin pas. Ndjesitë për to gjithashtu përsërite-shin në formë ciklike. Nga admirimi kalohej në mospërfillje, nga kjo te urrejtja, te shkatërrimi, për të mbërritur prapë te mospërfillja, pas së cilës vinte adhurimi, e kështu me radhë pambarimisht. Të ndara në dy grupe të mëdha ndjesitë ishin pro dhe kundra dhe në dyluftimin e tyre mijëvjeçar mund të thuhej se asnjëra as kishte luftuar, as kishte humbur. Dëshmi e kësaj ishte vetë piramida e Keopsit. Nëqoftëse rropama kundër saj nuk e kishte ndërprerë dot ngritjen e piramidave të tjera, ajo kishte arritur t'ia ndalonte racës rritjen e shtatit, madje t'ia ulte atë. Si ata që nuk duan të tërheqin vëmendjen në një shesh të rrezikshëm asnjë nga faraonët e mëvonshëm s'kishte dashur ta ngrinte varrin aq lart sa Keopsi. E mira dhe e liga përplasëshin së pari mbi të, ashtu si natën e katërmbëdhjetë shkurtit, kur njeriu me leckë, që kishte ditë të tëra që vërtitej në shkretëtirë, ndaloi pikërisht përpara saj.

Ndonëse hetuesit më vonë mbushën fletë të tëra me monologët e tij, asnjëherë nuk u mor vesh ç'ishte: endacak anonim, nga ata që lëviznin si rëra dhe si rëra humbin, faraon i rrëzuar, eunuk, matematicien epileptik apo astrolog leckaman, i ikur nga çmendina.

Një copë herë të gjatë ulëriu përpara piramidës, : ra tokës me grushte dhe me ballë, qeshi, u zgërdhi, pastaj e sheshoi rërën me dorë dhe me ngut prej të marri nisi të vizatonte sipër saj vija dhe figura gjeometrike. Pastaj përbri tyre filloi të shkruante shifra e të bënte përlllogaritje të pafundme.

Akuzën se donte të dëmtonte piramidën e kundërshtoi me ngulm duke thënë se donte vetëm ta varroste. Ajo ishte e vdekur, më kuptoni, dukej që larg që s'ishte veç një kufomë. Dhe si çdo kufomë duhej varrosur.

Me orë të tëra, siç e kishte rrëfyer vetë, kishte përlllogaritur gropën që duhej të hapej për ta futur, sasinë e dheut të gërryer, të njerëzve që duhej të gërmonin, të kohës së punimeve etj. etj. Do të duhej më shumë kohë dhe mund se sa për ndërtimin e saj, kështu që një diktaturë e re, mund ta shfrytëzonte fare mirë rrënimin, ashtu siç kishin shfrytëzuar të vjetrat ngritjen.

Asnjëherë nuk iu përgjigjej çartë hetuesve ç'kuptim kishin këto fjalë të fundit. Ashtu siç nuk e shpjegoj kurrë se ç'do të thoshte «piramidë e vdekur», dhe si e kishte kuptuar ai një gjë të tillë.

Mos qesh, i ulërinin hetuesit, ndonëse ai nuk qeshte aspak, veç fytyra i dukej ashtu nga shenjat e torturave. Ajo dukej menjëherë që s'ishte më e gjallë, ngulmonte. Mjaftonte t'i hidhje një sy që larg. Ideja e saj kishte vdekur, më kuptoni?

Në muret e burgut kishte vazhduar llogaritjet e tij, këtë herë për kohën e tretjes së piramidës. Kjo ishte edhe më e vështirë ngaqë duheshin marrë parasysh gërryerja e ngadaltë e erës, që në brinjët e ndryshme frynte me shpejtësi të ndryshme, ndryshimet e temperaturës midis ditëve dhe netve, lagështia që vinte nga Nili, deri te glasiat e zogjve, ose kalimi sipër saj i rrëshqanorëve, që ndonëse qenë të rrallë, po për në një kohështrirje prej gati një milion vjetësh

(kaq mendohej koha e tretjes së plotë), luanin një farë roli në dobësimin e gurëve.

Koha, murmuriste me vete kur rrëzohej i cilitur mu në rrëzë të murit, veç ajo do të të zhdukë nga faqja e dheut.

Piramida plakej vërtet tepër ngadalë. Për syrin njerëzor ndryshimet e saj qenë krejtësisht të pavërejtshme, me përjashtim të ngjyrës së bardhë në të kuqërremtë, që e humbi shumë shpejt. Rrudhat e para iu shfaqën pas tetëqind vjetësh. Ishte një gur i brinjës perëndimore që i pari mori krismë tejpertej një pasdite dhjetori. Përpara tij kishin plasur në thellësi nga shtypja gjastë të tjerë. Duhej të kishin plasur edhe të tjerë, por ato ishin krejt brenda, pa kurrfarë dalje në ndonjë mur a galeri të brendshme kështu që asnjë sy njerëzor s'mund të shihte ç'u kishte ndodhur. Madje dhe në rastet kur mbyturazi qe dëgjuar krisja e tyre, kurrsesi nuk qe e mundur të përcaktohej vendi i saktë e aq më pak ç'gurëve u kishte ndodhur ajo.

Përpara se t'u vërehej gërryerja e parë, katërmbëdhjetë gurëve të këndit veriperëndimor u ra një ngjyrë e sëmuri gri. Gërryerja u duk qartë pas dyqind e shtatëdhjetë vjetësh, veç jo vetëm atyre, po pothuajse krejt rreshtit. Ishte brinja që e rrihte më shumë era e shkretëtirës, kështu që ndonëse për të ishin zgjedhur gurët më të fortë, nga guroret e Asuanit, kjo gjë pritej ndaj dhe nuk habiti askënd.

Njëqind e njëzet vjet më parë shenja të hirta në mavi, madje edhe njolla të vogla në formë puçrrash u dukën në mjaft gurë të faqes jugore, në një renditje krejt të çrregullt, gjë që e bënte të vështirë gjetjen e shkakut.

Gërryerjet nisën të duken qartë në të gjitha këndet, madje dhe në faqet veriore e perëndimore pas një mijë e

pesëqind vjetësh, kurse në faqet e tjera, aty ku era rrihte më pak, shumë kohë më pas. Ato ishin nga më të ndryshmet: në formë poroze, plasaritjesh, lugjesh të vegjël, vrimash dhe tek-tuk këputjesh. Por shumica ishin të pavërejtshme në vështrimin e parë. Vetëm po të përqendroheshë gjatë do të gjeje mbi gur lloj-lloj gjurmësh të fërkimit të erës, disa herë në format më të papritura. Kështu u bë i dëgjuar një gur i faqes veriore sipër të cilit nga gërryerja u duk se po spikatnin ca si tipare njerëzore, një hije mollëzash dhe ca si vetulla, thujse një fytyrë e largët rrihte të dilte që brenda në sipërfaqe. Fjala shkoi gjer në pallat dhe një kohë të gjatë vranë mendjen se ç'duhej të bënin më të: të ndërhynin (me daltë apo me mjete më fine), për ta ndihmuar pamjen të shfaqej, siç bëhej për lindjen e fëmijës, apo të prisnin sa ajo të dilte vetë.

Faraoni ishte për ndërhyrjen, ngaqë i jepte rëndësi shenjës dhe kishte padurim për ta marrë vesh, kurse kryeprihti kishte mendim të kundërt: një dhunim në këtë rast mund të kishte pasoja fatale. Vendosën pra të prisnin atë që do të ndodhte vetë dhe te guri u vunë ditë e natë roje. Mirëpo me kalimin e kohës spikama mbi gur nisi të mjegullohet, thujse fytyra e panjohur po pendohej dhe po zhytej prapë në thellësi, çka te disa shkaktoi dëshpërim e te të tjerët një psherëtimë lehtësimi.

Pavarësisht nga të gjitha këto, askujt nuk i shkonte ndërmend se piramida po plakej. Qenë anëtarët e një dërgate të filozofëve grekë që e thanë të parët këtë. Sapo e panë, madje pa u afruar aq sa të dallonin intësitë, ata thirrën në një gojë: ah, ajo ka nisur të plakët!

E kishin thënë këtë me dhimbje, me ligësi apo gëzim, kjo nuk qe e mundur të merrej vesh. Kryesorja ishte se fjalët e tyre shkaktuan një tronditje kudo. Dhe befas shumë njerëzve iu duk se po dallonin qartë atë që gjer tani nuk e kishin vënë re: e parë në tërësi piramida s'dukej aspak e bardhë dhe e lëmuar siç e tregonin gravurat e vjetra,

por me faqet tërë zhubra, si një qenie lëkura e së cilës ishte egërsuar nga urdhja ose rrjebulla.

Po kjo ishte e përkohshme. Shumë kohë më vonë, si gruaja që ridëshmon moshën e saj të re me anë të pjelljes, piramida tremijë e pesëqind e ca vjeçare tashmë nisi të dërgonte shëmbëllimet e saj larg.

Përndritje, pamje të paqëndrueshme, horizontikëse, idera vetanake, shtyheshin duke u kalamendur ngado. Atëherë u kujtua ëndrra e dikurshme për piramidën e mbuluar nga bora, ajo që paratha e para se piramida do të dërgonte pamjen e saj nëpër botë.

Flitej se në stepat aziatike një sundues e kishte ngritur ndërkaq një piramidë, veç jo me gurë, po me kafka njerëzish.

Në të tjera vende e kohëra forma e saj ndillte idera më të përgjithshme, struktura qeverisjeje e hierarkie, që me vështirësi besohej se e kishin zanafillën në shkretëtirën e Saharës.

Një mëngjes, një turist flokëverdhë, që po e fotografonte pati një dëshirë të papërmbajtur që ajo të ishte e tejdukshme, në mënyrë që pas qelqit të shiheshin brendësitë e saj, mumjet dhe sarkofagët dhe misteri i padeshifrueshëm.

Turisti kishte ngritur kokën për të parë diellin dhe retë e lehta në të, si të bindej se ato ishin i vetmi mjet që shëmbëllimin e saj mund ta çonin larg, anekënd planetit. në verilindje, perëndim, veri, atje ku nuk kishte piramida, po ku, me sa dukej, kishin nevojë për to.

Tiranë, shtator 1989

NATA ME HËNË

Në fillim ne nuk kuptuam asgjë dhe kjo ishte e naty-
shme. Mbrëmja me rastin e fitimit të flamurit të garave
prej ndërmarrjes sonë u bë të nesërmen e ditëlindjes së
Cezarit, kështu që ne ishim ende të trullosur prej saj. Ishte
pikërisht ajo darka e famshme kur Lad Kroj, pak para mes-
natës, u ngrit nga gostia dhe tha se do të shkonte në spital
të bënte një encefalogram. Mezi e mbajtëm dhe e bindëm
të shtrihej një copë herë për të marrë veten në divanin
e kuzhinës, prej nga u ngrit përsëri, pas një çerek ore, duke
kërkuar këtë herë të bënte një letër në qeveri kundër drej-
torisë së përgjithshme të ujërave. Nuk e kuptuam dot as-
njëherë nëse kishte ndonjëfarë arsyeje, qoftë dhe të tërthor-
të, për të përmendur encefalogramin: apo drejtorinë e ujë-
rave. Çështje të subkoshiencës, kishte thënë Cezari, i vetmi
që kishte pirë më pak se të tjerët dhe që disi e mbante ve-
ten. Mirëpo, si për të vendosur një drejtpeshim të gjërave,
të nesërmen në mëngjes, kur të gjithë ne ishim zgjuar, vër-
tet me kokë të rëndë dhe me sy të fryrë, po sidoqoftë të bërë
esëll, Cezari, përkundrazi, qe ngritur nga gjumi i dehur tapë,

thua se kishte vazhduar të pinte në ëndërr. Pasi kishte dhënë ca mendime krejt të çuditshme për gërrhitjen e njerëzve, ai kishte bërë pak a shumë ato proçka që në i kishim pritur në fakt prej Lad Kroit, gjersa ishte shtrirë përsëri, këtë herë për t'u bërë esëll vërtet.

Pavarësisht nga këto hollësi, duhet thënë se në mbrëmjen e ndërmarrjes në të gjithë e kishim kokën të turbullt, kështu që nuk i vumë re shenjat e para të armiqësisë ndaj Marianës. Në të vërtetë në mbrëmje s'ndodhi asgjë e bujshme, që mund të merrej si veprim apo prije e hapët kundër saj. Ajo vetë kishte ardhur e veshur dhe e krehur bukur si zakonisht, nuk kishte treguar asnjë shenjë bezdie, apo nervozizmi, madje në fillim kishte qenë e qeshur po, më pas, duke ndier, siç duket, një frymë të ftohtë, që tkurrur disi dhe i kishte rënë një tis trishtimi. Ishte pikërisht kjo që, me sa duket, kishin pritur dashakeqët e saj, sepse porsa i pikasën shenjën e parë të brengës në fytyrë, shpërthyen një hare të papritur, si për të theksuar enkas ndryshimin midis gëzimit të tyre dhe pikëllimit të saj.

Më vonë, kur u kthyem e u rikthyem shumë herë tek ajo mbrëmje për të analizuar atë që kishte ndodhur, në ishim të një mendjeje se Mariana s'duhej të kishte rënë në atë kurth. Pavarësisht se ajo e kishte ndier frymën armiqësore, duhej të kishte bërë sikur nuk kishte vënë re dhe kështu do t'i kishte prishur planet e tyre. Mirëpo, ajo s'arriti t'i shmangej kurthit dhe bëri atë që ata e prisnin me padurim: u pikëllua. Ky pikëllim që ajo e tregoi hapur me fytyrën e saj, ishte triumfi i tyre. Ai ishte vërtetimi i akuzës që ata, ç'prej disa ditësh, po kurdësnin kundër Marianës. Dhe akuza ishte e ulët, meskine: Mariana, sipas tyre, kishte bërë çmos që të prishte lidhjen midis Norës dhe Gazmendit dhe, tani që ata ishin fejuar më në fund, ajo gjoja vuante dhe bëhej xheloze për Gazmendin.

Ja përse, sapo u shfaq shenja e parë e mërzisë në fytyrën e Marianës, Nora bashkë me klanin e saj pësuan një elektrij

zim të beftë, një gjallërim dhe përndezeje që e shtonin dhe e mbanin gjallë me këmbëngulje. Sado që qe përpjekur ta mbante veten, Mariana nuk i kishte sfiduar dot. Ajo kishte rënë, siç duket, në gjendjen që bie shpesh njeriu i ndershëm kur, duke e patur ndërgegjen të pastër, i hap udhë furisë të së keqes. Asaj, siç e shpjegoi vetë më vonë, iu duk se ishte e natyrshme që të tulatej kështu sa më tepër që gufmohej hareja, për të mos thënë historia e tyre. Le të kënaqeshin, meqenëse kjo gjë u pëlqente kaq shumë, kishte thënë ajo.

Natyrisht, ishte lehtë të thoshe më vonë se s'duhej të vepronte kështu, se kishte bërë lojën e tyre etj. Atëherë ishte herët për Marianën të kuptonte gjithë përmasat e mekanizmit që ishte vënë në lëvizje kundër saj. Ajo nuk dinte ende parapërgatitjen që ishte bërë, pëshpërimat gojë më gojë, në laborator dhe në zyrat e administratës, dhe kryesorja ishte që ajo nuk e dinte se shumë njerëz, që ishin të paanshëm në këtë histori, prisnin mbrëmjen e vallëzimit, që ishte dhe mbrëmja e parë ku Nora me Gazmendin do të vinin si të fejuar, për të parë sa të vërteta qenë fjalët e hapura për gjoja xhelozinë e Marianës ndaj lumturisë së shoqes së saj.

E keqja ishte se as shoqet e saj të ngushta nuk kishin nuhatur gjë, pa llogaritur pastaj treshen tonë («prapavijën e Marianës», siç na kishte quajtur nëndrejtori në një bisedë shefash), që të trullepsur pas darkës te Cezari, s'ishim në gjendje për asgjë. Por edhe sikur të kishim dëgjuar diçka, me siguri do të kishim qeshur dhe s'do t'i kishim dhënë asnjë rëndësi. Duhej të ishte i keq në shpirt që të besoje një gjë të tillë. Gazmendin e njihnim të gjithë, ashtu siç njihnim Marianën. Ai ishte një njeri jo i keq, po fare i rëndomtë, për të mos thënë mediokër nga çdo pikëpamje. Mund të përfytyronim çdo gjë, po kurrsesi atë që Mariana të mund ta pëlqente, madje të bëhej xheloze për shkak të tij. Sa për gjoja rivalitetin midis Marianës dhe Norës, në qoftë se hamendja e pëlqimit të Gazmendit prej Marianës

të bënte të qeshje, kjo e dyta, domethënë rivaliteti, të bënte të shqyheshe gazit. Asnjë pikë krahasimi s'gjendej midis tyre nga çdo pikëpamje, duke filluar nga inteligjenca, kultura e finesa, gjer te pamja e jashtme, sidomos shkurtësia e Norës, e cila, sa më tepër ajo përpiqej ta korrigjonte me anë të takave të larta dhe modelit të flokët «topuz», aq më shumë i theksohej.

Për një kohë të gjatë ne vramë mendjen të gjenim nëse besonte vërtet Nora bashkë me klanin e saj në këtë, apo ky s'ishte veçse një rivalitet i vetëshpallur nga pala më e dobët, si e vetmja mënyrë për të krijuar një lidhje apo një pikë referimi me palën më të fortë.

Sidoqoftë arsyeja e vërtetë e gjithë kësaj stuhie dhe sidomos e mllëfit të Norës kundër Marianës mbeti enigmatike për ne për një kohë të gjatë. . . Por le të kthehemi te mbrëmja e vallëzimit.

Atje, siç e thashë dhe më parë, s'ndodhi asgjë për të rënë në sy, me përjashtim të faktit që Mariana e la përgjysmë vallëzimin me Qemalin nga dega e planit. Nga shprehja e fytyrës së Marianës s'ishte e vështirë të kuptoje se ajo e ndërpreu vallëzimin në formë proteste, duke mos e fshehur përbuzjen dhe njëfarë nervozizmi ndaj partnerit. Megjithatë, duhet thënë se në një mbrëmje vallëzimi, të tilla gjëra janë të zakonshme, aq më tepër po të kesh të bësh me një tip si Qemali, që siç thoshte Lad Kroj, të zgjonte vetvetiu dëshirën «për t'i bërë një modifikim në portret», domethënë për t'ia thyer turinjtë. Dhe në të vërtetë ne mund t'ia thyenim turinjtë që atë mbrëmje, sikur ta dinim bisedën e vërtetë që qe zhvilluar midis tij dhe Marianës. Ne mund ta bënim këtë lehtë, qoftë dhe aty, mu në mes të mbrëmjes, sepse gjendja jonë disi e trullosur, nëse mund të ishte pengesë për të kapur gjëra fine e delikate, ishte përkundrazi tepër e përshtatshme për të ndërmarrë veprime brutale e verbërisht të furishme.

Sidoqoftë, fill pas incidentit me Qemalin, unë u ngrita

të vallëzoja me Marianën dhe gjéja e parë që bëra ishte ta pyesja nëse kishte ndodhur gjësend. Ajo tundi kokën me neveri dhe, përveç fjalëve «idiot» dhe «inorant», nuk tha asgjë tjetër për Qemalin, gjë që më bëri mua, dhe më pas të gjithëve ne, të mendonim se ishte fjala për ndonjë nga ato ngacmimet e rëndomta banale, me të cilat janë të mbushura plot mbrëmjet e vallëzimit.

Megjithatë, ndërsa vallëzoja me Marianën, m'u duk se pikëllimi dhe plagosja në sedër, që ajo nuk i fshihte më, ishin disi më të gjera dhe e kapërcenin Qemalin. Kur unë, duke e hapur bisedën për herë të dytë për të, duke dashur t'i shpjegoj se, po të donte ajo, ne mund t'ia tregonim vendin qysh atë mbrëmje, Mariana një hóp më vështroi disi habitshëm, thua se nuk po e kuptonte për kë po bëhej fjalë. Pastaj, si të përmendej, tha: «ah, e ke fjalën për atë idiotin,» dhe bëri prapë një gjest përbuzjeje dhe mospërfilljeje. Ishte e qartë se diçka tjetër, më e thellë dhe më plagosëse e kishte lënduar.

Një copë herë vallëzuam pa folur dhe mua m'u duk se ajo me vështirësi e mbyti një psherëtimë. Po ndërsa arriti ta shuante atë në organet e frymëmarrjes, psherëtimja u shkëput prej saj nëpërmjet duarve, ose së paku kështu m'u duk mua. Duke ndier krahun e saj të brishtë mbi supin tim, unë befaz e kuptova se gjatë gjithë kohës që e njihja Marianën, s'kisha bërë gjë tjetër veçse i isha shmangur dashurimit pas saj. Ndoshta shokët e mi kishin bërë të njëjtën gjë dhe ishte ndoshta pikërisht kjo marrëveshje e heshtur midis nesh që kishte krijuar atë qëndrim të veçantë, të për-bashkët, ku përziheshin respekti, mtkrojtja e largët dhe një distancë e mjegullt prej saj.

Kur vallëzimi mbaroi, u thashë shokëve atë që mendoja, domethënë se ajo që kishte ndodhur duhej të ishte ngacmim banal i Qemalit dhe, pasi Lad Kroi tha se në rast përsëritjeje atij mund t'i bëhej «modifikimi i portretit», ata e hoqën mendjen që andej.

Më vonë, kur u përpoqëm t'i risjellim të gjitha ndër mend, me aq renditje të rregullt sa lejonte një mbrëmje vallëzimi, gjithsesi nuk e gjenim dot nëse ishte vënë Qemall me qëllim për të shkaktuar një zymtim të mëtejshëm të Marianës dhe, me të mbaruar rolin e tij, qe hequr mënjanë, apo ndërhyrja e tij s'ishte veçse një rastësi, që u shfrytëzua nga pala tjetër. E vërteta ishte se qysh më parë Mariana e kishte humbur gëzimin me të cilin kishte ardhur në mbrëmje dhe incidenti me Qemalin s'kishte bërë gjë tjetër veçse e kishte dendësuar hijen e trishtimit mbi fytyrën e saj. Bashkë me këtë qe shtuar lëvizja e etshme midis shoqeve të Norës, të cilat venin sa andej-kënde, ndërronin vendet, uleshin një hop përbri njëra-tjetrës duke pëshpëritur diçka që përfundonte patjetër me një shpërthim të qeshuri. Tani jo vetëm ato, por edhe sy të tjerë, gjer atëherë të paanshëm, vështronin me kërshtëri herë në drejtim të çiftit të ri, herë në atë të Marianës.

Natyrisht që ne, në gjendjen që ishim, nuk i kapëm dot këto rryma të nëndheshme, të cilat, për hir të së vërtetës, duhet thënë se është vështirë të kapen në një mjedis të tillë si mbrëmja e vallëzimit, ku gjithçka është lëvizje, të qeshura dhe nënteskt.

Në qoftëse ne kishim një vëmendje të vetvetishme mbrojtjeje ndaj Marianës, sidomos pas vallëzimit me Qemalit, kjo u kufizua kryesisht rreth atij vetë dhe, përveç tij, rreth dy njerëzve të tjerë: Filip Dibrës, me të cilin ajo kishte patur marrëdhënie vitin që shkoi, dhe Terit, kryegaripit të ndërmarrjes.

Filipi, që punonte që prej dy vjetësh te ne si kimist, ishte i vetmi që kishte patur një lidhje të shkurtër me Marianën, lidhje që qe ndërprerë pastaj prej Marianës për arsye që nuk i kishim marrë dot vesh. Si zakonisht në kësi rastesh, u folën gjithfarë pandehmesh, njëra më e papritur se tjetra, por e vërteta mbeti që mbeti e errët. Vetë Filipi, në kundërshtim me shumë meshkuj që në raste të tilla bë-

hen të këqinj dhe shtrembërojnë të vërtetën, e kishte pohuar se qe Mariana që e kishte lënë, duke i shkaktuar atij një traumë të vërtetë. Njëfarë kohe pas ndarjes së tyre ne pritëm që ai të ndërmernte ndonjë hakmarrje kundër saj, hakmarrje që, siç qe shprehur Lad Kroj, do të shkaktonte «modifikimin e portretit të tij gjer në surrealizëm». Mirëpo ai s'bëri asgjë të tillë, u tërhoq mënjanë dhe nuk u ndie fare, thua se midis tij dhe Marianës s'kishte patur asgjë.

Më pas, kur filluan të frynin erërat kundër Marianës, ne pritëm përsëri që ai të lëvizte, por ai prapë nuk u ndie. Me siguri klani i Norës do të qe përpjekur ta shfrytëzonte në fushatën e tij, por ai nuk kishte rënë në atë grackë. U tregua i admirueshëm, s'ke ç'i thua, megjithëse Cezarit i dukej i tepruar ky epitete për të. Sipas tij nuk mjaftonte vetëm që Filipi të mos merrte pjesë në fushatën kundër ish-vajzës së tij, por ai duhej të ngrihej në mbrojtje të saj në kohën e akuzave të mëdha, sepse askush më mirë se ai nuk qe në gjendje për ta bërë këtë. Kështu mendonte Cezari, po ne nuk qemë në një mendje me të. Ishte herët të kërkohet një përsosmëri kaq e madhe e njerëzve.

Kështu pra, atë mbrëmje, pas incidentit me Qemalin, ne hapëm sytë (aq sa na lejonte turbullira e natës së kaluar), për të parë mos kishte ndonjë lidhje midis ngacmimit të Qemalit dhe Filipit dhe u qetësuam kur vumë re se Filipi, që rrinte në një kënd të sallës, me dy shokë të vet, ngjante si i shkëputur krejt nga salla e mbrëmjes.

Sa për Terin, ai shkoi ta ftonte Marianën fill pas një vallëzimi me Norën, pasi kishte qeshur në mënyrë të bujshme me të, po Mariana e refuzoi. Teri, që ishte mësuar me fyerje të tilla, e kaloi atë me të shkelur të syrit drejtuar gjithë atij këndi të sallës ku rrinte refuzuesja dhe, pas ca sekondash, u pa të vërtitej në vallëzim me magazinieren.

Sado të turbullt të ndiheshim, nuk e kishim të vështirë të vinim re këndeje e tutje, se sa më tepër që fytyra e Marianës pikëllohej, aq më shumë shtohej gëzimi, përndeja

dhe një lëvizje e ethshme e tërë zhganit të Norës. Tani ishte e qartë se ishte pikëllimi i saj që e ushqente tërë atë trazim ngazëllyes, një pikëllim i veçantë, shkretues dhe i pashpresë, që bëhej i tillë, ndoshta nga vetë fakti që Mariana po bëhej e ndërgegjshme se ajo vetë e ushqente atë helm kundër vetes së saj, po që nuk qe në gjendje të bënte asgjë për ta ndaluar rrjedhën e gjërave.

Turbull ne filluam të kapim diçka, po, të painformuar siç ishim, zor se mund të ndërmerrnim gjësend për ta lëhtësuar gjendjen, ndaj s'bëmë gjë tjetër veçse e lamë veten të na kapullonte një ndjenjë faji, që rrallë e kishim provuar në jetë.

2

Ajo ishte me të vërtetë mbrëmja më e hidhur e vallëzimit në të cilën Mariana kishte marrë pjesë ndonjëherë. Në çdo rast do të kishte ikur e do ta kishte lënë përgjysmë, po rrethanat u krijuan të tilla, që, kur ajo e kuptoi se s'duhej të qëndronte më, ishte vonë të tërhiqej, sepse mekanizmi i kurthit kishte vepruar.

Kishte ardhur tërë qejf, si zakonisht, dhe ndihej e lehtë dhe e gëzuar si rrallëherë. Në vallëzinin e parë e mori Cezari, i cili i tregoi disa nga qyfyret e darkës së datëlindjes, për të cilat qeshën të dy. Pastaj, duke folur për gjithfarë gjërash, fjala sesi ra për tumoret beninje dhe Cezari, që i pëlqenin paradokset, tha se dikur kishte lexuar se qelizat kanceroze, ashtu të çmendura dhe me energji të jashtëzakonshme siç ishin, mund të shfrytëzoheshin për të pjellë trupa të gjallë të hatashëm. Uf, ç'bisedë, tha Mariana, po tjetri e vazhdoi gjer në fund mendimin duke thënë se s'ishte e rastit që grekët e vjetër i përfytyronin perënditë duke

nxjerrë qenie të tjera hyjnore nga gjymtyrët e tyre. Zousi e ka nxjerrë Athinën nga truri, apo dikë tjetër nga pulpa e këmbës, të kujtohet që e kemi bërë në fakultet? vazhdoi ai. E pra të gjitha këto hyjni e hyjnesha s'kanë qenë veçse tumore beninje.

Mariana kishte qeshur prapë me gjithë zemër dhe në vallëzimin tjetër me Lad Kroin kishte dëgjuar qyfyra të tjera për darkën e famshme. Përbri tyre vallëzonin Nora me Gazmendin, po ajo s'vuri re asgjë të veçantë, qoftë në sjelljen e tyre, qoftë në të të tjerëve. Ishte shoqja e saj e ngushtë Dir, që i pëshpëriti kur u ul në vend:

— Ç'kanë këto kështu?

— Kush? — pyeti Mariana.

— Po ja, Nora, shoqet e saj...

U desh një copë herë që Mariana të kuptonte se ishte fjalë për ca shikime tinzare, për një ndjekje me sy të Marianës nëpër sallë dhe ca pëshpërima vesh më vesh të tyre.

— Ah, pa shiko, — tha ajo, — budallallëqet e tyre.

Kështu tha, por në vallëzimin tjetër vuri re se ajo që i shpjegoi Dir jo vetëm ishte e vërtetë, po kishte aftësinë të të bezdiste.

Marrëzira, tha me vete dhe u përpoq ta hiqte mendjen andej, megjithatë e ndjeu se këmbë i humbën atë lehtësinë e fillimit në vallëzim. Kishte ca ditë që kishte ndier një ftohtësi të dukshme nga gjithë grupi i vogël që njihej si shoqëria e Norës. Çudi, kishte thënë me vete, njeriu kur është i lumtur për vete, bëhet më zemërgjerë edhe me të tjerët, kurse me Norën po ndodh e kundërta. Qyshse kishte shpallur fejesën me Gazmendin, para dy javësh, kishte ndryshuar qëndrimin ndaj saj.

Mariana s'i kishte dhënë asnjë rëndësi kësaj dhe vetëm tani, në mbrëmjen e vallëzimit, iu kujtua se disa nga shoqet e Norës, lajmin për fejesën e saj ia kishin dhënë të shoqëruar me një shikim hetues këmbëngulës. E more vesh, Nora me Gazmendin u fejuan Mariana, e dëgjove, Gazmendi me

Norën... Ishte aq këmbengulëse, sa që ajo desh tha: po e dëgjova një herë, s'jam shurdhe...

— Ti ke të drejtë, — i tha Dimit, kur u ul prapë bri saj.

— Po nuk e kuptoj ku e kanë hallin

— Bëjnë vazhdimisht çu-çu-çu dhe nuk t'i ndajnë sytë. Është vërtet e neveritshme.

— Mos kujtojnë se...

— Pikërisht, prandaj më duket idiote e gjithë kjo

Në një rast tjetër Mariana do të qeshte me të madhe, po zembereku i të qeshurit dukej si i këputur në qeniet e saj.

Mos kujtonin se... Dy muaj më parë, pas një mbledhjeje që zgjati gjer tepër vonë, Gazmendin, që e kishte një pjesë të rrugës me Marianën, e kishte shoqëruar atë për në shtëpi. Ishte një natë e butë me hënë dhe Mariana kishte një gjendje shpirtërore si të sfungjëritë, të ngopur me atë lagështi hëne. Kalonin përmes një trualli bosh, të hapur, me sa dukej për ndonjë ndërtim dhe drita e hënës, duke rënë mbi gurëzit e rrugicës së përkonshme, e shndërronte atë rruginë në një gjerdan perlash.

Përbri tyre, mbi stendat e gjata prej druri që rrethonin kantierin e ardhshëm, ishin ngjitur gjithfarë afishesh teatrosh e koncertesh, në dy-tri prej të cilave dallohej fjala «dashuri». Mariana nuk e kuptoi dot as vetë nëse ishin afishet apo gjerdani i krijuar prej hënës që u bë shkak të pyeste shoqëruesin e saj:

— A është e vërtetë që burrat e kanë dashurinë më të fortë se gratë?

E ndjeu në çast se njeriu të cilit po ia drejtonte ato fjalë nuk ishte aspak i përshtatshëm për një bisedë të tillë, por ajo do ta bënte ndoshta atë pyetje edhe sikur të ishte vetëm.

Gazmendin kishte ngritur supet pa ditur ç'të thoshte dhe ajo kishte vazhduar:

— Më ka mbetur në mendje një strofë nga një vjershë e një poeti të viteve tridhjetë:

*Për dashurinë, o Zot,
Që shëmb një burrë,
Që s'e pat ndjerë dot
Gruaja kurrë.*

Gazmendi përsëri kishte lëvizur supet, pastaj në hesh-tjen që qe krijuar, duke fantazuar befas kushedi çfarë, i kishte hedhur asaj një shikim të lyrshëm, gjithë nënkuptim, pas të cilit ajo kishte ndier atë zilen e alarmit që binte brenda saj sa herë që dikush keqinterpretonte fjalët apo gjestet e saj. Kishin mbaruar stendat e drunjtat dhe bashkë me to afishet e koncerteve, pa të cilat nata u duk si e lënë në injorancë dhe ajo shpejtoi t'i thotë: «natën e mirë» pa i lënë kohë që ai t'i fliste ndonjë gjë.

Që nga dritarja e apartamentit e pa të largohej ngadalë madje të kthente një herë kokën pas dhe, duke u përpjekur të merrte me mend se si mund t'i kishte kuptuar fjalët e saj, përfundimisht u pendua që ia kishte thënë. Kishte bindjen se shumica e djemve i keqkuptonin shpërthime të tilla të vetvetishme të mendimit apo të ndjenjave dhe aty për aty ngrinin kthetrat për të përfituar prej tyre.

Të nesërmen e të pasnesërmen, këmbëngulshëm, me një mospërfillje të ftohtë ajo e shoi atë ndriçim të syve të Gazmendit, që u shfaq disa herë gjatë takimeve te bufeja apo në autobus, gjersa në shikimin e tij s'mbeti veçse një bosh hutaq, pyetës dhe gdhë.

Tani, tek i shikonte të venin e të vinin te njëra-tjetra, mendonte mos ia kishte treguar atë episod Norës dhe ajo shoqeve e tani kushedi ç'fantazonin të gjitha si bibat, me ato mendjet e tyre, që duke qenë të ngushta për çdo gjë, zgjeroheshin vetëm për budallallëqe të tilla. Ndryshe si mund të shpjegohej gjithë ai elektrizim që ato jo vetëm nuk e fshihnin, po donin ta vinin sa më tepër në dukje. Dhe ajo ftohtësi e javëve të fundit. Uf, një idiotësi e vërtetë, mendoi

ajo, duke u përpjekur të qetësonte veten me mendimin se nuk mund të ishin aq pa mend sa të besonin në gjëra kaq të paqena. Megjithatë, bashkë me trishtimin, ndjeu ta kapte një angëzshë që rrallëherë e kishte provuar.

Në atë kohë erdhi për ta marrë në vallëzim Qemali.

S'i kishte pëlqyer kurrë ai tip, me vetësigurinë që kërkonte ta vinte në dukje kudo, po tani, e nervozuar siç qe nga ajo që po ndodhte përreth, iu duk edhe më i bezdisshëm.

— Sonte je më e bukur se kurrë, — i tha ai, pas minutës së parë të heshtjes. — Siç duket trishtimi të shkon.

— Trishtimi? — ia ktheu ajo. — S'e kisha menduar... Megjithatë po përpiqem ta heq, ndonëse më shkoka...

E kuptonte dhe vetë se ishin fraza të kota, të varrëra, po kjo s'e ndihmonte dot të shkëputej prej tyre. Me tipa të tillë si Qemali niveli i gjithçkaje binte, ishte e kuptueshme.

— Dëgjo, — tha ai dhe pas një heshtjeje tjetër, këtë herë me një ton të ndryshëm, serioz. — kam kohë që kam dashur të ta them, besoj se e ke kuptuar dhe vetë që...

— Mjaft. — e ndërpreu ajo. — S'ka nevojë.

Ai mori frymë rëndë.

— Pse kaq arrogante? Me disa je më e butë, ke qejf të filozofosh për dashurinë, nën dritën e hënës...

— Si?!

— Desha të them...

Ai idioti, Gazmendi, me sa duket, s'kishte qëndruar dot pa e treguar atë copë rrugë që kishin bërë bashkë. Po faji kishte qenë i saj, mirë ia bënin.

— E ç'do të thuash me këtë? — tha ajo me një ton të hidhur — Çdo njeriu i pëlqen me dikë të flasë për dashurinë e për hënën e me dikë jo. Me ty, për shembull, s'do të më pëlqente kurrë.

— Ashtu?

Në fytyrën e tij u shfaq ajo buzëqeshja e ligë që sinjalizonte grumbullin e helmit hakmarrës.

— Po ai që të pëlqen ty të iku nga duart.

Ndyrësirë, mendoj ajo, por atij s'i tha asgjë, vetëm iu shkëput dhe i ktheu krahët për të shkuar në vend.

— Ç'të ndodhi? — pyeti Diri tërë alarm.

— Ndyrësira, — tha Mariana.

— Qetësohu. Ato të gjitha i kanë sytë këndej.

U desh njëfarë kohe që Mariana ta merrte veten. Pastaj, kur fill pas kësaj erdhën ta merrnin për të vallëzuar shokët e saj, duke i treguar haptas se ishin gati të ndërhynin për t'i treguar vendin kujtdo që kujtonte se mund ta ngacmonte, asaj gati sa nuk iu mbushën sytë me lot nga ndjenja e mirënjohjes. Megjithatë si t'ua shpjegonte atyre se e gjithë ajo që po sajohej rreth saj ishte e bazuar mbi një spekulim, për të cilin njëfarë faji e kishte ajo vetë, përderisa ato fjalë për hënë e për dashurinë i kishte thënë vërtet, po kurrsesi me atë qëllim. Ose për të qenë gjer në fund e sinqertë, në atë mbrëmje të butë hëne ajo kishte qenë vërtetë e prirur për një ëmbëlsi, ndoshta për një për-qafim, veç kjo s'kishte asnjë lidhje me Gazmendin, ishte diçka e përgjithshme, e papërcaktuar, ashtu siç thuhej në vargjet e këngës: se s'dashuroja as unë, as ti, po dashuronte dashuria... Mirëpo, si mund t'ua shpjegonte këtë? Së paku duhej të ishte vajzë që diçka të kapje.

Por ajo që e befasoi edhe më tepër Marianën ishte se, përveç shoqeve të Norës, me ca sy kureshtarë, përzier me një buzëqeshje të ligë, po e ndiqnin edhe nëndrejtori me shefen e administratës. Vërtet besonin ata se ajo bëhej xheloze për Norën, apo kështu u pëlqente t'i mbushnin mendjen vetes? Nga nëndrejtori mund edhe ta priste një pritje të keqe, ç'prej disa kohësh kishte pasur disa herë fërkime me të për çështjen e cilësisë së disa artikujve, sidomos të pastave të dhëmbëve. Disa herë ai e kishte thirrur në zyrë, herë duke e marrë me të mirë, herë duke e kërcënuar tër-thorazi se ajo me pedantizmin e saj po bëhej pengesë për realizimin e planit, gjë që s'mund të gëzonte veç ata që s'i donin të mirën ndërmarrjes, domethënë që s'i donin të mi-

rën atij, asaj vetë etj. etj. Kurse shefja e administratës i qe dukur përherë babaxhane, përshtypje që e shtonte dukshëm edhe trashësia e trupit të saj... Kurse tani seç thoshin të dy kokë më kokë, pa e fshehur që flisnin për të.

Mariana ndjeu ta kapte prapë angështia e mëparshme. Kishte ca lloje akuzash që të ndynin që në çastin e parë kur lindnin kundër teje. Ishin të tilla që, sado t'i luftoje me logjikë apo arsytim, prapëseprapë s'të shqiteshin kollaj, nuk e sqaroje dot kurrë të vërtetën për to, shkurt, ishte para-kohe i humbur. E tillë qe akuza që Mariana e ndiente se po notonte në erë kundër saj.

Ajo i ndjeu prapë këmbët t'i ngatërroheshin në vallëzim dhe pyetje torturuese nuk i hiqeshin nga mendja. Besonte vërtet Nora në gjoja xhelozinë e saj dhe, në qoftë se Gazmendi e kishte treguar episodën e rrugës nën hënë, kishte qenë kjo thjesht një kureshti, apo ishte rrëfyer me nëntekst, ashtu siç bëjnë zakonisht ata meshkuj që, duke e patur jetën e varfër, kanë qejf t'u hapen histori të paqena me femrat. Megjithëse Gazmendi, me sa e njihte ajo, ishte natyrë e thjeshtë dhe jo tinzare, kishte mundësi të ishte joshur nga një vanitet i tillë për ta shndërruar atë ecje nën hënë në një lloj gjerdani perlash, ndorëse perlat ishin kallpe.

Dy-tri herë Mariana kalimthi u përpoq të hetonte fytyrën e tij, dhe ajo iu duk si fytyra e njeriut që i kanë ngarkuar një rol për të cilin s'është gjer në fund i ndërgjegjshëm. Kurse Nora sa vinte bëhej më e furishme në ecejaket e saj nga njëri kënd i sallës te tjetri. Në mollëza kishte një skuqje të panatyrshme dhe gërshetimi i të folurave në vesh me shpërthimet e të qeshura sa vinte e bëhej më i shpeshtë.

Pas incidentit me Qemalin nuk e fshihnin triumfin e tyre, të cilit me atë trazim të ethshëm po i jepnin ngjyrën e një ngadhnjimi të virtytit e të lumturisë së ndershme mbi forcat e së keqes e të amoralitetit që mishëroheshin në këtë rast nga Mariana e mundur.

— Mos e çaj kokën për to, — i tha Diri. — Hiq e gëzuar.

Por ishte vonë për ta bërë këtë. Veç kësaj, Mariana s'kishte qenë kurrë shtiane dhe as qe e aftë të bëhej e tillë. Le ta merrnin vesh se ishte e trishtuar. Ajo nuk kishte frikë ta fshihte. Madje ishte tepër, tepër e trishtuar.

3

Mbrëmja e vallëzimit s'ishte veçse fillimi i asaj që më vonë mori format e një fushate të vërtetë ndaj Marianës. Askush nuk mund të përcaktohte me hollësi kronologjinë e ngjarjeve të vogla që ndoqën njëra-tjetrën (nganjëherë ato ishin aq të parëndësishme, ose së paku dukeshin të tilla, saqë nuk e meritonin as emrin ngjarje), ndryshimet e opinioneve të njerëzve shkaktuar prej thashethemeve, luhatjet, shkaqet e qëndrimeve pro dhe kundër dhe gjithçka tjetër që përfitohet prej një psikoze ku pështillet çdo ditë e më tepër një masë e madhe njerëzore.

Po sado megjullore të ishin këto, sajesa përfundimtare prej tyre ishte e qartë: qysh prej mbrëmjes së vallëzimit. Ose më saktë, disa ditë pas saj, në sytë e njerëzve Mariana s'ishte më ajo e para. Dhe këtë ndryshim në figurën e saj e shkaktonte kryesisht fakti që Mariana «diçka» kishte patur me Gazmendin (kuptohet një lidhje të fshehtë, gjë që e shtonte dozën e fajit të saj), të cilën e nxori në shesh fejesa e këtij të fundit me Norën.

Që Mariana, si vajzë e emancipuar, të kishte një të dashur kjo ishte një gjë normale dhe askush s'kishte ndërmend ta qortonte për këtë. Madje as kujtimi i lidhjes së saj me Filipin, megjithëse hidhte njëfarë hijeje mbi të, nuk ishte aq acarues për njerëzit sesa «kjo tjetra». Dhe «kjo tjetra»

që ata nuk ia falnin, qe pikërisht fakti se Mariana e kishte patur këtë lidhje me Gazmendin pikërisht në kohë që ky po bëhej gati të fejohej me Norën. Me fjalë të tjera, Mariana kishte dashur t'ia prishte lumturinë shoqes së saj.

Natyrisht që e gjithë kjo histori hidhte njëfarë hijeje edhe për Gazmendin. Mirë Mariana, po ky si kishte pranuar ta bënte këtë lojë të dyfishtë? Ndoshta këto pyetje do të shtyeshin edhe më tej sikur të mos sqaroheshin, më në fund, disa detaje të ngjarjes që e vinin çdo gjë në vendin e vet. Dhe, sipas këtij motërzimi të fundit, ngjarja kishte ndodhur kështu: një natë me hënë, gjatë një shoqërimi të rastësishëm për në shtëpi, Mariana i paskësh shprehur dashurinë Gazmendit dhe ky...

Kështu, domethënë në kundërveprimin e Gazmendit kishte prapë njëfarë errësimi, po fakti që tri javë pas kësaj Gazmendi u fejuua me Norën linte të nënkuptohej qartë që Gazmendi ose e kishte refuzuar prerazi dashurinë e saj, ose... (dhe kështu njerëzit pasi hapnin krahët siç bëhet kur flitet për gjëra fatalisht të pashmangshme, nuk harronin të shtonin fjalët: «epo, njeri prej mishi e kocke është dhe ai»). Megjithatë, e rëndësishme ishte që, qoftë me refuzimin e tij të prerë e aq më tepër në qoftë se refuzimi ishte bërë pas asaj... fatalisht të pashmangshmes... Gazmendi kishte kapërcyer një provë, duke treguar se, pavarësisht nga pamja, eleganca dhe gjithçka tjetër që i njihej si meritë Marianës, ai kishte parapëlqyer Norën («njeriu mbi të gjitha» etj. etj.)

Kjo ishte pak a shumë ajo që thuhej, madje kishte edhe një variant të tretë, sipas të cilit Gazmendi jo vetëm që e kishte refuzuar, por i kishte dhënë asaj edhe një mësim të mirë morali nga ata që mbahen mend tërë jetën.

Kuptohej menjëherë që e gjithë kjo s'ishte veçse një sajim i ndyrë, i ndërtuar me shumë kujdes e këmbëngulje dhe ne biseduam gjerë e gjatë se ç'mund të bënim me Marianën. Tani nuk na dukej më aq e lehtë si në fillim. Ishte

e qartë se Gazmendi qe burimi i të gjithave dhe Lad Kroj ishte për «modifikimin e portretit të tij gjer në postimpresionizëm» që do të thoshte rrahje për vdekje, po ne të tjerët u treguam më të përmbajtur. Cezari na kujtoi thënien e Engelsit se një gënjeshtër jeton gjatë kur ka brenda një bërthamëz të vërtetë dhe ne donim të zbulonim nëse kishte këtu një bërthamëz të vërtetë, që ndihmonte për të mbajtur në këmbë një mashtrim kaq të madh. Veç kësaj, duhej të bindeshim nëse shpifja e kishte vërtetë burimin te Gazmendi.

Vendosëm të bisedoja unë me të, ngaqë po ta bënte këtë Lad Kroj kishte rrezik që pas fjalëve të para të kalonte drejt e në «modifikim», duke mos sqaruar asgjë.

E lamë të takoheshim pasdite në kafe «Flora».

Koha ishte e vrenjtur, me shi. Biseda me Gazmendin qe e vështirë. Në fillim deshi t'i shmangej thelbit të çështjes, sytë i mbante vazhdimisht mbi syprinën e tryezës.

— Dëgjo, — i thashë, — për ty janë hapur fjalë lidhur me Marianën, ..ë qoftë se ke patur ndonjë gjë me të, s'ke ndonjë faj. Por, ama, aq më pak ka faj ajo. Veçse, në qoftë se ti shpif, kjo është një gjë e ndyrë. . .

— Unë nuk shpif, — më ndërpreu ai dhe për herë të parë më vështroi në sy.

Mua m'u bë një lëmsh në gjoks. Si t'i merrja fjalët e tij? Që ai nuk shpifte, domethënë që gjithçka ishte e vërtetë, apo thjesht që s'qe ai hapës i thashethemeve?

— Si s'shpif? — i thashë. — Domethënë ti pretendoke se paske patur lidhje me të?

— Unë s'e thashë një gjë të tillë.

— Atëhere si është puna?

— Unë nuk e di. S'përgjigjem për fjalët e të tjerëve.

— Mendoj se përgjigjesh. . . bile gjer në fund.

Biseda herë acarohet gjer në kufinj të sherrit, herë zbutej, siç ndodh me njerëzit që nuk janë të sigurt për diçka. Në një nga këto zbutje ai më tregoi për të famshmen ecje

të tij me Marianën nën dritën e hënës. Ndihej menjëherë se riprodhimi i asaj që kishte ndodhur ishte i vështirë për të. (Është një lloj si të riprodhohet mbrëmja e një ditë lindjeje prej një kanibali, kishte thënë më vonë Cezari). Përshtjellohej në gjithçka, po më shumë e ngatërronte vjersha e recituar prej vajzës e sidomos drita e hënës, që ai nuk harronte kurrë ta nënvizonte, si një dëshmi bindëse për fajësinë e Marianës. Pra, nën dritën e hënës, sipas tij, Mariana i kishte recituar një vjershë dashurie, të shoqëruar me fjalë me dy kuptime për dashurinë e femrës, që, sipas saj nuk çmohej sa duhej, ose s'vihej re, ose diçka e tillë e përngjajshme.

Eh, injorant, thashë me vete, ndërsa një mllef i befte më kapi ndaj Marianës. Paskësh gjetur kujt t'i thoshte vjersha!

— Dëgjo, — i thashë, — bjeri shkurt: të shfaqti ty ajo dashurinë, apo jo?

Tjetri nuk u përgjigj menjëherë.

— Jo, — tha pastaj. — Vecse ato fjalë m'i tha.

— Dhe, sipas teje, ato fjalë janë një lloj shfaqje e tërthortë dashurie?

Ai ngriti supet.

— S'e di, — u përgjigj. — Të them të drejtën, unë s'kam patur të bëj shumë me femra. Sidoqoftë janë fjalë që s'i thuhet kot kujtdo.

Ja, pra, ç'na qenkësh thelbi i historisë. Pavarësisht se më vinte të pëlçisja nga tërë mbrapshtia e kësaj pune, e sidomos nga kokëtrashësia e Gazmendit, isha pothuaj i sigurt që ai nuk gënjente.

Mora frymë thellë, mundimshëm dhe i thashë:

— Ja ta zemë se Mariana pati një çast dobësie për ty. Më kupton, një çast dobësie atje, nën dritën e hënës, siç the. Ty kjo gjë të ka fyer, apo të ka cënuar nderin, apo çfarë...

— S'e thashë një gjë të tillë, — u përgjigj ai. — Ç'më kujton mua ti, ndonjë anadollak?

— Po atëherë ç'dreqin pate që vure tellallin për atë çka të tha ajo? Nuk e kupton që s'është njerëzore... aq më pak kavalereske...

— S'është e vërtetë që vura tellallin, — më ndërpreu ai. — Ia thashë vetëm Norës. Kuptohet, e kisha njeri të afërt.

— Dhe ajo vuri tellallin.

— Për atë s'përgjigjem, — tha ai. me një ton të lodhur. — Mos kujto se dhe mua s'më ka ngjënë shpirtin Nora për atë mbrëmje. Hundësh ma ka nxjerrë

— Ashtu?

— E fshih të vërtetën, thotë, e mbron dashnoren. Rudallëqe, vërtet!

Hm, ia bëra me vete. Ishte pakëz e çuditshme e gjithë kjo.

— Gazmend, — i thashë. — Desha të të bëj një pyetje që do të doja të më përgjigjeshe sa më saktë. Beson vërtet Nora se midis teje dhe Marianës ka çatur diçka?

Ai pati një nënqeshje, nga ato që shoqërohen me ngritje supesh.

— Këtë pyetje ia kam bërë edhe unë, si asaj, si vetes sime. Të them të drejtën, s'di ç'të them. Nganjëherë më duket se bën ashtu kot... S'thonë kot që femrat janë të çuditshme.

E ndjeva se s'kisha ç'të bëja më tjetër me të. Desha t'i thosha një herë se ai duhej të bënte diçka për të frenuar atë psikozë kundër Marianës, po kjo m'u duk e kotë. Kuptohet që kjo s'ishte më në dorën e tij. Ai ishte një tip i varfër, që habitej ndoshta edhe vetë si që gjendur kështu papritur në qendër të vëmendjes. Me siguri, kjo gjë edhe e bezdiste, por edhe e joshte tinëzisht.

Gjithçka që bisedova me të ua tregova shokëve që atë mbrëmje edhe ata ishin të një mendjeje me mua, se nxi-

tësja kryesore në këtë histori s'qetë, po Nora. Përsa i përket asaj nëse besonte apo jo Nora për gjoja vardisjerë e Marianës ndaj të fejuarit të saj të ardhshëm, ne tashmë ishim të bindur se nga të gjithë ata që ishin tërhequr tashmë në këtë psikozë, ajo ishte ndoshta e vetmja që e dinte të vërtetën, pra që e dinte se e gjithë zhurma bazohej mbi një bllof.

Atëherë përse e bënte këtë? Natyrisht s'ishte e vështirë të gjeje një përgjigje: zilia, kompleksi i inferioritetit, ndonjë hakmarrje e vjetër. Mirëpo këtu dilte një pyetje: përse këto pasione të liga të shpërthenin pikërisht pas fejesës së saj, atëherë kur, përkundrazi, sipas logjikës së gjërave, ato duhej të fashiteshin?

Na u duk nën dinjitetin tonë të merreshim më gatë me zhbirimimin e kthinave të errëta të shpirtit të një psikopateje, siç e quajti Lad Kroj Norën dhe u kthyem te shoqërimi fatkeq i Marianës prej Gazmendit.

Një sëmbim, një mbetje pengu, një ndjesi faji të shkri- ra të gjitha bashkë në një tretësi hëne, me të cilën qe spërkatur kjo histori, shoqëronte fjalët tona. Na dukej e padurueshme që në një çast sa luksoz, aq dhe delikat, të brishtë e të tejdukshëm të Marianës të gjendej i pranishëm një kotësi si Gazmendi dhe akoma më i padurueshëm ishte abuzimi me të. Kështu duhej të ndodhte ndonjëherë në jetën e femrës. Kishte çaste sublime kur guaska mbrojtëse hapej dhe vajza ishte vërtet e pambrojtur, po në shkallën më të lartë e përkryer për të thithur plotësisht, pa humbje, lumturinë. Mirëpo pikërisht në këto çaste mund të ndodhte edhe e kundërta. Në vend të përkëdheljes delikate, të merrte një plagosje vulgare që do të shkaktonte pastaj jo vetëm mbylljen e guaskës, por egërsimin e famrës ndoshta për gjithë jetën.

Ideja se një gjë e tillë mund të ndodhte me Marianën na dukej e kobshme. Atëherë po mund të thuhej se Mariana ishte e humbur pa kthim.

4

Asgjë nuk ndryshoi në gjendjen e saj pas bisedës sime me Gazmendin. Kjo do të thoshte se mekanizmi që vepronte kundër saj ishte i tillë që, edhe po të godisje apo të paralizojë një pjesë të tij, të tjerat vazhdonin të vepronin vetvetishëm, për inerci.

Që në fillim ne e ndiem se po të mos gjente përkrahje nga ca njerëz e rrethana të caktuara, pasioni i Norës kundër Marianës, sado i furishëm e i lig të ishte, do të mpakej e do të mbetej jashtë vëmendjes. si çdo mllef i vetmuar njerëzor. Mirëpo ndodhi e kundërta

Për një kohë të gjatë ne u përpoqëm të gjenim ç'ishin ata njerëz e ato rrethana që ndihmuan fushatën kundër vajzës. Disa s'ishte e vështirë t'i pikasje qysh në fillim, po për ca të tjerë na u desh një kohë e gjatë, madje një pjesë arritëm t'i zbulonim vonë, atëherë kur historia e dhimbshme qe mbyllur.

Ja, pak a shumë, montazhi i tyre. i bërë jo në bazë të ndonjë renditjeje kronologjike, sipas hyrjes së personazheve në skenë, apo rëndësisë së rolit të secilit, po thjesht ashtu siç na erdhi për mbarë.

Nëndrejtori i ndërmarrjes. Dihej nervozizmi i tij i vazhdueshëm ndaj Marianës sa herë që në laborator ajo i hapte telashe për cilësinë e prodhimit. Kjo vajzë do të na marrë ndonjë ditë më qafë, kishte thënë andej-këndeje. Të ishim ndërmarrje private, do të besoja se na i kishin futur rivalët për të na nxjerrë bojën. Nëndrejtori qe përpjekur disa herë ta hiqte Marianën nga laboratori, sidomos pas një artikulli të botuar nga «Zëri i Popullit», ku kritikohesh ndërmarrja dhe të dhënat e të cilit ai besonte se gazetari i kishte nxjerrë pas një bisede me Marianën. Mirëpo Mariana ishte e aftë dhe e rregullt në punë dhe në gjithçka.

keshtu që ishte e vështirë të gjeje një shkak për ta lëvizur. Megjithatë ishin të shumtë ata që e dinin se nëndrejtori ia kishte bërë benë.

Shefja e administratës. Në të vërtetë ajo e kishte dashur Marianën gjer ditën kur iu kërkua nga dikush që në laborator të fuste mbesën e tij. Ky dikush, ndaj të cilit shefja e administratës kishte detyrimet të mëdha për shkak të nxjerrjes së një të drejte studimi, kërkonte, për fatkëqësinë e Marianës, pikërisht atë vend që zinte ajo Pa u bërë armike e hapët e Marianës, shefja e administratës priste megjithatë me padurim largimin e saj prej laboratorit.

Inxhinier Roberti. Meqenëse kishte maninë që në shumicën e gjërave të kishte mendime të kundërta me ato të zëvendëssekretarit të partisë të ndërmarrjes. Naumit, e kishte marrë zët Marianën vetëm se ky i fundit kishte folur mirë për të. Në të kundërtën, në qoftë se zëvendëssekretari do të kishte folur keq, inxhinieri do ta mbronte vajzën, kështu që, në çdo rast, njërin prej të dyve Mariana do ta kishte kundër.

Nafije B, laborante. Kur u luhat rër të bërë një deklaratë jo të favorshme lidhur me llojet e librave e të muzikës që gjoja Mariana pëlqente, u turr prej nëndrejtorit dhe, në praninë e shefit të kuadrit, laborantes iu kujtua si rastësisht kleçka që kishte në biografi lidhur me një dajë të saj që kishte bashkëpunuar me italianët gjatë pushtimit.

Arben T., Sali M., Teodor M., Klani i nëndrejtorit

Veronika, sekretarja e drejtorit. E urrente fshehtëzi Marianën për shkak të mospërfilljes me të cilën Filip Dëbra i përgjigjej ndjenjës së saj dashurore Duke qenë e bindur se shkaktare e këtij shurdhimi të partnerit vazhdonte të ishte prania në ndërmarrje e Marianës, bëri atë që kishte në dorë kundër saj, domethënë dorëzimin në drejtori, me një shpejtësi të pazakontë, të dy letrave anonime kundër Marianës.

Manushaqe V; laborante. Iu dha të kuptonte me anë

të shefes së administratës se kërkesa e saj për strehim do të shqyrtohej me ngut në qoftë se do të fliste «siç duhej» në mbledhjen që u quajt, dhe që në fakt ishte, fatale për Marianën.

Shefi i kuadrit. Për një kohë të gjatë qëndroi asnjnjës, por afër fundit bëri befaz një kthesë kundër Marianës. Nuk e sqaruar dot nëse shkak për këtë ishte vetëm miqësia e tij me V.L., zyrtar në Ministrinë e Industrisë, i cili duke shkuar keq me të atin e Marianës, me të cilin punonte në një sektor, kur mori vesh historinë e vajzës së kolegut, gjeti një mënyrë hakmarrjeje të ndyrë duke ndikuar për keq kundër saj, apo kishte edhe ndonjë pleksje tjetër intesash.

Lola C. teknologe. Për shumë kohë që e pamundur të gjendej shkak i vërtetë i acarimit të saj ndaj Marianës. Edhe kur u gjet, ngjante aq i pabesueshëm, sa që ne ishim gati ta hidhnim poshtë si qesharak, gjersa e rivërtetuan katërcipërisht. Shkurt, arsyeja e pezmatimit të Lolës ndaj Marianës, ishte, sado fantastike të dukej, pardesyja e re e kësaj të fundit. Ç'është e vërteta pardesyja i shkonte mrekullisht Marianës, por askujt s'mund t'i vente mendja se ajo mund të përbënte një shkak armiçësimi midis të dyjave. Megjithatë, e vërteta kështu ishte. Ma ha shpirtin kur e shoh me atë pardesy, i kishte thënë Lola dy vajzave të laboratorit K.T. dhe E.M., veç e veç. Ishim të bindur se, sikur Mariana të mos e kishte blerë atë pardesy gjatë një udhëtimi në Korçë, ose, së paku, në qoftë se e gjithë kjo histori nuk do të ndodhte në kohë vjeshte, pra në stinën kur vishen pardesytë, Lola do të mktante tjetër qëndrim ndaj Marianës.

Ky montazh, padyshim që nuk ishte i plotë dhe në të mungonin disa personazhe dhe rrëthana, që ne ose nuk i mblodhëm dot, ose i quajtëm të parëndësishme për t'u shënuar. Kështu, për shembull mungonte krejt klani i Norës, si edhe shoqet, shokët e kushërinjtë e tjerë të të dyja palë-

ve. Mungonin gjithashtu ata që u hodhën herë në njërin krah, herë në tjetrin, thashethemexhinjtë dhe ngatërrestarët që janë të tillë prej natyre, si dhe sehixhinjtë që në kësi rastesh s'mungojnë kurrë.

Sa për mbrojtësit e simpatizantët e Marianës, që ne nuk e quajtmë të nevojshme t'i përmendim, ata nuk ishin as më të paktë, as më pak të fuqisnëm se të parët. Mirëpo duhet thënë se duke qenë të tillë, domethënë të shumtë e të fuqishëm, ishin megjithatë më pak të bujshëm, ashtu siç janë përherë më të mirët, ndaj ndoshta dukeshin edhe më të paktë e më të tërhequr.

5

Megjithëse u duk sikur gjithë kjo aradhë e krijuar kundër Marianës ishte e aftë këndeje e tutje të vepronte në mënyrë të vetvetishme; pas një kohe të shkurtër ajo dha shenjën e parë të mefshtësisë. U ndie menjëherë që përcjen e saj të mëtejshme e keqja kishte nevojë për një shtytje të re. Dhe këtë «htytje nuk mund t'ia jepte askush tjetër, veçse Nora me ithtarët e saj.

Qetësimi i përkonshëm ndodhi pas thirrjes së përgjegjësit të laboratorit nga sekretari i partisë së ndërmarrjes, i cili qe vënë në dijeni për ngjarjen nga zëvendësi i tij. Sa më shumë që përgjegjësi i laboratorit i afrohej ndërtesës së administratës ku ndodhej zyra e sekretarit, aq më e parëndësishme i dukej e gjithë kjo. Ndërsa kërkonte të gjente fjalët me të cilat do t'i duhej t'ia shtronte njëfarësoj çështjen sekretarit, gjithçka iu duk edhe më e pakuptimtë, madje aq e pakuptimtë, saqë për të s'mund të përdroreshin as fjalët «ngjarje» apo «kështu ndodhi», sepse, në të vërtetë, s'kishte patur ndonjë ngjarje dhe s'kishte ndodhur asgjë.

Kështu i çoroditur, kishte hyrë te sekretari, të cilit, vetkuptohet, ato që i tha përgjegjësi gjysma-gjysma i qenë dukur thjesht gjepura, ndonëse nuk e kishte ndërprerë veç për të thënë një herë «ditë e zezë!» (me siguri me kuptimin: ditë e zezë, me se merremi!) Pra sekretari e kishte dëgjuar përgjegjësin gjer në fund, si për të kuptuar se gjer ku mund të shkonte budallallëku njerëzor dhe ky i fundit, duke e ndier edhe vetë se pas çdo fraze të tij gjithçka varfërohej edhe më tepër, i habitur tashmë se si një gjoja ngjarje, me të cilën merren dhjetëra gojë, mund të zhvlerësohet aq tepër gjatë riprodhimit të saj, i kërkoi ndjesë sekretarit që e kishte shqetësuar për këtë «idiotësi grarishte», siç e quajti ai dhe i qe lutur që të mos ia përmendte këtë drejtorit të ndërmarrjes, gjë për të cilën sekretari kishte qenë në një mendje me të.

Fill pas kësaj, me një nxitim dhe zemërim, që mungesa e flokëve ia vinte më shumë në pah, ai u kthye në laborator ku bëri një mbledhje të shkurtër të kolektivit për të paralajmëruar dhe kërcënuar cilindo që do të merrej këtej e tutje me abrakadabra të tilla.

Mirëpo si ne, si përgjegjësi u gabuam. Pas qetësimit të përkohshëm, tamam kur u duk se kësaj pune iu vu kapaku në drejtori, erdhi një ankesë, këtë herë serioze, e bërë nga prindërit e Norës.

Ishte një gjë që nuk pritej, sepse ata kishin qëndruar mënjanë gjatë gjithë kësaj historie, jo sepse nuk ishin në dijeni, po, siç u qe ankuar Nora shoqeve të ngushta, s'e kishin përkrahur vajzën e tyre kundër Marianës, madje e kishin qortuar për pasionin e saj. Fakti se tani u qe mbushur mendja të ndërhyenin për të mbrojtur lumturinë e vajzës, tregonte se çështja ishte më serioze nga ç'dukej.

Kishte ditë që Nora vinte në punë me pamje të pezmatuar. Një shtresë e hollë pudre e bënte edhe më të duk-

shme hijen e telashit mbi fytyrën e saj. Ndihej menjëherë se periudha e triumfit kishte marrë fund për t'i lënë vend dramaticitetit. Nora dukej e shqetësuar. Shkonin vërtetë heq me Gazmendin? Për shumë naivë ishte pikërisht kjo arsyeja e çmeritjes së saj. Dhe kjo, kuptohet, për shkak të «saj tjetrës», Marianës. Për ne e gjithë historia e gjoja dramës së saj me Gazmendin s'ishte veçse një bllof. Midis tyre jo dramë që s'ka, por as një skeç, kishte thënë Cezari.

Dhe kështu duhej të ishte vërtetë. E vetmja grindje e mundshme e saj me Gazmendin s'ishte veçse pakënaqësia e saj, që, kur ai u thirr nga nëndrejtori për të dëshmuar atë natën e famshme me hënë, nuk e kishte përlyer sa ç'duhej Marianën. Siç arritëm të merrnim vesh më vonë, kishte përsëritur pak a shumë ato që më kishte treguar mua, me të vetmin ndryshim që vjershën e cituar sipas Marianës e kishte cilësuar si «dekadente» (ishte pas kësaj që Nafijes iu kërkua të shpifte për shijet artistike të Marianës).

Pra qysh atëherë ne ishim të bindur se e gjithë kjo e ashtuquajtura dramë s'ishte veçse një lojë meskine nga ana e Norës, lojë në të cilën ajo kishte mundur të tërhiqte gjysmë me dashje, gjysmë pa dashje, partnerin e saj, Gazmendin. Por, duke qenë kallpe, loja kishte aftësinë, megjithatë, të zgjonte një valë sentimentalizmi pro Norës. Ajo ishte tani e fejuara e virtytshme, harmonia bashkëshortore e së cilës kërcënohej nga Mariana lumturiprishëse e simboli i zvetënimit, që arriti të qubej «tunduesja», «donna fatale», dhe madje «bukuri që vret» (kjo e fundit prej rrugacit Teri që, me sa duket, posa kishte dhënë provim Migjenin në shkollën e natës).

Përse e bënte Nora këtë? Ishte pyetja më e vështirë për t'i dhënë përgjigje, në gjithë këtë histori. Për të bërë të besueshme akuzat e saj të para kundër Marianës? Ishte tepër i lodhshëm një rol i tillë për një gjë kaq të thjeshtë. Aq më tepër që asnjëherë ato akuza nuk u vunë në rrezik të demaskoheshin si jo të vërteta përpara dikujt. Veç kësaj;

çfarëdo që të kishte ndodhur, historia quhej e mbyllur me triumfin e Norës. Tani, në qoftë se lumturia e saj nuk rrezikohej (dhe këtë më mirë se kushdo e dinte vetë Nora), përse vazhdonte me aq pasion fushatën kundër shoqes, duke helmuar bashkë me të edhe një pjesë të ditëve të saj të fejesës?

Siç e përmenda, ishte pyetja më e vështirë dhe e fundit që ne arritëm t'i jepnim përgjigje. E shoshitëm gjatë gjithçka nga ana psikologjike, filozofike, biologjike, sociale. sollëm ndërmend gjithë librat që kishim lexuar e filmat që kishim parë, duke përfshirë përrallat popullore për zilinë e shemrave, biseda e ngjarje të dëgjuaara andej-këndej, bëmë të gjitha pandehmat, duke filluar nga historia e atij që i tha vezirit: nxirrme mua njërin sy, mjafton që t'i nxjerrësh tjetrit të dy sytë! — gjer te sëmundjet psikike, derisa u bindëm se kishim zbuluar shkakun e vërtetë, po kjo atëherë kur historia qe mbyllur.

Shpjegimi ynë qe ky: Nora pavarësisht se qe dukur gjithmonë një vajzë e rëndomtë dhe pa kërkesa të veçanta, kishte qenë një egoiste e fshehur, me një grykësi për jetën, grykësi që sa më tepër e mbulonte pas një pamjeje modeste, aq më përvëluese i bëhej së brendshni. Ishte mesatare nga pamja, por e shkurtër, gjë që, sipas mendimit të Lad Kroit, duhej t'i shkaktonte një brengë të vazhdueshme, përderisa përpiqej më kot ta ndreqte atë me anë të takave, apo modelit të flokëve. Ishte ndoshta e vetmja pikë ku unë me Cezarin s'binim në një mendje me Ladin. Vajza me shtat të shkurtër kishim plot në ndërmarrje, po nuk kishim vënë re që kjo t'u kushtonte kushedi çfarë brengash, madje një pjesë e tyre ishin mjaft gazmore, pëlqeheshin prej djemve dhe s'duhej veçse pakëz njerëzillëk që epitetin «e shkurtër» ta zëvendësoje me «minjone».

Megjithatë edhe sikur Ladi të kishte një fije të drejtë lidhur me njëfarë bezdie që Nora mund të ndjente për shkak të shtatit, unë me Cezarin ishim të bindur se diçka

tjetër, më e qenësishme, u bë shkak për atë shpërthim të beftë egoizmi tek ajo. Vajzë e vetme në familje, duhej të kishte ndier përherë një ndryshim të madh midis vëmendjes që tregohej ndaj saj brenda mureve të shtëpisë dhe njëfarë mosrënieje në sy në shoqëri. Shkas për këtë ajo mund të kishte bërë pamjen, dhe jo vetëm pamjen, po gjithçka tjetër që, duke e pranuar dhe vetë se e kishte të rëndomtë, ndiente megjithatë një trazim zymtor sa herë që e kalonte nëpër mend.

Gazmendi ishte djali i parë që kishte njohur, por, siç ndodh shpesh me njerëzit që e marrin, ose kujtojnë se e marrin me vonesë atë që, sipas tyre, duhej t'u jepej më parë, ajo, në vend që të fisnikërohej, u tjetërsua. Marrëdhëniet dhe sidomos fejesën e saj me Gazmendin ajo e përftoi, në radhë të parë, si diçka që e nxori nga ajo monofoni gri, që e kishte munduar aq gjatë dhe që tani befasi iu duk e padrejtë dhe e pamërituar.

Të gjendurit e saj papritmas në qendër të vëmendjes, jo më të familjes, po të krejt fisit dhe të shoqeve të saj, siç ndodh shpesh me vajzat e vetme, fejesa e të cilave për arsye që kuptohet pritet me njëfarë ankthi, u bë ndoshta shkak për revoltën e parë të brendshme të Norës. Ajo ndieu befasi shijen e asaj që heshturazi e kishte patur zili më parë: rënie në sy. Po sendërtimi i diçkaje që i qe dukur e paarritshme, bashkë me kënaqësinë, zgjoi te Nora ndjenjën e turbullt të revanshit. Përse e kishin lënë kaq kohë mënjane, tërthorazi i kishin mbushur mendjen se ajo qe një vajzë e rëndomtë, shkurt, dinakërisht e kishin hequr nga mesi i tyre. Dikush ishte fajtor për këtë dhe ky dikush duhej të përgjigjej, madje të jepte shpagim.

Mirëpo ky dikush s'ishte një ose dy njerëz të veçantë. Ishin gjithë ato vajza, që Nora me shoqet e saj heshturazi, në mënyrë të qetë, i kishin patur zili. Kështu që edhe revolta e parë e Norës, duke u drejtuar kundër një ose dy njerëzve, vetvetiu u mjegullua.

Në ditët e para pas shpalljes së fejesës Nora ishte si në një gjendje etheje të vazhdueshme. Ecejaket te rrobaqepësja, këshillimi me shoqet për mdelet e fustaneve apo të këpucëve, vajtjes bashkë me Gazmendin te dyqanet e mobilerisë, te dyqani me komision, te tapicierët, këshillimi prapë me shoqet për dhomën e gjumit, për formën e kolltukëve etj., e gjithë kjo ethe, ky ritëm i panatyrshëm s'ishin veçse një ngut për të mbushur diçka që, me sa dukej, nuk mbushej.

Nora shumë shpejt duhej ta kishte ndier se ai mediokritet i hirtë prej të cilit ajo sapo kishte dalë (ose së paku kujtonte se kishte dalë), e kërcënonte përsëri dhe gjithë mobilimi i apartamentit të saj të ardhshëm, ajo gjetje me sukses e formës së bufesë apo të kolltukëve, e rimesos apo e perdeve, gjithsesi nuk mjaftonin për ta bërë të pasur një jetë njerëzore.

Ja, Mariana, që Nora gjer atëherë e kishte admiruar, nuk kishte asgjë nga këto, madje mund të thuhej se kishte një bilanc negativ, po të përdorej një shprehje e dëgjuar shpesh në mbledhjet për planin. Vitin që shkoi ajo kishte patur marrëdhënie dhe qe ndarë, për arsye që s'diheshin prej askujt, me Filipin. Në jetën e saj të tanishme s'dukej asnjë projekt fejese apo lumturie. E megjithatë përse edhe në humbjen e saj Mariana vazhdonte t'i dukej e pasur?'

Nuk e fshihte se e kishte patur zili jo vetëm për pamjen dhe dinjitetin e saj, për të qeshurën, ecjen, po (gjë e habitshme) edhe për ditët kur Mariana i qe dukur e mërztitur pas ndarjes me Filipin, për enigmën e saj... Në ditët kur shpirti i Norës qe trazuar nga ndjenja e revanshit, Mariana ishte një nga ato që i dukej fajtoare për mospërfilljen e gjertanishme ndaj saj. Po kryesorja, për mendimin tonë, që Mariana ra pré e Norës, më tepër nga zilia, ishte grykësia e Norës për të pasuruar jetën e saj me diçka që as mobilierët, as qëndistarët dhe as gjithë tapicierët e Tiranës nuk ia mbushnin dot.

Mariana kishte qenë përherë për të larg dhe zilia për të kishte qenë e llojit të qetë, si çac zili ndaj të paarritshmes. Mirëpo posa ndodhi një prekje me të, domethënë posa Nora mori vesh shoqërimin e Marianës prej Gazmendit në natën me hënë, mundësia për arritjen e së paarritshmes ndodhi. Dhe bashkë me të edhe ajo që e elektrizoi tërë qenien e saj: mundësia për ta përbaltur Marianën.

Në krye gjithçka nisi me tërbimin ngaqë Mariana, kjo e panginjur me lumturi, donte t'ia zhvaste edhe të vetmen fitore të saj, Gazmendin. Ky tërbim, bashkë me hidhërimin, kishte brenda edhe kënaqësinë djegëse të rivalitetit, domethënë faktin që i zgjedhuri i saj lakmohej nga një «vajzë e klasit» si Mariana. Kur pas sqarimeve të Gazmendit dyshimi për qëllimin e Marianës ra, bashkë me të u shua dhe kënaqësia djegëse e mbeti vetëm një urrejtje e shurdhër, shkretane.

Atëherë te Nora ndodhi një nga ato proceset e errëta e të pashpjegueshme të shpirtit njerëzor, kur njeriu, në vend që të qetësohet pas shpërndarjes së një dyshimi, kërkon shkaqe për t'u egërsuar edhe më. Pra s'i paskësh pëlqyer Marianës Gazmendi i saj! Kushedi si i qe dukur, mbase kështu dhe kishte thënë me vete; i rëndomtë, si Nora... Siç i thoshin fjalës, tenxherja kapakun.

Kaq i ishte dashur përfytyrimin të saj që të ndërzej flakë dhe pezmi i vjetër, i ushqyer tashmë nga disa burime bashkarisht, të shpërthente më furishëm se kurrë. Dhe kështu mosvërtetimi i asaj që shkaktoi në fillim tërbimin e Norës, në vend që ta shuante këtë tërbim, e ndezi më keq.

Çdo njeriu i vjen një ditë ora e vet, thoshte teto Sanija, pastruesja e laboratorit, dhe kjo jo me kuptimin e vdekjes, siç përdoret shpesh, po për të kundërtën, për shpërthimin e plotë të njeriut. Ora e vet i kishte ardhur Norës për të keq. E palodhur, e panginjur nga asgjë, ajo i qe qepur asaj nate me hënë për ta kthyer në një minierë ari për veten dhe xehe qymyri për Marianën.

6

Fill pas ripërtëritjes së psikozës kundër Marianës, shkaktuar prej futjes në valle të prindërve të Norës (mirë vajzës mund t'i marrë koka erë të sajorë gjithfarë fantazish, por asnjë prind nuk i futet pa arsye ngatërresave të tilla, thoshin me të drejtë njerëzit), pra tamam në kohën kur Nora kishte arritur më në fund ta vinte veten në qendër të vëmendjes dhe ngjyra e perdeve e kolltukëve apo e llambadarëve të apartamentit të saj të ardhshëm shkëlqente edhe më hijerëndë, me atë ndriçim që kanë vetëm gjërat e shtrenjta në sfondin e ndërlikimit dramatik të javëve të para të fejesës së saj, mua, Cezarin dhe Lad Kroin na thirrën në zyrën e sekretarit të partisë së ndërmarrjes për të na kërkuar sqarim për diçka.

Vajtja në zyrën e sekretarit të partisë nuk ishte një gjë e rrallë për cilindo, po që të thirrshim të tre bashkë s'na kishte ndodhur kurrë.

Në zyrë ishin sekretari me zëvendësin, të dy me fytyra jo të qeshura.

— Uluni, rrini, — tha sekretari dhe na tregoi karriget. Pastaj hapi sirtarin e tryezës së tij, kërkoi diçka në të, e mbylli dhe u duk se po atë gjë që s'e kishte gjetur në sirtar po e kërkonte sipër tryezës. Lëvizja dhe zhurma e sirtarit e thelluan edhe më heshtjen e krijuar. — Puna është se... — filloi sekretari, pa e fshehur se po bëhej gati të fliste për një gjë të bezdisshme.

Në të vërtetë, ato që tha s'kishin të bënin fare me ne, ose, për të qenë më i saktë, kishin të bënin me ne aq sa me çdo qytetar tjetër të Republikës. Në kohën që sekretari vazhdonte të fliste për edukimin e njeriut të ri, për vlerat e këtij të fundit, etj., ne vumë re se zëvendësi ia kishte ngulur vështrimin në një mënyrë kuptimplote. S'ishte e

vështirë të kuptohej se sekretari i shmangej temës për të cilën na kishte thirrur, gjersa më në fund pa u kujdesur më ta fshihte këtë, i tha zëvendësit:

— E po, vazhdo ti, Naum, për atë gështjen.

Zëvendësi, i mësuar me sa dukej me këtë, drejtoi shtëpinën në karrige.

— Para se të hyj në temë dua t'ju them se neve si parti na vijnë nganjëherë edhe gjëra të pasakta, për të mos thënë shpifje të ndryshme etj. Detyra jonë është ta sqarojmë çdo gjë me durim. Partia nuk bën gjëra prapa kraheve, ndaj dhe ju kemi thirrur t'ju pyesim sy më sy për një gështje.

Vura re se sytë e sekretarit u çelën disi, ndërsa na hetonte vëmendshëm në kohën që prej fjalëve të zëvendësit po e merrnim vesh më në fund përse ishim thirrur. Ishte fjala për atë darkën e ditëlindjes së Cezarit, ku sipas të dhënave të dikujt, ne paskëshim thënë shumë broçkulla, disa me tingëllim jo të mirë politik. Zëvendësi uli sytë mbi letrën ku diçka kishte shënuar dhe zëri i tij u bë më i ngadalhtë:

— Ja, për shembull, njëri nga ju ka shfaqur mendimin në formë kritike ... për ... për... këtu s'është fort e qartë, po diçka që lidhet me ujërat ose bonifikimin në vendin tonë...

Ne vështruam njëri-tjetrin dhe Lad Kroj mezi e mbajti të geshurën.

— Diçka duhet të kem thënë unë për ujërat, — tha Lad Kroj, — po, më besoni, kam qenë i pirë dhe s'mbaj mend çfarë.

— The se do të ankohe kundër Drejtorisë së Ujërave, — ndërhyri Cezari. — Vetëm kaq.

— Që njeriu mund edhe të kritikojë një institucion, s'është ndonjë gabim, — tha zëvendëssekretari, — përkundrazi. kritikën e drejtë ne e nxitim, por... — zëri i tij u bë prapë i ngadalshëm, — s'është vetëm kjo. Një tjetër ka

dhënë mendime krejt. . krejt të çuditshme, për të përdorur fjalën më të butë, për nënkryetarët e komiteteve ekzekutive. . .

— Kjo është e vërtetë, — e ndërpreu Cezari. — E kam thënë unë.

Sekretari i partisë e vështroi tërë habi.

— Na sqaro një çikë. — tha zëvendësi me zë të ftohtë. Po ne kurrsesi nuk i zemëroheshim atij ngaqë e dinim që ishte zemërmirë dhe, veç kësaj, në dy-tri raste e kishte mbrojtur Marianën.

— Po ja, — tha Cezari, — atë ditë, domethënë atë natë, kam thënë se kam vënë re se të gjithë ata që kanë punuar si nënkryetarë të komitetit ekzekutiv gërhasin. — Cezari hapi krahët. — Atë që e kam thënë e kam thënë, s'e mohoj.

— Që s'e mohon bën mirë, — tha zëvendësi, — po na thuaj pak nga të ka lindur ky mendim, ose më mirë, shkaqet që të vijnë në kokë idera të tilla. .

Cezari qeshi.

— Ç'shkaqe? Isha i pirë, prandaj ose, që të jem më i saktë, më ka qëlluar një natë, në një hotel të Durrësit. të fle në një dhomë me një agronom që kishte punuar dukur si nënkryetar i komitetit ekzekutiv të Lushnjës. Siç duket, më ka mbetur në mendje gërhitja e tij dhe. . .

Sekretari i partisë, që gjer atëhere s'kishte ndërhyrë, madje qe dukur i kënaqur nga çiltësia jonë, befas i ra tryezës me pëllëmbë të dorës. Fytyra e tij e shëndoshë qe skuqur flakë. .

— Pse flisni mbrapsht, more djem? — thirri ai. — Kaq jam bërë, s'më kanë shkuar ndërnjëherë në kokë mbrapshti të tilla. Pse s'na lini të punojmë, po na prishni gjakun me gjepura? Mbrëmë ku s'më shkoi mendja. Mirë thonë: hedh një i marrë një gur në pus dyzet të mençur s'e nxjerrin dot. Ç'kuptim mund të kenë këto fjalë, mendoja. Përpqesha të kujtoja shokë të ndryshëm, kuadro me rëndësi që kanë punuar si nënkryetarë komitetesh. Mendime të tur-

bullta më vinin në kokë. Gjithë anëtarët e Byrosë Politike i shkova nëpër mend. Dhe përse? Për marrëzitë tuaja. Tani nisuni në punë dhe mos të dëgjoj me të tilla, morët vesh?

Ishte i inatosur, po më tepër i lehtësuar. Në të vërtetë, më shumë se me ne, duhej të ishte zemëruar me ata që kishin sjellë informacionin. Gjëja e parë, kur dolëm përjashta, ishte të gjenim se kush mund ta kishte bërë këtë. Po sillnim nëpër mend gjithë ata që kishin qenë në ditëlindje, duke thënë «ky s'ka mundësi», «ky jo», kur Cezari u kujtua se një gjë e tillë ishte e kotë, meqenëse qyfyret e ditëlindjes së tij i dinte tashmë tërë ndërmarra.

Kjo ishte e vërtetë dhe me siguri ndonjë i jashtëm kishte raportuar. Qëllimi s'ishte vështirë të merrej me mend, ne ishim të shpallur tashmë si mbrojtës të Marianës dhe dikush donte, me një mënyrë ose një tjetër, të na paralizonte, goftë edhe përkohësisht.

Siç dukej, kundër Marianës po përgatitej diçka tjetër.

7

Parashikimi ynë u vërtetua shumë shpejt. Dy ditë pas thirrjes sonë te sekretari i partisë, ndodhi incidenti me Terin.

Ai që i thjeshtë, gjithçka nuk vazhdoi më tepër se gjysmë minute, dhe vendi i ngjarjes, korridorin midis laboratorit dhe magazinës, një mjedis i pandriçuar mirë dhe zakonisht i shkretë, nuk ishte i tillë që t'i jepte përmasa skandalit. Megjithatë incidenti, për fatin e keq të Marianës, u shndërrua në një skandal të vërtetë.

Ishte duke mbaruar pushimi i drekës, Mariana po kthehej nga bufeja në laborator, kur Teri, që se nga mbiu në atë kohë midis korridorit, tek ecte përbri saj, i ra me dorë

vitheve, duke i pëshpëritur: «ah, ç'm'i paske këto!» Mariana u kthye vrulltazi për ta goditur me pëllëmbë, po Teri arriti t'ia kapte krahun afër bërrylit. Atëherë Mariana e goditi me dorën tjetër, në kohën që Teri vazhdonte t'i mbante njërin krah. Ishte kjo pleksje në të cilën i panë njerëzit. Qëlluan enkas në korridor Qemali me Veronikën, sekretaren e drejtorit, apo kjo ishte një rastësi, nuk u mor vesh dot asnjëherë. E vërteta është se Veronika dhe një vajzë e laboratorit që vinte pas, thirrën të dyja: «Ej, ti i çmendur!» dhe Qemali u mat të ndërhynte, po në atë çast Teri ia lëshoi krahun Marianës dhe vrapoi nëpër korridor, mu përpara teto Sanijes, që e kishte parë ç'ndodhi dhe që arriti ta godiste me fshesë në vrap e sipër ngacmuesin.

Por enigma më e madhe mbeti se kush e lajmëroi policinë. Kishte kaluar gati gjysmë ore, Mariana ishte ende dyllë e verdhë nga tronditja, kur në laborator, të shoqëruar nga shefja e administratës, ia behën një polic dhe një civil.

— Si është puna? — pyeti shefja e administratës Marianën në kohën që sytë e të gjithëve po ndiqnin me kureshtje të porsaardhurit. — Kush e lajmëroi policinë?

Mariana ngriti supet.

— Nuk e di, — u përgjigj.

— Ka ndodhur, diçka, apo jo? — tha shefja. — Shokët për këtë punë kanë ardhur.

— Në të vërtetë, ne kujtuam se këtu ishte ndonjë gjë më e rëndë, — tha civili.

— Megjithatë, diçka ka ndodhur, apo jo, Mariana?

Në fytyrën e Marianës u pasqyrua gjithë vuajtje e një shpjegimi të vështirë.

— Sigurisht, — tha ajo.

— Keni ankesë për fyerje? — tha civili — Duhet të vini në rajon të policisë për të bërë denoncimin. A ka dëshmitarë?

— Me sa di unë ka, — u përgjigj në emër të Marianës

shëfja e administratës, — Veronika më tha se ishte gati të dëshmonte, — iu kthye ajo Marianës, që po e vështronte me sy të çmeritur, e habitur siç duket nga kjo gadishmëri.

— Ka dëshmitarë, posi, — tha teto Sanija që e kishte ende në dorë fshesën me të cilën e kishte goditur Terin. — I ra në qafë kot gocës ai zorzopi.

— Mirë, — tha civili dhe u kthye për të dalë. — Do të vini në rajon, — iu drejtua edhe një herë Marianës, — ju bashkë me dëshmitarët.

Mariana s'dinte ç'të përgjigjej.

Pas gjysmë orë mbërriti Lad Kroj, që s'kishte lënë vend pa e kërkuar Terin dhe kur mori vesh punën e denoncimit, e thirri mënjanë Marianën.

— Në asnjë mënyrë s'duhet të shkosh në polici, — i tha.

— Pse? — pyeti Mariana me një zë pa ngjyrë. Ligështimi i ndihej në çdo gjë të saj: në zë, në lëvizje. Ishte hera e parë që e shikonim kështu.

— Nuk e kupton se ata pikërisht këtë gjë duan, që të të tërheqin ty në një gjyq lagjeje, më kupton? Ankesat për fyerje shqyrtohen vetëm në lagje dhe atje Teri mund të mbledhë tërë alabakët për të bërë gallasë, më kupton? E përse e gjithë kjo, që t'i jepet një qortim Terit? Dëgjomë mua, kurrsesi s'duhet të biesh në këtë kurth. Të jap fja'ën që Teri do ta paguajë shumë më shtrenjtë atë që ka bërë.

Mariana dëgjonte me një pamje të lodhur. Deshi t'i thoshte se dhe ajo që habitur nga gadishmëria e Veronikës për të dhënë dëshmi dhe përgjithësisht nga sjellja e shëfesë administratës, po s'tha asgjë të tillë. Vetëm tundi kokën për të pohuar se do të bënte siç thoshte ai.

8

Ajo që nuk parashikoi Lad Kroj, dhe bashkë me të edhe ne, ishte përshtypja çuditërisht e keqe që bëri në ndërmarrje heqja dorë e Marianës prej denoncimit. Një pjesë, sidomos ata që Teri ua kishte sjellë në majë të hundës dhe mezi ç'prisnin një rast për të larë llogaritë me të, thjesht u zhgënjyen. Po disa gjetën rast për të vjellë vrer kundër saj. S'do mend, pëshpërisnin poshtë e lart, po shko-ve në hetuesi, atje punët shikohen thellë dhe, po të mos jesh i pastër, të dalin të palarat. Fill pas kësaj përmendeshin emrat e Filipit, të Gazmendit dhe të njëfarë Arion Ballit, që ndodhej për specializim në Suedi dhe që Mariana as e njihte, as e kishte parë kurrë, gjë që nuk i pengonte megjithatë gojët e liga të ngulnin këmbë se ajo kishte dy vjet që përpiquej t'i prishte mendjen me anë të letrave.

Në këtë atmosferë u bë mbledhja e përbashkët e kolektivit të laboratorit dhe të magazinës, ku punonte Teri, për të shqyrtuar çeshtjen e skandalit.

Flitej se dy ditë më parë puna kishte shkuar gjer në vesh të drejtorit të ndërmarrjes, shokut Nikollë, i cili i pezmatuar siç qe fill pas kthimit nga komiteti i partisë, ku e kishin kritikuar për dehje nga sukseset, kishte shfryrë rëndshëm dhe, duke u kujtuar me këtë rast edhe për ankesën e prindërve të Norës, që gjer atëherë s'i kishte dhënë kurrfarë rëndësie, kishte kërkuar, sipas stilit të tij, të ndëshkoheshin të gjithë ata që kishin njëfarëlloj lidhje me këtë histori, duke i futur të gjithë në një thes, domethënë Teri, Mariana, Nora, Gazmendi, madje dhe Filipi që s'hynte fare kurrkund.

Ndihmësit, duke e parë se kjo në vend që ta shpëstjillte, do ta bënte lëmsh tërë punën, gjetën mënyrën për ta bindur drejtorin, që, për të mos shpenzuar energjitë dhe

kohën e tij të çmuar me një punë kaq të bezdisshme, t'ua linte vartësve të merreshin me të.

Mbledhjen e dy kolektivave e kryesoi nëndrejtori. Ai foli shkurt për atë që kishte ndodhur, duke u zgjatur më tepër në anën parimore të çështjes, domethënë te shfaqjet borgjezo-revizioniste dhe te nevoja për t'i luftuar ato. Ndërsa fliste, vështrimi i tij u ndal disa herë te fytyra e Terit, që kishte ende ca njolla blu në mavi rreth mollëzës së djathtë, gjurma të «modifikimit të portretit të tij, sipas periudhës blu të Pikasos», siç qe shprehur Lad Kroj.

Në fund, pasi u dëgjua autokritika e Terit, që duhet thënë se ishte ndër më të turbulltat rga gjithë autokritikat e bëra ndonjëherë në historinë e ndërmarrjes, iu bë atij një paralajmërim i fundit.

— Po mendoj se edhe ju, shoqja Mariana, keni për të rishikuar diçka në veten tuaj, — tha nëndrejtori me një ton të akullt dhe tamam atëherë kur s'e priste askush. — Nuk po zgjatem, besoj se e kupton vetë se ç'dua të them.

Në heshtjen e thellë që u krijua befas, pa i lënë mundësi askujt tjetër të thoshte diçka, madje pa na lënë kohë të mendoheshim, ai e shpalli mbledhjen të mbyllur.

Ishte vështirë të llogaritej më saktë një goditje kaq e hidhur për Marianën. Gjithë ajo mjegullinë që gjer atëherë notonte në erë, e turbullt, pa formë, ai pluhur thashethemesh, pandehmash, kureshtish u dendësua me shpejtësi katastrofike, për të marrë konkretësinë e një përfundimi të nxjerrë tashmë në një mbledhje nga një zyrtar.

Mund të thuhej se këndeje e tutje Mariana u bë me të vërtetë me cen. Ajo po merrte hijen e femrës imorale, që shkakton grindje midis meshkujve. Për shumë njerëz të paanshëm, sa do që e dënonin sjelljen e Terit, njëfarë hijeje binte edhe mbi Marianën. Të tjerë, ata më të hidhurit, e bënin haptas pyetjen: përse nuk iu qep një tjetre Teri? Dhe ajo, kur ishte kaq e pastër, pse e tërhoqi denoncimin kundër tij? Pastaj, gjithë ato fjalë për filanin e filanin, e

gjer për filanin në Suedi, kot hapeshin? Midis grave e vajzave jetojmë, po s'kemi dëgjuar t'u hapen fjalë fare kot. Ndryshe bota do të qe bërë lëmsh... Pastaj, edhe nëndrejtori a nuk ia hodhi tërthorazi fjalën? Ç'tërthorazi, mo? Ai i tha copë...

Kështu bënin komente njerëzit për mbledhjen. Sa më shumë që kalonte koha, aq më tepër ndihej se ç'humbje kishte qenë për Marianën ajo mbledhje, ku shumëkush kishte kujtuar se nderi i saj do të vihej në vend. S'ishte e kotë që qysh atje, ndërsa nëndrejtori fliste, e sidomos pas daljes nga salla, vështrime kuptimplote, shkelje syri e buzëqeshje rrëshqitëse këmbeheshin midis klanit të Norës.

Kurse Mariana e priti gjithçka me fytyrë të palëvizshme, ku vetëm një sy vërejtës mund të dallonte ende, midis përvijimit të vuajtjes, pyetjen «përse»?

Ajo doli nga salla ngadalë, pa folur, midis shoqeve më të ngushta, ndërsa në fytyrë i shprehej tisi i parë i lodhjes.

9

Cezari kishte mendimin se kjo punë s'do të mbetej me kaq. Dhe vërtet, shumë shpejt u kuptua se po pritej një rast i ri për të goditur prapë Marianën.

Ftohtësia ndaj saj spikaste edhe më fort në sfondin e përkujdesjes sentimentale që rrethonte çiftin e ri, lumturia e të cilit quhej e kërcënuar. Flitej se ishin vënë të parët në listën e atyre që do të merrnin apartament, madje për Gazmendin thuhej se qe propozuar për të shkuar për një specializim të shkurtër jashtë shtetit.

S'dihej ende përgjigjja për ndërhyrjen e prindërve të Norës. Njëfarë heshtjeje që s'premtonte asgjë të mirë rrethonte gjithçka. Ishte një ditë e shqetësuar me shi dhe

ofshamje ere nëpër xhamat e mëdha të laboratorit. Në pushim na lajmëruan se do të bëhej një mbledhje për të punuar një material të Komitetit të Partisë së Rrethit, lidhur me shtimin e divorceve dhe me punën e paktë parandaluese që bëhej kundër tyre. Një parandjenjë e keqe më pushtoi të tërin kur në sallën e mbledhjes hyri nëndrejtori.

Ai foli shkurt: natyrisht, s'duhej bërë gogol puna e divorceve, divorce kishte patur e do të kishte gjithmonë, gjithë puna ishte që të mos keqpërdorej kjo e drejtë e grave dhe e burrave, dhe atje ku ishte e mundur, domethënë ku s'kishte arsye të thella për një divorc, ky të parandalohej.

— Ja, për shembull, në kolektivin tuaj kemi rastin e shoqes Shkëndija me shokun Tonin. Më duket se kemi diskutuar dhe herë tjetër për ta. Edhe shokët e gjykatës janë të mendimit se s'ka arsye që ata të ndahen, sedër e sëmurë nga njëri e nga tjetri dhe asgjë tjetër...

Më erdhi gjaku në vend kur dëgjova që mbledhja po ndalej në një gjë konkrete. Fjalët e nëndrejtorit po më dukeshin të arsyeshme, madje edhe fytyra e tij disi e këndshme.

Pasi u bëri edhe një herë thirrje Shkëndijës dhe Toninit që të pajtoheshin, nëndrejtori vazhdoi të fliste për punën edukative që duhej bërë te njerëzit kundër ndikimeve borgjezo-revizioniste lidhur me të ashtuquajturën dashuri të lirë, e cila çon në shturjen e familjes etj.

Diçka më pickoi në gjoks kur dëgjova fjalët e fundit dhe sytë e tij m'u dukën prapë të ftohtë. Ai vazhdoi të fliste për masat që duheshin marrë ndaj atyre që dëmtonin unitetin e familjes socialiste dhe unë ndjeva sytë e Cezarit të më vështronin ngultazi. Ishte e qartë për kë e kishte fjalën folësi. Më kot u përpoqa ta qetësoj veten duke menduar: le të grijë sa të dojë, pak baltë është hedhur mbi Marianën, do të kalojë edhe kjo mbledhje si të tjerat dhe jeta do të vazhdojë normalisht.

Po s'do të kalonte as një çerek ore për të parë se s'ishte aspak ashtu.

U duk se mbledhja po mbyllej, kur nëndrejtori, me një ton të lehtë, madje me atë gjallëri të gëzueshme që vetvetiu sjell përfundimi i një mbledhjeje të suksesshme tha:

— Dhe tani dy fjalë fare shkurt për ca çështje të vogla organizative. Drejtorja ka vendosur që dy punonjëse të laboratorit, Mariana Krasta dhe Lume Andoni të largohen në një sektor tjetër.

Një heshtje, nga ato që quhen prej varri, pasoi fjalët e tij. Vura re Norën që këmbëu një shikim të shkurtër si shkarkim elektrik me shoqet e saj, pastaj sytë e mi kërkuan Marianën. Nënteksti ishte mëse i qartë. Vinin edhe një shoqe krahas saj, gjoja për ta ruajtur nga shnderimi, po të gjithë e dinin se ajo tjetra kishte kërkuar vetë largimin.

Mariana ishte ulur disa radhë përpara meje, kështu që nuk ia shihja fytyrën. Vetëm karfica në flokët e saj gësh-tenjë të çelët lëshonte një vezullim të zbehtë, të dhimbshëm.

Ndjeva një shtypje në gjoks, pastaj në tëmtha.

— Me leje? — thirra pa u menduar pothuajse fare dhe brofa më këmbë. — Desha të di arsyen e largimit të Marianës.

— Çfarë? — tha nëndrejtori si të mos kuptonte.

Unë e përsërita pyetjen me një zë që edhe vetë m'u duk i huaj.

Sytë e tij u rruhdhën pakëz, si për ta bërë më të mprehtë e shpues shikimin që lëshonin, pastaj një dritëz u duk midis tyre dhe mollëzave. Në atë dritëz kishte një buzëqeshje ironike, shoqëruar me sipërinë që të jep siguria se ti di më shumë se të tjerët. Ah, na dashkeni edhe të vërtetën? Meqë e kërkonti vetë sherrin, përballojeni tani.

Mendimi se mos i bëja dëm Marianës më kaloi vetëtim-thi nëpër tru. Por ishte vonë të tërhiqesha.

— Meqë kërkonti arsyet, mund t'juaj themi. — tha nëndrejtori, duke i ndarë fjalët shkoqur nga njëra-tjetra. —

Porsa folëm pak më parë për moralin socialist. . . për mbrojtjen e familjes. . . — Ai u mbllaçit, «në një përpjekje gjoja të fundit për të ruajtur nderin e Marianës», siç e komentoi më vonë Cezari, pastaj hapi krahët. -- Mariana largohet nga laboratori për arsye që lidhen me ato që thamë.

Ambalazhi me heshtje i fjalëve të tij (sa ia ngrinte vlerën mallit nganjëherë ky ambalazh), mbeti përgjysmë, ngaqë unë thirra me sa zë që kisha:

— Kjo është shpifje!

— Si guxoni?

— Ka shpifje kundër Marianës! — këto fjalë që duhej t'i thosha unë gjëmuan diku në sallë si nga një altoparlant. Lad Kroit gjithashtu i kishte ndërruar zëri. — Dhe ju, në vend që t'i luftoni ato, i përhapni më keq.

Nëndrejtori qe bërë dyllë i verdhë.

— Si guxoni të flisni me këtë gjuhë? — tha.

— Guxoj që ç'ke me të, — u përgjigj Lad Kroit. — Në kurriz të Marianës po bëhen makinacione të ndyra.

Një zhurmë e mbytur, që megjithatë mezi ç'pritej për të prishur heshtjen që s'durohej më, mbuloi fjalët e tij të fundit. Kaq duhej që atmosfera të trazohej përfundimisht. Një shpërthim akuzash të ndërsjella, nga ato për të cilat më vonë të dyja palët thonë: mos vallë e teprova, bëri që mbledhja të ndërpritej.

U la një mbledhje e re për «të vënë pikat mbi i», siç u shpreh nëndrejtori. Kjo do të thoshte një mbledhje ku do të shqyrtohej nëse Mariana ishte apo jo imorale. Edhe pse kjo nuk u tha shprehimisht, u kuptua qartë se ky do të ishte thelbi i mbledhjes. Nëse nëndrejtori ishte shpifës dhe arrogant, nëse të tillë madje dhe më keq ishim unë dhe Lad Kroit, këto ishin gjëra të dorës së dytë që vërtetoheshin ose hidheshin poshtë prej kryesores: moralit apo imoralitetit të Marianës.

Ndërsa ecnim drejt shtëpisë, unë shfaqta prapë dyshimin se mos ne, duke dashur ta ndreqnim punën, po bënim të

kundërtën në gjithë këtë histori. Cezari me Ladin ishin të një mendjeje me mua, veçse tani ishte vonë të ktheheshim mbrapsht.

10

Koha u ftoh, oborri i ndërmarrjes që mbushur me gjethe të verdha, po ne nuk vinim re asgjë. E kishim mendjen të mbledhja e cila që shtyrë dy herë, thua se enkas për të na shtuar ankthin, (e shtyva mbledhjen me shpresë se ndoshta do të ftoheshin gjakrat kishte thënë më vonë sekretari i partisë, po, me sa duket, ndodhi e kundërta).

Ne kishim zbuluar ndërkaq një pjesë të makinacioneve që po luheshin pas shpinës së Marianës dhe kjo na gjallëronte. Mjaftonte që të renditnim vetëm gjysmën e tyre në mendje, për t'u habitur dhe vetë me ligështimin e një minute më parë. Ideja se ne i kishim në dorë na përndizte. Mjaftonte, për shembull, që masa e njerëzve të merrte vesh se si kërkonin ta largonin Marianën nga laboratorit, sepse vendin e saj e lakmonte mbesa e dikuajt, ndaj të cilit shefja e administratës kishte detyrime për rixjerrjen e një të drejte studimi, që gjysma e klanit të Marianës të mbeteshin me gisht në gojë. Dhe ky ishte vetëm një nga detajet. Ne sillnim ndërmend të tjerat, ndeshjet e Marianës me nëndrejtorin për arsye pune, thirrjen e Nafijes për ta pyetur për librat që lexonte Mariana (midis tyre, për të vërtetuar prirjet gjoja liberale të Marianës, ishte shënuar «Zonja Bovari») thirrje që ne e quanim metodë koçixoxiste etj. etj. I kujtonim këtu dhe fërgëllonim nga padurimi për t'u ndeshur sa më parë.

Kështu mendonim, po kur në sallën e gjatë të mbledhjes hynë me radhë njëri pas tjetrit sekretari i partisë së ndër-

marrjes zëvendësi i tij, nëndrejtori, shefi i kuadrit dhe dikush nga bashkimet profesionale, etja për t'u ndeshur ia la vendin një kujdesi të ftohtë për të qenë syçelur e për të mos bërë ndonjë gafë.

Mbledhjen e hapi sekretari i partisë. Fytyra e tij e ngjallme nuk e fshihte një lloj bezdie përzicë me dëshpërim, që ishte i detyruar të merrej me një çështje të tillë. (Mbledhje më të vështirë s'kam drejtuar ndonjëherë në tërë jetën time, kishte thënë më vonë. Megjithëse bëra çmos që ta shmangia acarimin, qysh në fillim pata një parandjenjë të keqe për gjithçka që do të ndodhte më pas).

Në të vërtetë kjo ndjesi, që ai nuk arrinte ta fshihte dot, vinte se gjatë ditëve të fundit, me siguri, kishte dëgjuar të hidhej shumë baltë kundër Marianës. Se sa kishte besuar s'dihej, megjithatë edhe një pjesë e vogël e atij llumi mjaftonte për ta vënë në bezdi përfytyrimin e njeriut.

Pas sekretarit të partisë, i cili u përpoq t'i jepte një drejtim pajtues mbledhjes, duke u kujtuar të gjithëve se kishte gjëra më të rëndësishme për t'u marrë, u bë një heshtje e gjatë. Në qelqet e dritareve gjethet e zverdhura dukeshin sikur trokisnin kur preknin me biskun e këputur.

Fjalën e kërkoi nëndrejtori. Ishte përgatitur me shkrim dhe shumë herë përmendi fjalët «moralist socialist», «uniteti i familjes» dhe «ndikimet borgjezo-revizioniste». Grindjen me mua dhe Lad Kroin e kaloi përciptazi, madje me një farë shpirtmadhësie nga ana e tij që «si kuadër, nuk vinte re vogëlsirat, përpara gjërave parimore». Dhe gjërat parimore, diç doli shkoqur nga ato që tha, na qenkeshin sjeiljet dhe pikëpamjet e Marianës.

Po ndodhte ajo që i ishim trembur më tepër se çdo gjëje. Në vend që një pjesë e vëmendjes të binte mbi ne, gjithçka po përqëndrohej kundër Marianës. E kishim ditur përherë që nëndrejtori ynë qe tepër dinak, po jo gjer në këtë shkallë.

Kur ai mbaroi, një nga vajzat bëri një pyetje për ma-

rrëdhëniet e nëndrejtorit me Marianën lidhur me çështjet e analizave. Pyetja ishte e zgjuar, madje duke i bërë një lavdërim pyetëses, për të lënë përshtypjen se pyetja s'kishte asnjë nëntekst kundër tij. E skuqur ilakë vajza u ngrit dhe bëri një pyetje të dytë, këtë herë më të vështirë për t'u keqintepretuar. Ku bazohej nëndrejtori për mendimet e tij për Marianën? Thashethemet janë të dëmshme, apo jo, vazhdoi ajo.

Për habinë e të gjithëve nëndrejtori tundi kokën në mënyrë miratuese. Madje, për herë të dytë i buzëqeshi vajzës.

— Më pëlqen serioziteti juaj, — u përgjigj ai. — Sikur të gjykonin të gjithë me një pjekuri të tillë, punët në ndër-marrjen tonë do të ecnin më mirë.

(S'më mbetej veç të ngrihesha e t'i thosha «mashtues» në sytë e të gjithëve, tha më vonë vajza).

Për t'iu përgjigjur «kërkesës» së vajzës, nëndrejtori kërkoi të lexohej letra e prindërve të Norës.

— Ç'mizerje, — pëshpëriti Cezari që e kisha përbri. — S'duhej të qe lexuar kjo letër.

Cezari kishte të drejtë. Letra bëri përshtypje të keqe kundër Marianës pikërisht sepse në të nuk kishte urrejtje ndaj saj. Qe përqëndruar e gjitha për shqetësimin e tyre si prindër për fatin e Norës. Në heshtjen e thellë, ndërsa shefi i kuadrit lexonte, u dëgjua një psherëtimë dhe në fund dy-tri gra i kishin sytë me lot.

— Dreq o punë, — mërmëriti Cezari, tek lëvizte gju-njët me nervozizëm.

U ngrit një nga shoqet e Marianës për të hedhur poshtë letrën, po zëri i saj i dridhshëm, i ndërprerë nga frymëmarrja shqetësuese, duke qenë në kundërshtim me stilin e qetë, pakëz të trishtë të letrës, bëri përshtypje të kundërt.

— Ngadalë, ngadalë ti, gocë, — e ndërpreu Ylberi, anë-tari i komitetit profesional. — Më respekt duhet të kesh për të vjetrit. Në qoftë se ata kanë shkruar atë letër, një ball i madh i ka shtyrë, prandaj dhe s'është ashtu siç thua ti.

Është mirë t'i peshosh fjalët përpara se t'i nxjerrësh.

Zëri i tij sa vinte bëhej më i fortë, sidomos kur nisi të fliste për ndikimin e filmave dhe librave të këqinj. Ja, Mariana s'do të përfundonte ndoshta këtu (e tmerrshme thashë me vete, ku paska përfunduar sipas tij Mariana), pra, Mariana s'do të kishte përfunduar këtu, në qoftë se s'do të pëlqente ca libra ku lavdërohej shthurrja në dashuri. Natyrisht të gjithë kishin përgjegjësi për këtë, ai vetë në radhë të parë, që si anëtar i komitetit profesional që ishte, qe treguar i butë dhe nuk i kishte vënë veshin sinjalizimeve.

— E dëgjon? — i thashë me zë te ulët Cezarit. — Natyrisht që do të flasë kështu, përderisa është kushëri i atij qelbanikut, Qemalit.

Cezari kërcëlliti dhëmbët. Kushëri me Qemalin. Ky qe një tjetër fakt për ta mbërthyer keq. Ejani, futuni vetë në thes, thosha me vete, duke e ndier prapë padurimin për t'u përfytyr me ta.

— Prit, — tha Cezari. — Pas tij do të flas unë.

Pa u ulur mirë tjetri në vend, Cezari u ngrit. Si përherë ai nisi të fliste rrjedhshëm dhe me zë të fortë. Megjithatë, qysh pas frazave të para m'u duk se diçka po i mungonte. Më fuqishëm kishin tingëlluar të gjitha ato që po thoshte, kur i kishim rrahur me njëri-tjetrin. Tani, në publik, gjithçka zbehej, rrëshqiste si rërë, bëhej fir. Ktheva kryet pas për të gjetur vështrimin e Lad Kroit dhe m'u duk se edhe ai qe disi i hutuar. Vetë Cezari, sikur ta ndiente, kishte në ballë ca bulëza djerse. Ishte duke thënë: «Ka makinacione kundër Marianës, ka pleksje interesash të ndyra», kur sekretari i partisë e ndërpreu:

— Ç'makinacione? Ç'pleksje interesash të ndyra? Na i thoni këto, more djem, që t'i dimë.

Në sallë u thellua heshtja.

— Po ja, kërkesa për largimin e Marianës nga laborator i bëhet për t'i hapur vend dikujt...

Si vala që shpejton të zërë prapë vendin e porsalëshuar një murmurimë e shurdhër zëvendësoi heshtjen.

— Po të jetë kështu, — nisi të fliste zëvendëssekretari, po nëndrejtori e ndërpreu:

— Ju duhet t'i vërtetoni ato që flisni, djalosh, ndryshe e kuptoni se...

— Si? — tha Cezari, dhe në çast m'u duk se e humbi sigurinë. Ndoshta isha unë që e humba i pari sigurinë, duke bërë befaz një zbulim të dhimbshëm: ka të vërteta të fuqishme, revoltuese, po që, për fat të keq, janë ende të paafta për të bërë efekt në publik për arsye se shtjellimi i tyre është tepër i zorshëm, ngaqë moria e detajeve shpjeguese ua thith atyre forcën goditëse. Si ta vërtetonte Cezari se shefja e administratës bashkohej me nëndrejtorin për arsyen e marrjes në punë të mbesës së X-it, të cilit i detyrohej për një të drejtë studimi. E gjithë kjo ishte krejtësisht e vërtetuar prej nesh, po hajde shpjegoje në mbledhje.

Ishte pak a shumë e njëjta gjë me Ylberin, nga komiteti profesional, që kishte kushëri Qemalin. Për ne, që e dinim prej Marianës sa i ndyrë qe Qemali dhe motivi i shpifjeve të tij, mjaftonte ideja që Ylberi ishte kushëri me të, për të zhvlerësuar çdo fjalë të tij. Mirëpo njerëzit nuk i dinin raportet Qemal-Marianë dhe, në qoftë se dikush do të më ndërpriste mua duke më thënë: e ç'ë pastaj që Ylberi e ka kushëri Qemalin, mos është e ndaluar të jesh kushëri me dikë, kishte rrezik që unë të ngelesha me gisht në gojë. Si ta vërtetoja poshtërsinë e Qemalit? Të thosha se në një mbremje vallëzimi ai i propozoi marrëdhënie Marianës dhe pastaj për hakmarrje... Oh, sa e vështirë, për të mos thënë e pamundur, ishte e gjithë kjo.

Ligështimi më krijoi një bosh në gjoks, ndërsa e ndieja se furia e të folurit të Cezarit kishte rënë. Tani ai më tepër mbrohej, se sulmonte. Sekretari i partisë nuk ia ndante sytë dhe në to, ashtu si në të gjithë fytyrën e tij të skuqur, ndihej keqardhja që kishte qenë i detyruar të ndërhynte.

Nga fleta ku kisha shënuar ca bika për diskutim i fshiva fjalët «Ylberi është kushëri me Qemalin», duke psherëtirë, me sa duket, aq fort, sa dikush nga rreshti përpara ktheu kokën.

Pas Cezarit foli Diri dhe pas saj njëri pas tjetrit Lad Kroj dhe unë. U duk se po krijohej një barrikadë e qëndrueshme rreth Marianës, megjithatë ajo ndjesia se diçka humbte, bëhet fir, nuk na u nda asnjë sekondë. Unë dhe Lad Kroj i dhamë diskutimit një karakter parimor, gjë që shkaktoi një kënaqësi të dukshme te sekretari i partisë dhe te zëvendësi i tij. Ata të dy tundën disa herë kokën në mënyrë miratuese, sidomos kur Lad Kroj foli për emancipimin e gruas dhe unë për shpifjen si një shfaqje e luftës së klasave. «Shpif, shpif se diçka do të mbetet». I turpëruar nga vetja që përdora një nga thëniet më të përdorura në të gjitha kafenetë dhe pasdarkat, nuk di as vetë pse, ndoshta për t'i dhënë një farë origjinaliteti, shtova aty për aty: «siç ka thënë gjakatarin Makiavel».

U ula në vend në një farë mënyre i kënaqur, sidomos nga tundja miratuese e kokave të sekretarit dhe të zëvendësit, pa më shkuar ndër mend se dashamirësinë e këtij të fundit do ta paguanim tepër shtrenjtë.

Atmosfera e mbledhjes, që dukej se po merrte anën e Marianës, ndryshoi shumë shpejt në të kundërtën. Dhe kjo ndodhi pas diskutimit të inxhinier Robertit.

Ka disa njerëz, fjala e të cilëve në rrethana të caktuara ka një peshë të veçantë. Në mbledhjet ku shfaqen haptas prirjet dhe pasionet e njëres palë kundër tjetrës, shumica e të pranishmëve, ata që duan të hetojnë të vërtetën, të lodhur nga anësia e të dyja palëve, vetvetiu priren për të dëgjuar fjalën e atyre që janë ose kanë hijen e të paanshmit. Paanësia e tyre, e shoqëruar me vetëpërmbajtjen, mënyrën e të folurit, deri te veshja, bën që të gjithë t'i pranojnë njëzëri si arbitra.

Inxhinier Roberti ishte i tillë. Ashtu si shumica edhe ne

ishim të bindur se ai do të thoshte te vërtetën për Marianën, madje, kur dëgjova sekretarin e partisë të thoshte, fjalën e ka kërkuar inxhinier Roberti, ndjeva një qetësi në shpirt.

Mirëpo, për habinë e të gjithëve, ai s'foli mirë për Marianën. Në të vërtetë, s'bëri asnjë akuzë kundër saj, as u fut në ndonjë gjë konkrete, po injaftoi teza që shtjelloi se nuk duhen idealizuar njerëzit, që të gjithë ta kuptonin se qëndrimi i tij ndaj Marianës qe me rezerva. Ndërsa fliste, shikimi i tij disa herë rrëshqiti me zemërim nga zëvendëssekretari i partisë i cili nga ana e tij qe vrenjtur krejt në fytyrë.

Diskutimi i inxhinier Robertit qe fatal për Marianën (më vonë ai vetë kishte pranuar se net të tëra nuk e kishte zënë gjumi nga vrasja e ndërgjegjes)

Pas tij foli Lola C. në një mënyrë gjithashtu të papritur. Ashtu si inxhinieri nuk foli keq kundër Marianës, madje s'bëri as ndonjë vërejtje parimore si ai, po ngaqë nuk foli mirë la përshtypjen se foli keq.

U ndie menjëherë një prishje e drejtpeshimit të mbledhjes. Klani i Norës kaq donte. U sulën njëra pas tjetrës dy shoqe të saj, që gjer atëherë nuk ishin ndier, shefja e administratës, nëndrejtori, që kërkoi fjalën për herë të dytë. Veçanërisht shoqet e Norës ishin agresive. Ku jemi këtu, thirri njëra prej tyre, mos jemi në Itali apo në Zvicër, që të lejohen gjëra të tilla?

— Dale, dale një çikë, — e ndërpreu sekretari i partisë. — Ç'janë këto Italira dhe Zvicra që po na përmend këtu? Dhe ç'paska bërë sipas teje kjo Mariana që meritoka krahasime të tilla?

Ne kujtuam se ndërhyrja e sekretarit do t'ia priste vruillin folëses, po nuk ndodhi ashtu. Në vend që t'i përgjigjej atij, ajo iu drejtua presidiumit.

— Kam vërejtje edhe për qëndrimin tuaj, shoku sekretar, si edhe për zëvendësin. Si shumë me mospërfillje e keni parë gjer më sot këtë çështje. Ky është liberalizëm.

— Është dhe shtypje e kritikës, — foli dikush nga salla.

Sekretari u bë flakë i kuq në fytyrë dhe mblodhi buzët si të fliste me vete. Me siguri që tha: ditë e zezë!

Një shmangie e kishte pushtuar sallën. Ktheva kokën nuk e di pse, dhe për herë të parë sytë më zunë fytyrën e hutuar, të zgjatur edhe më të Terit. Gjurmët e «periudhës blu të Pikasos» dukeshin ende në atë fytyrë, po për habi pamja e tij s'më zgjoi më asnjë fije zemërimi. Ç'po ndodhte kështu? Ishim nisur për të mirë dhe s'kishim bërë gjë tjetër veçse, me duart tona, pa dashje e kishim zhytur thellë e më thellë në baltë Marianën.

Ndërsa mendoja kështu, sytë më shkonin herë pas here te karfica e saj. Vezullimi ishte i dobët tani, si një yll që po shuhej, ndërsa kërkonte ndihmë.

Vazhdonin të flisnin kundër saj. Gjithçka po merrte rrrokullimën me shpejtësi. Mariana po dilte nga kjo mbledhje me një njollë të pashlyeshme. Si bluce të heshtura e përshkonin sallën shikimet e dashakeqëve të saj.

Cezari diçka më pëshpëriti, po në atë kohë unë kapa një lëvizje të vogël dy radhë përpara, aty ku midis shoqeve të saj rrinte Mariana. Dirë diçka i thoshte me nervozizëm. Mariana bënte «jo» me kokë. Dirë, me sa duket, i kërkonte një gjë që tjetra s'e pranonte. Pëshpërimat e tyre sa vinte e bëheshin më të forta, sa që tërhoqën vëmendjen e atyre që rrinin përbri. Ti duhet të ngrihesh, i thoshte Dirë. Jo, jo, dëgjohej përgjigjja e Marianës. M'u duk se kapa fjalën «kartë e fundit» pastaj «në qoftë se vërtet je e tillë», pas të cilave u bë heshtja.

Më vonë, kur arritëm të marrim vesh bisedën e plotë midis tyre, e kuptuam se ajo kishte qenë nga më dramatiket në atë mbledhje. *Ja riprodhimi i saj i plotë:*

— *Ti duhet të ngrihesh dhe ta thuash «atë», — i tha prapë Dirë. Ishte e treta herë që ia kërkonte këtë gjë, por tjetra s'donte që s'donte. I dukej e tmerrshme, fyese. — Çdo*

gjë po merr rrokullimën, e kupton? Duhet të ngrihesh.

— Jo, jo. E pamundur.

— Po mbulohesh me turp për tërë jetën.

— Le të mbulohem.

— Bashkë me ty po njollosemi edhe ne, — vazhdonte

Diri.

— Jo. Vetëm atë s'mund ta bëj.

— E përse? Do t'i mbërthesh të gjithë me shpatulla për muri. Është e vetmja mënyrë për t'i mbërthyer. Dhe s'është ndonjë turp që po përdor këtë kartë të fundit. Turpi le t'u mbetet atyre.

— Jo, jo.

— Në mos për vete, bëje për hirin tonë, për ata që të duan.

— Jo.

— Ti duhet ta bësh, — tha Diri me një ton pak të ndryshëm, — në qoftë se je vërtet e tillë. . .

Mariana s'u përgjigj, vetëm e vështroi heshturazi, me sytë e zbrazur, sikur t'i thoshte: as ti s'më beson më?

Dyshoi vërtet Diri që ia tha ato fjalë të egra, apo e bëri vetëm për ta nxitur të fliste? Këtë nuk e mori vesh askush, përderisa as vetë Diri s'qe në gjendje të thoshte më vonë si qe e vërteta. Me sa duket, ishin të dyja: edhe dyshimi edhe nxitja, po më tepër kjo e fundit.

Mariana vazhdonte të heshte dhe atëherë Diri i tha:

— Mirë, do ta them unë për ty.

Ajo u ngrit dhe kërkoi fjalën. Zëri i saj, megjithëse nuk qe aspak i ngjirur, të jepte përshtypjen e ngjirjes, si të gjithë zërat kur thohë diçka tronditëse.

— Këtu u hodh shumë baltë mbi shoqen tonë, Mariana, — tha ajo. — U folën shumë gjëra për të vërtetuar se Mariana është imorale. — Diri ktheu kokën nga pjesa tjetër e sallës. Në sytë kishte një skuqje të lehtë gërryese. — **Unë nuk do të përsëris ato që u thanë, vetëm dëshëroj të bëj një pyetje, që mendoj se është themelore. Dhe pyetja**

ime është kjo: a mund të jetë imorale, në atë kuptim që u tha këtu, një vajzë që... që nuk i njeh marrëdhëniet fizike me meshkujt?

Heshtja në sallë qe bërë e padurueshme. Midis saj, dikush ia bëri «hm».

— Mos bëni «hm», ju andej, — thirri Diri, me një zë vërtet të ngjirur. — Kjo është një gjë që vërtetohet... Për këtë ka mënyra... ka mjekë... Dhe në qoftë se vërtetohet, ku do të futeni atëherë ju, që aq shumë keni shpifur, që...

Gulçi nuk e la të fliste më tej, vetëm sytë e saj, të skuqur, po për çudi të thatë, vazhdonin të vështronin herë presidiumin, herë sallën, si të hetonin se a ishte kuptuar gjer në fund ajo që tha. Po s'kishte nevojë për fjalë të tjera, se gjithçka qe kuptuar dhe të gjithë e ndien veten befas të mbërthyer si nga një ngërç.

— Le ta vërtetojë, — u dëgjua një zë nga salla.

Nga fundi i sallës u ngrit atëherë një burrë i gjatë, i shëndoshë, kaldaisti Azem, që s'i qe dëgjuar kurrë zëri në ndonjë mbledhje. Fytyra e tij e kuqe dukej se do të pëlciste nga trazimi.

— Për besë, moj cucë, po ta vërtetonte, do të na hiqte të gjithëve një siklet, — tha ai me zërin si bubullimë. — Dhe shumëkush do të jepte llogari, për besë... për gjithë këtë mërzi.

Sekretari i partisë u mat të ndërhynte, po diçka ia preu vrullin. Në vend që të brofte më këmbë, ai mbështeti ballin te pëllëmba e dorës dhe po hetonte sallën.

Pas shtangies së parë, heshtja po prishej.

— Kjo s'duhej... — murmuriti Cezari.

Ende s'kisha marrë veten nga tronditja dhe s'kisha qarësi gjykimi, megjithatë edhe mua m'u duk se qe kapërcyer një kufi që s'duhej kapërcyer... Megjithëse, ndoshta... Por jo, ishte tepër e rëndë. Cezari kishte të drejtë. Ndonëse...

Po tani s'duhej vrrarë mendja për këtë. E ngutshme, zile e alarmit që binte e binte papushim ishte tjetër gjë: sfida

e Dirit ishte hedhur tani, fjala qe thënë dhe asgjë s'mund ta zhbënte apo ta kthente mbrapsht. Ishte një fjalë tiranike që kërkonte vazhdimësi...

— S'duhej kurrsesi... — tha prapë Cezari.

— Po, ndoshta...

— Është e papranueshme, barbare.

— Tani s'ke ç'i bën. U tha.

Cezari mori frymë thellë.

Kërkova me sy Lad Kroin dhe në vështrimin e tij pashë po atë çoroditje. Kishte nisur një fazë e re që diktonte tjetër gjë.

Ndërkaq salla, sikur t'i qenë liruar ca burma, gumëzhinte lehtazi. Njerëzit murmuritnin kokë më kokë. Ata të klanit të Norës shkëmbenin vështrime kuptimplote triumfi. Kishte edhe pëshpërima: Ku dihen këto gjëra? Pse, pishën i ka mbajtur ajo? Megjithatë, është diçka që vërtetohet.

Ç'të bënim? Të ngriheshim e të thoshnim se kjo që i kërkohet Marianës, vërtetimi i nderit të saj, ishte një marrëzi primitive, fyerje e dinjitetit të femrës etj., apo ta linim gjithçka të ecte vetë në rrjedhën e saj. Ja edhe sekretari i partisë, për të cilin ishin të bindur se e donte Marianën, dukej se po e provonte të njëjtën mëdyshje. Sa më tepër që kalonin sekondat, aq më çartë e kuptonim se kishim rënë në kthetrat e një gjendjeje të vështirë, ku rralëherë i qëllon të gjendet njeriu. Ishte si një makinë skëterre, rrotat dhe dhëmbëzat e së cilës vërtiteshin në drejtime të kundërta. Atëherë kur ti kujtoje se po çliroheshe prej saj, ajo mund të t'i ngulte dhëmbët më fort. Të pranonim atë që kishte kërkuar Diri do të thoshte t'i nënshtroheshim fyerjes dhe injorancës, po, nga ana tjetër, ta pengonim ishte njëllor si të përjetësonim rryollën e Marianës. Vec kësaj, çdo këmbëngulje, sidomos nga ana e jonë, për të mos lejuar «vërtetimin e nderit» të Marianës, a nuk do të merrej si një dyshim se ne dinim diçka më shumë për të, qoftë edhe në krahasim me Dirin dhe kështu donim ta shpëtonim Ma-

rianën nga ajo që, nga dëshmi e nderit, mund të kthehej në dëshmi të turpfit të saj? (A s'qe pëshpëritur ditët e fundit për ne të tre: po këta ç'kanë që e mbrojnë me kaq zjarr? Mos ndonjëri prej tyre...) S'duhej harruar gjithashtu se nga fjalët që kisha dëgjuar të këmbenin dy shoqet pak çaste përpara sfidës së Dirit, Mariana s'kishte dashur kurrsesi dhe qe paralizuar vetëm kur tjetra i kishte bërë presion. (Në goftë se je vërtet e tillë...)

Në goftë se... E në goftë se Mariana s'ishte e tillë, siç e donte Dirin. Uh, kjo ishte vërtet një torturë.

Duke kthyer sytë, s'di sepse, në drejtimin nga po vështronte Lad Kroin, për herë të parë pashë Filip Dibrën. Ku kishte qenë gjer atëherë? Isha i sigurt se edhe të tjerëve u dukej si i fanitur befasi. E hetonin me bisht të syrit dhe fakti që tani po e vinin re atë që gjer atëherë kishte qenë në hije, tregonte se në kokat e njerëzve (a nuk bëja pjesë edhe unë në to?) po nduhej mjegulla e pandehmave dhe dyshimeve. Ai mund ta dinte të vërtetën...

Filip Dibra rrinte i ngrysur, i rrasur pas karriges, si të donte të bëhej njësh me shpinën e saj për të mos rënë në sy.

Ndërkaq në presidium ndodhte pak a shumë e njëjta gjë si në sallë. Bisedohej dy nga dy, s'ndërmerrej asgjë. Sekretari i partisë, i skuqur e i djersitur në fytyrë, kishte zgjidhur kravatën si të donte të çlirohej nga sikleti. (Ç'të bëja? Kishte thënë më vonë. E ndieja veten ngusht dhe të paaftë të merrja ndonjë vendim. Dy-tri herë u mata ta hidhja poshtë përfundimisht kërkesën e Dirit: Ç'janë këto fjalë, moj vajzë, ku jemi këtu, në kohën e Nuhut, po pas ndërhyrjes së kaldaistit, diçka më pengonte. Vërtet ajo që kërkonte Dirin qe e pazakonshme, çnjerëzore, por ishte e vetmja mënyrë ama për t'i dhënë tund kësaj shëmtie. Sa për atë që Mariana mund të mos ishte e tillë, kjo as që më shkoi ndërmend. Kështu, ndërsa salla gumëzhinte dhe unë pakundesha midis dy mendimeve pa gjetur dot kurrsesi se

cili ishte më i arsyeshmi dhe, kryesorja, më i favorshmi për Marianën, më vetëtiu në kokë ideja e shtyrjes së mbledhjes për pasdite, si e vetmja mënyrë për të fituar kohë).

11

Kur sekretari i partisë tha se mbledhja ndërpritej për të vazhduar në orën pesë, të gjithë ndien një lehtësim. Dy-tri zëra thanë: «po pasdite kemi sport», por askush s'ua vuri veshin.

Njerëzit dolën nga salla në grupe të vogla, duke folur merrej me mend përse. Mariana ishte e bardhë në fytyrë dhe në sytë kishte një ndryshim të çuditshëm, që ishte e vështirë ta përcaktoje. Ngjante sikur një retinë e dytë, si një xham mbrojtës që vendosur një ose dy milimetra përpara syve të saj për të mos lejuar asnjë shikim të depërtonte thellë tyre.

Siç u mor vesh më vonë, pothuajse të gjithë, duke dalë nga mbledhja, kishin diskutuar të njëjtën gjë: duheshin apo s'duheshin pranuar forma të tilla dëshmie për nderin e një vajze. Shumica ishin gjithsesi kundër. Por edhe tek ata që lëkundeshin, pavarësisht nga lëkundjet, ndjesia e diçkaje trazuese qetësiprishëse shoqëronte fjalët dhe mendimet e tyre. Më mirë se nga kushdo kjo u shpreh në fjalët e teto Sanijes, pastrueses: «S'janë të mira këto, — kishte thënë ajo. — Unë s'di ta them pse, di vetëm që s'janë të mira. Pas gjërave të tilla vijnë tërmetet, sëmundjet.»

E çuditshme ishte se, ndërsa dilnin nga mbledhja, askush nuk u kujtua të pyeste: po pse do të vijmë prapë pasdite? Ç'do të bëhet?

Me sa duket, të kënaqur nga ndërprerja e asaj lo-dhjeje, vetëm në mes të rrugës, apo duke hyrë nëpër shtëpitë

e tyre për të ngrënë drekë, njerëzit ishin kujtuar e kishin thënë me vete: ç'do të bëhet pasdite?

Dhe vërtet, ç'do të bëhej? Duke mbyllur mbledhjen, sekretari i partisë nuk dha ndonjë shpjegim. U pranua apo nuk u pranua kërkesa e Dirit? Do të sillte apo jo Mariana atë vërtetimin e famshëm dhe, në qoftë se po, ishte fjala për atë pasdite? Apo mbledhja do të vazhdonte prapë si në mëngjes me zërat pro dhe kundër?

Asgjë nuk u tha shprehimisht dhe secili e mendonte punën pas kokës së tij. Po kjo vetëm në fillim. Sa më shumë kalonin orët, aq më tepër dukëj normale që kjo çështje duhet të sqarohet qysh atë pasdite, madje shumë që zvarritur.

Dy orë më pas, nga rrugë që s'dihej si e qysh, (ndoshta e kishin parë rastësisht grupin e vajzave që po ecnin drejt klinikës apo e kishin ndjekur me qëllim), u mor vesh që Mariana kishte shkuar të nxirrte dëshminë, kështu që pasdite kjo histori do të merrte fund. Madje u thanë edhe hollësi; ajo s'kishte dashur, kuptohej përse, fyerje, ulje e dinjitetit etj., po shoqet e kishin detyruar: tani u bë ç'u bë, duhej çuar gjer në fund.

Në orën katër e gjysmë, kur në sallën e laboratorit nisi grumbullimi i njerëzve (rrallë kishte qëlluar të vinin kaq herët për ndonjë mbledhje), u mor vesh se zërat që kishin qarkulluar ishin të saktë: Mariana kishte shkuar vërtet në klinikë.

Një kureshti e paparë dukej në sytë e disave. Për të tjerët ishte vështirë të gjeje ç'mendonin.

Në orën pesë pa çerek erdhën shoqet e saj të ngushta, midis tyre Diri. Nuk e fshehën që Mariana kishte shkuar për të bërë vizitën. Siç u mor vesh, ato e kishin shoqëruar një copë rrugë, por ajo kishte ngulur këmbë që të shkonte vetëm. Dhe ashtu bëri. Kjo kishte ndodhur para dy orësh dhe nga çasti në çast ajo mund të mbërrinte.

Minutat kalonin dhe tani askush nuk mendonte më: që

e mirë apo e keqe e gjithë kjo. Pritej vetëm ardhja e Marianës, të tjerat dukeshin pa rëndësi.

Në pesë pa pesë u dukën shenjat e para të ankthit. E sikur të mos vinte?

Nga fasada prej qelqi dukej rruga e lagur me kalimtarët e rrallë.

Në pesë pa dy minuta në sallë qenë futur ata që gjer atëhere kishin pirë cigare në korridor. Hapni dritën, tha dikush, po erret.

Diri me shoqet nuk e fshihnin më shqetësimin. Këmbenin fjalë të shkurtra me njëra-tjetrën, afroheshin te dritaret për të parë rrugën.

Klani rreth Norës nuk ndihej, si të kishte ngrirë.

Ora e laboratorit ra pesë.

Një pjesë e drejtuesve të mbledhjes ishin ende në korridor, po sekretari i partisë me zëvendësin zunë vend në tryezën e presidiumit.

U dëgjuan aty-këtu fjalët: vonesë autobusi, vonesë në klinikë, por ato ishin fare të dobëta.

Ankthi shquhej tani në sytë e shumë njerëzve.

Mos ka vrarë veten? Këto fjalë, që m'i tha me zë të ulët Cezari unë i kisha kaluar nëpër mend disa sekonda më parë. Kjo do të thoshte se Cezari, ashtu si unë, dyshonte që Mariana s'e kishte marrë dot atë vërtetim. Pra s'paskësh qenë e tillë, siç e kishim kujtuar... Në çast më erdhi të ulërija nga tërbimi dhe dhimbja... Ne nuk e kishim menduar asnjëherë Marianën «të tillë» apo «jo të tillë». «E tillë» ose jo, ajo ishte për ne Mariana që njihnim dhe të tjerat s'kishin patur asnjë rëndësi. Por ja, kishte ardhur kjo mbledhje e mallkuar, me atë ndërhyrjen idiote të Dirit, për të sajuar aty për aty atë makinë ferri, që të detyronte të mendoje pas ligjeve të saj.

— S'duhej ta kishim lejuar të shkonte, — tha Lad Kroi me një zë të shuar.

Në orën pesë e pesë, dy nga shoqet e saj u nisën diku,

me siguri për në klinikë, ose në shtëpinë e Marianës, për të marrë vesh ndonjë gjë.

Në rrugë vazhdonte të binte shi i imët. Një shurdhëri e brendshme bënte që salla të dukej e heshtur, megjithëse njerëzit flisnin me zë të ulët me njëri-tjetrin, një pjesë duke u shtirur se nuk e kishin mendjen te pritja. Fshehtazi hidhnin sytë te ora në mur, pastaj te orët e tyre, por asnjë zë nuk tha: pse nuk fillojmë.

Tani hapur ndihej dyshimi që ajo nuk do të vinte.

Qysh prej disa minutash nuk ia hiqja sytë Filip Dibrës. Fytyra e tij qe krejt e prerë. Ky duhet të dinte të vërtetën, mendoja.

(Vuajtje më të madhe se atë pasdite s'kam provuar ndonjëherë, kishte rrëfyer më vonë ai. Një brengë e zezë më kishte kapulluar të gjithin. E ndieja se njerëzit më vështronin me bisht të syrit, sikur unë të kisha çelësin e enigmës. Ta dinin ata se ankthi im qe më i madh se i kujtdo dhe kjo pikërisht për shkakun se, ashtu si të tjerët, unë s'dija asgjë. Ose, që të jem më i saktë, unë dija diçka, që ma shtonte brengën... Kur ora po i afrohej pesës isha gati të më këputnin një krah, veç që ajo të vinte... Kur dëgjova në mëngjes Dirin, e sidomos kur mora vesh se Mariana qe nisur për në klinikë, ndjeva një qetësim në zemër: e po shyqyr, thashë me vete. Kjo do të thoshte se ajo vazhdonte të ishte e pastër, siç i thonë, ashtu si në kohën e lidhjes sonë të shkurtrë. Sepse e tillë qe atëherë, madje një nga arsytet e marrëveshjes sonë kishte qenë kjo... Në mëngjes, pas ndërhyrjes së Dirit, desha të ngrihesha, madje më vonë dikush më tha: ti duhej të ngriheshe, pra u bëra gati të ngrihesha e të thosha: lërin marrëzitë, Mariana është e pastër, ne u ndamë pikërisht për këtë, po në çast dyshimi i mallkuar më frenoi. Po sikur dikush të më ndërhynte e të më bënte qesharak duke më thënë; ku e di ti, gjer me ty ndoshta ka qenë e tillë, po më vonë pishën i ke mbajtur? Desha të shtoj se këto fjalë të neveritshme m'i kapi veshi të përshpëriten

kur po fliste Dirë. . . Vërtet, kishin kaluar gati tetë muaj dhe dyshimi, si një gaforre e zezë, më shtrëngoi në gjoks. Ai më çliroi disi kur mora vesh se Mariana kishte shkuar në klinikë, po në orën pesë ai nisi të më fuste kthetrat përsëri thellë e më thellë. Dhe, bashkë me të, një dhimbje e papërballueshme, çnjerëzore, që ajo vajzë e mrekullueshme, që unë e kisha humbur, i kishte përkitur një tjetri, më gërricte egërsisht. Tani, kur e kujtoj, ende i ndiej kthetrat e saj. . .)

Në orën pesë e njëzet minuta u kthyen dy vajzat që kishin shkuar për të marrë vesh ndonjë gjë, të lagura, të dëshpëruara, me flokët si fitila. Nuk ishte nevoja për të dhënë sqarime, as ua kërkoi kush, sepse u bë e qartë se gjithçka kishte marrë fund: Mariana nuk do të vinte.

Trauma që na shkaktoi ishte mizore. Lad Kroit, që ishte betuar t'i modifikonte portretet e fajtorëve sipas të gjitha rrymave moderniste, i qenë skuqur sytë gjak sikur do të qante. Sekretari i partisë kishte zënë ballin me dorë dhe nuk vështronte askënd. Filip Dibra dukej më keq. Shumica kujtonin se qe ai autori. . . Edhe Teri rrugaçi dukej i shushatur.

Një brengë e shurdhër, e qetë na kishte kapulluar. Pse na e bëri këtë Mariana. . . E dinim se ajo s'kishte faj, edhe në qoftë se duhej gjetur një fajtor, ishte ndërhyrja mendjelehtë e Dirës. . . Me sa dukej, kjo punë kështu edhe do të bitisej, siç qe nisur, sa herë që kishim dashur ta ndreqnim, e kishim prishur më keq.

Në sallë vazhdonte një murmurinë e mbytur si midis rrënojave të një tempulli. . . Për çudi, askush nuk tha një fjalë të keqe për Marianën e rrëzuar. . . Po keq nuk flitet për të vdekurit, më shkoi një grimë nëpër mend. . . S'guxuan as dashakeqët, madje klani i Norës, ngjante si i paralizuar. Pas fjalëve të dikujt «gjynah humbëm dhe sportin», që u rrethuan nga një heshtje kërcënuese, të tjerët nuk e hapën gojën. Lad Kroit i vështronte me radhë me ata sy që i shkrepëtinin, si t'u thoshte: eh, u kënaqët tani? (Pak më pas, gjatë daljes në korridor, pa e ditur as vetë pse, ai eci

një copë rrugë ngjitur sup më sup me nëndrejtorin, në atë mënyrë, saqë ky i fundit, që kishte dashur më kot të shqitej, e kishte vështruar me frikë: ç'kërkon të bëjë ky i lajthitur?)

Sekretari i partisë e ndjeu më në fund që prej tij kërkoheshin diçka. U ngrit ngadalë nga karrigia, sikur t'i dhimbnin kokat, dhe me një zë poroz, gjysmë të ngjirur, tha:

— Meqenëse mungon Mariana, po e shtyjme mbledhjen.

Asnjë fjalë për vizitën mjekësore apo fletëekzaminimin që pritej.

(Kishte vite që s'kisha vënë pije në gojë, për shkak të tensionit, tregoi më vonë. Por atë mbrëmje shkuam në birrari bashkë me Naumin, zëvendësin, me dëshirën që të bëheshim xurxull).

Njerëzit nisën të dilnin pa ngut nga të dyja dyert e laboratorit. Duke dalë sajoheshin grupe të vogla që më shumë heshtnin se flisnin. Shoqet e saj të ngushta, të lagura, me sytë të çakërdisura nga brenga dhe zhgënjimi, vështronin në mënyrë të tillë sikur të prisnin ngushëllime... Ngushëllime për vdekjen e Marianës.

Vetëm njëra ia plasi një dënese të shkurtër, mu te porta e daljes, por ajo ishte për çudi dikush që nuk pritej, Lola C.

Në rrugë njerëzit ecën një copë herë po ashtu, në grupe të vogla, gjysmë të heshtur dhe një djalë i ri, bullafiq, që kishte vetëm dy muaj që kishte ardhur te ne e që nuk ia kishim dëgjuar kurrë zërin, ndërsa ecte dy hapa përbri Norës, tha nëpër dhëmbë:

— Kjo shkurtabiqe ia hëngri më në fund kokën Marianës.

Gazmendi, që ecte i zymtë përkrah së fejuarës, e dëgjoji, po nuk e ktheu kokën.

12

Si pamja që mezi zbulohet e plotë prapa një perdeje të ngritur mundimshëm, ashtu u mor vesh më vonë se si kishte qenë ajo pasdite e paharruar e Marianës.

Në të vërtetë, pas shtyrjes së mbledhjes, ajo, bashkë me shoqet më të ngushta, u gjend, si pakuptuar, thua se këmbët po e çonin vetvetiu atje, në rrugën e klinikës nr. 6. Ecte si e trullësor, pa folur fare, vetëm një herë ndali hapat dhe, si të përmendej nga gjumi, tha:

— Po kjo është një marrëzi, është një turp. Si nuk e kuptoni?

— Fillove prapë ti? — ia prenë ato. — Është si është, kjo duhet bërë. Në fund të fundit, ashtu i do mushka drutë.

Mariana i vështroi me radhë. Jeni në vete, përse më detyroni për këtë? Po diçka e akullt, e pamëshirshme në vështrimet e tyre e detyroi të vazhdonte rrugën.

Vetëm pranë klinikës u tha shoqeve: — Ikni ju, do të shkoj vetëm.

Ato vështruan njëra-tjetrën.

— S'më besoni? — tha dhe, për herë të parë pas kaq kohësh, buzëqeshi, po me ironi. — Mos kini merak, do t'jua sjell dëshminë. — Pastaj pasi bëri dy hapa, u kthye. — Në goftë se do të vë re se më prisni, apo më përgjoni, do të kthehem pa të.

Ato ikën vërtet dhe, që nga ai çast, nuk e pamë më.

Mariana mbërriti në klinikë pas disa minutash. Në kokë kishte vazhdimisht një pyetje. Ku do të paraqitej, si? Ndoshta për kësi rastesh kishte komisione mjeko-ligjore, ndoshta...

Ngadalshëm ajo u vërtit një copë herë nëpër korridoret, duke lexuar tabelat e dyerve «Otorino-laringologu», «Kardiologjia», «Sëmundje të lëkurës». Kalonin njerëz të ngutur, që brenda dyerve dëgjohej një zile telefoni.

Ajo pa një dorë gjysmë të hapur, përmes së cilës dukej perparësja e bardhë e një mjeku. Pa menduar e shtyu dhe kaperecu pragun. Brenda ishte, përveç mjekut, një grua me perparëse, ndoshta infermiere. Diçka bisedonin qetësisht, ndërsa tjetraja përtypte çamçakëz.

— Me falni, — tha Mariana.

Zem i paktë, apo ndoshta fytyra e saj, bënë që ata të shikonin me vëmendje.

— Çfarë kishit?

— Nuk e di. Ndoshta jam gabim... desha...

— Vuani nga diçka?

Ajo i vështroi të dy disa sekonda.

— Hyni, hyni, — tha mjeku.

Ishte i ri, i hollë, me një kravatë të kaltër, me vija të pjerrëta. (Megjithëse dukej e qetë në fytyrë, nuk qe e vështirë të kuptoje se ishte ende nën efektin e një traume, kishte treguar më vonë mjeku. Në raste të tilla qetësia është më e keqe).

— Urdhëroni? — pyeti ai me zë të butë.

— Desha të vizitohem, — tha Mariana, — për të parur një...

— Një raport? Po kjo s'është e vështirë. — tha mjeku për ta lehtësuar.

— Një raport... jo. Desha vetëm një vërtetim... një farë dëshmie... nuk e di si quhet... për...

Ajo pa një shprehim vuajtjeje në mollëzat e mjekut dhe kjo ia lehtësoi vërtet të folurën.

— Desha të them... një dëshmi që jam vajzë.

Mjeku me infermierën vështruan njëri-tjetrin, pastaj atë. Ishte e bukur, pak më e gjatë se mesatarja, me një karficë vezulluese në flokët e çelët. Mjeku deshi ta pyeste nëse kishte ndonjë problem me të tejuarin, apo çështje gjyqësore, apo... Kishte dëgjuar se kërkoheshin nganjëherë dëshmitarë të tilla, megjithëse rrallë, tepër rrallë. Atij vetë s'i kishte ndodhur ndonjëherë. Deshi ta pyeste, po ndërkaq

ndjeu të rëndohej i gjithi, sikur t'i qe dhjetëfishuar pesha, nga një trishtim i madh.

Ndërkaq sytë e vajzës ndaluan një grimë te shtrati i vizitave, pastaj qetësisht, në mënyrë pyetëse (tronditja e tij më dha mua qetësi, kishte thënë ajo më vonë), kishte vështruar mjekun.

— A mundeni?

Ai bëri po me kokë.

Ajo iu afrua shtratit dhe, pa e ditur mirë se ç'duhej të bënte, qëndroi gjysmë shtrirë në të, në pritje, duke mos bërë, për herë të parë në jetë, lëvizjen instiktive për të mbuluar gjunjët që iu zbuluan pak. (Ndenji ashtu, gjysmë shtrirë, si një sorkadhe e plagosur, kishte thënë mjeku).

Për një minutë rresht, ndoshta më tepër, ai vështroi shiun e hollë që binte përjashta, pas qelqeve të dritareve që dukeshin poroze, prej avullit, duke pritur më kot që trishtimi ta braktiste. Pastaj u kthye nga infermierja dhe të dy u panë në sy gjatë, në një marrëveshje të heshtur. Iu afruan tryezës, mori prej saj një fletë recete dhe, duke u përpjekur sa mundej të qetësonte gërmat e egër-suara, shkroi ca radhë në të.

Iu afrua pacientes që rrinte erde gjysmë e shtrirë, mbështetur në bërrylin e djathtë dhe ia zgjati recetën.

— S'ka nevojë për vizitë, — tha me zë të ulët. — Unë ju besoj. Mund të ngriheni.

Vajza drejtoi trupin, gjeti me këmbë njëren nga këpuçet që i kishte rënë në dysheme, pastaj zgjati dorën për të marrë fletën.

— Faleminderit, doktor, — tha me zë të qetë, ku s'ndihej asnjë gëzim. — Faleminderit, — i tha edhe infermieres dhe u drejtua nga dera.

Mjeku iu afrua prapë dritares dhe e priti gjersa ajo doli te porta kryesore, që dukej nga dritarja e tij. E ndoqi pastaj me sy gjersa humbi në rrjedhën e kalumtarëve.

Vetëm pasi eci një copë rrugë, Mariana u kujtua që

pa e mbante ende në dorë fletën e recetës. Një erë e athët, e njohur qymyrguri tregonte se kishin filluar të ndiznin kaldataj e ngrohjes së kaloriferëve. Ishte tamam mes vjeshtë.

Pa e ngadalësuar ecjen ajo vështroi recetën. Midis shkrimit të ngatërruar të mjekut dalloi vetëm fjalën «virginis». Një pikëz shiu që ra sipër saj e zgjati i-në e mesit, po shqetësimi se mos pikëzat e tjera ia fshihnin fjalët e dëshmisë mbeti në sipërfaqe të ndërgjegjes së saj. Në vend që ta fuste fletëzën në çantë, ajo vazhdoi ta mbante në dorë, siç bëjnë njerëzit me një faturë që do ta dorëzojnë së shpejti.

Një pikëz tjetër i vuri një bisht si një pikë loti gërmës «g». E çuditshme gjithsesi, mendoi. Po mbante në dorë nderin e saj.

Përfytyroi sallën e laboratorit që do të mbushej dalëngadalë, pritjen e tyre, murmurimën e shtruar përpara fillimit Pastaj, si shkrepëtimat në prag të çeljes së motit, fjalët triumfuese të dashamirëve të saj dhe kokat e ulura, gratë për të kërkuar ndjesë, të dashakeqëve. Dhe gjithë këtë mrekulli këtë përmbysje të gjendjes e bënte ajo fletëz e hollë, apo më saktë, ajo fjalëz «virginis», që vinte nga një gjuhë e vdekur për t'i kthyer asaj nderin. Por ah, ja, një pikëz e tretë e kishte bërë si me bisht gërmën «s».

Në vend që ta mbronte fletën tani që pikat e imta po shtoheshin ajo e pa habitshëm, si një kureshti, pastaj, duke e afruar te dora e lirë, e palosi recetën dhe e grisi katër copash. Disa sekonda i mbajti copat në dorë, gjersa gjeti me sy rrjedhën e ujit të krijuar prej shiut, nën bordurën e trotuarit. E hodhi recetën e grisur në të dhe, pa kthyer as kokën për të parë si rrjedhëza i çonte copëra e letërës drejt një zgare të hekurt shkarkimi, vazhdoi rrugën drejt shtëpisë.

Nëqoftëse për ditë me radhë në u kthiem e u rikthiem te ky gjest i Marianës, kjo s'kishte të bënte fare

me ndonjë dilemë sado të vogël për drejtësinë e këtij gjesti. Pavarësisht se ç'mendonin shoqet e saj (dhe kjo kryesisht fill pas ngjarjes), ne asnjëherë nuk e vumë në diskutim faktin që me atë gjest Mariana kishte bërë një gjë të mrekullueshme. Që një vajzë e re të griste me dorën e saj një dëshmi të atillë, duke treguar se s'kishte nevojë për të (sa vajza ishin rrëzuar nga hekuri i armës, nga helmi apo brenga për një gjë të tillë, sa të tjera qenë mbytur nëpër puse ose kishin përgjakur breza të tërë njerëzorë me zinxhirin e gjakmarrjes), pra, që një vajzë të hiqte dorë vetë nga dëshmia, kjo tregonte mbi të gjitha dinjitet dhe personalitet.

Ne na mungoi për ca kohë tjetër gjë dhe pikërisht pyetja se përse duhej të vinte ky gjest i Marianës për të na hequr një perde nga sytë. Pas gjestit të saj, gjithë ato arsyetimet tona përpara e gjatë mbledhjes, arsyetime që dukeshin aq të logjikshme për gjoja mbrojtjen e saj, u dukën pa kuptim.

Kurse ajo, më e përparuar nga të gjithë ne, me një lëvizje të dorës, çliroi veten e saj dhe ne të gjithë nga paragjykimi për gjoja forcën e mendësisë së vjetër, të cilës, do apo s'do ti je i detyruar t'i lëshosh rrugë.

Po për ta bërë atë grisje duhej një jetë e tërë përgatitjeje. E saj dhe e epokës.

13

Ç'ndodhi më pas?

Mariana mungoi tri ditë në punë... Moti që ftohur papritur e gjithçka na dukej se kishte ndodhur në një stinë tjetër. Në xhamat e mëdha të dritareve të laboratorit sqota afronte frymën e saj të akullt. Laboratori dukej bosh pa të.

Përgjumshëm vështroja provëzat e qelqta me etiketat e gjithfarë helmeve, çdonjëri prej të cilëve mund të kishte qenë vdekjeprurës për Marianën dhe më dukej si habi që do ta kishim prapë midis nesh...

...E sikur Mariana të mos vinte? Ç'ishte kjo mungesë triditshe? Tri ditë... Tre muaj... tre vjet...

Mariana nuk erdhi më as pas tre muajsh, as pas tre vjetësh...

Ajo s'erdhi më askurrë. Thuhej se mërzitë e forta nxitnin kanceret apo leucemitë. Natyrisht, në fletët e analizave që ajo kishte filluar nuk shënoheshin asgjëkund këto fjalë, po dalëngadalë të gjithë e mësuan se asaj i qe shfaqur një sëmundje e pashërueshme.

Pas rrezeve me kobalt i erdhi rradha shtrimit në spital. Ishte e qetë dhe asnjëherë s'e përmendi atë që kishte ndodhur. Vdiq në pranverë, atëherë kur përfytyroheshin më lehtë vdekjet e pazakonshme. Në varrim shkoi e gjithë ndërmarrja. Një pjesë e njerëzve qanin. Shoqet e saj të ngushta, të tjerë që s'të shkonte mendja se mund të lëshonin ndonjëherë lot. Qante sekretari i partisë me zëvendësin e tij, Naumin, drejtori i ndërmarrjes që e kishte marrë vesh i fundit gjithçka, Cezari, Filip Libra, teto Sanija pastuesja, e gjer te rrugaçi Teri, që ndërsa gulçonte, fshinte vazhdimisht me duar fytyrën, duke lënë në të ca si gjurmë balte. Po më shumë qanin ata që kishin qenë dashakeqët e saj. Sa më fort që e kishin sulmuar, aq më tepër dënesnin, me atë ngërdheshje të turbullt që shkakton mbi fytyra e cara prej pendimit. Shefja e administratës, inxhinier Roberti, Nafija, Veronika, gjithë klani i Norës. Gjatë kohës së zbritjes së arkivolit, Gazmendi kishte zënë kokën me duar dhe vetë Nora kishte lëshuar një gulç të thatë, të egër...

Duke përfytyruar vdekjen e paqenë të Marianës, shumë herë i kisha bërë pyetjen vetes se ç'ishte ky fantazim nga ana ime? Sentimentalizëm vulgar, ndjenjë e fshehtë e

shkatërrimit, apo një kotësi, që rrihte megjithatë të nxirte në sipërfaqe ca ndriçime të errta. të turbullta, si ato që lodrojnë në thellësitë e ndonjë pusi të ndërgjegjes sime?

E qetësova veten kur m'u kujtua se më kishte thënë dikush që shpeshherë fëmijët, sidomos kur ndëshkohen prej prindërve, përfytyrojnë vdekjen e vet si një mënyrë për t'i torturuar ata me ndjenjën e pendimit. Dashnorët gjithashtu, për motive nga më të ndryshmet, përfytyronin vdekjen e partnerit, po më shumë të vetes, me të vetmen dëshirë që të mund të shikonin të regjistruar në ndonjë videokasetë përshtypjen që ajo do të bënte. Në fund të fundit, a nuk e kishte shprehur pak a shumë këtë gjë populli me proverbin e vjetër: vdis të të dua?

Mariana s'mungoi veçse tri ditë. Ajo erdhi në mëngjesin e ditës së katërt, si të mos kishte ndodhur asgjë, pakëz e zbehtë në fytyrë, thua se vdekja e përfytyruar prej meje t'i kishte fryrë, megjithatë, si një puhizë nëpër gjumë.

Askush nuk e përmendi atë që kishte ndodhur. Pas ca ditëve me shi dhe erë, koha u ftoh dhe më shumë në prag të dimrit dhe një hënë e akullt u duk në qiellin e ngrirë. Atëherë ne e kuptuam sesa thellë e kishim përjetuar historinë e Marianës; për një kohë të gjatë ne nuk e shikonim dot pa tronditje hënë.

Pikërisht një natë me hënë më qëlloi të shoqëroja Marianën nëpër të njëjtën rrugë ku e pati shoqëruar atëherë Gazmendi. Afishet e shfaqjeve teatrale të qullura e të shkalafitura vende-vende nga shiu i disa ditëve më parë ishin prapë aty, me tituj të tjerë dhe me oraret e dimrit tashmë.

Desha t'i thosha: A ke menduar ndonjëherë ç'do të bënin të tjerët, sidomos dashakeqët, po të vdisje? E kam menduar unë për ty.

Po nuk i thashë asgjë. Ndriste hëna kudo dhe ne të dy s'kishte si të mos mendonim për të. T'i thosha se, qysh prej ngjarjes së saj, nuk e duroja dot hënë, si ai persona-

zhi i filmit «Drakula» që tjetërsonej nën dritën e saj?
— Kjo hënë, — thashë me zë fare të ulët, por ajo s'më la të vazhdoja.

— Pusho, — mërmëriti, duke kthyer kokën nga unë.

Hëna i vezulloi si flori nëpër qerpikë, supet e saj u gjendën vetvetiu afër supeve të mi dhe unë provova më të ëmblin përçafim të krejt jetës sime.

Por as kjo nuk ishte e vërtetë. Ashtu si vdekja e saj, edhe përçafimi ynë s'ishte veçse fryt i ëndërrimit tim.

Ishte e vështirë ta shoqëroja Marianën dhe aq më pak të bëja një bisedë të ëmbël me të. Dhe kjo, sepse pas asaj që i ndodhi, Mariana ndryshoi për të mos u njohur me. Ndodhi ajo që patëm patur frikë më shumë: Mariana u ashpërsua, u egërsua, u ftoh.

Gjithë të tjerët përfituan nga ngjarja e saj, u bënë më të mirë, më të arsyeshëm, më të qytetëruar. Vetëm ajo, sikur të paguante taksën e përkryerjes së tyre, pësoi të kundërtën. Shenjat e ashpërsimit u dukën edhe në fytyrë. Një vijë më e trashë iu shfaq rrotull syve, poshtë mollëzave. Lëkura i qe bërë si më e dendur, me një bardhësi allçie, apo që dukej ndoshta kështu nga njëfarë rëndim i lëvizjeve. Një ngrirje te beli i kalonte pastaj ecjes së saj. Edhe zëri s'e kishte më ëmbëlsinë e parë.

Dukej se gjithçka e mirë që ajo kishte patur po i ikte për t'u shkuar të tjerëve: shkëlqimi i kadifenjtë i syve, ngjyra gështenjë e çelët e flokëve, kristali i së qeshurës. Ndërsa të tjerët zbukuroheshin, ajo varfërohej, shkretëhej çdo ditë si një pallat i grabitur.

Edhe Teri, ishrrugaçi, qe bërë i sjellshëm, edhe vetë Nora, tek e cila dukeshin gjurmët e para të shtatzënisë ngjante e qetësuar, e çliruar nga e keqja. Nuk thoshnin më kot se njeriu që ka qenë dikur i mirë nuk e mban dot gjatë barrën e së keqes.

Vetëm Mariana ftohej çdo ditë, ngrinte, bëhej opake mu në sytë tanë. Ashtu si bizhutë e humbura që i sheh

papritur të mbahen prej të tjerëve, ashtu ne gjenim herë te dikush, herë te një tjetër cilësitë e humbura të saj...

Ja, kështu mendoja unë. Sepse edhe ky motërzim i tretë, ashtu si dy të parët, s'ishte veçse pjellë e fantazisë sime.

Në të vërtetë s'ndodhi kështu. Ose, që të jem më i saktë, ndodhi diçka nga të tri variantet dhe pikërisht ajo që ishte më e favorshme për Marianën. Kështu, përshembull, ishte e vërtetë që të gjithë sesi u bënë më të arsyeshëm e më të mirë pas ngjarjes, po kjo nuk u shoqërua aspak me egërsimin e Marianës. E njëjta gjë mund të thuhet për pendimin dhe ndjenjën e fajit që provuan vërtet shumë njerëz ndaj saj, duke përfshirë dhe dashakeqët, po për këtë s'kishte qenë e nevojshme vdekja e Marianës. Sa për shoqërimin që i bëra unë në një natë me hënë, edhe këtu kishte vetëm një pjesë të së vërtetës. Ishte, pa dyshim, shoqërimi pas një shfaqjeje teatrale, po nuk kishte hënë dhe as përqaftim.

Me Marianën të gjithë ishim të kujdesshëm pas kësaj si me qelqëri tejet të thyeshme. Ajo erdhi pas tri ditësh në punë, si të mos kishte ndodhur asgjë. Dhe kjo si të mos kishte ndodhur asgjë u shpall befaz si mesazh, si shenjë paralajmëruese në sytë dhe fytyrat e të gjithëve. Një marrëveshje e heshtur e rrethoi atë si me një mur kristali që nuk guxonte as ta kriste, as ta ndyente askush.

Një farë kohe kaloi kështu, gjersa një ditë, u duk se kësaj paqeje idilike i erdhi fundi. Këtë herë ishte vetë Mariana që e theu murin e kristaltë. Ajo nisi të shëndoshej, por jo me atë shëndoshjen e keqe prej gipsi, që kisha përfytyruar unë. Një mbushje e ëmbël spikati në fillim në mollëzat e në buzët e pastaj në krejt shtatin e saj. Ishte e qartë se ajo ishte shtatzënë.

As fejesë, as ndonjë lidhje tjetër në jetën e saj. Asgjë. Më e çuditshme ishte se Mariana s'bënte asnjë përpjekje për të fshehur gjendjen e saj. Ajo ndërroi modelin e fus-

tanit, siç bënëin zakonisht gjithë nuset, po, madje, edhe tani, që në një farë mënyre e zyrtarizoi, si të thuash nga ana biologjike, atë gjendje, askush nuk guxoi t'i kërkonte ndonjë shpjegim dhe as ajo vetë s'e quajti të nevojshme të jepte.

Po na vinte kështu në një provë të re të gjithëve?

Po na jepte ndoshta edhe një shans tjetër për ta shpëlarë gjer në fund ndërgjegjen tonë?

Thashethemja që qarkulloi rreth shtatzënisë së saj, ishte aq e dobët, në krahasim me të mëparshmen, sa ç'mund të qe vetimi i një zhapiu në krahasim me zvarritjen e tmërrshme të paraardhësit të vet, krokodijit.

Një i panjohur thuhej se e kishte kërkuar një ditë të portienaria, po biseda midis tyre kishte qenë e ngjashme me një përçartje. Ajo i thoshte: më vjen keq, po unë nuk të njoh, kurse ai: përse më ikën, s'të kam bërë asnjë të keqe, ti vetë më ftove atë mbrëmje. Ajo përsëriste: nuk të njoh, dhe kur ai përmendi prapë fjalët «atë mbrëmje», ajo tha qetësisht: me siguri të është bërë në gjumë.

Ajo qe larguar pastaj ngadalë, po në sytë e saj s'kishte kurrfarë shenje të atij lloj acarimi që shkakton te një grua këmbëngulja e partnerit për t'i kujtuar lidhjen e mëparshme, e aq më tepër, kur kjo lidhje është fryt i fantazisë. Në sytë e saj kishte diçka që dukej si e harruar qyshkur: mëshirë për tjetrin.

Ndoshta ishte kjo ngjarje e vogël te portienaria që ushqeje edhe pëshpërimën e zbehtë, se një natë, (një natë me hënë, o zot), ajo kishte grishur në shtëpi një të panjohur, ose një të porsanjohur, të cilin, pasi e kishte bërë ca çaste, apo ca ditë të lumtur e kishte nxjerrë prapë nga jeta e saj, për arsye që mund t'i dinte vetëm ajo. Tani ndoshta përpiquej t'i mbushte mendjen vetes ose besonte vërtet se ngjarja s'kishte ndodhur veç në gjumë.

Ajo po bëhej gati të merrte lejen e lindjes, shi në kohën kur u fol së pari se Nora po vizitohej në mjekë të ndry-

shëm i gaqë dyshonëj se s'bënte femijë. Më e çuditshmja ishte se e gjithë kjo ne të tjerëve na dukej tani gjëja më normale në botë, (ndonëse asgjë normale s'kishte në të, përderisa jetonim në Gadishullin ballkanik), dhe sado që përpiqeshim të habiteshim, e ndjenim se po e humbnim këtë aftësi.

Pas daljes nga materniteti, s'kuam për ta vizituar në shtëpi, me plot dhurata sipas zakonit. Foshnja ishte aty, përbri saj, një djalë yll i bukur, po, veç njerëzve të familjes, as burrë, as i fejuar, *asgjë*. Por kaq e thellë ishte mirënjohja jonë ndaj saj, mirënjohjes që ajo na kishte falur, saqë gjithçka vazhdonte të na dukej normale dhe plot dritë.

Që nga shtrojet e bardha, ajo na vështronte të gjithëve e qetë, buzëqeshëse, kjo Shën Mëri e re që ishte shfaqur në kohën kur pritej më pak

QORRFERMANI

I

Qysh në javën e parafundit të shtatorit u kupua se ato që po ndodhnin nuk ishin një rastësi. Pas rrëzimit, nëpër shkallët e minaresë së hoxhës së ri Ibrahim, fill pas këndimit të ezanit të tij të parë, këndim që kishte ngjallur admirimin e të gjithë dëgjuesve, u fol për sëmundjen e papritur të princit trashëgimtar, shkaktuar gjithashtu pas daljes së tij në publik, si dhe për dy-tri raste të tjera, të ndodhura të gjitha njëra pas tjetrës në atë javë të turbullt, fundi i së cilës ruante një të papritur tjetër. Ndërsa ambasadori i Anglisë po shpejtonte drejt pallatit mbretëror, ku thuhej se do t'i çonte sulltanit lajmin e shumëpritur të miratimit prej qeverisë britanike të një huaje të rëndësishme, karroca e tij u përmbys.

Një grua (apo ndoshta burrë i maskuar me ferexhe), që dyshohej se ia kishte ngulur sytë karrocës në kohën që po kalonte urën e Xhamisë së Kaltër disa çaste përpara rrëzimit, u kërkua prej turmës, madje u ndoq një kohë të gjatë nëpër rrugica, pa u gjetur dot. Po pavarësisht se njeriu nuk u gjet, një gjë ishte e qartë për të gjithë: karro-

ca e ambasadorit, ashtu sikurse rrëzimi i hoxhës së ri, si dhe sëmundja e princit trashëgimtar, bashkë me rastet e tjera, nuk ishin shkaktuar veçse nga e njëjta gjë: goditja e syrit të keq.

Nuk ishte hera e parë që ndodhte kjo. Kujtesa e njerëzve, madje arkivat e kronikat e shtetit ishin plot me raste të ngjashme, që tregonin se herë pas here syri i keq acarohet dhe niste të sillte kobe e gjëma njëlloj si epidemitë, ndoshta edhe më keq. S'ishte e rastit që në të folurën e njerëzve, çprej kohësh që s'mbaheshin mend, gjëllonte shprehja «e hangri syri i keq».

Por atë vjeshtë, ndoshta prej kohës së ftohtë e gjithë lagështi, e ndoshta edhe prej shtrëngesës ekonomike, goditja e sykëqinjve u ndie edhe më tepër. Ndaj dhe alarmi e pezmatimi i njerëzve ishte i madh, dhe po ashtu më i plotë qe edhe raporti, që thuhej se i qe paraqitur vetë sovranit.

Prej ditësh pritej kundërveprimi i mbretit. Në mos një dekret, (kishte njerëz që ishin të bindur se do të kishte dekret), një vendim, një shpallje, apo së paku një qarkore e fshehtë.

Gjer të martën në mbrëmje kanceleria e sulltanit nuk nxori asgjë. Dhe si përherë në raste pritjeje të tilla, krahas hamendjeve të vjetra se ç'vendim do të merrej, renditeheshin të reja, zakonisht me të mjegullta.

Më parë rastet e «ngrënies me sy» dënoheshin rëndë, njëlloj si heretikët: digjeshin të gjallë në gropën e gëlqeres, rripeshin ose mbuloheshin me gurë. Kështu ende mbahej mend në kryeqytet rrjepja e plakës Shanisha, e cila me një vështrim arriti t'i ngjiste vajzës së mbretit të mëparshëm, sulltan Azisit, epilepsinë, që shkaktoi në fillim bren-gën e pastaj sëmundjen e gjatë të këtij të fundit dhe që u bë shkak për heqjen e tij nga froni, pasuar kjo nga turbullira, prej të cilave shtetit iu deshën vite të tëra që ta merrte veten.

Kështu dënoheshin më parë sykëqinjtë, po tani, që pas reformave të mëdha, perandoria që modernizuar, dënime të tilla ngjanin barbare dhe disi jashtë kohës.

Po aherë ç'të bëjmë? T'i përkëdhelim sykëqinjtë, t'i lëmë të livadhisin gjersa të rrëzojnë përdhe jo me njerëzit, po muret e shtëpive? Kështu thoshin ata që ishin kundra çdo mëshire ndaj syngrënësve dhe që përgjithësisht ishin kundra çdo zbutjeje të ligjeve të shtetit. Dhe vërtet, ku ishte parë që të zhdukej një e ligë pa marrë masa të rrepta? Mos do të mjaftoheshin që t'i detyronin sykëqinjtë të mbanin ca si xhama, që porsa ishin snpikur andej nga viset e kaurit, ca qelqe djallëzore që quheshin «syze»? Apo t'ua lidhnin sytë me nga një shirit të zi, nga ata që mbajnë hajdutët e detit?

Kurrresi jo, se syri i lig e depërtonte helmin njëlloj, në mos më shumë, që pas shiritit të zi, e aq më tepër pas atyre qelqeve të nëmura, edhe sikur me blazë ato të lyheshin, siç e kishin bërë modë kohët e fundit, ca kokoroshë kryeqvetas.

Kështu flitej dhe kështu rrekeshin mendjet e njerëzve për të gjetur se ç'do të bëhej, gjersa më në fund, të premtën, dekreti doli.

Si gjithë dekretet e mëdha emrin e kishte të shkurtër, «Qorrferman», po s'ishte aq i egër, as aq i butë sa ç'pritej. Ishte midis të dyjave, nga ato që i lënë të dyja palët kundërshtare të pakënaqura, po me një pakënaqësi të shurdhër, pas së cilës nuk ishte vështirë të ndihej megjithatë admirimi për shtetin dhe sovranin, sidomos për këtë të fundit, që dinte të ngrihej e të qëndronte lart, sipër tallazeve të pasioneve njerëzore.

Çuditërisht shpejt, qysh javën e parë pas shpalljes, u morën vesh ca hollësira të diskutimit të projektdekretit në qeveri, ku si përherë qenë ndeshur rreptazi klani i Qyprillinjve me atë të Sheh-UI Islamit. Qyprillinjtë, pa guxuar të dilnin haptazi kundër dekretit, kishin qenë për masa

të buta ndaj sykëqinjve: mënjanim nga postet e nga vendet publike, arrest në shtëpi, shumë-shumë internim ose grumbullim i tyre në vende të veçuara, ashtu siç bëhej me lebrozët. Sheh — Ul Islami dhe grupi i tij ishin, përkundrazi, për dënimet e vjetra tradicionale, kurse sulltani, që i kishte dëgjuar të dyja palët me durim, nuk u kishte dhënë të drejta as njerës, as tjetrës palë, ose më saktë, u kishte dhënë të drejtë të dyjave. «Qorrfermani» ishte një lëshim ndaj të dyja klaneve, i tillë që gjithë pakënaqësinë e atyre që nuk ishin për ndëshkime barbare e drejtonte kundër Sheh — Ul Islamit, dhe, përkundrazi, mërinë e fanatikëve, kundër Qyprillinjve. Vetë sulltani, jo vetë që qëndronte jashtë tallazit, po tërhiqte njëlloj admirimin e të dyja palëve, atë admirim të veçantë që shkakton përzierja në të e keqardhjes për faktin që, veç punëve të tjera të mëdha, sovranit i duhej të ndante edhe sherret e pa-fundme të rivalëve.

Pa u shpallur ende prej kasnecëve dhe shtypit, në rrethet e caktuara të kryeqytetit u morën vesh pikat kryesore të dekretit. Përmbajtja e «Qorrfermanit» ishte pak a shumë kjo:

Meqenëse kohët e fundit ishin shpeshuar rastet e goditjes prej syrit të lig, dhe meqenëse sykeqoja, (fjala ishte nxjerrë prej një fjalori të vjetër të shekullit të gjashtëmbëdhjetë), kishte rrezik të kthehej në një epidemi të vërtetë, shteti, për të mbrojtur interesat e tij si edhe ato të shtetasve prej këtij rreziku, detyrohej të ndërhynte me një sërë masash.

Nuk dënoheshin me vdekje si dikur sykëqinjët, po vetëm privoheshin nga mundësia e krimit. Dhe kjo bëhej duke u hequr atyre armën e krimit, që ishin sytë e ligj.

Pra dekretohej nxjerrja e syve të këqinj të të gjithë atyre që do të vërtetohej se i kishte të tillë.

Ky veprim, d.m.th. verbimi, do të bëhej kundrejt një shpërblimi, që e jepte shteti dhe që do të ishte më i madh

për ata që do të paraqiteshin vetë (vullnetarisht), dhe më i vogël për të tjerët.

Do të kryhej *çsyzimi*, (fjala përdorej për herë të parë në një dokument zyrtar), pra do të bëhej nxjerrja e syve me forcë, madje pa shpërblim, e gjithë atyre që, me mënyra të ndryshme do të kërkonin t'i shmangeshin verbimit, do të fshiheshin apo do të kundërshtonin.

U bëhej thirrje gjithë shtetasve të perandorisë shekullore që të denonconin haptazi, ose me letra anonime, njerëzit me sy të lig duke vënë në fund të denoncimit emrin e plotë si dhe adresën e saktë të shpërndarës ose të punës së të akuzuarit. Denoncimi do të bëhej si për njerëzit e thjeshtë, ashtu edhe për zyrtarët, sado poste të larta të zinin ata në hierarkinë shtetërore.

Kjo fraza e fundit bëri që sytë e shumë njerëzve të ngriheshin në një grimë, sikur të kërkonin në hapësirë një pikë të padukshme.

II

Qyshse vazhdonin të përdoreshin paralelisht të dyja mënyrat e informacionit: ajo e vjetra, me anë të kasnecëve dhe e reja, me anë të gazetave, kishte dekrete që bënin më shumë përshtypje kur i dëgjoje me veshë, dhe të tjera, peshën e të cilave e rrëfente më mirë shtypi, gjë që varej natyrisht nga natyra e dekretit dhe nga fakti kujt i interesonte ai, masave të gjera të analfabetëve, apo elitës.

«Qorrfermani» u duk menjëherë i tmerrshëm në të dyja format e shpalljes së tij. Madje njëfarë kohe u duk se mund të kuptohej tërësisht vetëm duke u futur në tru me anë të syve dhe të veshëve njëkohësisht. Kështu ndoshta shpjegohej që ata të cilët e dëgjonin së pari nga kasnecët

shpejtonin të blinin gazetata për ta parë të shkruar, kurse përkundrazi, ata që fillimisht qenë të njohur me të nëpërmjet shtypit, e linin gazetën në tryezën e kafenesë apo mbi stolin e lulishtes dhe nxitonin drejt ndonjë udhëkryqi ku pritej të kalonte kasneci.

Një gjë e njohur, disi e harruar çprej disa vjetësh nisi të notonte në erë: frika. Ishte një frikë e veçantë, fare e ndryshme nga ajo që përfitonin sëmundjet, hajdutët, fantazmat apo vdekja: frika prej shtetit. Ë akullt, impersonale, pa përmasa, me një bosh të madh tejprtej, po që mbushte megjithatë gjithçka, ditë për ditë e orë pas ore, ajo nisi të përfshinte në mekanizmin e saj qindra mijëra njerëz. Kështu kishte ndodhur gjashtë vjet më parë, kur ishte shpallur fushata kundër sekteve të ndaluara, që kishin mundur të rigjallëroheshin. Dhe më larg akoma, pesëmbëdhjetë vjet të shkruar, kur qe zbuluar komploti i madh, i cili, në fillim qe dukur si një çështje që kishte të bënte vetëm me një rreth të ngushtë zyrtarësh të lartë, po që dalëngadalë e rrezatoi fatkeqësinë në mijëra e mijëra familje.

Njerëzit, me prirjen e natyrshme për t'i nxjerrë nga kujtesa gjëmat e përbashkëta, e kishin harruar, ose më mirë kujtonin se e kishin harruar klimën e veçantë që krijohet në prag të anktheve të mëdha, atë mpirje, atë shurdhëri shkretimtare në periudhën bosh miçis shpalljes së kërcënimit dhe goditjes së parë, aherë kur shpresa se mos e gjithë kjo nuk është e vërtetë, se mund të mbrapset, se mund të shkundet si ëndrra e keqe, në vend që ta zbutë e bën edhe më të mprehtë tmerrin.

Kështu kujtonin, po, porsa pas daulleve dëgjuan fjalët e para të kasnecëve, e kuptuan se nuk kishin harruar asgjë, se gjithçka kishte qenë brenda tyre, e fshehur me kujdes, si një unazë me helm. Dhe ashtu si edhe më parë, përpara se truri të kapte se për se bëhej fjalë realisht, qiellëzat në gojet e tyre pësuan atë tharjen e parë të njohur, pas së cilës vinin gjithë të tjerat. Qysë në fillim u ndie se, në

krahasim me fushatën kundër sekteve të ndaluara dhe në krahasim me të gjitha gjendjet e tjera të ngjashme, kjo e tanishmja ishte më e frikshme. Ishte e tillë sepse kishte të bënte me një gjë të papërcaktueshme dhe të përgjithshme. Ndërkaq ata e dinin mirë se ç'do të thoshte kjo. E kishin pësuar ata vetë ose të afërmit e tyre edhe aherë kur qe dukur se goditja do të binte mbi mjedise të përkufizuara qartë, siç qe rasti i sekteve, apo mbi zyrtarë të veçantë, si në komplotin shtetëror. Kurse tani që bëhej fjalë për një gjë aq haptazi të pasaktësueshme siç qe ky gjykim për keqësinë ose jo të vështrimit, e aq më tepër kur kjo lidhej me diçka të përgjithshme si sytë, (sy kishin të gjithë dhe askush s'mund të kujtonte se mund të hiqej mënjanë, duke thënë se mua kjo histori s'më përket), pra tani e kuptuan se fushata e re do të ishte e paparë për nga egërsia dhe përmasat e saj. Ndihej menjëherë se vorbulla e saj do t'i gjente e do t'i përfshinte ata mizorisht, pa mëshirë, gjersa t'i sfiliste krejt.

Qysh të shtunën në mëngjes, kudo nëpër familje, zyra, kafene nuk bisedohej veçse për dekretin e ri. Por, siç kishte ndodhur edhe gjatë fushatave të mëparshme, në kundërshtim të plotë me ankthin e zymtë që shkaktonte brenda shpirtrave njerëzorë, biseda për ngjarjen e re zhvillohej shpeshherë shkujdesshëm, e lehtë dhe disi gazmore. Njerëzve u dukej se kjo ishte mënyra më e mirë për të hequr prej të tjerëve, dhe në radhë të parë prej vetes çdo dyshim se ata i druheshin dekretit dhe se mund të ishin synimi i tij. Megjithatë vinte një çast kur midis së folurës apo së qeshurës, sytë ngrinin një grimë të mbërthyer te njëri-tjetri si shigjeta qelqi. Ishte çasti i vështirë kur secili mendonte për tjetrin: e sikur ai të kujtojë se unë kam sy të të atillë?

Por kjo zgjaste vetëm dy-tri sekonda, dikush e çngrinte i pari vështrimin dhe prapë vazhdonte e qeshura dhe komentet. Ato vërtiteshin zakonisht rreth saj, që të gjithë

bënin sikur i shmangeshin, por që i shqetësonte të gjithë: cilët ishin sytë e këqinj dhe a kishte një mjet të saktë për t'i përcaktuar?

Mendimet ishin nga më të ndryshmet. Përmendej tradita popullore e i gjente sytë e ligj kryesisht midis sybardhëve, disi më pak midis sykuqëve, por dihej që ngjyra ishte e pamjaftueshme për zbulimin e *sykëqojës*, e aq më tepër kur ishte fjala për një perandori shumëkombëshe, ku disa nga popujt i kishin sytë, ashtu sikurse edhe flokët apo lëkurën, më të çelët se të tjerët. Jo, ngjyra s'ishte kurrësi e mjaftueshme, ishte vetëm një nga karakteristikat, ashtu siç qe i pamjaftueshëm fakti që t'i kishte sytë të vëngër, ose të vegjël a të mëdhenj jashtë mase. Pa dyshim që nuk ishin këto, madje as perkimi i tërë këtyre te një palë sy nuk vërtetonte praninë e sykëqojës. Ishte tjetër gjë, tjetër... Një gërshetim i veçantë i natyrës së vetë syrit me gjurmët që linte vështrimi i tij në hapësirë... Natyrisht ishte pak e vështirë për ta kapur, aq më tepër dekreti nuk jepte ndonjë sqarim. Por, ndërsa dekreti nuk ndalej në hollësira të tilla, komisionet e veçanta, që po ngriheshin kudo, kishin marrë udhëzime me siguri, udhëzime të sakta për vërtetimin e sykëqojës, në mënyrë që të shmangeshin keqkuptimet dhe shpërdorimet e mundshme.

Zakonisht ky ishte dhe çasti kur, duke mbytur me zor një psherëtimë shqetësimi, njerëzit e vazhdonin bisedën me një gjallëri të gëzueshme.

Kështu ndodhte, zakonisht nëpër zyra, në kafenetë e mbushura me spiunë apo në familje, në prani të vizitorëve, por, kur mbeteshin vetëm, njerëzit shpejtonin nëpër ato kënde të shtëpisë ku kishte pasqyra për të qëndruar mendueshëm me minuta të tëra përpara tyre. Rrinin syzeatë për t'u bindur se e kishin ngjyrën e retinës aq të errët, sa që të përjashtoheshin nga çdo dyshim, rrinin sybardhët apo sykuqtë për të kundërtën, rrinin më gjatë se të tjerët vëngjoshët, ata që i kishin sytë të skuqur nga alergjitë, ten-

sioni i gjakut apo sëmundje të tjera, të tjerë që i kishin të zverdhur nga verdhëza, buhavitur nga dhimbjet e dhëmballës ose nga pija, e gjer tek ata që sytë po u zinin perde.

Askush përveç të verbërve nuk ishte i sigurt se mund të ndodhej jashtë veprimit të dekretit, dhe, siç e kuptuan shumë shpejt të gjithë, këtu mbështetej pikërisht fuqia hijerëndë e «Qorrfermanit».

Por, ndërsa një pjesë e njerëzve kujtonin se me fytyrë të qeshur e komente gazmore mund ta largonin të keqen nga vetja, kishte shumë të tjerë që tinëzisht nisën të mënjanoreshin nga jeta, të mos dilnin më as në rrugë e as në kafene, me shpresë se kështu do të harroreshin. Të mbyllur nëpër shtëpi, shpeshherë të shtrirë e me kokën të mbuluar me jorgan, ata sillnin e risillnin ndër mend armiqtë e tyre personalë, apo ata që kërkonin t'u zinin vendet në zyra, të cilët mund të përfitonin nga gjendja e krijuar për të bërë denoncime kundër tyre. Disa, për t'i dalë së keqes përpara, e bënin të parët denoncimin me shpresë se në mos e asgjësonin në kohë armikun e mundshëm, të neutralizonin së paku denoncimin e tij.

Ndërkaq, ndërsa vazhdonte e folura, peshpërimat dhe komentet për dekretin e ri, krahas veprimeve që, me siguri kishin filluar, por që mbeteshin të fshehta si nisja e denoncimeve apo hartimi në bazë të tyre i listave të para të të dyshimtëve, u shpall Komisioni Qendror që do të drejtonte fushatën dhe që do të kishte degët e tij të panumërta në të gjitha trojet e perandorisë. Fill pas tij u hapën ca si zyra të çuditshme, që edhe më të çuditshëm kishin emërtimin, të krijuar nga gërshtimi i fjalës osmanishte «qorr» me një fjalë të marrë, kushedi pse, prej gjuhës së mallkuar të frengjve apo anglezeve: *qorrofic*.

Njerëzit qëndronin grumbuj-grumbuj përpara tabelave të porsangjitura dhe, megjithëse në shumicën e tyre nën fjalën *qorrofic* me shkronja të vogla, midis dy pllakave,

qenë shkruar fjalët «Zyrë verbimi». kalimtarët, pothuajse pa përjashtim, bënë pyetjen: ç'janë këto zyra? Ç'do të bëhet në to?

Ç'do të bëhet në to? Dihet ç'ao të bëhet. Jeton në këtë botë ti, e ke dëgjuar fermanin e ri. që porsa ka nxjerrë sulltani ynë i madh, që zoti i shtoftë ymrin?...

Por ajo me çka do të merreshin qorroficet nuk u bë e qartë menjëherë. Shumë njerëz kujtuan se ato do të grumbullonin thjesht denoncimet, për t'i çuar pastaj më lart, të tjerë, dhe kjo ndodhi kur panë të vendoseshin në to ca si shtretër të hekurt, me rripa anash, si ata të kirurgjisë në spitale, s'e kishin të vështirë të kuptonin se nxjerrja e syve do të bëhej pikërisht atje. Por, me kalimin e kohës, e sidomos aherë kur fushata kishte arritur kulmin e saj, u sqarua përfundimisht se çka ishte në të vërtetë një qorrofic dhe ç'bëhej në të. Përveç denoncimeve, që secili shtetas, pavarësisht se adresat postare të komisioneve qenë afishuar kudo, mund t'i dorëzonte po të drite edhe në qorrofic, ishte e vërtetë se në asnjërin prej tyre nuk mungonte shtrati i hekurt i verbimit (qorrjataku). Por ai ishte më tepër simbolik. Në të vërtetë verbimi kryhej tjetërkund, me ndonjë përjashtim të rrallë, kur i duhej dhënë një mësim lagjes apo rrugës aty pranë.

Siç e treguan javët e mëpastajme, më tepër se për denoncimet apo verbimin qorroficet shërbyen gjatë gjithë fushatës për tjetër gjë. Ato, ndryshe nga ç'kujtuan njerëzit në fillim, sado që ishin të zymta e të shkreta si emri që mbanin, u kthyen në vende grumbullimi plot gjallëri. Aty vinin njerëzit të mësonin lajmet për fushatën, të sqaroheshin për pika të ndryshme të dekretit apo të udhëzimeve të mëvonshme të Komisionit Qendror. të këmbenin të rejat e fundit lidhur me X- person, i cili, pas lëkundjeve të shumta, u paraqit më në fund vetë për nxjerrjen e syve të tij, duke thënë fjalë lavdëruese për sovranin etj., etj.

Kishte njerëz që u pëlqente ta kalonin një pjesë të ko-

hës në qorrofic, madje disa e merrnin filxhanin e kafes nga kafeneja më e afërt për ta pirë atje, të tjerë, më të rinj, shërbenin vullnetarisht si korrierë, çonin e binin zarfe ose udhëzime nga kushedi ku, kurse disa, ata më të zellshmit, kishin qejf të flisnin gjatë, me zë të kumbueshëm e me një përndezje në sy për të mirat që do të sillte «Qorrfermani», pas të cilit bota, e pastruar më në fund prej sykëqinjve, do të ishte më e dëlirë e më e bukur.

Këtë atmosferë disi festive e ndërpriste herë pas here hyrja befas e ndonjë grumbulli njerëzish, që, duke shfryrë e dihatur, sillnin zvarrë në qorrofic, ndonjë sykeqi të kapur me presh në duar, ose dikë tjetër, që kishin folur kundër dekretit mbretëror.

Megjithatë, ndonëse qorroficet e kishin flakur zyrtësinë për t'u ngjarë më shumë vendeve publike, ndihej menjëherë se «Qorrfermani» s'do të kalonte kaq lehtë. Në një udhëzim të tij Komisioni Qendror kishte përcaktuar qartë pesë mënyrat e nxjerrjes së syve: atë bizantino-veneciane (me hekur me dy gjilpëra), tibetiane, (me shtypje gurësh mbi stomak për të shkaktuar daljen e kokërdhokëve), mënyrën vendase (me acid), romako-kartagjenase, (me tepri drite), dhe atë evropiane, (me mungesë drite).

Në po të njëjtin udhëzim përcaktoheshin gjithashtu se, përveç shpërblimit në të holla, do të kishin të drejtën e zgjedhjes së mënyrës së verbimit gjithë ata që do të paraqiteshin vullnetarisht përpara komisioneve, si edhe persona të tjerë që, për arsye të ndryshme, komisionet do ta quanin të nevojshme t'ua jepnin këtë të drejtë.

S'ishte e vështirë të merrej me mend se dy mënyrat që do të parapëlqeheshin, madje do të quheshin si favor i madh për viktimat, ishin romako-kartagjenasja dhe evropiana. Që të dyja, përveç që siguronin verbimin pa asnjë dhimbje, i linin të paprekur sytë e viktimës, pa shkaktuar gropa dhe shëmtira të tjera në vendin bosh.

I vetmi ndryshim midis dy mënyrave ishte koha e zgjatjes së procesit. Ndërsa me metodën romako-kartagjenase mjaftonin dy-tri minuta vështrim i detyruar i diellit që viktima të humbte pamjen, mënyra evropiane parashikonte një periudhë gati tremujore, gjatë së cilës viktima duhej të rrinte me sy të lidhur, në mënyrë që me heqjen e befasishme të cohës së zezë të sigurohej verbimi i plotë.

Natyrisht që mënyra romako-kartagjenase, përveç që shmangte torturën e gjatë shpirtërore të fatkeqit, (muaj të tërë në terr, brenga, kujtime sfilitëse etj.), kishte në vetvete diçka të pastër e të ndritshme, përderisa lidhej me diellin; kështu që shumë shpejt u bë mënyra më e lakueshme si prej vullnetarëve, ashtu edhe prej personave të tjerë, zakonisht nga kastat e larta, që «Qorrfermani» i gjithëfuqishëm s'mungonte t'i godiste.

Sa për mënyrat e tjera, ato të dhunshmet, të cilat i kishin të gjitha të këqijat: edhe dhembjen fizike, edhe shëmtimin, edhe mosshpërblimin, ishte vështirë të gjeje se cila qe më e tmerrshme. Kështu u shpjegua më vonë fakti që viktimat, shumë herë gjer në çastin e fundit, e ndërrojnë vazhdimisht zgjedhjen, gjersa më në fund hiqnin dorë prej asaj, duke e lënë në dorë së syheqësve, me të vetmen luhajtje, që të merrte fund sa më parë kjo lemeri.

Bashkë me udhëzimin për pesë mënyrat e verbimit, u fol gjithashtu për masa të tjera të ngutshme, të cilat tregonin se dita për fillimin e zbatimit të «Qorrfermanit» po afrohej. Kështu pranë shkollës së lartë të mjekësisë qe hapur një kurs i shkurtër për të përgatitur synxjerrësit, në kohën që disa nga punishtet e kryeqytetit po përfundonin sasinë e parë të hekurave me dy gjilpëra për verbimin a-la bizantino-venecian, disa të tjera acidin, të cilin e mbyllnin në fuçi të vogla metalike për të përballuar rrugën e gjatë gjer në provincat e largëta. Sa për gurët e mëdhenj që lipte mënyra tibetiane, ata gjëndeshin kudo, dhe, veç kësaj, s'kishin nevojë për kurrfarë përpunimi.

III

Maria u përpoq të mbaronte sa më shpejt ato punë të shtëpisë që duhej të bënte së bashku me kumatën, pastaj i tha asaj se i dhimbte koka dhe u ngjit në dhomën e vet. Tjetra e ndoqi me një vështrim të pakënaqur. Zakonisht pas punëve të shtëpisë, të reja, siç ishin të dyja, (nusja e vëllait s'ishte veçse një vit më e madhe se Maria), e kishin bërë zakon të pëshpëritnin një copë herë të gjatë së bashku, gjersa çuçurinë e tyre e ndërpriste shikimi i rreptë i nënës së Maries. Trembet se mos të tregoj të fshehta të jetës bashkëshortore, i thoshte nusja e vëllait, duke e mbytur me zor një të qeshur tinëzare. Maria kafshonte buzët.

Në të vërtetë nusja e vëllait i kishte treguar diçka si-
domos në prag të fejesës së Maries, dhe pastaj javët e para pas asaj. Vajza dëgjonte me ca sy të ndritshëm fjalët e kursyera të tjetrës, që turpi dhe edukata i kthenin në një curril uji të paktë në kohën që etja si prej shkretëtire e vajzës do të donte një vërshim të papërmbajtur.

Mirëpo për habinë e kumatës, kohët e fundit, pikërisht kur me afrimin e ditës së martesës së vajzës ajo po bëhej gati t'i hapej edhe më, Maria nisi t'i shmangej.

Kunata ngriti supet. Ç'pret në një shtëpi të çmendurish, tha me vete, ku njerëzit brenda një familjeje kanë fe të ndryshme.

Kishte qenë një nga çuditë e saj më të mëdha kur kishte dëgjuar të flitej se në shtëpinë e burrit të saj të ardhshëm, ashtu si në shumë familje kryeqytetase me origjinë shqiptare, kishte mbetur zakon, brez pas brezi, që njerëzit të kishin fe të ndryshme, për të mos thënë të kundërta. Ja, vjehrrin e saj, Aleks Ura, kishte mbetur i krishterë, në kohën që njërin djalë, i cili shërbente në flotë, e kishte bërë musliman, kurse tjetrin, burrin e saj, të krishter. Ndo-

shta do të bënte të njëjtën ndarje po të kishte pasur dy vajza por, meqenëse Maria ishte e vetme, qe përpjekur që njëfarësoj ta bënte ndarjen brenda saj. Dhe, meqenëse s'donte ta bënte të njëjtin njeri me dy fe, (kishte plot që e kishin bërë edhe këtë), e kishte pagëzuar së paku me dy emra. Kështu, ndërsa për njerëzit e shtëpisë e të farefisit ajo ishte Maria, për të tjerët, ndoshta dhe për të fejuarin, s'ishte veçse Merjem.

Prej kohe i shoqi ishte munduar t'ia shpjegonte arsyet e një dyzimi të tillë, të cilat lidheshin gjithsesi me fatin dhe historinë e atdheut të tyre të largët, Shqipërisë, por ajo nuk kishte kuptuar pothuajse asgjë nga shpjegimi i tij i ndërlikuar. Kishte kuptuar vetëm se kështu, me fe të ndryshme, kishin qenë vëllezërit e Aleksit, dhe kështu kishin qenë gjyshërit e stërgjyshërit e tij.

Në kohën kur bëhej marrëveshja e fejesës së saj, ajo qe habitur se përse ngulej këmbë të bëhej krushqi me këtë familje tuhafesh, por shumë shpejt e kishte marrë vesh të vërtetën. Familja ku ajo do të hynte ishte fis i largët, (vërtet i largët, megjithatë fis), me Qyprillinjtë e famshëm. Madje mbiemri i saj Ura nuk ishte veçse mbiemri i vjetër, origjinal i Qyprillinjve, që ata, për arsye të larta shtetërore, e kishin ndërruar duke e përkëthyer nga shqipja në osmanishte.

Në të vërtetë, qysh se ishte martuar ajo, nuk kishte parë me sy asnjë nga anëtarët e familjes së famshme, përveç një nipi të tyre, një djalë i zbehtë dhjetë-dymbëdhjetëvjeçar, që kishte ardhur për vizitë një vit e ca më parë së bashku me të ëmën. Djali quhej Ebu Qerim, ishte i paafroshëm dhe, kur vjehri i saj, Aleks, maniak siç qe për të shpjeguar origjinën e mbiemrit të familjes, i kishte vizatuar atij një urë triharkëshe, që ndodhej diku në Shqipëri në Qendrore dhe në të cilën ishte bërë dikur një flijim, djali kishte tundur kokën në mënyrë mohuese, duke thënë: nuk dua të dëgjoj gjëra të frikshme.

Shtëpi të çmendurish, tha prapë me vete nusja e re, pa i hequr sytë nga shkallët nëpër të cilat Maria ishte ngjitur në dhomën e saj. Ç'bënte vallë me orë të tëra e mbyllur atje?

Nuk e kishte zakon të përgjonte, megjithatë, pasi luftoi një copë herë me veten, kureshtja e mundi dhe ajo ngadalë dhe pa zhurmë ngjiti shkallët. Përpara derës së dhomës së vajzës mori frymë thellë, u siguria se përreth s'gje-ndej askush dhe afroi syrin te brima e çelësit.

Ajo që mundi të shihte pas pak e la gojëhapur. E zhveshur krejt përpara pasqyrës së lartë, Maria vishte dhe hiqte një palë mbathje mëndafshi me dantella.

Është e mundur kaq shpejt? tha me vete nusja e re, pa e shkëputur dot vështrimin nga trupi tepër i bardhë, që vajza e lëkundte disi përtueshëm. Trekëndëshi sipër pubisit nxiu një grimë shqetësueshëm përpara se të gllabërohej nga mëndafshi.

Jo, mendoi nusja, me qiellzën e gojës kushedi pse të mpirë. S'ishte e mundur që një femër të bënte lëvizje të tilla pa e provuar dashurinë. Po si ishte e mundur kaq shpejt?

Ajo shkakttoi, me sa duket, një kërcitje fare të lehtë, sepse vajza që brenda u kthye me vrull, duke mbuluar me njërën dorë gjinjtë. Por u qetësua shpejt kur, me sa duket, pa llozin në derë.

Kunata u tërhoq ngadalë dhe kujdesshëm, ashtu si pak më parë, i zbriti shkallët. Pa dyshim që kanë fjetur bashkë, mendoi. Vetëm kështu shpjegohej ajo mungesë kërshërie e saj kohët e fundit.

Nga përfytyrimi nuk i hiqej trupi i bardhë e i lëmueshëm gjer në padurim, me vijën e lakuar të vitheve që ndryshonte tronditshëm në çdo lëvizje, dhe prapë tha me vete: po, po, s'ka si të shpjegohet ndryshe.

IV

Kunata kishte plotësisht të drejtë. Dy javë më parë, në rrethana krejtësisht të papritura, midis saj dhe të fejuarit kishte ndodhur ajo që në mendimet e saj nuk mund të ndodhte veçse në natën e parë të martesës.

Ishte e vërtetë se në shtëpinë e tyre, ashtu si në shumë familje të tjera të ardhura nga Gadishulli ballkanik, kishte zakone tepër të çlira në krahasim me familjet muslimane të kryeqytetit, megjithatë, sado të çlira të ishin zakonet dhe sado tuhaf të quhej, ndër të tjera, edhe për to, babai i saj, Aleks, kurrsesi nuk mund të përfytyrohej që ajo të mbyllej në dhomë me të fejuarin, e aq më tepër të zhvirgjërohej përpara kohe me të.

Po dita kishte qenë me të vërtetë e jashtëzakonshme, dy javë më parë njerëzit e shtëpisë rgjanin të gjithë si të çmerritur, dhe kjo, për shkak të atij dekretit të ri, që porsa ishte shpallur. Që larg nga udhëkryqi fqinj, midis goditjeve të mbytura të daulles vinte zëri i kasnecit, që përsëriste tekstin, dhe ajo nuk ia hiqte sytë fytyrës së babait të zbardhur si letër.

Iu afrua ngadalë, e përkëdheli te supet, siç e kishte zakon dhe e pyeti qetë:

— Baba, përse shqetësohesh? Në shtëpinë tonë ne s'kemi ndonjë rast të tillë, apo jo?

Ai shkundi supet si të çlirohej nga mpirja.

— Natyrisht, — tha, — natyrisht, moj vajzë.

Ajo e përsëriti pyetjen e saj me sy, por ai bëri sikur nuk e vuri re, ose, i topitur siç ishte, nuk e vuri re vërtet.

— Veç kësaj, ne, megjithëse të largët, jemi fis me Qyprillinjtë, apo jo?

— Si, — gati sa s'thirri ai, — fis me Qyprillinjtë? Natyrisht, po në raste të tilla kjo s'ka të bëjë aspak.

Sytë e tij u rruadhën ngadalë, u zvogëluan dhe bashkë me ta edhe zëri iu bë më i ulët:

— Në raste të tilla është më mirë të mos jesh fis me askënd.

Në atë kohë trokiti porta dhe pas pak hyri i fejuari i saj Xheladini. Ndryshe prej të tjerëve, fytyra e tij ishte aq e qetë, saqë Aleks i vështroi një copë herë i vrenjtur, sikur t'i thoshte: po ti, jeton apo s'jeton në këtë botë? Nuk ke dëgjuar ende për «Qorrfermanin»?

Shumë shpejt, pa u shtruar ende dreka, ata do ta merrnin vesh se nga i vinte qetësia, për të mos thënë ai ngazëllim i fshehtë, (ndoshta nuk ishte ngazëllim, po në sfondin e tmerrit të tyre qetësia e tij merrte formën e ngazëllimit), pra shumë shpejt do ta merrnin vesh se nga i vinte kjo dhëndrit të tyre. Ai jo vetëm që ishte në dijeni të dekretit, po dinte më shumë se të gjithë për të, dhe kjo për arsyen e thjeshtë se dy ditë më parë e kishin thirrur nga zyra ku punonte për ta emëruar në Komisionin Qendror që do të merrej me zbatimin e «Qorrfermanit».

Fjalët e dhëndrit shkaktuan një ndryshim të befasisëm në atmosferën e shtëpisë. Një ndjesi çlirimi përzier me admirimin për dhëndrin që e kishin caktuar në një detyrë kaq delikate, por kryesorja s'që kjo, kryesorja, ajo që shkaktonte ndjesinë e lehtësimit, ishte mendimi, ndonëse ende i turbullt, se tani që kishin njeriun e tyre atje, mu në qendrën, mu në strofullën e së keqes, e keqja vetvetiu do të largohej prej tyre.

Përveç syve të Maries, admirimi dukej qartë në vështrimin e nënes, të nuses së vëllait, madje të vetë vëllait, i cili kushedi pse, ishte sjellur ftohtë gjer aherë me të fejuarin e së motrës.

Xheladini, mirënjohës për klimën që shkaktoi, u bë më i dashur me të gjithë. Një hare e përmbajtur e përshkonte tryezën e drekës, ndërsa gjëmimi i largët i daulles ngjante tani si nga një botë tjetër.

Vetëm në fytyrën e Aleksit shfaqej herë pas here një si hije e turbullt.

Ai e vështronte dhëndrin në atë mënyrë sikur përpjeqej të dallonte diçka përbrenda lëkurës së tij, në thellësi, në eshtra. Dhe ishte pikërisht pas një vështrimi të tillë, që ai, duke vënë dorën e tij mbi atë të dhëndrit, i tha:

— Besoj se ti atje do të mbetesh i pastër. . .

— Si?! — foli dhëndri duke e tërhequr dorën kujdes-shëm. — Ç'do të thotë kjo?

Fytyra e tij ishte bërë befaz e ttohtë, pyetëse.

— Asgjë, asgjë, — qeshi Aleks i ra supeve. — Asgjë, biri im. Do të bisedojmë ndoshta një herë tjetër. U duk menjëherë se Aleks i ishte penduar për atë frazë dhe gjatë gjithë pjesës tjetër të drekës ndihej përpjekja e tij që keqkuptimi të harrohej. Atmosfera u bë prapë e hareshme si më parë dhe ishte ndoshta ajo mungesë vëmendjeje që krijon hareja, që u bë shkak që në mbarim të drekës, kur Maria bashkë me të fejuarin, në vend që të drejtoheshin nga veranda, për ku e kishin fituar të drejtën dhe e kishin bërë zakon të rrinin e të pëshpëritnin një copë herë kokë më kokë. heshturazi ngjitën shkallët që çonin në dhomën e saj.

Nuk i panë vërtet apo bënë sikur nuk i panë? Ishte e vështirë të kuptohej. E ëma bashkë me të kumatën mund të mos i kishin vënë re, të zëna siç ishin me pastrimin e tryezës. Vëllai fill pas ngritjes nga tryeza që tërhequr në dhomën e tij, kurse i ati. . . Ndoshta dhe ai s'i kishte parë, ose, dhe kjo ishte më e mundshme, mirënjohës siç që ndaj dhëndrit për ato orë shkrehjeje që ai i kishte sjellë, pas atyre ditëve plot ankth, e aq më tepër duke mos dashur të krijonte një acarrim të dytë, pas atij të tryezës, kishte kthyer kokën mënjanë duke bërë sikur nuk i kishte vënë re. Në fund të fundit pas një muaji e gjysmë do të martoheshin.

Daullja e kasnecit vazhdonte të binte në largësi, duke i dhënë përmasa të reja gjithçkaje... Nën atë gjëmin të mbytur, lart në dhomën e saj Maria, pa i bërë asnjë ku-

ndërshtim të fejuarit, pas të puthurave të para, e kishte lënë ta zhvishte dhe të bënte ç'të donte atje në qendrën drithmuese të trupit të saj. Gjithçka kishte ndodhur hesh-turazi, në një çast të ngutshëm, ku dhembja dhe kënaqësia djegëse ishin kapërthyer, duke ngritur krye herë njëra, herë tjetra. Po dhimbja nuk i qe dukur asaj kurrsesi aq e padu-rueshme, siç i kishte rrëfyer nusja e vëllait, kurse kënaqë-sia, përkundrazi, i qe dukur më e madhe.

Një javë më vonë, kur gjithçka qe përsëritur, (e kishin bërë me fjalë që ai të vinte gjysmë fshehurazi, në kohën që prindët e saj do të shkonin në një ceremoni vdekjeje), me zhdukjen e dhembjes kënaqësia kishte fituar një shije përrallore.

Pas kësaj Maria e kishte ndier menjëherë se s'kishte më ç'të mësonte prej kumatës për të fshehtat e jetës bashkë-shortore. Me padurim të ethshëm ajo priste ardhjen e të fejuarit, por atë javë, përveç që ishte dukur vetëm dy herë, (puna në atë komisionin e tmerrshëm ia gllabëronte tërë kohën), nuk kishin pasur dot mundësi të veçoheshin.

Ajo kishte pritur të dielën, kur ai, sipas zakonit, do të vinte për drekë me një parandjenjë se mrekullia do të përsëritej. Kishte mbaruar me shpejtësi punët e mëngjesit bashkë me kumatën dhe, kur kjo e fundit kishte pritur që të tërhiqeshin në ndonjë qoshe për të llomatitur pak, siç bënin më parë, Maria, duke dashur të mbyllej vetëm në dhomë, me përfytyrimin e lumturisë së afërt, i kishte thënë se i dhimbte koka dhe qe ngjitur lart.

Një copë herë qe vërtitur kot nëpër dhomë, kishte sodi-tur rrugën prej nga ku ai duhej të vinte, gjersa sytë i kishin shkuar te sepeti i pajës së saj. Atje, midis dhjetëra vesh-jeve, çarçafëve e qëndizmave të përgatitura vite me raçhë, ishin dhe një duzinë të brendshme prej mëndafshi, të lehta si një mjegullinë qelqi... O Zot, si nuk i kishte shkuar mendja më parë që t'i bënte një surprizë?

Kohë më parë, kur i kishte rastisur të shihte të brend-

shmet e nuses së vëllait të vëna mki tharësen prej druri sipër mangallit, asaj i visheshin sytë nga turbullimi. Kishte ndodhur kjo sidomos pas rrëfimeve të para të kunatës. Ato të brendshme, që ashtu të lehta e delikate, siç dukeshin, kishin qenë më pranë se gjithçka tjetër në aktin e dashurisë dhe në përzierjen e furishme të trupave, i ngjanin asaj plot mister. E sidomos i dukeshin të tilla në krahasim me të brendshmet e veta, që, të ftohta e pa jetë, qenë të palosura në sepetin e pajës, si një sarkofag, në pritje që të ngjallehin...

Me hapa të ngadalshëm ajo iu afrua sepetit, e hapi dhe, si e kundroi një copë herë, nisi ta trazonte me duar të kujdesshme atë rregull e atë pastërti.

Ja ku ishin rresht, të kthjellëta, të akullta... Por ajo do t'i vishte ato një rën pas tjetrës. do t'i pagëzonte, t'i shenjtëronte, t'i mbushte me ngrohtësinë, aromën, njollat, lëngun dhe rënkimin e dashurisë.

U zhvesh me shpejtësi dhe si në ethe nisi t'i provonte përpara pasqyrës. Donte të zgjidhte më të bukurat për atë ditë. Të kaltrat, jo, ndoshta këto ne ngjyrë gushëpëllumbi.

Ishin model i gjerë, që pas një lëvizjeje të shkujdesur lejonin të dukej një pjesë e seksit. Maria u ul mbi qilim me këmbë gjysmë të hapura përpara pasqyrës. Pas mëndafshit buzët e seksit zbuloheshin vërtet përgjysmë dhe ajo gëlltiti pështymën nga vala e ngrohtë e dëshirës. Mendimet i kishte disi të shkëputura, të ardhura si nga një largësi e panjohur. Kjo ishte hyrja për në trupin e saj... Ajo duhej të ishte e bukur, me dantella në formë lulebajamesh anash, ashtu si portat mikpritëse me saksitë e luleve... Nusja e vëllait i kishte thënë se kishte dëgjuar që sekset e grave janë të ndryshme, ashtu si fytyrat... Maria ishte e sigurt se e kishte të bukur dhe në qoftë se ishte kështu aherë ishte gjynah që ai të mos e shikonte...

Ajo u ngrit, i hoqi mbathjet për të provuar një palë të tjera, kur iu duk se dëgjoi një gërvimë. Ktheu kokën e

tmerruar, po dera qe e mbyllur dhe ajo u qetësua në çast.

I provoi shumicën e të brendshmeve, po prapë u kthye tek ato me ngjyrë gushëpëllumbi. I veshi ato, pastaj u vesh krejtësisht dhe u ul e menduar sipër flokëses së mi-nderit. Në çdo lëvizje mëndafshi jepte ndjesinë e ëmbël të pranisë së tij.

Ajo u përpoq ta hiqte mendjen që andej, të përqendrohej te lëvizja e rrugës, po kjo ishte mbi forcat e saj. Tashmë e kishte të qartë se, në qoftë se pas drekës nuk do të ngjitej dot në dhomë me të fejuarin, tortura do të ishte e papërballueshme.

V

Si përherë ditëve të diela, dreka ishte shtruar në tryezën e madhe në formë ovale në dhomën e ndenjjes. Xheladini erdhi pak minuta pas mesdite, veshur me kostum të stilit evropian, siç u pëlqente të mbanin kohët e fundit një pjesë e burrave të rinj të kryeqytetit.

— Si shkojnë punët? — Pyeti Aleks Ura kur të gjithë kishin zënë vend në tryezë.

Dhëndri buzëqeshi në mënyrë të papërcaktuar.

— Mirë... Mjaft mirë.

U desh njëfarë kohe gjersa, pas frazave të shkëputura për gjëra anësore, të hapej më në fund ajo, që ata e kishin pritur me padurim gjatë gjithë javës. biseda për «Qorrfermanin.»

— A ka shumë denoncime? — pyeti djali i Aleksit, Gjoni. — Të them të drejtën më duket pakëz e vështirë, për të mos thënë e pamundur.

— Varet, — tha kunati. — Për shembull...

— Për shembull, — e ndërpreu Gjoni, — dikujt, për arsye të ndryshme, shumë herë personale, mund t'i duken sytë e tjetrit të këqinj e dikujt jo. Aherë si i bëhet kësaj?

Xheladini vazhdonte ta dëgjonte kunatin me buzëqeshje, por ajo mezi mbahej tani mbi fytyrën e tij.

— Ke të drejtë, — tha ai. — Po tamam për të shmangur këtë Komisioni Qendror, ashtu si edhe degët e tij, punojnë në bazë të një qarkoreje të brendshme, ku janë përcaktuar me imtësi të gjitha veçoritë që duhet të ketë një sy për t'u përcaktuar i atillë. Dhe këtu nuk hyn vetëm pamja e jashtme, siç duan të thonë disa. — Ai qeshi një grimë me zë. — Ja, unë, për shembull, i kam sytë të çelët dhe sipas këtyre mendjelehtëve duhej të isha një i dyshimtë që s'mund t'i afrohesha as portës, pale pastaj të punoja në Komisionin Qendror.

Shumica e drekëtarëve tundën kokën. Qysh ditën që ishte shpallur «Qorrfermani» ata, drejtpërdrejt apo tërthorazi, kishin vënë re me hollësitë më të mëdha çdo veçori të syve të njëri-tjetrit, dhe tani s'ishte e nevojshme të ngrinin kokën nga pjata për të parë nëse dhëndri i tyre i kishte sytë vërtet të çelët, me një si rrjetë të lehtë bojë hiri, e cila, përveç bukurisë, u jepte atyre vendosmërinë e ftohtë të mashkullit.

— E pra s'është fjala vetëm për pamjen e jashtme. — vazhdoi ai. — Gjithçka duhet të gërshetohet me gjëra të tjera... Më falni, unë jam këtu midis njerëzve të mi, po prapë ka ca të fshehta të punës, që e kemi të ndaluar rreptësisht t'i përflasin... Shkurt, ajo që doja të thosha është se, përpara se të merret vendimi për ta shpallur X-n apo Y-nin sykeq, gjithçka do të studiohet e do të hetohet me kujdes, madje, po të jetë nevoja, duke e vënë për njëfarë kohe të akuzuarin edhe nën mbikëqyrje të fshehtë.

— Ashtu? — pyeti e shoqja e Aleksit.

Xheladini bëri po me kokë.

— E megjithatë mua s'më mbushet mendja se mund

të ketë një mënyrë të saktë, si të inem, shkencore, për të përcaktuar sykeqojën, — tha Gjoni.

Xheladini nuk u përgjigj dhe për ca çaste vazhdoi një heshtje që tringëllima e porcelanit të pjatave e bënte më të ftohtë. Më kot vështrimi i Aleks Urës iu ngul qortueshëm të birit.

— Madje unë mendoj se fuqia e vërtetë e «Qorrfermanit» qëndron pikërisht këtu, — vazhdoi Gjoni.

— Ku? — pyeti kunati.

Gjoni nuk u përgjigj menjëherë. Ndoshta, për t'iu shmangur shikimit të të atit, sytë e tij vështronin sipër kokave të të tjerëve, në drejtim të dyerve prej xhami që hapeshin në verandë.

— «Qorrfermani» është pa dyshim dekreti që me shumë se çdo dekret tjetër ka tronditur si tërmet shtetin tonë, — vazhdoi Gjoni. — Dhe që të kthehem atje ku e lashë fjalën, unë mendoj se fuqia e tij e tmerrshme qëndron pikërisht në mjegullinën e tij. Përpara «Qorrfermanit» secilit i hip dyshimi për tjetrin, askush nuk i shpëton dot ankthit, çdo njeri fillon ta ndiejë veten fajtor. Pikërisht në këtë trandje totale mendoj se qëndron fuqia e tij.

— Kurse unë mendoj se fuqia e çdo dekreti të madh qëndron vetëm në drejtësinë e tij, — tha Xheladini me një zë aspak të acaruar, përkundrazi mjaft butë, gjë që i bëri të gjithë të merrnin frymë lehtë.

— Është e vërtetë se ka pasur letra anonime dhe se është hedhur dyshimi pastaj mbi kushëririn e vezirit të madh Muhtar pashanë? — ndërhyri e shoqja e Gjoni, më tepër për të ndërruar bisedën.

Xheladini ngriti supet.

— Nuk e di, — u përgjigj, — ka mundësi të jenë thashetheme.

— Kështu u hapën fjalë vitin që shkoi për vezirin Basri, — tha Gjoni. — U tha që janë thashetheme, po pastaj dolën të vërteta dhe veziri përfundoi në trikëmbësh.

— Qëllon edhe ashtu, — ndërhyri Aleks Ura, i vendosur këtë herë që të mos i lejonte më të flitej mbarë e mprapsht në tryezën e drekës.

Kishte qenë përherë për zakone të çlirëta, qe tallur me ata që s'i pranonin femrat në bisedë, siç ishte përgjithësisht kundër gjithë zakoneve fanatike të aziatikëve, megjithatë çdo gjë kishte një kufi. Nuk kishte mjaftuar Gjoni, po ja tani edhe nusja e tij kërkonte të ngatërrohej me dhëndrin.

Përgjigjet e Xheladinit sa vente bëheshin më të kursyera, dhe ai do të ishte acaruar ndoshta me kohë në këtë tryezë, sikur të mos ndiente herë pas here vështirimin zbutës të Maries.

Vëmendjes së Aleksit nuk i kishte shpëtuar ajo lektisje në sytë e së bijës. Ishte e ndryshme nga ndriçimi i syve në ditët e para të fejesës, kur ajo nuk e fshihte pëlqimin për të fejuarin. Madje e ndryshme edhe nga ditët e mëvonshme, kur ai ndriçim u bë më i thellë, me një ngjyrim disi enigmatik. Tani ishte tjetër gjë. Në sytë e vajzës kishte diçka të avullt, të brishtë, të plagosshme lehtë aq lehtë, saqë ai kishte filluar t'i shmangej ndeshjes së shikimit me të, ngaqë i dukej se një ndeshje e tillë do t'i shkaktonte një krisje të dhimbshme.

Dy javë më parë, pas një dreke si kjo, i qe dukur se kishte dëgjuar hapat e tyre të ngjiteshin nëpër shkallët që çonin në dhomën e saj. Kishte ngrënë një grimë në vend, po nuk kishte kthyer kokën pas si njeriu që i shmanget pamjes së një fantazme... Dita e martesës nuk ishte larg dhe ai qe i lumtur më shumë se më parë tani për këtë krushqi. Në kohë të vështirë vetvetiu lindi dëshira të mbylleshe brenda mureve të shtëpisë, pranë zjarrit dhe njerëzve të afërt, ndërsa përjashta ulërinte era e thatë e ankthit. Dhe aq më tepër me atë punë që kishte dhëndri i tij. Një burim i çmuar informacioni drejt e nga qendra e misterit, dhe tamam në kohën kur sa më e mprehtë bëhej ku-reshtja njerëzore, aq më e rrezikshme ishte e folura... Djali

i tij bashkë me nusen mendjehetë nuk dinin ta çmonin këtë dhe s'kërkonin veç ta acaronin të ftuarin. Por ai do të vinte rregull në këtë tryezë të shthurur. Do ta vinte menjëherë, qysh tani, duke e udhënequr vetë bisedën gjer në fund.

— A do të fillojë shpejt zbatim i dekretit?

Aleks Ura nuk u besoi veshëve të tij nga habia se qysh i nxori ato fjalë. E kishte hapur gojën për tjetër gjë, për të thënë diçka të ndryshme, gazmore, larg, sa më larg dekretit, në mënyrë që atmosfera e drekës të ndërronte krejt, dhe ja, pa iu bindur vullnetit të tij, goja i kishte shqiptuar të tjera fjalë. U matufose, i tha vetes, nuk kontrollon dot as gjuhën tënde, më keq se gratë.

— Zbatim? — u përgjigj dhëndri me një lëvizje supesh. — Besoj se do të fillojë shpejt. Madje shumë shpejt. — shtoi pas pak. — Ndoshta që këtë javë.

— Ashtu? — thanë dy-tre zëra.

— Është e vërtetë se edhe në nxjerrjen e syve do të ketë dallime? — pyeti nusja e Gjonit. — Flitet se ndryshe do të veprohet me aristokratët e ndryshe me njerëzit e thjeshtë.

— Është e logjikshme të ketë dallime, — ndërhyri Gjoni. — Si kudo.

— Flitet për ca verbime me anë të diellit, — vazhdoi nusja e tij. — Është herë e parë që e dëgjoj një gjë të tillë. Ndonjë mënyrë e re, me siguri, apo jo?

Aleks Ura u bë gati të ndërhynte, po, për habinë e tij, dhëndri qeshi gëzueshëm.

— S'është aspak e re, — tha, — përkundrazi, është ndoshta më e vjetra.

Ai nisi të tregonte për ca plazhe të shkreta dhe për ca hotele apo vila luksoze ndanë detit, ku të dënuarit do të kalonin të qetë ditët e tyre të fundit me dritë. Një mëngjes, nga ato kur qielli është më i kthjellët se zakonisht, do t'i ulnin në ca stola përballë diellit dhe atje, për disa minuta...

— Punë e pastër, s'ke ç'i thua, — tha Gjoni. — As gjak, as hekura te skuqur apo ç'janë barbaritë e tjera.

— Kurse mua më duket se kjo mënyrë është më e dhimbshme, — tha gruaja e Gjoni. — Të jesh midis kthjelltësisë së qiellit e të detit dhe befaz t'i lësh përgjithmonë

— Mos do të të pëlqente mënyra e kundërt, kur të të futin në bodrum me sy të lidhur tue muaj rresht? — tha Gjoni.

— Ndoshta është më mirë ashtu, — ia ktheu e shoqja. — Ke kohë të mësohesh me errësirën.

— Oh, jo, — tha Gjoni. — Ajo duhet të jetë një torturë e vërtetë... Koka të çahet nga mendimet.

— Pash zotin lëreni këtë bisedë. — tha e zonja e shtëpisë. — A s'keni gjë më të gëzueshme për të folur?

Ajo vuri pjatancën me ëmbëlsirë midis, duke i ftuar të gjithë të merrnin aq sa dëshironin.

— Gjithfarë gjërash flasin njerëzit, — tha Gjoni mendueshëm. — Ka që thonë se e gjithë kjo ndjekje e syve të këqinj nuk është veçse një marrëzi e pakuptimtë, në të cilën nuk besojnë as ata vetë që po e nxitin.

— Ç'janë këto fjalë? — tha Aleks. — Je apo s'je në vete?

— Nuk jam unë që po i them baba, — u përgjigj Gjoni. — Të tjerët flasin. Thonë se gjithë kjo bëhet për të tërhequr vëmendjen nga vështirësitë ekonomike.

— Mjaft, — e ndërpreu Aleks, — nuk të lejoj të flasësh kështu!

— Unë nuk flas, baba.

— Fajtor je edhe po të dëgjosh, — tha Aleks me zërin që i dridhej nga tronditja.

Fytyra e dhëndrit kishte mbetur e palëvizshme.

VI

Të premtën që pa gdhirë gjëmuar përsëri daullet, që lajmëronin se zbatimi i «Qorrfermanit» kishte filluar.

Të llahtaritur, me flokë të shprishur e sy të buhavitur nga ndërprerja e gjumit, që prapa grilave dhe kunateve të mbyllura njerëzit përpiqeshin të dallonin fjalët e kasnecit. Ç' thotë, ç' thotë, pyesin me zë të ulët njëri-tjetrin. Pusho, që të dëgjojmë. Më duket se po thotë emra, emra...

Emrat e vullnetarëve të parë u morën vesh më saktë të nesërmen. Me tituj të mëdhenj, fill pas lajmit të fillimit të zbatimit, gazetë jepnin ata që u paraqitën të parët në qorrificet, shumë e shpërblimit që iu dha secilit si edhe lidhjen e pensionit të përjetshëm.

Një pjesë e gazetave botonin deklaratën e njëfarë Abdurahimi, nëpunës protokollit në kryeqytet, i cili, ndër të tjera, kishte thënë: «I flijova me gjithë qejf sytë e mi. Përveç kënaqësisë që ndjava ngaqë munda të bëja diçka për të mirën e shtetit, i jam mirënjohës «Qorrfermanit» që më shpëtoi nga vuajtjet e ndërjegjes që më shkaktonte vetë mendimi se sytë e mi ishin një burim fatkeqësish.»

Përveç listës së emrave gazetë nuk jepnin hollësi për numrin e saktë të tyre, as për faktin se ku ndodheshin ata, apo me ç'mënyrë që bërë *çsyzimi*, (çprej disa ditësh kjo fjalë kishte zëvendësuar në shtyp fjalën verbim).

Disa thoshin se ishin me qindra, të tjerë ngulnin këmbë për mijëra që mbaheshin të veçuar në ca fusha të mëdha.

Ndërkaq, përveç anës festive të fushatës, vazhdonte haptazi ose fshehtazi gjuetia e sykëqinjve, cilësimi si: të tillë i atyre që i kishin shpëtuar gjer tani syçeltësisë së turmave, ose kërkimi i atyre që, pasi qenë demaskuar, kishin mundur të fshiheshin. Kishte të tjerë që fshiheshin gjitha-

shtu, pasi kishin marrë vesh se denoncimi për ta që nisur nga diku, ose që kujtonin se që nisur, dhe kështu, të munduar nga mania e ndjekjes, shkaktonin dyshime të tilla, sa që merrnin në qafë veten.

Të martën kasnecët përsëritën thirrjen që sykëqinj të paraqiteshin vetë, sepse nga kjo veç të mirë do të kishin. «Profeti ka thënë se nuk është faj të kesh lindur me sy të këqinj», thërritnin ata. «Faj është kur e fsheh këtë.»

Kronikat e gazetave nisën të jepnin ngjarje të ndryshme lidhur me sykeqojën. Njëfarë Selimi që kapur me presh në duar në kohën që, i fshehur pas një kaçubeje, me anë të syve të tij të ligj, të përqendruar mbi një urë që po ndërtohej, përpiquej të rrezonte harkun e saj. Që lidhur e që verbuar menjëherë në vend nga muratorët e kalimtarët që u ndodhën atje rastësisht. Gazeta nuk jepte mënyrën e verbimit, po merrej me mend se ajo duhej të ishte një nga të tria mënyrat që tashmë quheshin «tri të egrat», në mos ishte ndonjë mënyrë tjetër, e shpikur aty për aty, më e tmerrshme edhe se të parat.

Por, ndërsa në shtyp jehona e «Qorrfermanit» herë ndërtoj më shumë, herë më pak, në qorroficet gjallëria që e përhapte. Venin e vinin korrierët vallnetarë me pusulla, lajme e udhëzime të reja, pa mbërritur mirë niseshin prapë për diku, me fytyra të ngazëllyera, por herë-herë edhe serize, për t'i dhënë rëndësinë e duhur asaj që po bënin.

Kërkimi i sykëqinjve ishte në kulmin e tij. Qorroficet ishin në garë me njëra-tjetrën se kush do të zbulonte me shumë syresh, dhe nganjëherë, kur në ndonjë qorrofic punët nuk kishin shkuar dhe aq mbarë, nëpunësit e tyre, tek rrinin në mbrëmje vonë nën dritën e llambës me vajguri, me fytyra të dëshpëruara e të trembura, i kujtonin njëri-tjetrit emra njerëzish në lagjen apo rrugën e tyre, që ndoshta i kishin sytë të atillë, por që atyre u kishin shpëtuar.

Nganjëherë në qorroficet kishte dritë gjer në mesnatë dhe banorët që i kishin shtëpitë aty pranë dhe që nuk i zi-

nte gjumi gjersa të likej drita aty, peshpëritnin me njëri-tjetrin: ç'dreqin bëjnë kaq vonë? Ç'të liga të tjera përgatitin që i marroftë Zoti!

Ndërkaq vazhdonin kërcënimet për ata që përgojnin «Qorrfermanin» e lavdishëm, gjë që s'i pengonte aspak një-rëzit ta përgjonin edhe më keq. E shanin, e përfllitnin, duke përfiturar nga emërtimi i tij e quanin dekreti i errësirës, dekreti i verbër apo fermani i zi. E njëjta gjë ndodhte me thashethemet, lufta kundër të cilave s'bënte gjë tjetër veçse e shtonte edhe më tepër valën e tyre. Ato sa vinte e bëheshin të atilla që të ngjethnin mishtë. Ja, ditët e fundit kishte nisur të qarkullonte një fjalë për vezirin e madh. Thuhej se edhe mbi të, krahun e djathtë të sovranit, kishte rënë dyshimi se i kishte sytë të këqinj. Një letër anonime kishte guxuar ta bënte këtë. Me një tmerr që kishte brenda një shije të veçantë, ku përziheshin edhe frika, edhe kureshtja, edhe një lloj dehjeje ngazëlluese, (ja pra edhe të mëdhenjtë e pësonin njëlloj si të vegjlit), njerëzit s'pushonin së komentuari këtë lajm të fundit. Si ishte e mundur të dyshohej për vetë vezirin e madh... Pse habitesh, se mos është hera e parë që ka ndodhur...

Madje thuhet edhe diçka tjetër, nm flitet se e gjithë kjo krahurë për sytë e këqinj s'paskërka veçse një qëllim: rrezimin e vezirit të madh... Ah, me tal, po kjo që thua s'ka fare kuptim. Të ishte kështu, të ishte që sovranit donte ta zhbente vezirin e madh, kush ia ndalonte dorën? Pak vezirë të mëdhenj janë ngrysur me kokë = janë gdhirë pa kokë?... Eh, kështu ka qenë njëherë, po tani ndryshon puna. Tani punët e shtetit s'bëhen vetëm me shpatë, si njëherë. Tani duhet takt. Veç kësaj, ti harron që veziri i madh është vënë në atë post me këmbënguljen e klanit të Qyprillinjve. Dhe besoj se e di që me ata s'bëhet shaka. Që të heqësh nga posti një njeri të tyre duhet përgatitur opinionin brenda dhe jashtë. Sepse është dhe bota jashtë që flet...

Kështu vazhdonin thashethemet. Por luftë nuk bëhej

vetëm kundër tyre. Ndiqesnin si mjallos të dëmshme shakatë e pavend, uonitë, anekdotat e disa herë gjëgjëza me dy kuptime.

Në një nga qorrfocet e qendrës së kryeqytetit u thirr një të shtunë pasdite poeti i shquar Tahsin Kurtogllu. Në praninë e shumë njerëzve, pasi iu shpjegua në fillim se po i bëhej një favor, ngaqë ishte poet i njohur, që po e thërritnin në qorrfoc dhe jo drejt e në hetuesi, iu kërkua llogari për disa vargje që kishte botuar dy javë më parë, si dhe për ca fjalë që kishte lëshuar andej-këtej me miqtë e tij.

Për sa u përket vargjeve, (ishte fjala kryesisht për njërin prej tyre: «më vrau harku, jo shigjeta»), poeti u mbrojti gjer në fund, duke thënë se kjo ishte thjesht një vjershë dashurie kushtuar një femre, që i kishte vetullat shumë të bukura, dhe fakti që ai në vjershën e tij çmonte ose quante më plagosëse vetullat e gruas (harkun), sesa sytë e saj (shigjeta), s'kishte të bënte fare me ndonjë sfidë ndaj «Qorrfermanit» madhështor.

Ata që e dëgjonin me fytyrat plot mosbesim, i përmendën aherë fjalët e tij me dy kuptime, të cilat ai i mohoi tërësisht. Aherë njëri prej tyre nxori nga çanta një fletë dhe nisi të lexonte: «Në datën shtatë të këtij muaji, në një darkë me ca miq, ke thënë se terri i botës do të shtohet me këtë verbim të madh. Në datën dymbëdhjetë ke thënë, në një kafene, se ka një drejtpeshim midis ditës dhe natës, dritës dhe errësirës, e asaj që shihet dhe asaj që nuk shihet, dhe se ky drejtpeshim tani do të prishet në dëm të të parave. Ke thënë gjithashtu, dhe kjo është më e keqja, se shuma e gjithë syve të njerëzve në botë, rrath një miliard e ca, përbëjnë, sipas teje, atë që mund të quhet syri i njerëzimit mbarë, dhe se ky sy dobësohet kur verbohën një pjesë e njerëzve, e sidomos kur verbohën, vini re ju të tjerët, kur verbohën sytë më të ndritur:»

Pas çdo fraze që zyrtari i qorrfocit lexonte, Tahsin Kurtogllui bënte «jo» me kokë, dhe kur tjetri mbaroi, ai

thirri: Të gjitha këto janë shpifje e trillime të rivalëve të mi.

Fjalët e tij në vend që ta qetësonin e zemëruan më shumë turmën e pranishme, e cila nisi të bënte zhurmë, madje pati zëra midis saj që thirrën: mjaft e latë të dërdëllitë. ai meriton *tibetianen*. Tibetianen, tibetianen, gërthitën edhe të tjerë, po njëri nga zyrtarët, pasi i bëri shenjë turmës për qetësi, mbajti një lloj fjalimi fare të shkurtër, ku theksoi zemërgjerësinë e shtetit, i cili mjaftohej këtë herë vetëm me një qortim të rëndë ndaj Kurtoglluit. Veçse ky është paralajmërimi i fundit, shtoi ai duke tundur gishtin e tij në drejtim të poetit.

Tashmë ishte e qartë për të gjithë se vërshimi i denoncimeve dhe i letrave anonime kishte kaluar çdo kufi, dhe kur në rrugë kalonte karroca e postës, kalimtarët e ndiqnin me ca sy të topitur, ngaqë e dinin se gjysma e saj ishte mbushur me të atilla.

Në një ditë të tillë plot zymti Maria, pasi mbylli derën e dhomës, iu afrua dritares për të parë të fejuarin kur të dilte në rrugë. I qe dukur disi ndryshe nga herët e tjera, më i ngrysur. Edhe biseda gjatë drekës mezi qe lidhur, me gjithë përpjekjet e babait për ta gjallëruar.

Ja ku ishte. Ajo e ndoqi me sy gjersa silueta e tij u zhduk nën drurët e trotuarit dhe prapë mendoi: diçka ka.

E çoi mendjen në gjithfarë gjërash: ngarkesë në punë, intriga, vrasje e ndërjegjes, gjersa më në fund tha me vete: ndoshta ishte kot. A nuk qëllonte shpesh të gdhieshe me humor të prishur, i cili të prishej edhe më kur dikush të thoshte: s'më dukesh në qejf sot? Me siguri kështu do t'i kishte ndodhur edhe atij.

Gjysmë e zhveshur siç ishte ajo iu afrua pasqyrës dhe u vështrua një copë herë duke përkëthyer herë njërin gju, herë tjetrin. Ja, në rrëzën e ijës së djathtë kishte dy njolla mavi. kujtim i së dielës së shkuar. Kurse njollat e së sotmes do të shfaqeshin pas dy-tri ditësh... Njëfarë kohe

vështroi barkun e lëmuar, kaçubëzën e errët sipër pubisit, pastaj u ul në qilim, me këmbë gjysmë të hapura, duke vështruar seksin e saj.

I qetë, mendoi ajo, sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

Nuk i hiqte dot sytë nga vija ndarëse, pakëz e lakuar, midis dy buzëve ngjyrë rozë të zbehtë. Ishin tamam si buzë mece. . . Dhe të mendoje se pak çaste më parë ato ishin si të çmendura, të lëvizshme, të rrëshqitshme.

E pabesueshme, tha me vete. Dhe aty për aty i shkrepri në kokë mendimi se seksi i femrës ishte ndoshta gjëja më e pazbërthyeshme e më enigmatike në botë. Ato buzë mece s'do të tregonin kurrë atë çka kishte ndodhur në to dhe rrotull tyre.

Mirënjohëse, dora e saj përkëdheli barkun, pubisin dhe pastaj ato vetë. Pak çaste më vonë ndjeu ftohtë dhe u ngrit të vishej.

Megjithatë ai diçka kishte, mendoi përsëri, ndërsa vinte një karficë midis flokëve.

VII

Fushata kundër sykëqojës ishte në kulmin e saj. Si një lumë që ka dalë jashtë brigjeve ajo i zgjeronte çdo ditë përmasat, duke përfshirë në vorbullën e saj fate të numërta njerëzore.

Nuk ishin vetëm sykëqinj të që ndodheshin në ndjekje të paprerë. Krahas tyre ndiqeshin me po atë zell ata që ishin shpallur ose dyshoheshin si mbrojtës të tyre, si frenues të shënjës të zbatimit të «Qorrfermanit», si njerëz të afërt, kushërinj apo përkrahës të përkrahësve të sykëqinjve. Të tjerë akuzoheshin për mungesë syçeltësie, për mospërfillje apo mungesë zelli. Qëllonte që me të njëjtat fjalë këta të fundit

akuzonin akuzuesit e tyre. Një bateri e paparë shfrynte si stuhi mbi shtetin e madh. Flitej hapur për larje llogarish dhe luftë për pushtet midis klaneve politike. Të tjerë zëra thoshin se do të kishte dënime edhe midis vetë atyre që dukeshin si më të paprekshmit prej stuhisë, zyrtarëve që merreshin me zbatimin e «Qorrfermanit». Flitej se sykëqinj të kishin mundur të depërtonin nëpër qorrficet, madje gjer në Komisionin Qendror, dhe që atje, duke përfitur nga pozita, shumë punë i kishin bërë lëmsh.

Aha, ja përse kemi menduar, madje kemi guxuar të themi disa herë se ca gjëra duken të çuditshme, thoshin njerëzit. Pa dyshim, pa dyshim, veçse sovrani është i drejtë. Ke shërbyer me besnikëri, merre çpërblimin që meriton, por ama, gabove, bërë faj, pavarësisht nga shërbimet, do të ndëshkohesh edhe ti.

Mirë thua. Shyqyr që e kemi, allahu ia shtoftë ditët, pa të rrëmujë do të bëhej bota. Dëgjove ç'ndodhi dje përpara «Tabir Sarajit»?...

Dhe prapë vazhdonte, e turbullt, gjëmimtare vala e lajmeve nga më të pabesueshmet. Dhe aty-këtu, si një ashkël midis dallgëve të trazuara, shfaqej sërishmi thashethemja për vezirin e madh.

VIII

Të gjithë e kishin vënë re, me siguri, se ai qe dobësuar, por vetëm ajo ia tha kur u mbyllën rë dhomë.

— Je dobësuar. Kaq shumë punë ke?

— Shumë, — u përgjigj ai. Dhe pas pak përsëriti: — Shumë.

— Eja, të harrohesh...

Ajo nuk druhej më fare tani, dhe pasi u shtri e para

në krevat, e mbështolli atë në fillim me krahët, pastaj me këmbët e bardha. Rënkimi i saj ishte i lehtë, i njëtrajtshëm, dhe vetëm herë pas here shndërrohej në një si dënesë.

Pas pak, kur ishin qetësuar, ai nguli sytë një copë herë mbi njollat mavi, që ngjanin si vula mbi kofshën e saj të zbuluar. Ajo priti t'i thoshte diçka për to, por ai, për habinë e saj, pyeti për tjetër gjë:

— A u jeni drejtuar ndonjëherë Qyprillinjve për ndonjë hall?

Ajo ngriti supet pa e fshehur habinë.

— Me sa di unë asnjëherë. Po pse?

— Kot... M'u kujtua që në shtëpinë tuaj pothuajse nuk përmenden fare.

— Është e vërtetë. Jemi vërtet kushërinj me ta, po tepër të largët. Veç kësaj, babai me atë karakter që ka...

— E kuptoj, — e ndërpreu ai, pa i hequr sytë nga njollat mavi.

Ajo e përkëdheli në gjoks.

— Ti se ç'ke, — i tha me zë të qetë.

Ai përpiquej t'i shmangej shikimit të saj.

— Nuk kam asgjë.

— Të vret ndërgjegjja për punën që bën?

Tjetri tundi kokën në shenjë mchimi.

— Aspak. Nuk kam asnjë arsye... Përkundrazi...

— Ç'domethënë përkundrazi?

— Uf, sa pyetje të bezdisura që bën!

— Ashtu, — tha ajo e fyer dhe deshi të kthehej më-njanë, por ai ia zbuloi çarçafin, që vajza u përpoq më kot ta hidhte prapë sipër barkut. Një dritëz e veçantë, gati anormale në shikimin e tij, bëri që vajza ta harronte fyerjen dhe të hetonte me kujdes fytyrën e të fejuarit. Sytë e tij ishin të ngulur te pubisi i saj, sikur ta shihte për herë të parë.

— Pas tri javësh do të martohemi, — tha ajo, — do të rrimë orë të tëra kështu.

— Po... Mundet që unë këto ditë të marr lejën...

— Ashtu? Shume bukur... Do te çohemi vonë, kështu që një pjesë të natës... mund ta kalojmë pa gjumë. Është qejf, apo jo, ta bëjmë atë gjysmepërgjumësh, në mesnatë, në terr...

Ai u drodh si të përmendej nga dremitja

— Në mesnatë, në terr... — Gati sa s'thirri.

— Shët, ule zërin, — tha ajo. — Ç'pate?

— Në mesnatë, në terr... — pësëriti ai, këtë herë me zë të shuar.

Ajo e përkëdheli një copë herë te qafa, te tëmthat.

— Ti se ç'ke, — i tha me zë fare të ulët, siç i flitet njeriut në gjumë.

Unë e marr me mend se ç'ke... po ti mos u shqetëso për atë... Ti s'je veçse një zbatues i ligjit... ndërgjegjja te ti vrasë ata që e ngritën këtë furtunë. Më kupton... ata le ti vrasë... Dhe tani eja të dëfrejme prapë... shpirt!

IX

Ra më në fund veziri i madh. Në fillim u tha se u hoq nga posti për të kaluar në një detyrë më pak të rëndësishme, pastaj thjesht se u hoq, gjersa me në fund ljala «heqje» u zëvendësua me fjalën «rrëzim». Për s'ishte as ulje rangu, as kalim në detyrë tjetër dhe as shkarkim për moszbatim me zell të punëve të shtetit, e sidomos të «Qorrfermanit», por thjesht pushim nga puna dhe arrest shtëpie në të njëjtën ditë me akuzën e prerë dhe mizore se i kishte sytë të këqinj.

Që veziri i madh e kishte vështrimin pakëz të vëngër, këtë e dinin gjithë të afërmit dhe bashkëpunëtorët e tij. Ajo që i habiste njerëzit ishte se si sulltani, syri i të cilit vëzhgonte çdo gjë, nuk e kishte vënë re gjer aherë një gjë

të tillë? Nuk ishte dhe aq e lehtë, kundërshtonin të tjerët. Të gjithë e dinë tashmë se syri i vëngër nuk është përherë i dëmshëm po nuk u gërshetua me gjëra të tjera. Eh, ia bënin të tjerë, ka ca gjëra që mund t'i tjerrësh si të duash.

Menjëherë pas rënies së vezirit të madh u përhapën prapë zërat e mëparshëm: a s'thamë ne se qëllimi final i gjithë kësaj batërdie s'qe veçse zhdukja e tij?

Po të ishte kështu, kundërshtonin të tjerët. tani, që qëllimi u arrit, përse nuk pushon fushata?

Pikërisht që të mos zbulojë arsyen e vërtetë përse u bë. Veç kësaj, makina e tmerrit, ashtu siç do kohë, të vihet në lëvizje, gjersa të marrë shpejtësinë e plotë, po ashtu kërkon kohë sa të ngadalësojë lëvizjen, gjer në pushim.

Siç ndodh pas çdo rrënimi, donte vërtet njëfarë kohe sa të ulej pluhuri i ngritur prej zhvendosjeve, goditjeve dhe trazimit të përgjithshëm. Një valë spastrimesh, që të gjithë e ndienin se ishte e fundit, kishte përfshirë gjithë shtetin. Njerëzit s'mendonin veçse si të shpëtonin nga kjo valë, e cila, ngaqë ishte e fundit, ngjante edhe më e hidhura.

X

Rrinin shtrirë të dy të përçafuar. ajo e zhveshur krejtësisht, ai përgjysmë. Ia kishte thënë të vërtetën vetëm përpara pak çastesh dhe ajo as nuk kishte klithur, as kishte qarë, thaujse e priste. E bardhë si mermeri kishte dëgjuar fjalët e tij dhe vetëm pasi kishte ngjitur fytyrën pas fytyrës së tij, ai kishte ndier lotët e saj t'i lagnin mollëzat. Kështu do të rridhte ndoshta lëngu i acidit poshtë mollëzave. pasi t'i kishte gërryer sytë, mendoi.

Në qoftë se nuk i miratohej kërkesa që verbimi i tij i mundshëm të kryhet me mënyrën mesjetare evropiane,

(nuk kishte guxuar të kërkonte menyrën romako-kartagjenase, me diell, nga druajtja se mos ia merrnin për mungesë modestie), pra në qoftë se nuk miratohej verbimi me terr, do të përfundonte ndoshta tek acidi. Ka edhe më keq, i kishte thënë një shok i zyrës, mendo bizantinën, për të mos përmendur tibetianën, më të llahtarshmen e të gjithave.

— Domethënë që ditën që më the se do të merrje lejen, ti i dije? — pyeti ajo.

— Po. Pikërisht atë ditë më kishin njoftuar shkarkimin nga detyra.

— Ah, — ia bëri ajo. — Po si e mbajte, si nuk e the?

— S'doja të të brengosja para kohe. Kisha ende një shpresë të vogël, përderisa më kishin thënë se duhej të prisja pa lëvizur nga kryeqyteti, gjësa të shqyrtonej denoncimi i mbërritur kundër meje. Po shpresëza erdhi duke u fikur dalëngadalë... Denoncimi, siç duket, u besua.

— Po përse? Përse? — gati sa s'klithi ajo.

Vështronte sytë e tij me atë njetë të imët bojëhiri. të kërkonte në të pretekstin që mund të kishte shërbyer si fillim i procesit.

— Ti pyet përse, — tha ai, duke shkaktuar në fytyrë një nënqeshje të hidhur. — Nuk po e fut veten ndër sytë e ndritur, ata, që shohin më qartë dhe më larg, në të ardhmen dhe që janë të padëshirueshëm për çdo pushtet tiranik.

O zot, mendoj ajo. Babai i saj një mbrëmje kishte thënë pothuajse të njëjtat fjalë.

— Pra, nuk e fut veten në radhën e mendjeve të tilla të ndritura, — vazhdoi ai. — Megjithatë ka një arsye që sytë tanë duhet të zhbëhen: zhdukja e gjurmëve.

— Si? Nuk të kuptova, — tha ajo.

— Është e thjeshtë, — u përgjigj ai. — Ne jemi dëshmitarë të shumë gjërave që duhet të harrohen.

— Kush ju? — pyeti ajo.

— Ne, që gjer dje kemi shërbyer në komisionet e ver-

bimit. Sytë tanë kanë parë shumë gjëra që s'duhet t'i shihnin. më kupton?

— Gjëra që s'duhet t'i shihnit, — përsëriti ajo me zë fare të ulët. — Ishin të tmerrshme?

— Pa dyshim. Ne ishim fare pranë mekanizmit. Rrotëzat dhe rripat e tij gati sa s'na preknin.

— I shkreti ti, — psherëtiu ajo dhe ai ndjeu prapë lotët e saj në mollëza. po mendimi i acidit e përshkoi jo aq thershëm, thua se lëkura e tij qe bërë më pak e ndjeshme.

— Nganjëherë listat vinin të gatshme drejt e nga lart, — vazhdoi ai. — Procedura fillonte pastaj.

— Ç'tmerr, — tha ajo. — Domethënë gjithë ato peshpërима për larje llogarish s'ishin të kota.

Ai tundi kokën për të thënë «po».

Vajza u shtrëngua e gjithë pas tij.

— Po të tjerët? — tha pas pak. — Mos vallë të gjithë që kanë punuar atje do ta pësojnë këtë?

— Sigurisht që jo. Do ta pësojnë në radhë të parë ata që dyshohet se mund të flasin.

— Se mund të flasin, — përsëriti ajo. — Aherë ç'hyjnë këtu sytë? Në radhë të parë është goja që...

— Goja gjithashtu mund të pritet, — e ndërpreu ai.

— Nëse s'mjaftojnë sytë për të vënë mend, — shtoi pas një grime.

— O perëndi, — ia bëri vajza.

— Veç kësaj, edhe sikur dyshimi të mos binte mbi askënd, një pjesë prej nesh do të flijoheshin.

Vajza e vështronte me atë vuajtje në sy që shkakton moskuptimi i fjalëve të tjetrit.

— Kjo është ndoshta dhe një nga arsyt kryesore, — vazhdoi ai. — Dënohemi ne, që një pjesë e hidhërimit të asaj që ndodhi të shkarkohet mbi re. Më kupton ç'dua të them? Secilit do t'i pëlqejë që rastin e fatkeqësisë së tij ta hedhë mbi gjoja gabimet tona.

Njëfarë kohe, në heshtjen që u bë, secilit i dukej se dëgjonte frymëmarrjen e tjetrit.

— Qysh se u pëshpërit për herë të parë për gabime të bëra nga komisionet, diçka më thei në shpirt, por u përpoqa ta harroja, — tha ajo.

— Kurse shoku im i zyrës, pas pëshpërimës së parë tha: ra dhe këmbana jonë.

Përsëri qëndruan ca kohë pa folur. Ndireshin vetëm lëvizjet e trupave të tyre për të gjetur një qëndrim përqa-fimi të ri.

— Prandaj më pyete një ditë për Qyprillinjtë? — tha ajo. — Apo ishte rastësi?

— Jo, nuk ishte rastësi. Pothuajse e dija përgjigjen tëndë. E dija gjithashtu se Qyprillinjtë kishin telashet e tyre. Megjithatë, si i thonë fjalës, i mbyturi kapet pas flokëve të vet.

— Kurse tani e kuptoj përse atë ditë që të përmenda dashurinë në errësirë, ti përsërite si në kllapi: «në mesnatë... në terr...»

— Po. Qysh aherë e ndieja veten si të asaj bote.

Ajo e përkëdheli gjatë.

— Ti do të jesh përherë këndej, midis dritës, përderisa unë jam këtu.

Rrjeta e syve të tij ishte tejet e pikëlluar.

— Mendon se s'ka asnjë shpresë? — Pyeti vajza — Se nuk mund të bëhet asnjë ndërhyrje?

Ai tundi kokën për të thënë se ashtu mendonte.

— Po ku shqyrtohet e gjithë kjo? Ku merret vendimi, për shembull për rastin tënd?

— Ndoshta askund, — u përgjigj ai. — Vendimi është dhënë ndoshta qysh në ditën e parë, qysh në minutën kur u tha se kundër meje ka mbërritur një denoncim.

— Ah, po... Zhdukja e gjurmëve.

Ajo u pendua për pyetjet e kota dhe e përkëdheli prapë. Ai iu përgjigj ngathtësisht ledhatimit të saj. Vetëm sytë

i kishte të gjallë, të lëbyruar, si nga një dritë e sëmurë. E ngulte shikimin i etur mbi gjinjtë e saj, te njollat mavi sipër kofshëve dhe te rrëza e barkut, pastaj më poshtë, midis këmbëve, që ajo i hapte pak që ai të mund të shihte më mirë te buzët e seksit të saj.

Vështron ashtu që t'i mbajë mend të gjitha, mendoi ajo.

— Do të jetoj me kujtimin tënd, — tha ai, si ta kishte kuptuar mendimin e saj.

— Unë do të të pres, — tha vajza me zë të ligështuar. — Më kupton, se do të të pres sa të dalësh që andej... Do të jetoj vetëm për ty, më kupton. E ndiej që do të vdes po nuk më mbajte ti në kujtesë kështu siç jam tani... Do të zbehem si hije, më kupton?... Unë s'do të kem më as jetën, as pamjen time... Do të jem vetëm ajo që më mban mend ti... Dhe dije, në qoftë se ti do të më shuash nga kujtesa, unë do të shuhem vërtet pas kësaj, si ajo skica që fshihet me gomë...

Ai nuk u përgjigj, vetëm i përkëdheli ngadalshëm gjithë ato pjesë të trupit që ia kishte vështruar me ngulm pak çaste më parë. Ajo vuri re se, ndërsa dora e tij e prekte, sytë i mbante të mbyllur. Po bën provë si do të më përkëdhelë në terr, mendoi.

Asaj i erdhi të dëneste, të klithte gjer në kupë të qiellit, dhe kjo jo vetëm për gjëmën që kishte përpara, por më shumë për diçka tjetër që as vetë s'donte ta pranonte, por që turbulli i vinte nga thellësia e ndërgjegjes: frika se nuk do ta mbante premtimin që po i bënte.

— Të verbohem edhe unë bashkë me ty, — tha si në ethe. — Një mëngjes të kthjellët, te veranda, është shumë e lehtë... Kështu të jemi të dy në të njëjtën pjesë të botës... Atëherë edhe po të dua s'të iki më dot...

Fjalët e fundit i mbyti dënesa dhe ai s'dëgjoi asgjë.

— Marrëzira, — tha ngadalë, — Pak më parë fole shumë bukur. Përse thua marrëzira tani?

U përkëdhelën përsëri pa folur, gjersa ai tha:

— Ne mund të jemi bashkë si dita me natën. Unë do të jem nata jote dhe ti dita ime. Apo jo?

Dënosa nuk e la vajzën të përgjigjej. një dënosa e mbytur, e ndërprerë nga gulsh shqyese, të atilla, që shkakton qarja e diçkaje pa kthim.

XI

Nuk ishte e vështirë të ndihej shuarja e fushatës. Kasnecët s'dolën rrugëve për të lajmëruar rikthimin e gjenajes së mëparshme, megjithatë të gjithë e kuptuan se rrebeshi kishte kaluar. Kishte ende goditje të rralla aty-këtu, si bubullima të fundit, por ato ishin si të largëta e pa fuqi.

Ditët e sprapsme të vjeshtës po merrnin pamjen e ditëve normale përpara «Qorrfermanit». Qenë mbyllur njëra pas tjetrës zyrat e verbimit, sikur të mos kishin qenë kurrë, kafenetë po mbusheshin prapë me njerëz në fytyrat e të cilëve dukej gëzimi që i kishin shpëtuar goditjes së verbër. Fjalë të tilla të tmerrshme si «sykëqoja», «qorrofic», «tibetiana», të cilat pak kohë më parë, pasi qenë shfaqur në horizont, dukej se do të shoqëronin përjetë ditët e jetës, po harroheshin me shpejtësi.

Njollat në ijët e bardha të Maries po zhdukeshin gjithashtu dalëngadalë. Kështu zbehej ndoshta pamja e saj në trurin e tij, mendonte ajo.

Ç'bënte vallë i lidhur këmbë e duar, atje në bodrumet e errëta? Kështu rrëfenin, që të mos mundnin t'i hiqnin fashat nga sytë, i lidhnin njëloj si të dënuarit me vdekje.

Një i afërm i tyre i kishte treguar se ç'ndodhte në ato bodrume.

Të shtrirë përgjysmë, rresht, njëri pas tjetrit, i kalonin orët dhe ditët. Një pjesë luteshin pa pushim, të tjerë qa-

nin, disa në heshtje, disa me zë. Të tjerë akoma flisnin me vete me orë të tëra. Kishte nga ata që revoltoheshin, klithnin si të çmendur, shanin dekretin e zi, gjersa më në fund qetësoheshin prapë, kërkonin falje, mëshirë, lutnin allahun që t'i shtonte ditët sulltanit perandor. Një pjesë tjetër, të rënë në përdezje fetare, prisnin ditën e verbimit, për t'u çliruar, siç thoshin ata vetë, nga pamjet e një bote të rreme.

Kishte të tjerë që binin në delir dhe ashtu të dehur mbanin fjalime me orë të tëra. Thoshin se bota u dukej më e bukur tani që nuk e shihnin dhe se në vend që të kishin errësirë, kishin përkundrazi më shumë dritë në kokat e tyre. Tani e kuptuam, thoshin, se sytë nuk futnin dritë në kafkën e njeriut, përkundrazi, e zbraznin pikë pas pike dritën, si rubineti i prishur, duke e varfëruar trurin.

Kështu flisnin ata, po shumica rrinin të heshtur, si memecët. veç herë pas here bënë ca si lëvizje pa kuptim me duar, sikur të hiqnin një cergë merimange përpara ballit të lidhur.

Ç'bënte vallë ai? Kishte mundur ta ruante të paprishur në kujtesë pamjen e saj, apo ajo kishte nisur t'i shpërbëhej ndërkaq?

Padashur Maria vinte duart sipër mollëzave, në anët e buzëve, sikur prishja të kalonte nga përfytyrimi i tij te mishi i saj. Vështronte pastaj trupin, vendet ku kishin qenë njollat mavi dhe që tani ishin zhdukur dhe mendime të trishtueshme për përkohshmërinë e gjithçkaje në botë e kapullonin.

I kishte thënë se do ta priste, por e dinte se nuk ishte tamam ashtu. Do ta priste vërtet në mendimet e saj, s'do ta harronte kurrë, por kjo që tjetër gjë. Qysh të dielën e parë, kur ai mungoi dhe në tryezë ra heshtja mortore, ngaqë të gjithë e kuptuan se ai ndodhej atje prej nga s'ktheheshe më ashtu siç shkove, ajo gjithashtu e kuptoi se midis tyre çdo gjë kishte marrë fund.

I vetmi dhe i fundit lajm prej tij ishte se kërkesa që kishte bërë për të verbuar me mënyrën evropiane ishte miratuar.

Është e kotë ta mendosh më, i kishte thënë i ati. Je tepër e re për ta ngrysur jetën me një të verbër. Dhe veç kësaj ti e kupton se s'është një i verbuar prej sëmundjes apo zotit, po prej shtetit...

Ajo s'kishte thënë asgjë, ishte ngjitur në dhomën e saj dhe atje kishte qarë pa zë ndarjen me të.

Ndiente një lehtësi në shpirt që i ishte dhënë e gjitha. Më tepër s'kishte mundur dot të bënte për të.

Po afronte dimri me netët e gjata e të mërzitshme dhe ajo e ndiente se këtej e tutje ai do të ishte vërtet nata e saj, gjumi i shprishur, vrasja e përhershme e ndërgjegjes. Nganjëherë i dukej se një ndjesi e tillë faji notonte përreth dhe jashtë saj, në erërat e para të dimrit, në dridhjen e xhamave dhe në gjithë zhaurimën e jetës.

XII

Në mes të dimrit të verbrit mbushën papritur rrugët dhe kafenetë. Njerëzit ndalonin në trotuar për të ndjekur me sy me njëfarë habie ecjen e tyre të hallakatur. Megjithëse muaj të tërë kishin jetuar me ankthin e «Qorrfermanit», tani që po shihnin frytet e tij, shtangeshin në vend të ngurosur.

Njëfarë kohe që dukur se viktimat e dekretit i kishte përfshirë nata dhe harrimi dhe se njerëzit nuk do të ndeshnin rrugëve e udhëkryqeve veçse të verbrit e vjetër, me pamjen dhe trokëllimat paqësore të shkopinjve të të cilëve u qenë mësuar sytë dhe veshët. Mirëpo ja, bashkë me ngricat e para të dimrit ishin shfaqur papritur të zymtë e të panumërt të verbrit e rinj.

Kishin diçka të veten që i dallon nga të verbrit tradicionalë, një zhvendosje këmbësh shqetësuese, dhe akoma më kërcënuese ishte goditja e shkopit të tyre mbi kalldrëm.

S'janë mësuar ende, thoshin disa. Verbimi u erdhi papritur, jo shkallë-shkallë, siç vjen zakonisht, kështu që nuk i kanë mësuar ende shprehitë e raja. Por ata që dëgjonin tundnin kokat me mosbesim. Të ishte vetëm kjo?

Ajo që i tronditi më shumë të gjithë ishte vërshimi i tyre i njëkohshëm. Nuk ishte pa dyshim një rastësi, por asnjë marrëveshje e fshehtë midis tyre, siç deshën të përhapnin zëra ata që në çdo gjë shihnin veç komplete kundërshtetit. Ishte thjesht koha e nevojshme që iu desh shumicës së tyre ta merrnin veten, disave nga plagët e shkaktuara gjatë heqjes së syve, të tjerëve prej traumës psikike.

Një pjesë, sidomos midis atyre që ishin çsyzuar me mënyrën aristokratike diellore, hynin dhe zinin vend në kafene apo çajhane me pamje të rëndë e dinjitoze. Po për këtë, përveç shpërblimit dhe pensionit të mirë, i ndihmonte, pa dyshim, edhe mosprishja e syve gjatë procesit të verbimit. Kurse shumica e kishin lëshuar veten. Visheshin keq, me rroba të vjetra dhe në vend të këpucëve mbanin nallane druri që e bënë veçanërisht të pikëllueshme pamjen e tyre.

S'ishin vetëm të verbuarit me dhunë që mbaheshin keq. Kishte të rreckosur edhe midis atyre që kishin shkuar në qorrific me bujë e me nderime, ashtu siç kishte midis të verbuarve dhunshëm disa që visheshin mirë, madje më mirë se më parë, duke u shfaqur krenarisht në çdo vend publik, sikur të donin të sfidonin gjithkënd me gropat e zeza.

Kaq shumë hutoheshin disa nga këto gropat, sa që u merreshin këmbët, thua se gropat u hapeshin befaz nën këmbët e tyre.

Q'kërkoni që vërtiteshin kështu? thoshin me njëri-tjetër.

trin. Përse nuk i hiqnin nga rrugët që të mos u prishnin gjakun njerëzve me ato zgavra boshe?

Por askush nuk ua vinte veshin zërave të tillë. Nëpër çajhanet dhe kafenetë, të verbrit jo vetëm që shtroreshin me orë të tëra, por dëgjonin lajmet e gazetave të lexuara në tryezën fqinje dhe flisnin me njëri-tjetrin: shyqyr punët e shtetit po shkonin mirë tani, kështu që së paku flijimi i syve tonë s'shkoj kot. Gjynah që nuk i shikojmë dot ato që po bëhen, vazhdonte ndonjëri prej tyre, por s'ka gjë. dhe në s'i shohim i marrim me mend dhe gëzohemi njëllor si ju.

Disa nuk flisnin fare, po rrinin të vrenjtur si korbi, kurse të tjerë, pas traditës së verbërisë, kishin gjetur nga një vegël muzikore për të shoqëruar me të vjersha heroike apo dashurie, që i sajnin vetë.

Vërshimi i të verbërve sa vinte shtohet dhe së bashku me të edhe zërat kundër tyre. U pëshpërit për një dekret që do t'i mblidhte shumicën e tyre diku në thellësi të vendit, (pak humbëtira kishte perandoria?), që së paku të mos i shihnin të huajt.

Shteti jo vetëm që nuk i dëgjoi këta zëra, por të premtën e fundit të dhjetorit, pikërisht atë ditë që me dekret të veçantë shpalli faljen e të gjithë atyre që qenë të verbuar me dhunë, shtroi një drekë mëshire, «sadaka», siç quhej në gjuhën e vendit, për të gjithë të prekurit prej «Qorrfermanit» pa përjashtim.

«Dreka e pajtimit», siç e quajtën më vonë me ironi gojët e liga, u shtrua në manezhin mbretëror të kuajve, e vetmja ndërtesë që mund të nxinte tryeza për mijëra të ftuar.

Të verbrit vërshuan nga të gjitha anët drejt manezhit me një trokëllimë të pafundme shkopinjsh e nallanesh dhe në një mënyrë të tillë kaotike, saqë xhandarët u detyruan ta ndërprinin qarkullimin në të gjithë zonën për një kohë të gjatë.

Megjithëse kishin dalë për t'i pritur e orientuar me

dhjetëra nëpunës, hyrja në sallën e madhe e sidomos zënia vend nëpër tryeza, u shndërrua në një rrëmuje e shtyrje të vërtetë. Një pjesë rrëzonin karriget, të tjerë s'dinin ku t'i vinin lahutat, që kushedi pse i kishin marrë me vete. Kurse shumica kërkonin me duar pjatën e gjellës, llangoseshin me të ose e derdhnin fare.

Thuhej se midis të verbërve, të veshur keq e me nallane si shumica e tyre, kishin parë tek po shtyhej për të zënë vend në njërin prej tryezave ish-vezirin e madh.

Në drekë, në një kënd të veçantë, merrnin pjesë zyrtarë të lartë nga oborri, qeveria dhe selia e Sheh — Ul — Islamit. Ishin ftuar gjithashtu gazetarë dhe diplomatë nga ambasadat e huaja.

Një nga zyrtarët nisi të mbante një fjalim, por, ngaqë shumica e të verbërve kishin filluar ndërkaq të hanin, pjesa më e madhe e fjalimit u mbulua nga zhurma shurdhuese e lugëve. Megjithatë frazat kryesore për domosdoshmërinë e flijimit për hir të interesit të përgjithshëm, e sidomos leximi i mesazhit të sovranit, i cili i ftonte të gjithë të harrojnë ç'kishte ndodhur e t'i mbeteshin besnikë shtetit, u morën vesh njëfarësoj.

Të gjallëruar nga ushqimi i shijshëm, sidomos pas hallvës me arra, megjithëse të zhyer me gjellë, shumë prej të verbërve nisën t'u binin lahutave.

Nga tryeza e tyre e veçantë zyrtarët, gazetarët dhe diplomatët e huaj heshturazi ndiqnin me sy gostinë.

— Çdo e keqe vjen edhe për të mirë, besoj se te ju gjithashtu gjendet një shprehje e tillë, — i tha konsulli gjerman kolegut të tij francez.

— Mais, oui, certainement, — iu përgjigj tjetri.

— Ky dekret, me atë emër të tmerrshëm e të papërkthyesëm, përveç kobeve që dihen tashmë, solli një ndihmesë në zhvillimin e poezisë orale, që, sipas vëzhgimeve të mia, kishte njëfarë rënieje kohët e fundit në këtë vend.

— Ah, ashtu? — ia bëri francezi duke e vështuar me

habi. Pastaj u kujtua se prej kohës, tjetri i kishte thënë se po merrej me hulumtime rreth poezisë orale vendase, ndaj më tepër se cinike, fjalët e tij iu dukën disi të çuditshme.

— Për t'u bindur mjafton t'i hidhni një sy kësaj salle,
— tha — tjetri.

— Ah, oui, — tha francezi, pa i hequr sytë nga mesi i sallës, atje ku zallahia e të verbërve kishte arritur kulmin.

tetor, 1984

P E R M B A J T J A

T R E G I M E :

Koha e dashurisë	5
Pasditja së cilës i shkonin fjalë të vjetra pleqsh	29
Ëndrra mashtruese	31
Prometeu (trilogji)	36
Nata e Sfinksit	44
Muri kinez	47
Përpara banjës	50
Nudo	53
Ur-libri	64
Baladë për vdekjen e J. G.	73
Lamtumira e së keqes	89
Kujtimet e humbura	118
Ditë kafenesh	133
Shënime nga kapiteneria e portit	163
Kalimet e nëndheshme	176
Në periferi, pranë aeroportit	184

N O V E L A

Ndërtimi i piramidës së Keopsit	193
Nata me hënë	245
Qorrfermani	316